

KISHA E FSHEHTË

PËRGATITJA ♦ MBJELLJA ♦ TË JETUARIT



Erik Folei
Riçard Vurmbrand

KISHA E FSHEHTË

PËRGATITJA ♦ MBJELLJA ♦ TË JETUARIT

Erik Folei

Riçard Vurmbrand

Originally published in English as three separate books:

Preparing for the Underground Church

Planting the Underground Church

Living in the Underground Church

by Eric Foley with Merv Knight

© 2017 by Eric Foley.

Published originally by Voice of the Martyrs, Korea

© 2025 for the Albanian edition

Përgatitja për kishën e fshehtë

Nga I Përndershmi **Erik Folei** (Eric Foley)

Përktheu nga anglishtja: Edlira Roberts

Redaktoi: Enkeleda Hebibasi

Citimet e Shkimit të Shenjtë në shqip janë përkthim i
vargjeve të zgjedhur nga autori i librit sipas versionit të
Biblës së përdorur nga ai në anglisht.

Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat e rezervuara

Nëse jeni të interesuar të mësoni më shumë rreth
dishepullimit të krishterë, përndjekjes së të krishterëve ose
nëse dëshironi ta përdorni materialin e këtij libri për kishën
ose shërbesën tuaj, ju lutemi kontaktoni:
<https://vomkorea.com/en/about/history/>.

PËRMBAJTJA

PJESA I: PËRGATITJA PËR KISHËN E FSHEHTË	7
Parathënie për “përgatitja për kishën e fshehtë”	8
HYRJE PËR PËRGATITJEN PËR KISHËN E FSHEHTË, VARIANTI KOREAN.	11
I. I vetmi revolucion i aftë për betejën vendimtare kundër krishterimit në botën e lirë.	12
II. Si quhet shtypëse thjesht vetëm ekzistenca e kishës.	16
III. Kisha është më e ngjashme me përndjekësit e saj sesa me zotin e saj	20
IV. Pendimi: përgatitja kryesore për kishën e fshehtë	25
V. Çfarë është kisha e fshehtë?	31
VI. Koha e përgatitjes mbërriti	36
VII. Lidhur me volumn 2 dhe 3 të serive të ardhshme	
PËRGATITUNI PËR KISHËN E FSHEHTË	45
Përgatituni për kishën e fshehtë-tani	46
Përgatitja për Vuajtjen	48
E vërteta për të Vërtetën	52
Ushtrimet Shpirtërore	54
Dyshimi prodhon tradhtarë.	57
Testi i torturës.	58

Çasti i krizës	61
Dashuria Supreme	64
Mësoni të Jeni të Heshtur	66
Dredhitë e lejueshme në luftë	69
Zënkat e pabesa	72
T'i bësh Rezistencë Trushpëlarjes	74
Mposhtja e Vetmisë.	78
Identiteti i Vërtetë	83
PJESA II: MBIJELLJA E KISHËS SË FSHEHTË	86
Hyrje.	87
Parimi I. Përfshirja ligjore e vendos kishën në skllavëri; Në vend të kësaj, jini të huaj dhe banorë të përkohshëm . . .	96
Parimi II. Mos ikni për të shpëtuar, mos rezitoni, e mos e strehoni përndjekjen; në vend të kësaj, jini i krishterë i plotë në mes të saj	109
Parimi III. Në vend që të kaloni në fshehtësi si kundërpërgjigje ndaj përndjekjes, kaloni në fshehtësi për ta mbajtur gjënë Kryesore, gjë kryesore	115
Parimi IV. Në vend që të siguronit ndërtesa, takohuni në vendet ku janë tashmë njerëzit.	122
Parimi V. Kisha është një shtëpi e shtëpive	127
Parimi VI. Bëjeni jetën e përditshme të shtëpisë, jo adhurimin e së dielës, fokusin e kishës	132
Parimi VII. Në vend të drejtuesve profesionalë, përdorni amatorët	137

Parimi VIII. Mos rekrutoni; në vend të kësaj porositini shtëpitë për ta ndjekur Krishtin	144
Parimi IX. Trajnojini anëtarët për të pasur njohuri të përgjithshme, jo për të qenë specialistë	148
Parimi X. Kujtoni kush jeni	153
Parimi XI. Jepni të dhjetën për të zbuluar karakterin e Perëndisë, jo për të mbështetur kishën	160
Parimi XII. Përhapeni ungjillin në fshehtësi përmes misioneve të varësisë	166
PJESA III: TË JETUARIT NË KISHËN E FSHEHTË	173
Hyrje.	174
Kapitulli 1. Përgatitja për ta marrë Biblën	180
Kapitulli 2. Shikimi i Kredos së Nikeas me sytë e një foshnje	196
Kapitulli 3. Konteksti	201
Kapitulli 4. Veprimet e Perëndisë	211
Kapitulli 5. Urdhërimet e Perëndisë	221
Kapitulli 6. Çfarë duhet të bëjmë?	237
Kapitulli 7. Karakteri i Perëndisë.	249
Përfundimi	256

PJESA I

PËRGATITJA PËR
KISHËN E FSHEHTË

PARATHËNIE PËR “PËRGATITJA PËR KISHËN E FSHEHTË”

*Nga **Merv Nait** (Merv Knight, Themeluesi
i Zëri i Martirëve, Australi)*

E takova për herë të parë Pastorin Riçard Vurmbrand (Richard Wurmbbrand) më 1 gusht 1969, në Aeroportin e Sidneit, kur ai mbërriti për takimet në Australi. Në atë kohë, nuk e dija se Perëndia po bashkonte dy zemra për të bashkëpunuar për 31 vitet e ardhshme. Ndërsa po e njihja më tepër, nuk kisha absolutisht asnjë dyshim se ky burrë kishte kaluar përmes përvojave të thella me Perëndinë, të sjella prej Tij, kur Perëndia në urtësinë e Tij e pajisi për të ardhur në Perëndim si zëri i Kishës së fshehtë. Jam shumë falënderues për vitet që pata mundësi të punoja krah për krah me të dhe të mësoja prej tij.

Pastori Vurmbrand erdhi nga Rumania në botën komuniste me një mesazh për Kishën që jetonte në liri. Ai tha: “Mesazhi që ju sjell nga Kisha e fshehtë është: ‘Mos na braktisni! Mos na harroni! Mos na hiqni nga lista! Na jepni mjetet për të cilat kemi nevojë! Do ta paguajmë çmimin për përdorimin e tyre!’ ... Ky është mesazhi që më është ngarkuar për ta përcjellë te Kisha në botën e lirë.”

Gjatë asaj vizite në Australi, Riçard Vurmbrandi iu shkroi fëmijëve të tij dhe pjesërisht iu tha: “Gjithashtu jam i shqetësuar për të gjithë punën tonë. Përgjigjja është e madhe për sa kohë që unë flas për t’i ndihmuar ata që vuajnë në vendet komuniste. Por nuk ka asnjë kujdes për botën e lirë. Kjo më solli ndër mend një

histori të Judenjve: një lypës lypte më kot derë më derë. Asnjëri nuk i dha as edhe një send. Ai shkau në dëborë dhe theu njërën këmbë. Pastaj e shpunë në spital. Që të gjithë u mbushën plot me keqardhje. Ata i sollën atij të gjitha llojet e gjërave të mira. Ai i shkroi së shoqes: ‘Falemnderit Perëndisë, kam thyer njërën këmbë.’ Njerëzit do të parapëlqenin më tepër të ndihmonin dikë që ka pësuar një dëm, sesa të bënin diçka për ta parandaluar dëmtimin. Për punë filantropike nga ana e martirëve – jemi dakord. Por për të parandaluar Azinë Juglindore që të mos bëhet komuniste – as mos e zini në gojë. Kjo është politikë.”

Me zemrën plot shqetësim, Riçard Vurmbrandi dëshmonte sesi Kisha në botën e lirë po zbriste teposhtë të njëjtit shteg, që ai e kishte parë të shkonte në atdheun e tij. Teksa po e përçonte mesazhin me besnikëri prej kishës së fshehtë dhe i nxiste të krishterët e lirë që “t’i kujtonin ata që janë në pranga” (Heb. 13:3), ai pa nevojën urgjente për ta përgatitur kishën që jetonte në liri për kohët e vështira që po vinin përpara dhe për rënien në vlerat e krishtera, gjë për të cilën ai ishte i sigurt se po vinte.

Pastori Vurmbrand e donte Kishën - Nusen e Krishtit. Ai duroi 14 vjet tortura të patregueshme, tmerri, poshtërimi dhe privimi në burgjet komuniste me mizori të patregueshme të Rumanisë, për shkak të dashurisë së tij të madhe për Krishtin dhe Kishën e Tij. Diktatura komuniste prapa Perdes së Hekurt e kishte detyruar Kishën e vërtetë të kalonte në ilegalitet, teksa po luftonte për mbijetesë dhe për të drejtën e predikimit të ungjillit që shpëton shpirtat.

Të pashpresë prej mungesës së dukshme të gatishmërisë nga ana e drejtuesve të kishës së lirë që ta pranonin plotësisht përndjekjen e të krishterëve në botën Komuniste, pastori Vurmbrand besoi se kishte nevojë urgjente që ta adresonte situatën. Që nga Australia, pastori udhëtoi për në Afrikën e Jugut, vend për të cilin i rëndonte thellë në zemër e ardhmja e mirëqenies së kishës. Njërin prej predikimeve të tij ai ia kushtoi të folurit për nevojën

Kisha e fshehtë

që ka kisha në botën e lirë për t'u përgatitur për ardhjen e kishës së fshehtë. Ai leksion u transkriptua, e u bë ky libër i vogël që po e mbani në duar.

Gjatë ditëve të tij me ne, pastor Vurmbrandi vajtonte për faktin se kur kishës në Rumani iu vërsul një regjim totalitar i paperëndishëm, ajo ishte krejtësisht e papërgatitur për një situatë të tillë. Ai përmend shkurtimisht në këtë libër të vogël dilemën e kishës teksa i duhej ta çante shtegun përpara në një territor të panjohur, atëherë kur të krishterët besnikë kërkonin mënyra e mjete për t'u takuar së bashku për miqësi, adhurim dhe për të dëshmuar.

Ashtu sikurse pastor Vurmbrandi ishte burri i duhur për atë kohë, kur u shty për në botën e lirë pas largimit nga Rumania, edhe ky libër është një mesazh për kohët, për të cilin ka nevojë urgjente kisha e sotme, teksa përgatitet për vështirësitë që po i vijnë. E inkurajoj gjithsecilin që e mban këtë volum të vogël në dorë t'i shqyrtojë seriozisht paralajmërimet e tij, sfidat e tij dhe këshillat e tij.

HYRJE PËR PËRGATITJEN PËR KISHËN E FSHEHTË, VARIANTI KOREAN

Nga I Përndershmi Dr. Erik Folei
Drejtor Ekzekutiv, Zëri i Martirëve, Korea

I. I vetmi revolucion i aftë për betejën vendimtare kundër krishterimit në botën e lirë

Përndjekja në mënyrë të pashmangshme e kap kishën në befasi. Pavarësisht nga paralajmërimet e Jezusit për ndjekësit e tij, sesi ata do të fyheshin vazhdimisht nga bota, kisha nuk pret se do të përndiqet. Ngaqë kisha kërkon t'u bëjë mirë edhe armiqve të saj, ajo gabimisht pret të marrë mbrapsht respekt prej botës. Ajo nuk e percepton vetveten si kërcënim ndaj askujt, me përjashtim ndaj atyre që kërkojnë adhurimin e saj, gjë që ajo e rezervon vetëm për Perëndinë.

Kjo është arsyeja se pse I Përndershmi Vurmbrand e dinte se po përballej me një sfidë të vështirë për t'i bindur të krishterët në botën e lirë se ata duhej të përgatiteshin që t'i kalonin kishat e tyre për të vepruar në fshehtësi. Të krishterët në botën e lirë thjesht nuk mund ta imagjinojnë dot se kanë një kundërshtar të motivuar dhe të aftë për t'i përndjekur të gjithë ata sistematikisht.

Të krishterët në botën e lirë kanë besim të madh në qeveritë e tyre. Edhe kur ata nuk bien dakord me drejtuesit e tyre politikë, kanë mirëbesim se ligji dhe kultura e vendit të tyre do t'i mbrojnë, që të mos humbin lirinë e besimit dhe lirinë e praktikimit të besimit të tyre. Ata kanë besim se gjykatat e vendit të tyre përgjithësisht do t'i mbrojnë liritë e tyre dhe do të sigurojnë shpagimin kundër sulmeve individuale.

Të krishterët në botën e lirë gjithashtu kanë besim të madh në fuqinë e kishave të tyre. Edhe në ato vende në botën e lirë ku kisha është minoritet, ajo zakonisht ka ndikim, është e pasur, e arsimuar dhe e lidhur mirë në arenën ndërkombëtare. Prandaj,

ndonëse Apostulli Pal paralajmëron se “gjithkush që kërkon të jetojë një jetë të perëndishme në Krishtin Jezus do të përndiqet,” të krishterët në botën e lirë tentojnë ta konsiderojnë veten si të përjashtuar prej përndjekjes, për shkak të gjeografisë së tyre.

Por edhe katër dekada më parë, kur I Përndershmi Vurmbrand e prezantoi për herë të parë *Përgatitja për kishën e fshehtë*, ai e dinte se kisha në botën e lirë një ditë do të binte vetë nën përndjekje serioze. Ai nuk e besonte se kjo do të ndodhte vetëm si rezultat i ndryshimeve në regjimin politik.

Përkundrazi, ai besonte se kjo do të ndodhte për shkak të gjërave që kishte arritur t’i kuptonte gjatë katërmbëdhjetë viteve të tij të burgimit në burgjet komuniste, si dhe për shkak të viteve të mëtejshme që kaloi duke punuar me të krishterët e përndjekur në vendet komuniste. I Përndershmi Vurmbrand arriti të kuptonte se kishte diçka të fshehur thellë brenda komunizmit — një principatë ose pushtet që nuk kishte të bënte fare me pushtetin politik, ekonomik ose ushtarak. Komunizmi ishte vetëm ena. Ajo që mbante ena brenda ishte rebelimi kundër Perëndisë.

I Përndershmi Vurmbrand shkroi për këtë burim pusi të fshehtë në librin e tij: *Marks i dhe Satani*. Ai dokumentoi sesi Karl Marksi “dikur ishte një i krishterë”, i cili, “e nisi jetën në një familje që i druhej Perëndisë.” Vurmbrandi detajoi sesi “një ndryshim drastik në një çast të jetës së tij e bëri Karl Marksin që të hidhej në një rebelim të thellë personal kundër Perëndisë dhe kundër të gjitha vlerave të krishtera.” Shumë kohë më përpara sesa të kishte ndonjë interes ndaj komunizmit, Marksi shkroi: “Unë dua të hakmerrem vetë kundër Atij që sundon atje lart.”¹

Kjo është arsyeja pse I Përndershmi Vurmbrand nuk përqendrohej tek mposhtja e komunizmit si një sistem politik.

¹ Riçard Vurmbrand, 1986. *Marks i dhe Satani*. Bartlesville, OK: Kompania e Librit Flijimi i Gjallë (Living Sacrifice Book Company), kapaku i mbrapmë.

Ai përqendrohej tek ekspozimi i tij si një fuqi satanike prej së cilës njerëzit duhej që të liroheshin shpirtërisht. Komunistët nuk ishin armiku; Satani ishte. Për Satanin, ekonomia ose politika nuk janë kurrë çështje të rëndësishme. Ato janë vetëm preteksti.

Çështja e rëndësishme gjithmonë është shkatërrimi i autoritetit, meqenëse i gjithë autoriteti, edhe ai i shtrembëruar dhe i keqpërdorur, duhet të vijë prej Perëndisë. Satani e përdori komunizmin për të krijuar kaos në mjedisin e autoritetit ekonomik e politik, me thirrjen e tij ndaj punëtorëve që “ta hidhnin poshtë” zgjedhën e shtypësve të tyre kapitalistë.

Por, teksa i Përndershmi Vurmbrand udhëtonte për të folur anembanë nëpër botën e lirë, ai mund ta shihte se Satani nuk ishte i kënaqur vetëm për të zhvilluar beteja ekonomike ose politike, dhe se ai patjetër që nuk ishte i kufizuar përbrenda Perdes së Hekurt. Tek *Marksii dhe Satani* ai shkroi:

I tmerruar lexova misterin e gradës së shtatë të satanizmit, të mbishkruar në një poster në Universitetin e Parisit gjatë trazirave të vitit 1968. Ai ishte thjeshtuar me formulën: “Është e kundërligjshme të ndalohej.”²

Është e kundërligjshme të ndalohej. Satani kishte krijuar shumë kaos përmes komunizmit. Por ajo gjë që nisën të dallonin I Përndershmi Vurmbrand dhe mendimtarët e tjerë të krishterë ishte se strategjia e Satanit zor se ishte e kufizuar vetëm në sferën politike ose ekonomike. Përfundimisht, strategjia e Satanit do të aktualizohej edhe më plotësisht në sferën e *identitetit personal*, gjë që do të arrinte të nxiste politikat dhe ekonomitë e botës së lirë në mënyra që vetëm pak veta i kishin parashikuar ose mund t'i kishin imagjinuar. Do të ishte përmes asaj sfere, të mbështetur jo vetëm nga politika dhe ekonomia, por edhe nga shkenca, arsimi, argëtimi dhe madje edhe spiritualizmi, se thënia

² Riçard Vurmbrand, 1986, fq. 107.

Parathënie për “përgatitja për kishën e fshehtë”

“është e kundërligjshme të ndalohet” do të brohoritej si etika e ndritur e botës së lirë.

Do të ishte përmes asaj sfere, e cila zakonisht quhet “revolucioni seksual,” që Satani do të kërkonte të jepte goditjen e tij përfundimtare kundër kishës, duke e tallur atë si ndaluesen më të madhe në histori.

II. Si quhet shtypëse thjesht vetëm ekzistenca e kishës

Madje edhe në mes të përleshjeve të sotme që po dalin mes Krishterimit dhe revolucionit seksual, është ende e vështirë për shumë të krishterë në botën e lirë ta kuptojnë se kishat tona mund të kalojnë në fshehtësi thjesht sepse pikëpamjet tona mbi seksin ndryshojnë nga ato të shoqërisë së gjerë. Megjithatë, para jo më larg se 80 vitesh, shumë armiq të kishës që të gjithë po nxirrnin këtë përfundim: vetëm seksi, jo socializmi, do të mund ta shkatërronin krishterimin. Ashtu siç shkruan Surrealistët francezë në manifeston e tyre: “Beteja përfundimtare kundër krishterimit mund të kryhet vetëm në nivelin e revolucionit seksual.”³

Po pse është revolucioni seksual ai që është i aftë të japë një betejë vendimtare kundër kishës në botën e lirë? Është ngaqë ndryshimet mes etikave seksuale shkojnë shumë më thellë sesa pyetjet për ekonominë ose politikën. Ato shkojnë në thelbin e të kuptuarit tonë për Perëndinë dhe qeniet njerëzore. Krishterimi nuk ka nevojë për një sistem të posaçëm politik ose ekonomik, që të funksionojë. Por ai kërkon një të kuptuar të caktuar për seksin. Ashtu siç e thotë Xhon Risti (John Rist), historia njerëzore gjithmonë është në “konflikt mes një Perëndie monoteist dhe një race njerëzore që ka prirje ta dëshirojë autonominë e saj të plotë.”⁴ Seksi ose i

³ Mateo Hanlei (Matthew Hanley) 2016. “Modernizmi si një Kolaps Metafizik.” *Gjëja Katolike*. <https://www.thecatholicthing.org/2016/07/28/modernity-as-metaphysical-collapse/>. Theksimi tek origjinali.

⁴ Xhon M. Rist (John M. Rist,) 2014. *Agustini i Deformuar: Dashuria, Mëkati, dhe Liria në Traditën Morale Perëndimore*. (Augustine Deformed: Love, Sin, and Freedom in the Western Moral Tradition.) Cambridge: Cambridge University Press, p. 10.

shërben përulësisht dhe besnikërisht qëllimeve të Perëndisë, ose iu jep njerëzve autonominë më arrogante e më vdekjeprurëse.

Aleanca e seksit me shkencën dhe me ateizmin ishte deklarata e tij për pavarësinë. Gjatë periudhës së Iluminizmit, shkenca e ngushtoi sferën e saj të kërkimit deri në “faktet e verifikueshme në mënyrë empirike.”⁵ Shkenca nuk do ta konsideronte më çështjen *teleologjike* (domethënë, qëllimin përfundimtar) për të cilën Perëndia e kishte bërë diçka.

Në fakt, shkenca nuk do ta konsideronte më fare Perëndinë, ngaqë Perëndia nuk është një “fakt i verifikueshëm në mënyrë empirike.” Kjo gjë shkaktoi pa vonesë fillimin e filozofisë së shkencizmit e cila pohonte se jo vetëm që Perëndia nuk do të konsiderohej në shkencë, por se shkenca—që t’u ishte besnike parimeve të saj të zgjeruara—duhet të pohonte se “asgjë nuk ekziston përveç fakteve të thjeshta të verifikueshme, as edhe një gjë fare.”⁶

Kur seksi studiohet në këtë mënyrë, ashtu si u studiuua në mënyrën më të famshme së pari prej Markiz de Sade (Marquis de Sade) dhe më vonë prej Vilhelm Raih (Wilhelm Reich), atëherë seksi nuk mund të jetë *për* riprodhimin. Në fakt, sipas shkencizmit, seksi nuk mund të jetë *për* asnjë gjë. Kur shkenca e shqyrton seksin në këtë mënyrë, ashtu siç vëren me shqetësim Augusto del Noçe (Augusto del Noce), “gjithçka që mbetet është energji jetësore.”⁷ Cilido kufizim ndaj asaj energjie jetësore duhet të konsiderohet si “shtypës.”⁸ Ashtu siç vëren Stiven

⁵ Majkëll Kuk (Michael Cook), 2016. “Pse Ndodhi Revolucioni Seksual?” *Shqyrtim Intelktual*. <http://www.intellectualltakeout.org/blog/why-did-sexual-revolution-happen>.

⁶ Po aty.

⁷ Pjetër Leithart (Peter Leithart), 2015. “Seksi dhe Tradita.” *Gjërat e Para*. <https://www.firstthings.com/web-exclusives/2015/10/sex-and-tradition>.

⁸ Stiven Adubato, 2016. “Një tërheqje Revolucionare.” *Rishikim Pastoral i Predikimeve*. <http://www.hprweb.com/2016/06/a-revolutionary-attraction/>.

Adubato (Stephen Adubato), ai “zbulim” e hodhi kishën në mënyrë vendimtare në rolin e shtypësit:

Pikëpamja morale kryesisht “puritane” u akuzua se e kishte zvogëluar horizontin e lirisë dhe të përmbushjes së personit të njeriut... . Të mbështetur prej dëshmisë shkencore dhe psikologjike, që synonte të provonte se ndrydhja seksuale i shkaktonte dëmtim personit të njeriut, ata mbronin një shprehje “të lirë” të seksualitetit që mohonte çdo lloj nënkuptimi moral: “Seksualiteti është një përvojë e kënaqshme dhe asnjë gjë më tepër se kaq ... Puna terapeutike konsistonte në ndryshimin e karakterit neurotik në një karakter gjenital, dhe në zëvendësimin e rregullit moral me vetë-rregullimin.” Revolucioni Seksual po përgatitej për të sjellë një epokë të re të utopisë.⁹

Pikërisht ashtu si revolucioni komunist iu bënte thirrje punëtorëve të bashkoheshin në “luftën kundër shtypjes” në duart e shtypësve të tyre kapitalistë, tani revolucioni seksual iu bën thirrje njerëzve të bashkohen në “luftën kundër shtypjes në duart e shtypësve të tyre seksualë, kishës.¹⁰ Pjetër Leithart thotë se britma luftarake e revolucionit seksual është: “Çdo kufi mbi shtysat tona është një sulm ndaj dinjitetit tonë. Frenimet seksuale janë të panatyrshme, secili frenim është një kërcënim ndaj lirisë së njeriut”:

Revolucionarët seksualë në këtë mënyrë e kthejnë përmbys moralitetin seksual. Ideat e mëparshme të tilla si modestia, pastërtia dhe vetëpërmbajtja tani shihen si shtypëse dhe jonormale. Kategoria e “persionit seksual” duhej eliminuar. Prapa kësaj është anti-teleologjia

⁹ Adubato, 2016.

¹⁰ Majkëll Kuk (Michael Cook), 2016.

e metafizikës së re seksuale: Seksi e shpreh më mirë thelbin e tij kur nuk ka asnjë qëllim (dmth. riprodhimin) përtej vetes, dhe për këtë arsye “shprehjet homoseksuale ose mashkullore, ose femërore duhen konsideruar si forma më e pastër e dashurisë.”¹¹

Kur seksit i hiqet cilido qëllim (ose siç do të debatonte shkencizmi, kur lirohet prej çdo qëllimi), atëherë aspektet e tij fizike dhe emocionale—të cilat historikisht kanë qenë “vetëm një pjesëz e vogël e asaj që ne përjetojmë në të vërtetë si qeniet dhe kuptimet tona seksuale”¹²—bëhen përjetimi ynë i seksit në total. Dhe meqenëse seksi është “energji vitale” në qendër të personit, përjetimet fizike dhe emocionale të seksualitetit bëhen vendndodhja e identitetit personal. Në një akt lirimi prej shtypjes seksuale të kishës, revolucionari seksual nxitet që të “vetë-identifikohet” me karakteristikat fizike dhe emocionale që ata i përjetojnë më fort ose me të cilat tërhiqen më fort. Trupi bëhet “plastelina modeluese,” “lënda e parë në shërbim të vullneteve tona.”¹³

¹¹ Pjetër Leithart, 2015. “Seksi dhe Tradita.” *Gjërat e para*. <https://www.firstthings.com/web-exclusives/2015/10/sex-and-tradition>.

¹² “Është renditja e të gjithë jetëgjatësisë sonë, që në fakt e përcakton siç duhet seksualitetin tonë në kuptimin e ‘themelimit të tij’ dhe që siguron kufizimet dhe kanalet për miratimin e seksualitetit.” Efraim Radner (Ephraim Radner). 2016. *Një Kohë për të Mbajtur: Teologjia, Vdekshmëria, dhe Forma e një Jete Njerëzore*. Waco, TX: Baylor University Press, Loc. 979.

¹³ Çarlz J. Çepat (Charles J. Chaput), O.F.M. Cap., 2016. “Adresa tek Brigham Young University: Zgjimët: Të jetuarit si Besimtar në Kombin që Kemi Tani.” *Arkdioqeza e Filadelfias*. http://archphila.org/address-at-brigham-young-university-awakenings-living-as-a-believer-in-the-nation-we-have-now-2/#_ednref4.

III. Kisha është më e ngjashme me përndjekësit e saj sesa me zotin e saj

Ky është kuptimi dhe shprehja e seksualitetit, të cilin të krishterët me të drejtë e identifikojnë si mëkat. Ata e lidhin më shpesh atë me homoseksualitetin dhe transgjjinorizmin. Por në fakt ideja e trupit si një plastelinë modeluese që formësohet prej nesh sipas vullneteve dhe tërheqjeve tona është njëra nga ato me të cilat përfshihen shumë të krishterë përditë pa protestuar. Ashtu siç na kujton Apostulli Pal tek Romakëve 2:3-4, Perëndia na bën që ta njohim mëkatën së pari, jo që të mund ta gjykojmë atë, por përkundrazi që të mund ta njohim *po atë rrënjë që punon ndër ne* dhe të pendohemi me zell për të, me sigurinë e plotë të vetëpërmbajtjes dhe durimit të Perëndisë.

Si të krishterë, ne duhet të bëhemi të vetëdijshëm lidhur me faktin se si i trajtojmë ne vetë trupat tanë si blloqe prej plasteline. Kjo është sidomos e vërtetë për ne në Kore, ku kirurgjia plastike—mishërimi i trajtimit të trupit si një bllok argjile që do të formësohet sipas dëshirës sonë për të qenë të dëshirueshëm—është kaq i zakonshëm, saqë iu jepet si dhuratë diplomimi vajzave gjimnaziste.

Por, ka forma tepër më shumë prozaike sesa vetë-dizenjimi, që vijnë prej së njëjtës rrënjë, madje duke shkuar në rrënjët e vetë flokëve tanë. “Flokët e thinjur janë një kurorë lavdie.” na mësohet tek Fjalët e Urta 16:31; ajo gjendet në rrugën e drejtësisë.” Ne jemi thirrur ta vëmë moshën tonë si një *kurorë* mbi krye—kurorën e martirit që dëshmon për një jetë të përqendruar te Krishti, që në fakt jepet për të tjerët—por ne e fshehim

moshën tonë duke u përpjekur të portretizojmë energji jetike. Por Bibla nuk na thërret për ta mrekulluar e për ta tërhequr botën me energjinë jetike në dispozicion të të krishterëve.

Përkundrazi, ajo na thërret që ta pranojmë me maturi në trupat tanë realitetin e vdekjes, jo si diçka prej së cilës të kemi frikë ose diçka që ta shmangim, ose mohojmë, por si diçka që duhet kujtuar, dhe për të cilën të meditojmë përditë, me qëllim që fokusi ynë të mbetet në krijimin e ri, jo në këtë të tashmin. Ashtu siç thotë Apostulli Pal: “Ne që jemi gjallë, gjithmonë dorëzohemi në vdekje për shkak të Jezusit, që jeta e tij të mund të shfaqet në trupat tanë të vdekshëm.”¹⁴ Me fjalë të tjera, trupat tanë të krishterë, nuk janë synuar për të shërbyer si reklama të përjetshme mashtruese për forcën jetësore të kësaj bote. Përkundrazi, pamja jonë e jashtme është projektuar për të shpalosur haptas se që të gjitha qeniet njerëzore janë krijesa të vdekshme, mirëbesimi i të cilëve nuk është në forcën jetësore të kësaj bote, por në forcën jetësore të botës që do të vijë.

Në fakt, Bibla është shumë më tepër e drejtpërdrejtë në paralajmërimet e saj kundër shfaqjes së kësaj force jetësore të botës — për shembull, përmes flokëve të gërshetuar, arit, perlave dhe rrobave të shtrenjta¹⁵ — sesa është lidhur me martesat brenda së njëjtës gjini. Kurse ne nuk i kushtojmë pothuajse fare vëmendje këtyre udhëzimeve, ndonëse përmes ndjekjes së këtyre udhëzimeve ne mësojmë të jemi besnikë ndaj gjërave më të mëdha lidhur me trupin.

Kështu, ne nuk ia dalim dot mbanë të shohim sesi këto dëshira vijnë nga e njëjta rrënjë si edhe shprehjet seksuale,

¹⁴ 2 Korintasve 4:11.

¹⁵ “Gjithashtu dua që gratë të vishen me modesti, në mënyrë të hijshme dhe korrekte, jo me ar ose perla ose duke mbajtur flokë të gërshetuar, apo duke u veshur me rroba të shtrenjta, por me vepra të mira, siç u ka hije grave që shpallin se adhurojnë Perëndinë.” — 1 Timoteut 2:9-10.

të cilat na shqetësojnë shumë më tepër. Ati i madh i kishës së hershme koreane, Kim Kjo Shin (Kim Kyo Shin), sapo zbuloi shishen e së bijës me krem të importuar për zbutjen e lëkurës, ia përplasi atë tek një gur, si një kujtesë jetike për rëndësinë që të krishterët duhet të kërkojnë të zbukurohen me vepra të mira e jo me grim. Ai e sfidoi të bijën: “Meqenëse guri është mbuluar me krem, a e sheh dot pamjen natyrale të gurit?”¹⁶ Është e vështirë të përfytyrohet se Kim Kjo Shin nuk do të gjente shumë gjëra të tilla në jetët tona për t'i përplasur me gurët sot.

Madje edhe të kuptuarit tonë bashkëkohor për martesat e krishtera e merr ushqimin nga e njëjta rrënjë si martesat mes së njëjtës gjini, bazuar mbi shoqërinë shpirtërore, përmbushjen e përbashkët dhe dashurinë romantike. Por ashtu siç vëren Stiven Adubato, nuk është romanca në martesë që pasqyron marrëdhënien mes Krishtit dhe kishës, por përkundrazi është martirizimi:

[Kjo është ajo që] burri e gruaja janë thirrur të bëjnë në martesën e tyre: përfundimisht të vdesin ndaj vetes dhe të bashkohen me Krishin përmes bashkëshortes ose bashkëshortit të tyre. Në këtë kuptim ata po përsërisin veprimin heroik të martirëve, që realisht vdiqën për shkak të bashkimit me Krishtin dhe lavdërimit të Tij. Prandaj, ndoshta në një mënyrë më pak dramatike, burri e gruaja që janë të martuar, po dëshmojnë faktin se vlera dhe kuptimi i martesës së tyre dhe i jetës njerëzore në tërësi, i përket Diçkaje tjetër nga vetja e tyre.¹⁷

¹⁶ *Kujtimet e Kim Kjo-Shin* http://www.biblekorea.net/articles/Recollection_of_Kyo-shin_Kim.doc, fq. 200.

¹⁷ Stiven Adubato, 2016. “Një tërheqje Revolucionare.” *Rishikim Pastoral i Predikimeve*. <http://www.hprweb.com/2016/06/a-revolutionary-attraction/>.

Madje edhe fëmijët sot janë modeluar prej argjilës së dizenjës sonë dhe dëshirave tona individuale në vend që të pranohen atëherë kur i jep Perëndia dhe ashtu siç i jep Ai. Sociologu Pol Jonet (Paul Yonnet) shpjegon:

Dhuntia thelbësore e jetës sot është bërë produkt i vullnetit të njeriut: fëmijët ngjizen, shtatzania shkon deri në fund, dhe pastaj iu jepet jeta në botë, sipas orareve dhe mjeteve të caktuara nga prindërit, dhe jo domosdoshmërisht përmes përfshirjes fizike të nënës e babait biologjik të fëmijës. Kështu që, të qenit fëmijë tani përkufizohet ligjërisht si të qenit “i dëshiruar” në vend të të qenit “i dhuruar.”¹⁸

Fëmijët linden prej planit tonë në një shoqëri tek e cila ne të krishterët patëm ndihmuar për ta projektuar — këtu në Kore, një shoqëri e “shtatë dorëheqjeve”¹⁹ ku fëmijët rriten duke ecur drejt pengesave gjithnjë e më tepër të pakapërcyeshme për të gjetur punë të dobishme, për të mbështetur veten për martesën ose për të pasur një fëmijë, lëre më disa të tillë.

Nuk është për t’u habitur që, të bllokuar prej shpatave flakëruese të vetë egoizmit tonë edhe prej ngushëllimeve që na u dhanë neve në lindje të Edenit, ata i konsiderojnë si të pavlera dhe shtypëse identitetet që na janë dhënë prej Perëndisë dhe në vend të kësaj i japin formë vetes prej argjilës së bërë nga K-POP dhe drama koreane. Rezultati është një lindshmëri kaq e ulët, sa që popullsia e Koresë do të përgjysmohet krahasuar me numrin e tanishëm në njëqind vitet e ardhshme, dhe madje

¹⁸ Efraim Radner, 2016. *Një Kohë për të Mbajtur: Teologjia, Vdekshmëria, dhe Forma e një Jete Njerëzore*. Waco, TX: Baylor University Press, Loc. 2291.

¹⁹ Hjung-A Kim (Hyung-A Kim), 2015. “Brezi i shtatë dorëheqjeve” Krizat me të cilat përballen të rinjtë në Korenë e Jugut.” *Forumi i Politikave APPS*. <http://www.policyforum.net/the-seven-give-up-generation/>.

gjysma e asaj gjysmës së mbetur atëherë do të jetë mbi moshën 65 vjeçare.²⁰ Vetëm myslimanët, që ende e konsiderojnë lindjen si një dhunti dhe detyrë të shenjtë, do të jenë vërdallë duke vrarë mendjen për frytin e një shoqërie të prirur ndaj vetëshkatërrimit të vetëkrijimit.

²⁰ Jun Ja-jong (Yoon Ja-young), 2016. “Popullsia do të përgjysmohet pas 100 vjetësh.” Lajmet e Koresë (Korea Times). <http://www.koreatimes.co.kr/www/common/vpage-pt.asp?categorycode=488&newsidx=219771>.

IV. Pendimi: përgatitja kryesore për kishën e fshehtë

Kjo është arsyeja pse në hapin e parë që I Përndershmi Vurmbrand përvijon tek *Përgatitja për Kishën e Fshehtë* nuk është mbrojtja e mënyrës sonë të krishterë të jetës, por përkundrazi është pendimi që ne nuk ia kemi dalë dot mbanë ta jetojmë vetë atë jetë. Përpara sesa të kërkojmë t'i mësojmë dikujt diçka mbi seksin, përpara sesa të protestojmë vetë-krijimin mëkatar të të tjerëve, vetë ne duhet të pendohemi, t'ia nënshtrojmë jetët tona të vetëkrijuara Perëndisë për shpengimin e Tij, duke mësuar në të njëjtën kohë për gjërat që ka ruajtur tërësia e traditës së krishterë. Në vend që të punojmë për të përcaktuar identitetet tona, ne duhet t'i largojmë duart nga vetja dhe të rrëfejmë me apostullin Gjon: “Ende nuk është bërë e ditur se çfarë do të jemi. Por e dimë se, kur të shfaqet Krishti, ne do të jemi si Ai, sepse do ta shohim sesi është Ai.”²¹

Vetë-krijimi i të gjitha llojeve është krejtësisht i papajtueshëm me krishterimin. Por në Krishtin nuk ka dënim për bashkëfajësinë tonë në revolucionin seksual. Ashtu siç e thekson I Përndershmi Vurmbrand se komunistët nuk janë armiq të tanë, bashkëkomplotuesit në revolucionin seksual janë gjithashtu edhe ata subjekt i dashurisë së Perëndisë. Dashuria e tij merr formën e dritës, që na aftëson secilin prej nesh për të parë përtej vetes sonë, për tek përqafimi i dashur i krijuesit tonë.

Por përpara sesa të përpiqemi që ta sjellim këtë dritë tek shokët tanë revolucionarë seksualë, ne gjithashtu duhet të pendohemi për përpjekjet tona të ngathëta në rimodelimin e teologjisë

²¹ 1 Gjonit 3:2.

së krishterë sipas modelit të vetë përvojës sonë. Teologjia e krishterë e ka ruajtur formën e saj thelbësore për më tepër se dy mijëvjeçarë, edhe sikur nganjëherë shërbimi të binte në duart e disave. Pikërisht ashtu sikurse nuk duhet që të ri-skalitim veten, po ashtu nuk duhet që të ri-skalitim besimin që kemi trashëguar. Siç këshillonte teologu metodist Tomas Odën (Thomas Oden), guri i varrit të një teologu nuk mund të mbartë një epitaf më të lartë sesa: “Ai nuk dha asnjë kontribut të ri në teologji.”²² Me Vinsentin e Lerins (Vincent of Lerins) ne e kuptojmë thirrjen e secilit të krishterë për të përfshirë kujdesin e kushtueshëm dhe këmbëngulës dhe vëmendjen e plotë ndaj “atij besimi që ka qenë besuar kudo, gjithmonë, prej të gjithëve.”²³

Kjo është jetike, ngaqë mes mbrojtësve të krishterë të revolucionit seksual, fjalë të tilla si “dashuri” dhe “liri” bëhen dalta për ri-skalitjen e besimit tonë. Por këto fjalë nënkuptojnë diçka shumë të ndryshme në krishterim nga ajo që nënkuptohet në botë, dhe kuptimi i tyre duhet të mësohet prej traditës së gjatë të historisë së krishterë dhe prej teologjisë e jo të importohet prej përvojës sonë post-moderne e krahasimisht të shkurtër.

Në besimin historik të krishterë, “liria” nuk është heqja e kufizimit, ashtu siç dëshirohet në mënyrë tipike liria në këtë epokë të tashme të rënë, por përkundrazi është liria nga mëkati – ose, siç do ta përpilonte Agustini, liria nga “pengesat” për tek ajo gjendje bekimi ku ne nuk kemi më asnjë dëshirë për të mëkatuar.²⁴ Është një liri që mund të kuptohet vetëm nën dritën

²² Kejt Shellnat (Kate Shellnut), 2016. “Vdiq: Thomas Oden, Teologu Metodist i Cili Themeloi Krishterimin Klasik.” *Krishterimi Sot*. <http://www.christianitytoday.com/gleanings/2016/december/died-thomas-oden-methodist-theologian-who-found-classical.html>.

²³ Vinsenti i Lerins-it (Vincent of Lérins). Të përbashkëtat kapitulli. II, §6; NPNF Series II Vol. XI fq. 132.

²⁴ Xhon M. Rist, 2014. *Agustini i Deformuar: Dashuria, Mëkati, dhe Liria në Traditën Morale Perëndimore*. (Augustine Deformed: Love, Sin,

e “gjendjes së saj përfundimtare”, d.m.th. ajo “që do të jemi” e 1 Gjonit 3:2 se ne mund të njohim vetëm “pjesërisht” në këtë jetë të tanishme, por që do të na bëhet plotësisht e njohur kur të qëndrojmë në praninë e Krishtit. Xhon Rist (John Rist) e përshkruan të kuptuarin klasik të krishterë për lirinë, si dhe zvogëlimin modern të saj në këtë mënyrë:

Ne jemi gjithmonë të lirë vetëm deri në atë shkallë tek e cila i afrohemi asaj gjendjeje përfundimtare të bekuar. Por po ta largojmë gjendjen përfundimtare të Agustinit, nëse dëshirat tona për autonominë personale e mposhtin dorëheqjen Stoike, opsioni ynë i vetëm do të jetë që të synojmë për shkallën më të lartë të mundshme të lirisë prej çdo ‘pengimi’. Këto do të përfshijnë faktorët moralë—mes tyre një detyrim për të riprodhuar dhe për të edukuar një brez të ri—dhe gjithashtu faktorët fizikë: ne mundet për shembull, të dëshirojmë të jemi të lirë prej kufizimit për të qenë mashkull ose femër.²⁵

Ky kuptim për lirinë si liri nga mëkati është thelbësor për të na ndihmuar të kuptojmë atë që përndryshe duket pikërisht si dashuria e pakëndshme e Perëndisë.

Në besimin historik të krishterë, dashuria e Perëndisë nuk është një çështje pohimi, përfshirjeje ose “vullneti të mirë”; përkundrazi, ashtu siç vëren David Shindler (David Schindler), është diçka shumë më e thellë dhe në një kategori krejt tjetër. Dashuria e Perëndisë është “pikërisht gjëja që i bën reale jetët tona dhe gjërat e botës, rendi themelor i jetëve tona dhe i të gjitha gjërave.” Ose në mënyrë më specifike, është “ajo gjë që iu jep gjërave rendin dhe kuptimin e tyre më të thellë dhe më të duhur, gjithmonë dhe

and Freedom in the Western Moral Tradition.) Cambridge: Cambridge University Press, fq. 9.)

²⁵ Po aty.

kudo.”²⁶ Në një botë të rënë, dashuria e Perëndisë e shfaq veten si restaurimi i këtij rendi të hirshëm. Kur Jezusi në mënyrë të mrekullueshme i thotë Nikodemit tek Gjoni 3:16: “Sepse Perëndia e deshi kaq shumë botën, saqë Ai dha Birin e Tij të vetëmlindur, që kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme,” ai nuk është duke i thënë se Perëndia është kaq marrëzisht i dashuruar me ne, saqë ai e dërgoi Birin e tij të vdesë për ne për të na treguar sa shumë na do. Përkundrazi, ai po thotë saktësisht atë që e shpreh tek Gjoni 3:17: “Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e Tij në botë që ta dënojë botën, por që përmes Tij bota të mund të shpëtohet.” Dashuria e Perëndisë ka kuptimin e ribërjes së duhur (ose vendosjes së duhur) të krijimit të rënë, që bota të mos përpihet prej vetë-krijimit të saj, bashkë me ne në të. Ai duhet t’i vendosë siç duhet dëshirat tona, prandaj ne së pari përjetojmë dashurinë e Tij, jo si pohim, por përkundrazi si kryqëzimi më i dhimbshëm i mishit tonë. Kjo ndodh ngaqë ne jemi bërë jo sipas rregullit të duhur dhe për këtë arsye e kundërshtojmë atë. Dashuria e Perëndisë për ne nuk është dashuria e një të dashuri, por përkundrazi është dashuria e një armiku.

Kjo nuk është dashuria që e kërkojmë në mënyrë të mbinatyreshme. Ajo na bën që “të gëzohemi në Zotin, jo të jemi të lumtur në mishin tonë.”²⁷ Ashtu siç vëren një student bashkëkohor i të Përndershmit Vurmbrand, “Vëllai Vurbmbrand pati gëzim të madh në atë [burg], por mishi i tij nuk ishte i lumtur, në fakt mishi i tij ishte në gjendje të mjerueshme gjatë gjithë kohës. Mishi i tij vuajti, kurse shpirti i tij ngjitej lart në qiell.”²⁸ Ky është paradoksi i dashurisë së Perëndisë: Është një

²⁶ David Shindler (David L. Schindler). 2001. *Dashuria që vendos rregull: Shoqëritë Liberale dhe Kujtesa e Perëndisë*. Nju Jork: Wm. B. Eerdmans Publishing. Loc. 25-35.

²⁷ CDP. 2012. “Të Drejtoresh Prej Perëndisë apo Jo.” *Gjetja e Shtegut të Lashtë*. <https://outpostpilgrim.wordpress.com/tag/richard-wurmbrand/>

²⁸ Po aty.

nga gjërat më të mjerueshme me të cilat mund të përballlet mishi ynë. Perëndia nuk pohon gjithçka që është e mirë dhe e drejtë ose e vërtetë në ne. Në vend të këtyre, sipas Zbulesa 21:5, ai “i bën të gjitha gjërat të reja.” Ashtu siç vëren Shauers, (Showers), ajo përfshin gjëra që ne nuk mund t’i imagjinojmë se kanë nevojë për t’u ribërë.

Ndërsa shumë prej dëshirave tona janë në të vërtetë të mira dhe shumica prej tyre vijnë prej Perëndisë, nuk ka asnjë pjesë prej natyrës sonë të vjetër e cila mund të mbetet - ne duhet të ribëhemi plotësisht në Krishtin... Madje edhe gjërat “e mira” duhet të zbriten për tek vdekja e kryqit dhe të ribëhen sipas natyrës së Jezusit ... Cilësitë tona të neveritshme - gënjeshtrat, sharjet, festat, etj. — duhet të hiqen dhe të ribëhen në diçka që është e pëlqyeshme për Krishtin, si për shembull të thuhet e vërteta, të përdoret fjalor i pastër dhe të kalohet koha jonë e lirë duke lexuar Biblën e duke u lutur. Por edhe cilësitë më të mira njerëzore nuk arrijnë dot të barazohen me natyrën e Jezusit, kështu që edhe ndershmëria jonë, integriteti, altruizmi etj., që të gjitha duhet të ribëhen me qëllim që ne të kemi ndershmërinë, integritetin e altruizmin e Zotit.²⁹

Jezusi nuk vdes që të na shpëtojë prej jetës së tij me formën e kryqit. Përkundrazi, ai na shpëton ne për tek ajo jetë, që ajo të bëhet gjithashtu edhe jeta jonë. Është e vetmja rrugë për tek jeta e tij e ringjallur. Ai nuk na liron për një jetë vetë-skalitjeje, të cilën ai më pas e pohon me mirësjellje. Në vend të kësaj, ai na jep jetën e tij për ta marrë e për ta jetuar si jetën tonë, dhe për ta prezantuar vazhdimisht përpara botës në mënyrë që renditja

²⁹ Shirat e Prillit (April Showers), 2011. “Galatasve 5:17 ... kuptimi??” *Flisni Jezusin*. <http://www.talkjesus.com/threads/galatians-5-17-meaning.35687/>.

e tij e duhur të mbahet gjithnjë përpara saj.³⁰ Dashuria të cilën ne jemi thirrur për t'ia ofruar Krishtit si këmbim është dashuria për ta zgjedhur Krishtin përmbi të gjitha gjërat, përfshirë, më thelbësisht, vetveten dhe dëshirat tona. Hiri nuk është pranimi i Perëndisë për ata që jemi, por përkundrazi fitorja e tij mbi mëkatin dhe vdekjen për të gjithë që ia besojnë veten e tyre plotësisht përkujdesjes së tij.

Ky – nënshtrimi i dashurive tona më të pakta ndaj dashurisë së tij më të madhe, jo nënshtrimi i dashurisë së tij më të madhe ndaj dashurive tona më të vogla – mishërohet në kishën e fshehtë sot anembanë botës, ashtu siç ka qenë në kishën e fshehtë përgjatë tërë historisë. Nga kjo kishë ne mundemi – dhe duhet – të mësojmë shumë. Kisha e fshehtë qëndron në anën e kundërt me revolucionin seksual. Revolucioni seksual sakrifikon lavdinë e Perëndisë me qëllim që të përkrahë energjinë e tij jetësore. Kisha e fshehtë sakrifikon energjinë e saj jetësore me qëllim që të përkrahë lavdinë e Perëndisë. Ashtu siç vëren Stiven Adubato: “Dëshmia e tyre... na provokon për të pyetur: a mund të jetë vërtet e mundshme për burrat e gratë moderne që t'i jetojnë jetët e tyre të përkushtuar ndaj Diçkaje tjetër veç vetes së tyre?”³¹

³⁰ Efraim Radner 2016. *Një Kohë për të Mbajtur: Teologjia, Vdekshmëria, dhe Forma e një Jete Njerëzore*. Waco, TX: Baylor University Press, Loc. 55.

³¹ Stiven Adubato, 2016. “Një tërheqje Revolucionare.” *Rishikim Pastoral i Predikimeve*. <http://www.hprweb.com/2016/06/a-revolutionary-attraction/>.

V. Çfarë është kisha e fshehtë?

Përfytyrimi ynë për kishën e fshehtë i detyrohet më tepër imagjinatës, sesa realitetit. Si rezultat, ne nuk mund ta imagjinojmë përgatitjen për t'iu bashkuar asaj. Kur dëgjojmë shprehjen “kisha e fshehtë”, ne përfytyrojmë një bandë njerëzish të çrregullt që fshihen, duke lëvizur vjedhurazi në errësirë për t'i shpëtuar zbulimit prej një fuqie të madhe që është në gjendje ta shkatërrojë atë. Ne përfytyrojmë njerëz që ikin fshehtëazi prej shtëpive të tyre për të marrë pjesë në shërbesa adhurimi në pyll, ose që pëshpërisin himne apo lexojnë Biblën nën dritën e qiririt, nën batanije nëpër shtëpitë e tyre.

Këto imazhe nuk janë krejtësisht trillime. Por po ashtu as kisha e fshehtë nuk përcaktohet prej çrregullsisë së saj, prej lëvizjeve vjedhurazi ose prej të qenit pranë shkatërrimit. Kisha e fshehtë nuk ia detyron aspak ekzistencën e saj përndjekjes. Përndjekja vetëm sa e nxjerr në dukje kishën e fshehtë; ajo nuk mundet dot ta krijojë atë.

Kisha e fshehtë është struktura e paprishshme e punës së Krishtit që del në dukje kur kisha publike nuk mundet dot më ta mbajë veten, ose për shkak të ndonjë sulmi shkatërrues, ose për shkak të përmbysjes nga përbrenda. Ajo bëhet e dukshme nën rrethana të tilla, por krijohet kur të krishterët i nënshtrohen së bashku thirrjes së Zotit: “Po qe se kokrra e grurit nuk bie në tokë e nuk vdes, ajo mbetet e vetme; por nëse vdes, ajo prodhon shumë fryt.”³² Kështu që, kisha e fshehtë është e tillë jo sepse rri në fshehtësi, por sepse, ashtu si një farë e mbjellë në tokë, është ajo pjesë e kishës e cila tashmë ka vdekur ndaj botës. Për shkak se tashmë ka vdekur ndaj botës, ajo është e papërshkueshme

³² Gjoni 12:24.

prej sulmeve të botës. Ajo është në gjendje të mbetet në këmbë kur bien shirat, kur ngrihen përrrenjtë dhe kur fryjnë erërat e përplasen me atë shtëpi.³³

Ky është shkaku i ndryshimit në mënyrën sesi i përgjigjen përndjekjes kisha publike dhe kisha e fshehtë. Kisha publike përgjigjet ndaj përndjekjes si një organizatë publike. Kur përballet me sulme, ajo mbron interesat e saj, pasuritë e saj, të drejtat e saj, mënyrën e saj të jetës dhe besimet e saj. Ajo vepron e shtytur prej një ndjenje shumë reale të frikës se mos i humbet këto gjëra. Ajo frikë bëhet e dukshme në betejat që kisha publike kryen kundër atyre që e kërcënojnë: procese gjyqësore, protesta dhe demonstrata, dhe përpjekjet për bindjen dhe edukimin e publikut. Në sipërfaqe dalin flluskat e zemërimit e dëshpërimit, që e lëndojnë dëshminë e krishterë të kishës publike përpara shoqërisë së gjerë. Ajo fiton disa përleshje, humb disa të tjera, dhe me secilën prej tyre e forcon kundërshtimin e publikut ndaj saj. Më në fund ajo nis të kthehet kundër vetes me segmente të tëra — kisha të mirënjohura, teologë, dhe denominacione — që justifikon kompromisin me armiqtë e saj dhe denoncon me zë të lartë segmentet që nuk pranojnë të bëjnë njëlloj. Përfundimisht, këta dezertorë bëhen përndjekës gjithashtu. Ndërkohë, pjesa tjetër e kishës e konsumon vetveten — financiarisht, fizikisht, shpirtërisht — teksa ajo kërkon në mënyrë dëshpëruese që të shpëtojë jetën e vet. Teologjia dhe praktika e saj shtrembërohen prej mbrojtjes së vetes dhe prej praktikave të saj, duke bërë që krishterimi të sillet rreth vetes pa kujdes ashtu si një batanije në procesin e prodhimit, në mënyrë që besimi t'i shërbejë kishës. Ky është avancimi që po ndodh tashmë sidomos në Amerikë, teksa kisha publike vazhdon të lëkundet nën sulmin e gjithanshëm intensiv blic dhe nën infiltrimin e revolucionit seksual që e kapi pa mendje.

Por kjo nuk është mënyra e veprimit të kishës së fshehtë, e cila karakterizohet prej dashurisë së disiplinuar të Krishtit dhe nga

³³ Mateu 7:25.

teologjia e tij e dashurisë që vuan. Kisha e fshehtë është kisha e një dashurie, dhe ajo dashuri nuk është vetvetja. Për shkak se tashmë ka vdekur, ajo nuk kërkon ta mbrojë ose ta ruajë veten. Në vend të kësaj, ajo është e lirë që t'i shërbejë vetëm Zotit. Ajo mbetet e përkushtuar vetëm ndaj dëgjimit dhe zbatimit të të gjithë fjalës së Perëndisë, duke administruar trashëgiminë teologjike që i është besuar asaj—“shpresa” e saj—në mënyrë që asnjë gjë të mos i shtohet asaj dhe të mos ketë asnjë gjë që të lihet pas dore. Nuk kapet pa mendje prej kundërshtimit të botës, ngaqë ajo e ka futur thellë në zemër këshillën e Zotit: “Në këtë botë ju do të keni mundime.” Nuk vepron e shtytur prej frikës, ngaqë e ka ngulitur në zemër ngushëllimin e Zotit: “Por merrni zemër! Sepse unë e kam mundur botën.”³⁴ Ajo vepron në përputhje me urdhërimin e Zotit për ta hedhur poshtë shpatën, prandaj ajo nuk i ngre lart “shpatat” e botës—gjykatat e saj, median e saj, politikën e saj—por në vend të këtyre është e armatosur vetëm me gjakun e Qengjit dhe me fjalën e dëshmisë së tij.³⁵ Kur e fyejnë, ajo nuk fyen mbrapsht; kur e mallkojnë, nuk mallkon mbrapsht; kur e përndjekin ajo bekon; kur e vrasin, ajo fal. Ajo nuk ia beson veten botës, ngaqë e di se çfarë ka në zemrën e botës. Ajo nuk fshihet. Ajo e kryen punën e saj në vetëdije të plotë për kundërshtimin prej botës dhe bën strategjinë përkatëse. Ajo gjithmonë shërben, madje edhe ndaj armiqve të saj, por gjithmonë si ndaj Zotit, dmth ajo nuk i shërben botës duke u bërë si ajo. Ajo e paguan me gëzim çmimin e të mos u kompromentuarit me botën, duke e konsideruar gjithçka gëzim, kur vuan, për shkak se është quajtur e denjë që të vuajë për emrin e Zotit.³⁶ Gjithmonë është e përgatitur për të dhënë arsyen e shpresës që ka, kur bota i kërkon llogari. Por ajo bën kështu “me butësi dhe respekt, duke pasur një ndërgjegje të pastër, që

³⁴ Gjoni 16:33.

³⁵ Zbulesa 12:11.

³⁶ Jakobi 1:2; Veprat e Apostujve 5:41.

ata që flasin keq kundër sjelljes së tyre të mirë në Krishtin, të mund të turpërohen për shpifjen e tyre.”³⁷

Me pak fjalë, kisha e fshehtë nuk “përzihet” aspak me revolucionin seksual dhe me sulmet e tij të papritura. Ajo thjesht vazhdon që të jetë kisha. Ajo nuk e tërheq Krishterimin rreth vetes, sikur besimi të ishte shërbëtori i saj. Ajo mbetet e mahnitur dhe e nderuar nga katoliciteti i besimit dhe kështu nuk pranon të bëhet kisha e një çështjeje. Ajo e di se i kërkohet jo që të vdesë duke e mbrojtur besimin, por që të vdesë duke e praktikuar atë. Se vdekja mund të ndodhë në çast përmes një martirizimi të përgjakshëm, ose ajo mund të ndodhë përditë, përmes vdekjes ndaj vetes dhe ndaj botës, gjëra që gjithashtu janë martirizime, që asaj i janë mësuar t’i vlerësojë.

Nëse kisha e fshehtë shumë shpesh është portretizuar në histori si pa ndërtesa, pa sanksione ligjore, ose pa burime tokësore, kjo ndodh vetëm sepse ajo ka mësuar të “hedhë poshtë” — jo sundimtarët e saj kapitalistë, ose moralitetin shtypës, ose etiket seksuale gjoja të vjetëruara, por më tepër “gjithçka që pengon dhe mëkatën që kaq lehtë na zë në kurth”, që ajo të mund

të vrapojë me këmbëngulje garën që na është caktuar, duke i fiksuar sytë tek Jezusi, pionieri dhe përsosësi i besimit. Për gëzimin që ishte vënë përpara tij, ai duroi kryqin, duke përbuzur turpin e tij, dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë.³⁸

Kisha e fshehtë është ajo pjesë e kishës e cila ka mësuar se nuk është thirrur për të mbrojtur ndërtesat, denominacionet, pasuritë, mënyrat e jetesës, ose interesat e saj vetiake. Prandaj, për t’u përgatitur për kishën e fshehtë, nuk do të thotë të përgatitesh që të luftosh kundër revolucionit seksual, por më

³⁷ 1 Pjetrit 3:15-16.

³⁸ Hebrenjve 12:1-2.

Parathënie për “përgatitja për kishën e fshehtë”

tepër të përgatitesh për të mos luftuar. Do të thotë të përgatitesh për largimin, rënien, sfidimin e skulpturave të frymëzuara nga Krishti të kishës publike që rrinë përmbi kishën e fshehtë, por të cilat përfundimisht nuk janë pjesë përbërëse e saj. Të përgatitesh për kishën e fshehtë do të thotë të bëhesh gati për të qenë i krishterë i plotë në mes të shkëlqimit verbues të ditës, kur çdo gjurmë nderi do na hiqet prej botës, dhe kur nuk ka mbetur asnjë gjë për të mbuluar lakuriqësinë tonë, me përjashtim të lavdisë së Zotit vetë.

VI. Koha e përgatitjes mbërriti

Kjo na sjell sërish tek pyetja se përse duhet të përgatitemi që të kalojmë në fshehtësi. Ne *jemi* pengesa ndaj revolucionit seksual — jemi ata që, sipas Efesianëve 4:24 “veshin veten e re, të krijuar për të qenë si Perëndia në drejtësi të vërtetë e në shenjtëri,” në vend që ta zhveshin atë, veten e re, për shkak të shtypjes së madhe. Revolucioni seksual nuk është çështja mbi të cilën ne zgjedhim të bëjmë të ditur qëndrimin tonë, përkundrazi ai është çështja mbi të cilën qeveritë dhe njerëzit e botës së lirë kanë zgjedhur të mbajnë qëndrimin e tyre kundër nesh.

Si fëmijë edhe të kishës, edhe të botës së lirë, ne nuk jemi mësuar të na duhet të zgjedhim mes të dyjave. Dhe natyrisht që nuk jemi mësuar të portretizohemi si shtypës të lirisë. Por Jezusi nuk jep ashtu siç jep bota, dhe kur bota — madje edhe bota e lirë — lëviz për ta mbështetur lirinë për të mëkatuar me anë të kufizimit të lirisë për të mos mëkatuar, atëherë bota e lirë e shfaq vetveten se është thjesht një maskë më tepër e “botës,” e cila ka qenë gjithmonë armiqësore ndaj gjërave të Perëndisë.

Së fundmi, Krishterimi tradicional nuk është bërë më popullor në Korenë e Jugut sesa në atë të Veriut, për shkak se Krishterimi tradicional i sfidon themelet e ndërtesës mbi të cilën është ndërtuar çdo shoqëri, përfshirë edhe këtë. Nuk është çështja se ku është më e këndshme që ne të jetojmë (në një shoqëri komuniste apo kapitaliste), po ku është më e kënaqshme për Perëndinë që të jetojmë, ku e gjen ai veten të mikpritur. Dhe rezulton se ai nuk ndihet më i mikpritur në Korenë e Jugut sesa në Korenë e Veriut, por në të dyja vendet ai është njëlloj i fyer, ngaqë ai nuk është më tepër Perëndia i revolucionit seksual nga sa është Perëndia i revolucionit komunist. Këto revolucione

zbulohet se janë dy anë të së njëjtës medalje, që të dyja janë prerë prej “racës së njerëzve të prirur për të dëshiruar autonominë e tyre absolute” në konfliktin e tyre me një Perëndi monoteist.³⁹ Që të dy revolucionet kanë të përbashkët një rrënjë identike. Kur të dyja anët shohin nga afër njëri-tjetrin përtej Zonës së Demilitarizuar, ata që janë mashtruar për një kohë të gjatë prej njërit revolucion, janë duke parë ata që janë mashtruar së fundmi prej revolucionit tjetër.

Qeveria e Koresë së Jugut, jo vetëm që është palë e revolucionit seksual; ajo është mes nxitësve të tij të zjarhtë. Në vitin 2011 – shumë kohë përpara “Stilit të Gangnam” – të ardhurat vjetore prej të ashtuquajturave “eksportet me përmbajtje kulturore” KPOP dhe drama koreane tashmë vlerësoheshin se ishin \$4 miliardë dollarë amerikanë në vit. Ajo pretendon një vlerë monetare për këto pasuri kulturore prej \$83.2 miliardë dollarë amerikanë. Ajo ndan specifikisht 1% të buxhetit kombëtar për të “kultivuar kulturën popullore” dhe mban një fond me mbi \$1 miliardë dollarë amerikanë për ta çuar më tej këtë “kultivim.” Kjo do të thotë se ata shpenzojnë paratë e taksapaguesve për t’i përkthyer videot e muzikës KPOP në gjuhët e huaja dhe për t’u kërkuar rrjeteve televizive të vendeve të tjera për t’i transmetuar programet e tyre.⁴⁰ Ajo e di se, kur yjet e saj kryejnë kirurgji plastike, ose blenë një telefon të ri celular, ose mbajnë një stilim të ri flokësh, ose përdorin një makijazh të caktuar ose një çantë dore, ekonomia koreane lulëzon prej rivalitetit të konsumatorëve. Prandaj qeveria e Koresë së Jugut nuk ka vlera asnjëse. Krahasoni një dramë koreane

³⁹ Xhon M. Rist, 2014. *Agustini i Deformuar: Dashuria, Mëkati, dhe Liria në Traditën Morale Perëndimore*. (Augustine Deformed: Love, Sin, and Freedom in the Western Moral Tradition.) Cambridge: Cambridge University Press, fq. 10.

⁴⁰ Melissa Leong, 2014. “Si u bë Koreja marka më e lezetshme e botës.” *Financial Post*. <http://business.financialpost.com/news/retail-marketing/how-korea-became-the-worlds-coolest-brand>.

ose një këngë KPOP sot me ato prej dhjetë viteve të shkuara. Vini re rritjen e nervozizmit dhe përqafimin e formave më të guximshme të seksualitetit. Qeveria e Koresë së Veriut është e vetëdijshme në mënyrë akute për zhvillimet kulturore globale. Ajo i konsideron reflektimin e këtyre “vlerave ndryshuese në përmbajtjen e saj kulturore si mjetin më të fortë për të përhapur kanalet globale të shpërndarjes së K-kulturës dhe diversifikimin e konsumatorëve të tij.”⁴¹

Qeveria e Koresë së Jugut jo vetëm që i kultivon karakteristikat e saj kulturore për qëllime ekonomike, por ajo gjithashtu i përdor ato në maksimum edhe për luftërat ideologjike, sidomos në marrëdhënien e saj me Korenë e Veriut. Nuk janë fjalimet politike që ajo i hedh për të shpërthyer përgjatë kufirit, por K-POP (kej popi). Nuk janë fjalimet mbi kapitalizmin që ajo i hedh përmes MP3 dhe tullumbaceve e dronëve në përpjekje për të komunikuar me kundërshtarin e saj, por dramat koreane.

Prandaj, ne nuk duhet të presim që qeveria e Koresë së Jugut të jetë aleati ynë për t'i bërë rezistencë revolucionit seksual. Në fakt, duke pasur parasysh marrëdhënien e fortë historike të kishave koreane me qeverinë koreane, ne mund të presim plotësisht që qeveria koreane do të presë që ne të jemi aleati *i saj* në këtë çështje, duke mbështetur atë që ajo beson se do të avancojë më së miri interesat kombëtare koreane.

Pikërisht një situatë e tillë ekziston në vendet Nordike të Danimarkës, Finlandës, Islandës, Norvegjisë dhe Suedisë. Merit Xhantera-Xherëborg (Maarit Jänterä-Jareborg) është Profesore e Drejtësisë në Universitetin e Upsala në Suedi. Ajo nuk shkruan nga perspektiva e krishterë, por më tepër nga

⁴¹ Chung Jo-uon (Chung Joo-won) dhe Li Jun-jung (Lee Eun-jung), 2016. “Fokusi i lajmeve) K-pop, K-dramat përqafojnë vlerat universale për të rritur joshjet. *Agjencia e Lajmeve Jonhap (Yonhap News Agency)*. <http://english.yonhapnews.co.kr/focus/2016/10/31/88/1700000000AEN20161031007600315F.html>.

perspektiva e ligjit Skandinav në shoqëri lidhur me atë që pret qeveria skandinave prej kishës lidhur me revolucionin seksual. Ajo shkruan shumë qartë: “Shteti mund të presë që kishat — ose të paktën Kisha e saj Popullore kombëtare⁴² — të përshtatet me zhvillimet e reja, madje edhe sikur ajo të mos mundet dot të vendosë për këtë.”⁴³ Ajo vëren se kisha nuk e ka zhgënjyer shtetin lidhur me këtë çështje:

Çfarë e shpjegon përshtatjen e Kishave Popullore ndaj formalizimit ligjor të marrëdhënieve të të njëjtit seks, duke marrë në konsideratë se që të gjitha ato fillimisht ishin kundër regjistrimit të partneritetit dhe më vonë ndaj martesave mes të njëjtit seks? Një shpjegim i përgjithshëm do të dukej se ishte roli historik i këtyre Kishave dhe pozita si Kisha kombëtare Popullore të cilave iu përket shumica e popullsisë së secilit shtet. Me qëllim që të jetë pjesë e shoqërisë së gjerë, një Kishë kombëtare Popullore nuk mund të çmojë vlerat që devijojnë tepër shumë prej vlerave mbizotëruese të përgjithshme në shoqëri, pavarësisht prej lidhjeve të dobësuar me shtetin. Për shembull, kur një peshkop i kishës së Finlandës bëri deklarata kritike për marrëdhëniet mes të njëjtit seks në një intervistë të publikuar disa vjet më parë, kjo gjë bëri që mijëra anëtarë

⁴² Evropa ka dy lloje kishash: Kishën Kombëtare (ose Popullore) dhe Kishën e Lirë. Kishat Kombëtare janë kishat zyrtare të një vendi Evropian. Ato mbështeten nga qeveria dhe financohen prej parave të taksave. Kisha e Lirë, nga ana tjetër, nuk ka lidhje zyrtare me qeverinë e vendit të tyre dhe financohet prej donacioneve të anëtarëve të bashkësisë së tyre.

⁴³ Merit Xhantera-Xherëborg, 2016. “Një perspektivë Skandinave mbi Homoseksualitetin, të Drejtat e Barabarta, dhe Lirinë e Besimit Fetar.” Tek Xhak Fridman (Jack Friedman), Timote Sho (Timothy Shaw) dhe Tomas Far (Thomas Farr). *Liria Fetare dhe të Drejtat e personave Gei: Konfliktet që po dalin hapur në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë*. Oxford: Oxford University Press. Loc. 5595.

Kisha e fshehtë

të largoheshin nga kisha dhe zuri titujt kryesorë të medias kombëtare finlandeze.⁴⁴

Ajo shpreh pikëtakimin ku kisha dhe shteti kanë bërë paqe lidhur me revolucionin seksual:

Nga këndvështrimi i teologjisë biblike, urdhërimi i dashurisë është më i larti mbi të gjitha urdhërimet dhe ndalimet në Bibël. Prandaj faktori vendimtar lidhur me format e bashkëjetesës nuk janë pjesët individuale nga Bibla, por çfarë është për përfitimin ose dëmtimin e njerëzve. Kjo do të thotë se kur kisha duhet të formojë një opinion mbi martesën mes çifteve të së njëjtës gjini, pyetja e përshtatshme që duhet bërë është nëse kjo gjë i dëmton njerëzit apo iu sjell përfitime atyre.⁴⁵

Ky përkufizim i “dashurisë” e mohon krejtësisht atë që qëndron në thelbin e traditës së krishterë: Dashuria si renditja e drejtë e hirshme e Perëndisë (dhe, prej hirit të tij, ri-renditja) për botën, që na liron prej mëkatit përmes kryqëzimit të mishit tonë. Të krishterët që nuk pranojnë të marrin daltën për të ri-skalitur përkufizimin e traditës sonë dymijë vjeçare mbi dashurinë, në këtë mënyrë gjithnjë e më tepër hidhen jashtë si fanatikë, potencialisht të rrezikshëm, dhe që duhen ruajtur, kontrolluar, frenuar, monitoruar dhe, natyrisht, duhen tallur.

Ashtu siç vëren Pjetër Leithart, kjo ishte parashikuar me tepër se një brez përpara prej Augusto del Noçe (Augusto del Noce). Del Noçe ishte një filozof i krishterë pak a shumë bashkëkohës me të Përndershmin Vurmbrand, që jetoi përmes kohës së fashizmit dhe komunizmit në Itali. Del Noçe e ndjeu se kisha në botën e lirë shumë shpejt do të përballej më sfida shumë më tepër të

⁴⁴ Merit Xhantera-Xherëborg, 2016. Loc. 5631.

⁴⁵ Po aty., Loc. 5667.

mëdha prej revolucionit seksual, sesa ato me të cilat u përball nën komunizmin. Leithart e përmbledh atë që Del Noçe mendoi se do u ndodhte të krishterëve që nuk pranonin të kompromentonin besimin e tyre përballë revolucionit seksual:

Besimtarët që mbeten nën një autoritet më të lartë të vlerave do të marginalizohen dhe do të reduktohen në qytetarë të dorës së dytë. Ata do të burgosen, së fundi, në kampet e përqendrimit “morale”. Por askush nuk mund të mendojë seriozisht se ndëshkimet morale do të jenë më pak të ashpra sesa ndëshkimet fizike. Në fund të procesit qëndron versioni shpirtëror i gjenocidit.⁴⁶

Nuk është e vështirë për t’u parë pse, duke pasur parasysh ngjarjet që po shpalosen aktualisht në vendet nordike. Ashtu siç vëren Leithart: “Që të gjitha opinionet teologjike do të gjykohen lidhur me, nëse ato e përparojnë vizionin e posaçëm të liberalizmit lidhur me lirinë dhe drejtësinë.”⁴⁷ Të vetmet opinione teologjike që do të lejohen për t’u zgjeruar përtej pragut të derës së kishës janë ato që e përparojnë dhe nuk e shtypin revolucionin seksual.

Në këtë mënyrë, liria e besimit fetar reduktohet në lirinë për të adhuruar për ata që kanë tjetër mendim prej ortodoksisë seksuale të shtetit. Liria për të adhuruar nënkupton se ne mund të themi çfarë të duam përbrenda ndërtesave tona, me kusht që ajo të mos ndikojë asnjë nga gjërat që bëjmë përjashta ndërtesave tona. Për fat të keq, kjo është një ujdë që shumë kisha historikisht kanë qenë të gatshme për ta pranuar.

⁴⁶ Augusto del Noçe, 2015. *Kriza e Modernizimit*. Kingston, Ontario: McGill-Queen’s University Press, fq. 153.

⁴⁷ Pjetër Leithart, 2016. “Arbitrat, Lojtarët dhe Liria e Besimit Fetar.” *Gjërat e para*. <https://www.firstthings.com/blogs/leithart/2016/09/referees-players-and-religious-liberty>

Kisha e fshehtë

Ndoshta kjo është arsyeja se pse kisha e fshehtë më shpesh gjendet nëpër shtëpia, sesa në ndërtesa kishash: kostot e mirëmbajtjes së kishës publike thjesht janë tepër të larta, dhe vetëm pak prej këtyre kostove janë financiare. Ungjilli i Perëndisë është tepër i madh për t'u mbyllur brenda getove morale. Prandaj, teksa qeveritë e botës së lirë përqafojnë bindjen se ato duhet të vendosin kufij për kishën bazuar mbi ato, që ato qeveri i konsiderojnë si ruajtja e lirisë për të gjithë, ne përqafojmë bindjen tonë se liria e krishterë kërkon përgatitjen tonë për kishën e fshehtë.

VII. Lidhur me volumin 2 dhe 3 të serive të ardhshme

Ajo që është më sfiduese dhe e padëgjuar lidhur me situatën tonë është se në të shkuarën, kur vinte përndjekja, kisha mund të kthehej tek rrënjët e fshehta të familjes. Kjo do të thotë, ashtu siç mund të shihet prej esesë së Të Përndershmit Vurmbrand, se ajo mund të takohet nëpër shtëpitë, të cilat gjithsesi krishterimi gjithmonë i ka konsideruar si “kisha e parë” e besimit.⁴⁸ Ashtu siç vëren Radner, familja është edhe “baza qendrore për metaforat e formimit shpirtëror”, edhe “sfera aktuale e shfaqjes së formimit shpirtëror.”⁴⁹ Është vendi ku përçohen traditat, sidomos, ashtu siç e nxjerr në pah del Noçe: “ideja e martesës monogame të pazgjidhshme dhe idetë e tjera të lidhura me të (modestia, pastërtia, vetëpërmbajtja),”⁵⁰ si dhe mbajtja e pikëpamjeve të krishtera për virgjërinë, beqarinë fetare dhe miqësinë.

Por familja është pikërisht ajo që është shkukur prej revolucionit seksual. Prandaj, volumet e dyta dhe të treta të këtyre serive adresojnë ndihmesën ndaj “kishës së parë” të krishterimit, familjes, në kontekstin e përgatitjes për kishën e fshehtë. Volumi 2: “Mbjellja e kishës së fshehtë,” është një udhëzues praktik lidhur me si janë ndërtuar kishat e fshehta “prej nivelit të familjes e më lart” e jo “nga foltorja poshtë”. Volumi 3: “Jeta në kishën e fshehtë,” është një paketë e mjeteve të dishepullizimit dhe hermeneutikës nga tradita e kishës për

⁴⁸ Shih 1 Timoteut 3:1-5.

⁴⁹ Efraim Radner 2016. *Një Kohë për të Mbajtur: Teologjia, Vdekshmëria, dhe Forma e një Jete Njerëzore*. Waco, TX: Baylor University Press, Loc. 2097.

⁵⁰ Augusto del Noçe, 2015. *Kriza e Modernizimit*. Kingston, Ontario: McGill-Queen's University Press, fq. 161.

Kisha e fshehtë

t'i pajisur të krishterët për dëgjimin dhe zbatimin e fjalës në kontekstin e kishës së fshehtë. Lutja jonë, si gjithnjë, është që ne të mos sjellim asnjë gjë të re në teologjinë e Krishterë.

Dhe me të vërtetë, kjo është arsyeja se pse tani ne i kthehemi Volumit 1 të këtyre serive tek një ese e shkruar afro katër dekada më parë për të mësuar se në fakt, asnjë nga gjërat me të cilat po përballemi në të tashmen, në termat e krishterë, nuk është aspak e re. Sepse në të gjitha kohët e vendet, përfshirë këtu në Korenë e Jugut, të krishterët duhet të jenë gati për të predikuar, për t'u lutur ose për të vdekur pa ndonjë paralajmërim.

PËRGATITUNI PËR KISHËN E FSHEHTË

Nga **Riçard Vurmbrand**
(Richard Wurmbrand)

Përgatituni për kishën e fshehtë-tani

“Pastaj Ananias u përgjigj: ‘Zot, kam dëgjuar nga shumë persona për këtë burrë, sesa shumë dëm u ka shkaktuar ai shenjtorëve të Tu në Jeruzalem.’ Por Zoti i tha atij: ‘Shko, sepse ai është një enë e zgjedhur e Imja për ta mbartur emrin Tim përpara Johebrenjve, mbretërve dhe bijve të Izraelit. *Sepse unë do t’i tregoj atij sesa gjëra duhet që të vuajë për hir të emrit Tim*’” (Veprat e Apostujve 9:13, 15, 16).

Me sa di unë, nuk ekziston as edhe një seminar i vetëm teologjik, shkollë Biblike, ose universitet në të gjithë botën, që ka një kurs studimor mbi Kishën e Fshehtë. Nëpër seminare ju mund të mësoni mbi Sebalianizmin dhe Apollinarianizmin. Pesë minuta pasi ka mbaruar seminari, i keni harruar ata. Ndoshta asnjëherë nuk do të takoheni me ndonjë Sebalian ose një Apollinarian. Ne mësojmë për Kishën Koptike dhe për të gjitha llojet e sekteve të vogla që ndoshta asnjëherë nuk do t’i takojmë në jetën tonë. Kisha e fshehtë është Kisha e një të tretës së botës, burra që kurrë më parë nuk e kishin menduar se do t’i përkisnin një kisha të fshehtë. Ndërkohë që Amerika ishte e preokupuar me Uatërgejt (Watergate), komunistët morën nën kontroll mbi pesëmbëdhjetë vende. Islami dhe Humanizmi janë duke fituar ndikim e pushtet. Pastorët e krishterë duhet ta dinë sesi duket një kishë e fshehtë dhe çfarë bën ajo. Fola me një peshkop në Britani për pak a shumë një orë lidhur me punën në kishën e fshehtë. Më në fund, ai më tha: “Më falni, por ju po flisni për pasionin tim; jam shumë i interesuar në arkitekturën e kishës. A mund të më tregoni, ju lutem, nëse kisha e fshehtë përdor stilin Gotik në ndërtesat e kishave?”

Po t'ju tregoja se cili është ky peshkop, ju ndoshta nuk do ta duronit as ta imagjinonit sesi një burrë me një emër kaq të madh do ta bënte një pyetje të tillë.

Kisha e Fshehtë është krahasimisht e panjohur. E kemi pikërisht si fqinje pranë nesh, por nuk jemi gati për t'iu bashkuar asaj dhe nuk jemi të stërvitur për të. Secili pastor i Krishterë tani e ka të tërë botën si famullinë e tij dhe ne duhet ta dimë këtë gjë, ngaqë mund të na duhet të kalojmë përmes rrethanave tragjike. Edhe sikur të mos kalojmë përmes këtyre rrethanave tragjike, e kemi për detyrë t'i ndihmojmë dhe t'i udhëzojmë ata që kalojnë përmes tyre.

Në vendet myslimane, në Kinën e Kuqe, e në vende të tjera, shumë besimtarë janë bërë viktime. Shumë janë futur në burgje dhe shumë kanë vdekur në burg. Ne nuk mund të jemi krenarë për këtë gjë. Gjëja më e mirë do të kishte qenë që njerëzit të mësohen mirë sesi të bëjnë punën në fshehtësi e të mos kapen.

Në një luftë, ata që vdesin për atdheun e tyre nuk admirohen aq shumë sa heronjtë që i bëjnë armiq të tyre të vdesin për atdheun e tyre. Nuk jam *unë* që duhet të vdes për atdheun *tim*; *ai* duhet të vdesë për të *tijin*. I admiroj ata që dinë sesi të punojnë aq mirë, saqë nuk kapen. Ne duhet ta njohim punën që bëhet në fshehtësi.

Përgatitja për Vuajtjen

Vuajtja nuk mund të shmanget në kishën e fshehtë, sado masa që mund të merren, por vuajtja duhet zvogëluar në minimum.

Nuk është e mundur të jepet një kurs mbi kishën e fshehtë në një kohë të shkurtër. Do t'ju nxisja që t'i kërkonit sinodit ose denominacionit tuaj që të prezantojnë kurse mbi kishën e fshehtë.

Çfarë ndodh në një vend kur pushtetin e marrin fuqitë shtypëse? Në disa vende terrori filloi përnjëherësh, si në Mozambik e në Kamboxhia. Në vendet e tjera liria e besimit fetar vijon si kurrë më përpara. Dhe kështu fillon. Disa regjime vijnë në pushtet pa pasur fuqi reale. Ata nuk i kanë njerëzit në anën e tyre. Ata nuk i kanë organizuar domosdoshmërisht akoma policinë dhe personelin e tyre. Në Rusi, komunistët iu dhanë përnjëherë liri të madhe Protestantëve, me qëllim që t'i shkatërronin Ortodoksët. Pasi i shkatërruan Ortodoksët, iu erdhi radha Protestantëve. Situata fillestare nuk zgjat shumë. Gjatë asaj kohe, ata infiltrojnë kishat, duke i vënë njerëzit e tyre në drejtim. Ata zbulojnë dobësitë e pastorëve. Disa mund të jenë burra ambiciozë; disa mund të jenë zënë në kurth prej dashurisë për paranë. Një tjetër mund të ketë një mëkat të fshehur diku, me të cilin i bëjnë shantazh. Ata i shpjegojnë se do ta nxjerrin sheshit atë mëkat dhe në këtë mënyrë i vënë njerëzit e tyre në drejtim. Pastaj, në një çast të caktuar nis përndjekja. Në Rumani, ky lloj shtrëngimi ndodhi brenda një dite. Që të gjithë peshkopët Katolikë u burgosën, bashkë me një numër tejet të madh priftërinjsh, murgjërish e murgeshash. Pastaj i arrestuan pastorët Protestantë të të gjitha denominacioneve. Shumë vdiqën në burg.

Jezusi, Zoti ynë, i tha Ananias: “Takoje Saulin e Tarsit. Ai do të jetë pastori Im i fshehtë, punëtori Im i fshehtë.” Pikërisht ashtu ishte Pali - pastori i një kishe të fshehtë. Jezusi nisi një kurs trajnimi të shpejtë për këtë pastor të fshehtë. Ai e filloi me fjalët: “Unë do t’i tregoj atij sesa shumë gjëra duhet të vuajë ...” (Veprat e Apostujve 9:16)

Përgatitja për punën e fshehtë nis duke studiuar mundimologjinë, martirologjinë. Solzhenjici (Solzhenitsyn), në librin e tij *Arkipelagu i Gulagut*, thotë se oficerët e policisë në ish-Bashkimin Sovjetik bënë kurs trajnimi mbi arrestologjinë – shkenca që iu mësonte sesi t’i arrestonin njerëzit në mënyrë që askush përreth të mos i shihte. Nëse ata kanë krijuar një emër të ri, *arrestologji*, le të krijojmë edhe ne emrin *mundimologji*.

Më vonë do të shohim anën teknike të punës së fshehtë, por së pari duhet të ketë një përgatitje shpirtërore për të. Në një vend të lirë, të qenit anëtar i një kishe mjafton për të besuar e për t’u pagëzuar. Në Kishën e fshehtë nuk mjafton vetëm të qenit anëtar i saj. Mund të pagëzohesh e mund të besosh, por nuk do të jesh anëtar i kishës së fshehtë nëse nuk di sesi të vuash. Mund të keni besimin më të fortë në botë, por nëse nuk jeni përgatitur për të vuajtur, do të merreni nga policia. Do t’ju japin dy shpulla dhe ju do të deklaroni gjithçka. Prandaj, *përgatitja* për vuajtjen është njëra nga gjërat thelbësore në përgatitjen për punën e fshehtë.

Një i krishterë nuk bie pre e panikut, nëse e futin në burg. Për besimtarin e zakonshëm, burgu është një vend i ri ku mund të dëshmojë për Krishtin. Për një pastor, burgu është një famulli e re. Është një famulli pa ndonjë të ardhur të madhe financiare, por me mundësi të mëdha për punë. Unë flas pak mbi këtë temë në librin tim *Me Perëndinë në Qelinë e Izolimit*. Në librat e tjerë unë përmend Kodin Mors, i cili gjithashtu është një pjesë e trajnimit për kishën e fshehtë. Ju e dini se ç’është ai – një kod me anë të të cilit përcillen mesazhet. Përmes këtij kodi ju mund

t'u predikoni ungjillin atyre që janë në të djathtën e në të majtën tuaj. Të burgosurit gjithmonë ndryshojnë. Disa nxirren jashtë nga qelia e të tjerë futen brenda. Perëndia iu ka dhënë shumë të krishterëve që kanë qenë në burg privilegjin për të sjellë te Krishti, përmes kodit Mors, burra të cilët ata nuk i kanë parë kurrë. Të tjerët, pas shumë vitesh, i takojnë këta burra të cilët i drejtuan për te Krishti nëpërmjet kodit mors. Kam pasur disa famulli në qeli të përbashkëta.

Në kishat e botës së lirë të dielën në mëngjes, ju mund t'i bini kambanës. Nëse duan, ata vijnë në kishë – nëse nuk duan, nuk vijnë. Nëse dikush nuk e pëlqen shërbesën tuaj këtë të diel, të dielën tjetër ai rri larg. S'bëhet fjalë të vijë nëse bie shi. Kurse kur e ke burgun si famullinë tënde, i ke famullitarët me vete gjithë ditën. Famullitarët e lirë i shohin orat e dorës: “Deri tani ka tridhjetë minuta që predikon. Kur do mbarojë?” Kur arrestohesh, ta marrin orën e dorës; i ke famullitarët me vete tërë javën dhe mund t'u predikosh atyre nga mëngjesi deri natën vonë! Ata nuk kanë zgjedhje. Nuk ka pasur ndonjëherë, në historinë e kishës Romake ose Ruse, kaq shumë kthime në besim sa kanë ndodhur nëpër burgje. Prandaj mos e kini frikë burgun. Shiheni atë si një detyrë të re të caktuar prej Perëndisë. Më kujtohet se kur u arrestova për herë të dytë, grua ja më tha teksa e përqafoja atë përpara se të shkoja me policët: Riçard, kujto atë që është shkruar: ‘Do t’ju shpjenë përpara sundimtarëve dhe mbretërve për të qenë dëshmi për ta.’” (Mateu 10:18)

Burrat mund ta pranojnë këtë. Po për torturat e tmerrshme që iu bëhen të burgosurve? Çfarë do të bëjmë ne për këto torturat? A do të jemi në gjendje t'i durojmë ato? Nëse nuk i duroj ato, do të fus në burg edhe nja pesëdhjetë ose gjashtëdhjetë burra të tjerë, që i njoh, ngaqë këtë kërkojnë prej meje shtypësit e mi, që t'i tradhtoj ata që kam rreth vetes. Prandaj këtu lind nevoja e madhe për t'u përgatitur për vuajtjen, që duhet të fillojë që

tani. Është tepër e vështirë për ta përgatitur veten për të, kur tashmë jeni në burg.

Më kujtohet që patëm një rast në Rumani, kur një pastor me njëzet vite në shërbim pati mëkatuar me një grua. Pastorët e tjerë e debatuan këtë çështje. Thuhej: “Mëkati i tij nuk ishte ajo gjë që ai bëri atë mbrëmje; rrethanat ishin të tilla që ai nuk mundi t’i *rezistonte* dot tundimit. Mëkatin e kishte bërë njëzet vjet më parë, kur nuk ishte ende i tunduar në këtë formë, sepse ai *nuk* i pati thënë vetes: ‘Gjatë jetës sime pastorale do të më ndodhin gjëra të ndryshme. Ndër të tjera do të tundohem për mëkat seksual. Atëherë unë *nuk* do ta kryej atë mëkat’”. Ju duhet ta përgatisni veten që më përpara për *të gjitha* të papriturat. Ju duhet të *përgatiteni* për vuajtjen.

E vërteta për të Vërtetën

Sa shumë mund të vuajë secili prej nesh varet nga sa shumë është i lidhur ai me një çështje, sesa e shtrenjtë është ajo çështje për të dhe sesa shumë do të thotë ajo për të.

Në lidhje me këtë, në vendet komuniste, ne kemi pasur surpriza shumë të mëdha. Ka pasur predikues dhe shkrimtarë të librave të krishterë, që janë bërë tradhtarë. Kompozitori i librit më të mirë të himneve në Rumani, u bë kompozitori i himneve më të mëdha komuniste të Rumanisë. Gjithçka varet nga fakti, nëse ne kemi mbetur në sferën e fjalëve apo jemi shkrirë me realitetet hyjnore.

Perëndia është e Vërteta. Bibla është e vërteta rreth të Vërtetës. Teologjia është e vërteta rreth së vërtetës për të Vërtetën. Një predikim i mirë është e vërteta për të vërtetën për të vërtetën, për të Vërtetën. Nuk është e Vërteta. E Vërteta është vetëm Perëndia. Rreth kësaj të Vërtete ka një skelë fjalësh, teologjish, dhe interpretimesh. Asnjëra prej këtyre nuk është ndihmë në kohët e vuajtjes. Vetëm Vetë e Vërteta është ndihma, dhe ne duhet të depërtojmë përmes predikimeve, përmes librave teologjikë, përmes gjithçkaje që ka “fjalët” dhe të lidhemi me realitetin e Vetë Perëndisë.

Ju kam treguar në Perëndim sesi të krishterët ishin lidhur në kryqe për katër ditë e katër net. Kryqet ishin vënë në dyshe me dhe të burgosur të tjerë u torturuan dhe detyruan me forcë të kryenin nevojat e tyre trupore mbi fytyrat dhe trupat e të kryqëzuarve. Që atëherë më kanë pyetur: “Cili varg Biblik të ka ndihmuar dhe të ka forcuar në ato rrethana?” Përgjigjja ime është: “Asnjë varg Biblik nuk ishte fare ndihmë.” Është gjë e pamundur, madje hipokrizi fetare, të thuhet se: “Ky varg

Bible më forcon, ose se ai varg Bible më ndihmon.” Vargjet e Biblës në vetvete nuk janë synuar për të ndihmuar. Ne e dinim Psalmin 23: “Zoti është Bariu im; asgjë nuk do të më mungojë... edhe sikur të ec përmes luginës së hijes së vdekjes...”

Kur kalon përmes vuajtjes e kupton se asnjëherë nuk u synua prej Perëndisë që Psalmi 23 duhej të të forconte. Është Zoti ai që mund të të forcojë, jo psalmi që flet për Të se është në gjendje të forcojë. Nuk mjafton ta kesh psalmin. Ti duhet ta kesh Atë për të cilin flet psalmi. Ne gjithashtu e dinim vargun: “Hiri im të mjafton” (2 Korintasve 12:9). Por vargu në vetvete nuk mjafton. Është hiri që është i mjaftueshëm, dhe jo vargu.

Pastorët dhe dëshmitarët e zellshëm që e trajtojnë Fjalën si një thirrje prej Perëndisë janë në rrezik t’u japin fjalëve të shenjta më shumë vlerë sesa kanë në të vërtetë. Fjalët e shenjta janë vetëm mjete për të arritur tek realiteti që ato shprehin. Nëse jeni të lidhur me Realitetin, me Zotin e Plotfuqishëm, e keqja e humb fuqinë e vet mbi ju; ajo nuk mund ta thyejë dot Zotin e Plotfuqishëm. Nëse keni vetëm fjalët e Zotit të Plotfuqishëm, ju mund të thyheni fare lehtë.

Ushtrimet Shpirtërore

Përgatitja për punët e fshehta është një spiritualizëm i thellë. Ashtu sikurse ne ia heqim lëkurën qepës për ta përgatitur për gatim, po ashtu edhe Perëndia duhet të “heqë lëkurën” prej nesh për ato që janë vetëm fjalë, ndjesitë e kënaqësive tona në besimin fetar, me qëllim që të arrijë në realitetin e besimit tonë. Jezusi na ka thënë se “gjithsecilit që dëshiron të vijë pas” Tij do t’i duhet ta “marrë kryqin e tij” (Mateu 16:24), dhe Vetë Jezusi na tregoi sesa i rëndë mund të jetë ai kryq. Ne duhet të përgatitemi për këtë.

Shikojeni mënyrën e botës! Një reklamë për një revistë pornografike e ndez flakë imagjinatën. Në po të njëjtën mënyrë, ne duhet ta ndezim flakë imagjinatën duke pasur përpara nesh realitetet shpirtërore. Ne duhet të kryejmë ushtrime shpirtërore. Më vjen shumë keq që ushtrimet shpirtërore pothuajse nuk njihen fare në Protestantizëm. Neve duhet t’i rigjallërojmë ato në kishën e fshehtë. Ushtrimet shpirtërore mund të kenë qenë keqpërdorur prej disa katolikëve dhe pastaj erdhi Reformimi. Gjithnjë ekziston lëvizja e lavjerrësit. Nëse njëri ka rënë në njërin ekstrem, tjetri do të bjerë në ekstremin tjetër.

Ngaqë disa abuzuan me përdorimin e ushtrimeve të rreme shpirtërore, të tjerët nuk do të kryejnë fare ushtrime shpirtërore. Ne duhet të kemi jo vetëm çastet tona në lutje, në të cilat ne flasim, por gjithashtu duhet të kemi çastet e meditimit e përsiatjes. Ne mund të lexojmë tek Hebrenjve 11 listën e gjatë të atyre që u sharruan, u dogjën në turrën e druve, u përpinë nga luanët, por gjithashtu duhet t’i përfytyrojmë ato gjëra. Tani unë jam përpara luanëve, më kanë rrahur, rrezikoj të më djegin, etj. Si duhet të sillem në këtë lloj situatë?

Më kujtohet hera e fundit në Shkollën e së Dielës, përpara se të largohesha nga Rumania. Mora një grup prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë djem e vajza një të diel në mëngjes, dhe nuk i shpura në kishë por në kopshtin zoologjik. Përpara kafazit të luanëve iu thashë atyre: “Të parët tuaj në besim u hodhën përpara kafshëve të tilla të egra për besimin e tyre. Ta dini se edhe juve do t’ju duhet të vuani. Juve nuk do t’ju hedhin përpara luanëve, por do t’ju duhet të vuani në duart e njerëzve që do të jenë shumë herë më të këqij sesa luanët. Vendosni që tani dhe në këtë vend nëse dëshironi t’ia jepni besën tuaj Krishtit.” Ata patën lot në sy, kur thanë: “Po”.

Ne duhet të përgatitemi që tani, përpara se të burgosemi. Në burg, ju humbisni gjithçka. Të zhveshin e të japin uniformën e burgut. Nuk ka mobilje të bukura, qilima të bukur ose perde të bukura. Nuk e ke më bashkëshorten tënde dhe as fëmijët e tu. Nuk e ke më bibliotekën tënde dhe nuk do të shohësh kurrë një lule. Nuk mbetet më asnjë gjë, që e bën jetën të këndshme. Askush nuk i bën rezistencë personit që ka hequr dorë që më parë nga kënaqësitë e jetës. Ka një varg biblike te Kolosianëve lidhur me konsiderimin si të vdekur të gjymtyrëve tuaja që janë në tokë. Katolikët e paditur dhe të zellshëm kanë imponuar disa supersticionizma dhe ndëshkime të vetvetes. Protestantët kanë hequr dorë krejtësisht nga mortifikimi. Por ekziston një mortifikim i krishterë, një “heqje dorë” prej gëzimeve tokësore. I krishteri që e përgatit veten për këtë tani, nuk do ta vuajë humbjen e tyre kur të jetë në burg. Ju do të duhet t’i përdorni gjërat e botës pa lejuar që të lidheni emocionalisht me to.

Unë personalisht përdor një ushtrim. Jetoj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. A mund ta imagjinoni se si duket një supermarket amerikan? Atje gjeni shumë gjëra të shijshme. Unë i shoh të gjitha dhe i them vetes: “Mund t’ia dal pa këtë gjë e pa atë tjetrën; kjo gjëja është shumë e mirë, por mund të bëj pa të; mund t’ia dal edhe pa këtë gjënë e tretë gjithashtu”.

E vizitova të gjithë supermarketin dhe nuk shpenzova as edhe një dollar të vetëm. Pata gëzimin të shikoja shumë gjëra të bukura, dhe gëzimin e dytë të njohurisë se mund t'ia dilja pa to.

Ne gjithashtu kishim teologët modernë liberalë. Asnjëri prej tyre nuk duroi asnjë torturë. “Pse duhet që të vdes për një Perëndi të vdekur dhe për një Bibël problematike? Po qe se historitë e Adamit dhe Evës nuk janë të vërteta, nëse Jozueu nuk e ndaloi diellin, nëse profecitë u shkruan shumë vjet *pasi* ato ishin përmbushur, nëse Jezusi nuk u lind prej një virgjëreshe dhe nëse ai nuk u ringjall trupërisht prej së vdekurish – atëherë ka më tepër gënjeshtër në Bibël sesa në gazetën sovjetike *Pravda*. Pse duhet të vdes për diçka që nuk është e vërtetë ose që të paktën mbetet problematike?

Dyshimi prodhon tradhtarë

Unë jam Jude. Në hebraisht, gjuha që foli Vetë Jezusi dhe në të cilën u dha zbulesa e parë, nuk ekziston fjala “dyshim”. Të dyshosh do të ishte aq e gabuar për një njeri, sa do të ishte po të ecte me katër këmbë – ai nuk është bërë për të ecur me katër këmbë. Njeriu ecën me trupin e ngritur lart; ai nuk është një kafshë e egër. Të dyshosh është nënjerëzore.

Tek secili prej nesh vijnë dyshimet, por mos i lejoni dyshimet për doktrinat thelbësore të Biblës – të tilla si ekzistenca e Perëndisë, ringjallja e Jezus Krishtit, ose ekzistenca e jetës së përjetshme – të bëjnë fole në mendjen tuaj. Secili dyshim teologjik ose filozofik, ju bën një tradhtar potencial. Ju mund t’i lejoni vetes tuaj dyshime, ndërkohë që keni një studio të mirë dhe përgatisni predikime, kur hani mirë ose kur shkruani një libër. Pastaj ju mund t’ia lejoni vetes të gjitha llojet e ideve guximtare ose të dyshimeve. Kur torturoheni, këto dyshime shndërrohen në tradhti, për shkak se ju duhet të vendosni që të jetoni apo të vdisni për këtë besim.

Një nga gjërat më të rëndësishme për përgatitjen shpirtërore të një punëtori të fshehtë është zgjidhja për dyshimet e tij. Në matematikë, nëse nuk e gjeni zgjidhjen, do të keni bërë një gabim diku, prandaj ju e vazhdoni punën deri sa ta zbuloni gabimin. Mos jetoni me dyshimet, por kërkonit zgjidhjen e tyre.

Testi i torturës

Tani të vijmë pikërisht tek çasti i torturave. Ndonjëherë tortura është shumë e dhimbshme. Ata përdorin hekura të skuqur. Ndonjëherë është një rrahje e thjeshtë. Ne të gjithëve na kanë goditur kur ishim fëmijë dhe rrahja është thjesht një goditje tjetër. Një goditje e thjeshtë merret lehtë. Jezusi tha se ne duhet të vijmë tek Ai si fëmijët, që është më tepër si kandidatë për t'u rrahur!

Një mjeke erdhi tek unë dhe tha: “Çfarë duhet të bëj? Mendoj të hidhem nga dritarja. Ata më thërrasin vazhdimisht dhe duan që të më bëjnë një informatore të kishës së fshehtë. Ata më kërcënojnë se do të më rrahin, nëse nuk e pranoj këtë. Çfarë duhet të bëj? Është e tmerrshme ta mendoj se do të më rrahin. Nuk e duroj dot. Kam alternativën të bëhem një informatore, ose të hidhem nga dritarja.” I thashë: “Ke një zgjidhje tjetër. Jepi një shkop burrit tënd dhe thuaji të të fusë një të rrahur të mirë dhe shiko se si do ta durosh atë.” Mos kini frikë nga rrahja.

Megjithatë, me ne, komunistët nuk u ndalën me rrahjet - ata përdorën tortura shumë të rafinuara. Tani, siç mund ta dini, tortura mund të veprojë në dy mënyra. Mund t'ju kalitë e t'ju forcojë besimin për të mos i treguar asnjë gjë policisë. Ka vjedhës që u rezistojnë të gjitha torturave dhe nuk i tradhtojnë personat me të cilët kanë bashkëpunuar në vjedhje. Sa më tepër t'i rrihni, aq më kokëfortë bëhen ata. Ose tortura thjesht do t'ju thyejë vullnetin.

Tani do t'ju tregoj një rast shumë interesant që u botua nga Shtypi Komunist Çek. Ju do ta dini se nën Aleksandër Dabçek (Alexander Dubcek) pati një periudhë relaksimi dhe pastaj

ata do të publikonin gjëra të caktuara në Çekosllovakia. Në atë kohë doli një artikull. Novotni (Novotny), që ishte paraardhësi i Dabçek dhe që ishte një diktator komunist, pati arrestuar njërin prej miqve të tij më të ngushtë, një drejtues komunist, një ateist të bindur, dhe një anëtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste. (Në burg nuk ishin vetëm të krishterët, Judenjtë ose patriotët. Një komunist arrestonte një komunist tjetër dhe e torturonte njëlloj siç bënte me gjithë të tjerët.) Ata e arrestuan këtë drejtuesin komunist dhe e futën në qelinë e izolimit. Qelinë e përshkonin rrezet elektromagnetike, që shqetësojnë mendjen. Ditë e natë një altoparlant përsëriste: “A e ke emrin Jozef, apo nuk e ke emrin Jozef?” (Emri i tij nuk ishte Jozef.) “Mendo përsëri. A je Jozefi, apo nuk je Jozefi? Krimineli më i madh në Amerikë ka qenë Dillinxhër (Dillinger), kurse ti je një kriminel edhe më i madh sesa Dillinxhër. Si e ke emrin? A quhesh Jozef apo nuk quhesh Jozef? Ti je kundër-revolucionar, je spiun, po a je Jozefi apo nuk je Jozefi?”

Ata u përpoqën ta çmendnin atë. Ditë e natë. Ai po ndihej sikur po luante nga mendtë e kokës. Në një çast të caktuar, ai pati një ndriçim në mendje. “Tani po përballem me ligësi të pazbutur. Nëse komunistët e torturojnë një të krishterë, nuk është absolutisht gjë e keqe, ngaqë komunistët besojnë se ata do ta ndërtojnë parajsën në tokë. Të krishterët i pengojnë ata, kështu që është e drejtë t’i torturosh të krishterët. Por kur një komunist e torturon një komunist tjetër, kjo është torturë për hir të torturës. Nuk ka absolutisht asnjë shfajësim për të. Po prit pak. Çdo monedhë ka dy anë, çdo kabëll elektrik ka dy pole. Nëse ekziston kjo ligësi e pazbutur, kundër kujt lufton ajo? Duhet patjetër që të ekzistojë një mirësi e pazbutur gjithashtu. Ky është Perëndia, dhe ata luftojnë kundër Atij.”

Kur e thirrën tek hetuesi, ai hyri duke buzëqeshur në dhomë dhe u tha se mund ta fiknin altoparlantin tani, ngaqë e kishte kryer qëllimin. “Jam bërë i krishterë.” Oficeri e pyeti: “Si ndodhi

kjo?” Ai ia tregoi të gjithë historinë. Oficeri tha: “Prit pak.” Ai thirri disa prej shokëve të tij dhe i tha: “Të lutem përsërite të gjithë historinë përpara shokëve të mi.” Ai e përsëriti historinë dhe kapiteni i tha oficerit tjetër të policisë: “Të thashë se kjo metodë nuk do të funksiononte. Ju e tepruat me të.”

Djalli nuk është i plotfuqishëm dhe i gjithëditur si Perëndia. Ai bën gabime. Tortura e ligë është një tepri e cila mund të përdoret shumë mirë nga ana shpirtërore.

Çasti i krizës

Tortura ka një çast shpërthimi dhe torturuesi pret për këtë çast kritik. Mësoni si ta mposhtni dyshimin dhe si të mendoni tërësisht. Gjithmonë ka një çast krize kur jeni gati të shkruani ose të shqiptoni emrin e bashkëpunëtorit tuaj në punën e fshehtë, ose të thoni ku ndodhet shtypshkronja e fshehtë, ose diçka të tillë. Ju kanë torturuar aq shumë, saqë tanimë asgjë nuk llogaritet; fakti se nuk do të kem dhimbje gjithashtu nuk llogaritet. Nxirrni këtë përfundim të fundit në fazën ku keni mbërritur dhe do ta shihni se do ta mposhtni këtë çast krize; ju jep një gëzim të madh të brendshëm. Keni ndjesinë se Krishti ka qenë me ju në atë çastin vendimtar. Rojet e burgut janë të trajnuar e të rafinuara, të vetëdijshëm se ekziston një çast krize. Nëse nuk mund të nxjerrin asgjë prej jush në atë çast, ata heqin dorë nga torturimi juaj: ata e dinë se nuk ka dobi ta vazhdojnë atë.

Kur isha një i krishterë i ri më kanë thënë që duhej të lexoja përditë; dhe për këtë arsye lexoja edhe me tim bir, Mihain, që kur ai ishte tre ose katër vjeç, duke lexuar një faqe nga Bibla dhe nga jeta e një shenjtori ose martiri. Lexova *Librin e Martirëve të Foksit*; lexojani fëmijëve tuaj. Mësojini ata sesi martirët e mposhtën çastin e krizës.

Ka edhe disa pika të tjera në lidhje me torturën. Është shumë e rëndësishme ta kuptojmë atë që tha Jezusi: “Mos u shqetësoni për të nesërmen, sepse e nesërmja do të shqetësohet për gjërat e veta” (Mateu 6:34). Unë bëra katërmbëdhjetë vjet burg. Vëllai Hrapov bëri njëzet e gjashtë, Uong Ming-Dao (Wong Ming-Dao) bëri njëzet e tetë. Duket e pamundur të durosh vite të gjata në burg. Juve nuk ju kërkohet ta duroni të gjithën atë periudhë

njëherësh. Mos duroni as edhe një ditë njëherësh – duroni një orë njëherësh. Një orë dhimbjeje e duron gjithkush. Të gjithë kemi pasur dhimbje të tmerrshme dhëmbi, një aksident me makinë – duke kaluar, ndoshta, përmes vuajtjesh të patregueshme. Juve nuk ju kërkohet të duroni dhimbjen më tepër sesa në këtë minutën e tanishme. Ajo që e shumëfishon dhimbjen është kujtimi se më kanë rrahur e më kanë torturuar kaq shumë herë, dhe se nesër do të më marrin sërish, madje edhe pasnesër. Nesër unë mund të mos jem gjallë – ose ata mund të mos jenë gjallë. Nesër mund të ketë përmbyse pushteti, si në Rumani. Rrahja e së djeshmes ka kaluar; tortura e së nesërme nuk ka ardhur akoma.

Unë jam bërë profesor në torturologji. Në fillim, tortura është një goditje e llahtarshme dhe ka dhimbje të tmerrshme. Por vazhdimi nuk është njëlloj. Kardinali Mindsenti (Mindszenty) nuk u lejua të flinte për njëzet e nëntë ditë e net. Pas kësaj ai deklaroi gjithçka që i kërkuan. Tani, çfarë ndodhi? Pas disa ditësh e netësh pa fjetur fare, ose pas disa ditësh me tortura intensive fizike, vjen një çast, kur për ty nuk ia vlen të llogaritet më asgjë. Ti harron për detyrat që ke ndaj bashkëshortes tënde dhe ndaj fëmijëve të tu, ndaj emrit tënd të mirë dhe ndaj Perëndisë. Bëhesh absolutisht indiferent ndaj gjithçkaje. Ky është çasti kritik kur nevoja për të marrë frymë siç duhet bëhet realitet. Praktikoni të merrni frymë siç duhet.

Arti i frymëmarrjes ka shumë kuptim në fetë Hindu dhe Budizëm në ushtrimet që bëjnë gjatë jogës. Lexoni për llojet e ndryshme të frymëmarrjes në Bibël. Jezusi “fryu frymën” mbi apostujt. Thuhet se Jezusi fryu mbi ta Frymën e Shenjtë. Pra, është një mënyrë e veçantë frymëmarrjeje që përcjell Frymën e Shenjtë. Në Kishën Ortodokse, gjatë pagëzimit, prifti dhe kumbarët “fryjnë frymën” tri herë mbi fëmijën. Kur Jezusi fryu, ai fryu Frymën e Shenjtë. Tek Veprat e Apostujve 9 shkruhet se Sauli po nxirrte frymën e “kërcënimeve dhe vrasjeve.” Ka vrasës që fryjnë krimin. Tek libri i Jeremias është shkruar për disa që

hingëllijnë pas grave të burrave të tjerë.” Është fryma e një kurorëshkelësi. Ka një lloj frymëmarrjeje bazuar mbi emocionet. Përpiquni ndonjëherë të bëni sherr me dikë duke marrë frymë qetësisht, me ritëm dhe thellë. Do të zbuloni se nuk mund të ziheni me të.

Frymëmarrja e duhur është njëra nga mënyrat për t'i rezistuar torturës. Tradhtia do të thotë një çarje në të gjithë kishën. Ju jeni një i krishterë tek i cili ka besim Perëndia dhe kaq shumë njerëz të tjerë. Juve ju janë besuar sekretet e kishës së fshehtë. Tradhtia do të sjellë emocione të fuqishme. Ju nuk mund të ziheni me dikë e t'ju bërtisni atyre, ndërkohë që jeni duke marrë frymë thellë e në mënyrë ritmike. Dhe as nuk mund të kaloni përmes emocionit të tradhtisë, nëse jeni duke marrë frymë në këtë mënyrë. Nën torturë, merrni frymë ashtu si një tradhtar nuk mundet dot. Merrni frymë në mënyrë ritmike, qetësisht – shumë thellë, deri tek thembra. Oksigjenimi i jep rezistencë të gjithë trupit, gjë që balancon reagimet tuaja dhe ju jep një qëndrim të drejtpeshuar.

Edhe një gjë tjetër, që një punëtor i fshehtë duhet ta dijë, jo vetëm me mendjen, por ta dijë në majë të gishtave: ai duhet ta dijë se i përket trupit të Krishtit. Ai i përket një trupi që ka qenë duke u fshikulluar për afro 2000 vjet. Gjithmonë ka qenë fshikulluar, jo vetëm në Golgota, por nën perandorët Romakë dhe prej kaq shumë përndjekësve. Ka qenë fshikulluar nën nazistët, dhe ka qenë fshikulluar në Rusi për më tepër se shtatëdhjetë vjet. Kur u ktheva në besim, *në mënyrë të ndërgjegjshme* u bëra pjesë e një trupi të fshikulluar; një trupi të tallur; një trupi që e kanë pështyrë; dhe një trupi të kurorëzuar me një kurorë gjembash, me gozhdët që ia ngulën në këmbët e në duart. E pranoj këtë si fatin tim të mundshëm në të ardhmen. Unë nuk do të mendoj kurrë për Jezus Krishtin se ai ka qenë kryqëzuar vetëm 2000 vjet përpara. Vuajtjet e Jezusit në trupin e Tij mistik duhet të bëhen realiteti për mua.

Dashuria Supreme

Bibla mëson disa fjalë që janë shumë të vështira për t'u pranuar: "Ai që e do nënën e babanë më shumë se Mua, nuk është i denjë për Mua. Dhe ai që e do djalën ose vajzën më shumë se Mua nuk është i denjë për Mua" (Mateu 10:37). Këto fjalë nuk kanë pothuajse asnjë kuptim në një vend të lirë.

Ndoshta ju e dini nga publikimet e Zërit të Martirëve se mijëra fëmijë janë marrë prej prindërve të tyre në ish-Bashkimin Sovjetik, ngaqë ata i mësonin për Jezus Krishtin. Ju duhet ta doni Krishtin më tepër sesa familjen tuaj. Ja ku jeni përpara një trupi gjykues dhe gjyqtari ju thotë se, nëse e mohoni Krishtin ju mund t'i mbani fëmijët tuaj. Nëse jo, kjo do të jetë hera e fundit që i shihni ata. Zemra mund t'ju thyhet, por përgjigjja juaj duhet të jetë: "Unë e dua Perëndinë."

Nadia Sloboda e la shtëpinë e saj për të kaluar katër vjet në burg. Ia morën fëmijët, por ajo u largua nga shtëpia duke kënduar. Fëmijët, të cilët policia po i priste me një kamion për t'i marrë, ndërsa ajo po largohej, i thanë nënës së tyre që këndonte: "Mos u shqetëso për ne. Kudo që të na shpien, ne nuk do ta braktisim besimin tonë." Ata nuk e braktisën besimin. Kur Jezusi ishte në kryq, ai vuajti jo vetëm fizikisht, ngaqë e kishte nënën e Tij përballë duke vuajtur. Nëna e Tij dha të Birin që të vuante. Ata e deshën njëri-tjetrin, por lavdia e Perëndisë ishte në rrezik, dhe në lidhje me këtë cilado ndjenjë njerëzore duhet të jetë dytësore. Vetëm nëse e marrim këtë qëndrim njëherë e përgjithmonë, mund të përgatitemi për punën e fshehtë.

Vetëm Krishti, Vuajtësi i Madh, Njeriu i Dhimbjeve, duhet të jetojë brenda nesh. Ka pasur raste në vendet komuniste, kur

torturuesit komunistë i hodhën shkopinjtë e tyre të gomës me të cilët po rrihnin një të krishterë dhe e pyetën: “Ç’është kjo aureolë që ke rreth kokës? Si ka mundësi që të shkëlqen fytyra? Nuk mundem dot të vazhdoj të të rrah.” Thuhet në Bibël për Stefanin se “fytyra e tij shkëlqeu.” Ne kemi dijeni për raste të torturuesve komunistë që i thoshin të burgosurit: “Bërtit me zë të lartë, ulëri me zë të lartë, sikur do të të rrihja, që kolegët e mi të mendojnë se jam duke të torturuar. Por unë nuk mundem dot të të rrah ty.” Kështu që, ju do të bërtisnit duke mos ju ndodhur asnjë gjë.

Ka pasur raste të tjera kur të burgosurit vërtet janë torturuar, ndonjëherë deri në vdekje. Ju duhet të zgjidhni mes të vdekurit me Krishtin dhe për Krishtin ose të bërit tradhtar. Cila është vlera e vazhdimit të jetës, kur do të të vijë turp ta shohësh veten në pasqyrë, duke e ditur se pasqyra do të të tregojë fytyrën e një tradhtari?

Të menduarit në këtë mënyrë është kërkesa e parë e nevojshme e të qenit një punëtor i fshehtë, sidomos një pastor i fshehtë—dhe ajo që është më e rëndësishme, bashkëshortja e një pastori të fshehtë. Ajo luan një rol të jashtëzakonshëm. Ajo duhet ta forcojë atë; ajo duhet t’i japë atij guximin për t’i bërë të gjitha gjërat. Nëse ajo i kërkon atij të shohin filma ose të ndjekin kënaqësitë rastësore të jetës, ai nuk mund të jetë një luftëtar i fshehtë. Asaj i duhet ta shtyjë atë për të punuar dhe për të luftuar. Asaj i duhet ta flijojë veten.

Mësoni të Jeni të Heshtur

Një gjë tjetër që na duhet ta mësojmë në kishën e fshehtë është të jemi të heshtur. Pastorët, nga vetë profesioni i tyre, janë njerëz muhabetçinj, njerëz që flasin. Tani, një pastor nuk nënkuptohet se do të rrijë duke folur tërë kohën. Askush nuk mund të predikojë mirë, po qe se nuk dëgjon mirë. Kur shoh prapa në mënyrën sesi jam sjellë me shpirtrat, kam fituar më tepër shpirtra duke i dëgjuar ata, sesa duke iu folur atyre. Njerëzit kanë kaq shumë barra brenda zemrave të tyre, dhe nuk ka asnjë njeri që ka durimin t'i dëgjojë ata. Madje as bashkëshorti juaj nuk ka durim, as grua juaj apo fëmijët tuaj. Këta të fundit janë të rinj dhe duan të shkojnë diku. Nuk është askush që do t'ju dëgjojë. Nëse dikush gjen një burrë që dëgjon, ai mund të fitohet pa shumë bisedë. Në kishën e fshehtë, heshtja është një nga rregullat e para. Çdo fjalë e tepërt që thoni, mund ta fusë dikë në burg. Një miku im, një kompozitor i madh i krishterë, shkoi në burg, ngaqë të krishterët kishin zakon të thoshin: “Sa e bukur është kjo kënga e kompozuar nga Vëlla _____.” Ata e lavdëronin atë, dhe për këtë gjë, ai kaloi pesëmbëdhjetë vjet në burg. Këndojeni këngën, por mos e përmendni emrin e atij që e ka shkruar atë.

Ju nuk mund të mësoni të rrini të heshtur në çastin që vendi pushtohet. Ju duhet të mësoni të jeni të heshtur që nga çasti i kthimit tuaj në besim. Një i krishterë është një burrë që flet pak dhe thotë fjalë me peshë të madhe. Ai mendon, nëse duhet ta thotë një fjalë, nëse ajo do të sjellë dëm apo jo. Në kishën e fshehtë çdo fjalë e panevojshme mund të shkaktojë dëm.

Solzhenjitsin (Solzhenitsyn), fituesi i çmimit Nobel, tha në një intervistë se personi që kishte qenë përndjekësi i tij më i

madh, që e kishte denoncuar atë, ishte vetë ish-bashkëshortja e tij.⁵¹ Shkruhet tek libri i Predikuesit që të mos ia thuash sekretet e zemrës tënde, madje as bashkëshortit / bashkëshortes tënde. Kjo është Fjala e Perëndisë. Perëndia e dinte se do të kishim një kishë të fshehtë, dhe Ai e dinte se në një çast të caktuar një bashkëshort / bashkëshorte mund të zemërohej me ju lidhur me një pyetje të caktuar. Sekretarja e Solzhenjitsinit u vu kaq shumë nën presion prej komunistëve (ngaqë ishte denoncuar prej gruas së Solzhenjitsinit), saqë i dha fund jetës së vet duke u vetëvarur. Nëse Solzhenjitsini do të kishte ndenjur i heshtur, kjo gjë nuk do të kishte ndodhur.

Edhe një çështje tjetër që është shumë e rëndësishme: Unë e falënderoj Perëndinë për vitet që kalova në qelinë e izolimit. Për tre vjet, ndodhesha afro dhjetë metra nëntokë. Nuk dëgjova kurrë një fjalë. Nuk thashë kurrë një fjalë. Nuk kishte libra. Zërat e jashtëm ndaluan. Rojet kishin këpucë me taban të butë; nuk i dëgjoje kurrë se po afroheshin. Pastaj, me kalimin e kohës, zërat e brendshëm pushuan. Neve na drogounin, na rrihnin. E harrova krejt teologjinë. E harrova krejt Biblën. Një ditë vura re se e kisha harruar edhe “Ati ynë.” Nuk mund ta thosha më atë. E dija se fillonte me “Ati ynë...,” por nuk e dija si vazhdonte. Thjesht vazhdova të isha i lumtur e thashë: “Ati ynë, e kam harruar lutjen, por me siguri ti e di atë përmendësh. Ti e dëgjon atë kaq shumë mijëra herë brenda ditës, saqë mund t’i thuash një engjëlli ta thotë atë në vendin tim dhe unë thjesht do të rri në heshtje.” Për njëfarë kohe, lutjet e mia ishin: “Jezus, unë të dua.” Dhe pastaj pas pak kohe sërish: “Jezus, të dua. Jezus, të dua.” Pastaj u bë tepër e vështirë edhe për ta thënë atë shprehje,

⁵¹ Në vitin 1973, Solzhenjitsini shkroi një novelë të diskutueshme, të titulluar: “*Arkipelagu i Gulagut*”. Në këtë novelë ai përmendi disa individë me emër, dhe për sigurinë e tyre, kishte frikë ta publikonte atë. Por në njëfarë mënyre autoritetet mësuuan për këtë gjë. Tradita thotë se ishte gruaja e Solzhenjitsinit që u tregoi autoriteteve për këtë novelë.

ngaqë na ngopnin me droga, të cilat na shkatërronin mendjen. Ishim shumë të uritur. Hanim vetëm një fetë bukë në javë. Ishin edhe rrahjet, torturat, mungesa e dritës dhe gjërat e tjera. U bë e pamundur që ta përqendroja mendjen edhe për të thënë kaq shumë fjalë sa: “Jezus, unë të dua.” E braktisa atë, ngaqë e dija se nuk ishte e domosdoshme. Forma më e lartë e lutjes që njihja ishte rrahja e qetë e një zemre që e do Atë. Jezusi duhej thjesht ta dëgjonte: “tik-tak, tik-tak,” dhe Ai do ta dinte që secila rrahje zemre është për Të.

Kur dola nga qelia e izolimit dhe isha bashkë me të burgosurit e tjerë e i dëgjoja të flisnin, pyesja veten se pse po flisnin! Kaq shumë prej të folurit tonë është i padobishëm. Sot burrat njihen me njëri-tjetrin dhe njëri thotë: “Si je?” e tjetri i përgjigjet: “Si je?” Çfarë dobie ka kjo? Pastaj njëri thotë: “A nuk mendon se koha është e mirë?” dhe tjetri mendohet e thotë: “Po, mendoj se është e mirë.” Pse duhet të flasim nëse moti është i mirë? Ne nuk e marrim seriozisht fjalën e Jezusit që thotë se njerëzit do të gjykohen jo për çdo fjalë të keqe, por për çdo fjalë të padobishme. Kështu është shkruar në Bibël. E folura e padobishme në disa vende mund të nënkuptojë burgim dhe vdekje për vëllain tënd. Një fjalë lavdërimi për vëllain tënd, nëse nuk është e domosdoshme, mund të nënkuptojë katastrofë. Për shembull, dikush të vjen për vizitë dhe ti i thua: “Oh! Më vjen kaq keq që nuk ishe këtu më përpara – Vëllai V. sapo u largua.” Vizitorja mund të jetë një informatore e policisë sekrete. Tani ajo do ta dijë se Vëllai V. është në qytet! Mbajeni gojën të mbyllur. Mësoni si ta bëni këtë gjë tani.

Dredhitë e lejueshme në luftë

Ju nuk mund të bëni punë të fshehtë pa përdorur dredhi luftime. Di për një rast që ndodhi në Rusi. Komunistët dyshonin se të krishterët po mblidheshin diku dhe ata po mbanin nën vëzhgim një rrugë. Ata e dinin se takimi duhej të mbahej diku. Panë një djalë të ri që shkonte drejt shtëpisë ku ata supozuan se duhej të mbahej takimi. Policia e ndaloi djalin dhe e pyeti: “Ku po shkon?” Me një fytyrë të trishtuar, ai tha: “Vëllai im i madh vdiq dhe tani po e mbledhim të gjithë familjen që të lexojmë testamentin e tij.” Oficeri i policisë u impresionua kaq shumë, sa që i rrahu shpatullat djalit dhe i tha: “Shko.” Djali nuk gënjeu.

Një vëlla ishte marrë në polici dhe e kishin pyetur: “A vazhdoni të mblidheni nëpër takime?” Ai u përgjigj: “Shoku kapiten, tani takimet e lutjes janë të ndaluara.” Kapiteni iu përgjigj: “Ashtu, është mirë që po veproni në përputhje me këtë. Thjesht shko.” Vëllai nuk kishte thënë se ai kishte vepruar në përputhje me rregullin; ai nuk kishte thënë se ai nuk shkonte nëpër takime.

Një korrier nga “Zëri i Martirëve” shkoi në një vend komunist. Atë e ndaluan në kufi dhe e pyetën: “Çfarë librash keni me vete?” Ai tha: “Kam fjalët e Shekspirit dhe fjalët e Jehovahit.” Oficeri i policisë nuk dëshoi t’i bënte të ditur se ai ishte injorant. Jehovahi mund të ishte ndonjë poet tjetër i madh britanik dhe të thoshte se nuk kishte dëgjuar ndonjëherë për Jehovahin mund të turpërohej. Ai tha: “Mirë, mirë, vetëm kalo.” Këto janë dredhi të lejueshme në luftë.

Nëse engjëjt ekzistojnë si përralla që u tregohen fëmijëve, unë nuk kam nevojë për ta. Engjëjt janë realë; secili prej nesh ka një engjell ruajtës të vetin. Atje ku mblidhen të krishterët,

gjithashtu mblidhen edhe demonët. Neve na duhet të mbështetemi tek engjëjt dhe tek Fryma e Shenjtë. Ne nuk jemi të detyruar t'i tregojmë të vërtetën një tirani ateist. Ne nuk jemi të detyruar t'i tregojmë atij se çfarë jemi duke bërë. Është e pahijshme nga ana e tij që të më bëjë pyetje, një pafytyrësi.

Nëse unë thjesht do të pyesja: “Sa lekë keni në bankë?” ose “Sa e keni rrogën mujore?” A nuk do të ishte e turpshme? Pyetje të tilla nuk duhen bërë. Ju nuk nënkuptohet ta pyesni një vajzë: “A ke të dashur apo jo? A je e dashuruar me ndokënd?” Ajo mund të mos dojë t’ju tregojë juve një gjë të tillë. Prandaj, asnjë njeri nuk duhet të më bëjë presion për veprimtarinë time fetare, nëse nuk dua t’ia tregoj atij këtë gjë. Kjo është futje hunde në punët e mia private. Shteti ateist nuk ka asnjë të drejtë të bëjë pyetje të tilla dhe ne nuk jemi të detyruar t’u përgjigjemi atyre.

Gjatë marrjes në pyetje, ata ju bëjnë të gjitha llojet e pyetjeve. Komunistët më thoshin mua: “Ti je i krishterë dhe je pastor. Nënkuptohet të thuash të vërtetën. Tani na trego, kush janë drejtuesit e kishës së fshehtë? Ku mblidheni ju? Kë takoni ju? Cilët janë drejtuesit në qytetet e ndryshme?” Po të kisha treguar të vërtetën, do të ishin bërë arrestime të panumërta të burrave, që nga ana e tyre do të kishin treguar të vërtetën etj. Kësaj gjëje i duhet bërë rezistencë. Kur rezultatet e të bërit rezistencë janë rrahjet e torturat, ju duhet t’i merrni ato mbi veten tuaj, edhe sikur të duhet të vdisni.

Njoh një pastor që sot ka përjetuar dhimbje po aq të mëdha sa ato që pata unë kur më rrihnin, ngaqë ai luante regbi. Diçka i ndodhi në këmbë dhe kjo i jep dhimbje te tmerrshme. Për regbin, unë i marr mbi vete dhimbjet dhe, kur të zhduket dhimbja, do të luaj sërish regbi duke e ditur se do të më ndodhë ndonjë aksident tjetër. Kështu që, ne i marrim mbi vete dhimbjet fizike për regbin, që është një sport, një kënaqësi dhe gjë e shëndetshme për trupin. Në të njëjtën mënyrë, ju merrni mbi vete dhimbjet

fizike të torturës për t'i mbrojtur vëllezërit tuaj, që të mos i arrestojnë. Gjëja më e keqe që mund të ndodhë është se ju do të vdisni nën torturat. Por vdekja është gjëja më natyrale në botë.

Një lypës ndaloi tek shtëpia e një të pasuri dhe i tha: A mundet, të lutem, të fle një natë këtu? Nuk kam një vend për të fjetur.” I pasuri tha: “Ik tutje prej këtu, lypës. Ky nuk është hotel.” I varfri tha: “Më fal; do të iki më tutje.” Pastaj i tha: “Por më përpara, a do të më përgjigjesh për një pyetje? E pashë këtë shtëpi. M’u duk kaq e bukur. Kush e ka bërë këtë shtëpi?” Tani i pasuri u ndie i lajkatur dhe tha: “Këtë shtëpi e ka ndërtuar gjyshi im.” “Dhe ku është tani gjyshi yt?” “Ai vdiq para shumë kohësh.” “Kush jetoi në shtëpi pas gjyshit tënd?” “E po, babai im.” “A jeton ende ai?” “Jo, edhe ai vdiq.” “Dhe kush jeton në shtëpi tani?” “Unë.” “Dhe ti do të vdesësh gjithashtu?” “Po.” “E kush do të jetojë në shtëpi pasi të vdesësh ti?” “E po, shpresoj se fëmijët e mi.” Pastaj lypësi tha: “Po pse më bërtet mua? Ti the se ky nuk ishte hotel. Është një dhomë hoteli. Ti i paketon gjërat e tua, dikush tjetër vjen.” Vdekshmëria juaj është e dukshme; merreni si pikëpamjen tuaj për jetën në përgjithësi. Nëse Perëndia do që unë të vdes sot, ai nuk ka nevojë për një torturues. Mund të vdes nga një sulm në zemër, pa një torturues. Prandaj, torturuesi nuk mundet dot ta shkurtojë jetën time as për një ditë të vetme. Asnjëherë nuk mundet që restoranti më i mirë me ëmbëlsirat më të mira të ma zgjatë jetën vetëm me një ditë. Unë vdes atëherë kur më thërret Perëndia.

Zënkat e pabesa

As edhe zënka më e lehtë nuk lejohet në kishën e fshehtë. Secila zënkë në kishën e fshehtë do të thotë arrestime, rrahje e ndoshta vdekje. Kundërshtarët tanë vëzhgojnë e dëgjojnë. Ata kanë informatorët e tyre në kishën e fshehtë. Kurdoherë që ka një sherr, ka akuza të ndërsjella. Njëri do t'i thotë tjetrit: “Kur ishe me vëllain Smith, ti bëre këtë, etj.” Kështu që policia e merr Smithin.

Zënkat gjithnjë nxjerrin emrat dhe tregojnë faktet. Prandaj, fjala është e shkruar në Bibël: “Një shërbëtor i Zotit nuk duhet të zihet, por të jetë i butë me të gjithë” (2 Timoteut 2:24). Di për një qytet në Rumani, ku pati një sherr të tmerrshëm mes dy bashkësive. Njëra ishte Baptiste dhe tjetra ishte Vetëm Vëllezërit⁵². Ishte një zënkë kaq e tmerrshme, saqë rezultoi me arrestimin e drejtuesve të të dyja organizatave.

Do të ishte më mirë të fillonit sot që të ishit një shenjtor. Do të ishte tepër vonë të nisnit të ishit i shenjtë, kur të shkonit në parajsë! Atëherë, nuk do t'ia dinit nga t'ia nisnit. Duhet ta filloni atë tani. Atëherë, nëse në një rast pushtimi do të ishte më mirë që të mos ziheshit, gjëja më e mirë është të mos ziheni që tani.

Për fat të keq, ka sherre mes organizatave që punojnë në rrethana të rrezikshme. Ato duhen shmangur sa më shumë. Madje edhe një sherr brenda familjes mund të nënkuptojë vdekje. Isha në të njëjtën qeli me një burrë që kishte pasur një të dashur. Ashtu siç ndodh në moshë të re, ai kishte takuar një vajzë tjetër,

⁵² Vetëm Vëllezërit janë një degë e Vëllezërit e Plejmuthit, një sekt protestant i Krishterimit. Ata ndjekim mësimet e një burri me emrin Xhon Derby (John darby).

të cilën e kishte preferuar para vajzës së parë. Por asaj vajze ai i pati treguar sekrete të ndryshme, dhe vajza njoftoi Policinë Sekrete. Ai u burgos me burgim të përjetshëm. Në burg u çmend.

Përgatitja për punën e fshehtë është gjëja më themelore në përgatitjen për një punëtor normal të krishterë, vetëm se është më e thellë dhe duhet të bëhet shumë më tepër reale—një pjesë e jetës. Kam informacion për shtete, ku shumë bashkësi janë shkatërruar prej një sherri mes dy pastorëve ose dy pleqve të kishës. Kjo ndodh kudo, por në një vend tiranik, kjo gjë nënkupton burgosje dhe ndoshta vdekje.

T'i bësh Rezistencë Trushpëlarjes

Një nga metodat më të fuqishme nuk është vetëm tortura fizike, por shpëlarja e trurit. Ne duhet ta dimë sesi t'i bëjmë rezistencë trushpëlarjes. Trushpëlarja ekziston edhe në botën e lirë. Shtypi, radioja dhe televizioni na i shpëllajnë trutë. Nuk ka asnjë motiv në botë për ta pirë pijen Coca-Cola. Ju e pini atë ngaqë jua kanë shpëlarë trutë. Uji i thjeshtë sigurisht që është më i mirë sesa Coca-Cola. Por askush nuk bën reklamë: “Pini ujë, pini ujë.” Po t'i bënin reklamë ujit, ne do të pinim ujë.

Disa e kanë shpënë këtë teknikën e trushpëlarjes në ekstremim e saj. Metodat variojnë, por trushpëlarja në burgun tim në Rumani konsistonte thelbësisht në këtë: ne duhej të rrinim ulur për shtatëmbëdhjetë orë në një formë e cila nuk na jepte mundësinë për t'u përkulur dhe nuk lejohej as t'i mbyllnim sytë. Për shtatëmbëdhjetë orë në ditë duhej të dëgjonim: “Komunizmi është i mirë, komunizmi është i mirë, komunizmi është i mirë, ...; Krishterimi ka vdekur, krishterimi ka vdekur, krishterimi ka vdekur,...; Dorëzohuni, dorëzohuni,...”. Mërziteshe edhe vetëm pas një minute duke dëgjuar këto, por duhej t'i dëgjoje edhe për të tëra shtatëmbëdhjetë orët për javë, muaj e madje edhe vite të tëra, pa asnjë ndërprerje. Mund t'ju siguroj se nuk ishte e lehtë. Ishte një nga torturat më të këqija, shumë më e keqe nga torturat fizike. Por Krishti i ka parashikuar të gjitha gjërat, ngaqë me Të nuk ekziston koha. E ardhmja, e shkuara dhe e tanishmja janë të gjitha njësoj: Ai i di të gjitha gjërat që nga fillimi. Komunistët e shpikën trushpëlarjen tepër vonë! Krishti e kishte shpikur tashmë të kundërtën e trushpëlarjes – larjen e

zemrës. Ai kishte thënë: “Të bekuar janë ata që kanë zemër të pastër, sepse ata do ta shohin Perëndinë” (Mateu 5:8).

Stefani, martiri i parë për Krishtin, pati rreth vetes qindra njerëz me gurë të mëdhenj ndër duar për t'i hedhur drejt tij. Ai tha: “Po shoh...” dhe gruaja e Stefanit ndoshta mendoi se ai e pa rrezikun ku ndodhej dhe do t'ia mbathte me të katra. Por ai tha: “Po shoh *Jezusin* që rri në këmbë në të djathtën e Perëndisë.” (Veprat e Apostujve 7:56). Ndoshta ajo tha (nuk është regjistruar): “A nuk i sheh të gjithë në turmë rreth teje gati për të të gjuajtur me gurë?” “Oh po! Po shoh disa milingona të vogla atje poshtë, që nuk ia vlen të përmenden. Unë po shoh *Jezusin*.” Ai nuk i pa ata që dëshironin ta vrisnin atë. Të bekuar janë të pastrit në zemër.

Unë pata kaluar përmes trushpëlarjes për gati dy vjet. Komunistët do të kishin thënë se truri im ishte ende i ndotur. Në të njëjtin ritëm me të cilin ata thoshin: “Krishterimi është i vdekur,” unë dhe të tjerët i përsërisnim vetes: “Krishti gjithashtu ka qenë i vdekur, Krishti gjithashtu ka qenë i vdekur.” Por ne e dinim se Ai u ringjall së vdekuri. Ne kujtonim se jetuam në bashkësinë e shenjtorëve.

Ne zakonisht besojmë se shenjtorët që kanë kaluar në praninë e Zotit ndodhen diku në qiej rreth yjeve. Bibla na tregon se ku ndodhen ata. “Ngaqë ne jemi rrethuar prej një reje kaq të madhe dëshmitarësh...” (Hebrenjve 12:1). Pse duhet që ata të rrinë ulur mes yjeve? Ata ndodhen këtu, ku janë luftëtarët dhe vuajtësit e vërtetë. Në botën e Frymës nuk ekziston koncepti këtu dhe atje. Konceptet e hapësirës dhe kohës nuk ekzistojnë në botën e Frymës. Ne ishim të izoluar në burg, por ata ishin përreth nesh. Ne e ndienim praninë e shenjtorëve gjatë të gjithë kohës. Unë personalisht e kisha shumë ndjesinë e pranisë së Maria Magdalenës. Mendoja gjatë procesit të trushpëlarjes: “Ç’po më thonë ata se krishterimi është i vdekur? Duke supozuar se ata kanë të drejtë, çfarë ndryshimi do të përbëjë kjo gjë? Po të

supozojmë se nuk ka asnjë të krishterë të vetëm në botë, përveç meje, çfarë ndryshimi do të përbënte kjo gjë? Maria Magdalena thjesht e donte Jezusin. Nëse Jezusi ishte i vdekur, ajo e deshi Jezusin e vdekur. Ajo ndenji tek varri i Jezusit të vdekur, i cili nuk mund të bënte asnjë gjë për të. Ai nuk mundej as të ngrinte një gisht për ta ndihmuar atë; Ai nuk mund të bënte asnjë mrekulli për të; Ai nuk mund t'i thoshte as edhe një fjalë ngushëllimi. Ai nuk mund të fshinte një lot – asnjë. Ai ishte Shpëtimtari. Prandaj, po sikur të më thuash se Ai është i vdekur? Unë e dua Atë po aq shumë sikur Ai të ishte i gjallë. Nëse e tërë kisha do të vdiste ose do ta humbte besimin e saj, kjo nuk përbën motiv për mua që ta humb besimin tim.”

Ne duhet që të arrijmë tek një bindje e plotë e besimit. Unë ju kam thënë se fjalët “të dyshosh” nuk ekzistojnë në Hebraisht. Kjo shprehje nuk ekziston në Dhjatën e Vjetër. Më lejoni t’ju tregoj një fjalë tjetër e cila nuk ekziston në Hebraisht? Shpesh akuzohesha prej drejtuesve të Këshillit Botëror të Kishave. Ata shkruan kundër meje: “Vurmbrandi e pikturon situatën prapa Perdes së Hekurt në bardhë e zi. Nuk është e tillë. Ekziston ngjyra gri.” Unë përgjigjem se e pranoj këtë, po të më tregojnë nga të dyja Dhjatat fjalën “gri.” Ekzistojnë në Dhjatën e Re shumë ngjyra – “grija,” një përzierje, nuk ekziston. Një gjë është ose e vërtetë, ose e pavërtetë; është e drejtë ose e gabuar. Është e bardhë ose është e zezë. Të duhet të shkosh me botën ose të duhet të shkosh me Krishtin. Prandaj Dhjata e Vjetër, në Hebraisht, nuk i ka fjalët “të dyshosh.” Ne duhet të jemi të sigurt në këto problemet e besimit po ashtu siç jemi të sigurt për tabelën e mbledhjes dhe të shumëzimit. Dy dhe dy bëjnë katër. Kjo është e vërtetë. Nëse familja ime është e gjallë apo i kanë vrrarë, nëse kam mjaftueshëm apo do të vuaj urie, nëse jam i lirë apo ndodhem në burg, nëse më kanë rrahur apo më ledhatojnë, e vërteta e matematikës nuk ndryshon. Dy përkëdhelje plus dy përkëdhelje bëjnë katër përkëdhelje, dhe dy rrahje plus dy rrahje bëjnë katër rrahje.

Siguria e së Vërtetës dhe një dashuri si ajo e Maria Magdalenës ju aftësojnë për t'i rezistuar trushpëlarjes. Rezistoni deri në ekstrem.

Unë nuk dua që të shtirem si hero. Jam njeri dhe si çdo njeri kam ulje-ngritjet dhe dobësitë e mia. Prandaj, ne ekzistojmë si një kishë për ta inkurajuar njëri-tjetrin në çastet e dobësisë. Nën një presion kaq të tmerrshëm unë, në një çast të caktuar, i pëshpërita një vëllai pranë meje — një shërbyesi Presbiterian dhe një i krishterë shumë i mirë — "Vëlla, besoj se e kam humbur besimin tim. Nuk mendoj më se jam një besimtar." Ai, me një buzëqeshje që nuk iu largua kurrë, më pyeti: "Po, a ke besuar ndonjëherë?" I thashë: "Po, patjetër që kam besuar." Ai tha: "Atëherë kujto një varg nga Bibla. Kur Maria e virgjër erdhi tek Elizabeta, Elizabeta i tha asaj: 'E bekuar është ajo që *besoi*.' Është në kohën e shkuar. Nëse ke *besuar* në të shkuarën, je i bekuar. Vazhdo të jetosh në këtë gjendje bekimi." Nuk mund t'ju tregoj se çfarë vlere patën për mua ato fjalë nën ato rrethana. Nuk e di sesa e shëndoshë është teologjia, por ne nuk jetuam me teologjinë në atë kohë. Ne jetuam me kujtimet e shkuara. Prandaj, Bibla na mëson që duhet ta bekojmë Zotin e të mos harrojmë bekimet e tij të shkuara. Kujtojeni bekimet e shkuara edhe nëse kaloni përmes një nate të errët të shpirtit.

Mposhtja e Vetmisë

Njëri nga problemet më të mëdha për një luftëtar të fshehtë është si ta mbushë vetminë e tij. Ne nuk kishim absolutisht as edhe një libër. Jo vetëm asnjë Bibël, por asnjë libër, asnjë copë letre, dhe asnjë laps. Ne nuk dëgjuam kurrë asnjë zhurmë, dhe nuk kishte as edhe një gjë, që të na tërhiqte vëmendjen. Ne shihnim muret, kaq ishte e gjitha. Tani, normalisht një mendje nën rrethana të tilla çmendet. Lexoni librat e mëdhenj për jetën e burgut (*Flutura* -titulli në origjinal: *Papilloni*⁵³ e libra të tjerë të tillë që janë shumë të vlefshëm për t'u lexuar nga një punëtor i ardhshëm i fshehtë) vetëm për ta kapur atmosferën e burgut, me aq sa mund ta kuptojë atë një njeri i lirë. Do ta shihni çmendurinë e të qenit vetëm për vite të tëra me radhë, pa pasur asnjë gjë që mund të të tërhiqte vëmendjen. Mund t'ju them nga përvoja ime sesi ia dola mbanë të mos çmendem, por sërish kjo gjë duhet të parapërgatitet nga një jetë ushtrimesh frymërore. Sa shumë kohë mund të rrini vetëm pa një Bibël? Sa shumë mund të duroni pa ndezur një radio, një magnetofon etj?

Unë, dhe shumë prej të burgosurve të tjerë, ia dolëm mbanë. Ne nuk fjetëm kurrë natën. Flinim ditën. Tërë natën rrinim zgjuar. Ju e dini se një psalm thotë: “Ja, bekojeni Zotin,

⁵³ Papillon është një novelë e shkruar nga Henri Çarriere (Henri Charriere) dhe e botuar në vitin 1969, për një burrë që është dënuar gabimisht për vrasje. Ai u dënua me burgim të përjetshëm. Kur protagonist i këtij filmi përpiket që të arratiset nga burgu, ai dënohet me qëndrim në qelinë e izolimit. Rojet nuk i japin fare ushqim protagonistit për të mësuar emrin e bashkëkompolitistit të tij. Ai asnjëherë nuk ua tregoi.

të gjithë ju shërbëtorë të Zotit, që rrini natën në shtëpinë e Zotit” (Psalmi 134:1). Një lutje natën ka vlerë sa dhjetë lutje ditën.

Të gjitha mëkatet dhe krimet e mëdha kryhen gjatë natës. Vjedhjet e mëdha, të dehurit, zbavitjet, kurorëshkelja — e tërë kjo jetë e mëkatit është jetë nate. Gjatë ditës që të gjithë duhet të punojnë në fabrikë, në kolegji ose diku tjetër. Forcat demoniake janë forca të natës, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që t’i kundërshtojmë ato gjatë natës. Të ndenjurit roje është shumë i rëndësishëm. Në botën e lirë, nuk njihet shumë të ndenjurit roje. Në vendin tim, edhe përpara se ta merrnin pushtetin komunistët, ne bënim roje. Djali im, Mihai, kur ishte tre-katër vjeç e dinte për të qenit roje. Ne do ta kalonim të tërë natën në lutje. Fëmijët e vegjël të moshës tre e katër vjeç, kur ne luteshim, edhe ata do të luteshin pak, pastaj do të luanin duke gjuajtur njëri-tjetrin. Ne do t’i qortonim pak e pastaj ata do të luteshin pak, e do t’i zinte gjumi nën ca tavolina. Që të vegjël janë rritur me përgjegjësinë e rojes.

Në qelinë e izolimit ne zgjoheshim, kur të burgosurit e tjerë shkonin për të fjetur. Ne e mbushnim kohën tonë me një program, që ishte kaq i rëndë, sa që nuk e realizonim dot. Ne fillonim me një lutje, një lutje në të cilën udhëtonim përmes të tërë botës. Luteshim për secilin shtet, për ato vende ku dinim emrat e qyteteve dhe njihnim njerëz, dhe luteshim për predikues të mëdhenj. Na merrte nja dy orë të mira për t’u kthyer. Luteshim për pilotët, për ata që ishin në det, dhe për ata që ishin në burg. Bibla na tregon për një nga gëzimet e mëdha që mund të kemi, edhe në një qeli burgu: “Gëzohuni me ata që gëzohen” (Romakëve 12:15). Unë gëzohesha që diku atje jashtë kishte familje që mblidheshin me fëmijët e tyre, e lexonin Biblën bashkë, tregonin shaka dhe ishin shumë të lumtur me njëri-tjetrin. Diku ishte një djalë që donte një vajzë të re dhe takoheshin bashkë; unë mund të isha i lumtur për ata.

Atje tej zhvillohej një takim lutjeje; dhe ishte dikush që kishte studiuar; dhe ishte dikush, që i pëlqente ushqimi i mirë, etj. Ne gëzoheshim me ata që gëzoheshin.

Pasi kisha udhëtuar nëpër të gjithë botën, lexoja Biblën nga kujtesa. Mësimi përmendësh i Biblës është shumë i rëndësishëm për një punëtor të fshehtë.

Sa për të na bërë që të qeshim pak, do t'ju tregoj diçka që ndodhi. Njëherë, teksa rrija shtrirë mbi disa dërrasa që ishin në shtratin tim, lexova nga kujtesa Predikimin në Mal, sipas Lukës. Mbërrita tek pjesa ku thuhet: “Kur përndiqeni... për hir të Birit të Njeriut, gëzohuni në atë ditë dhe kërceni nga gëzimi” (Luka 6:11, 23a). E kujtova se ishte shkruar ashtu. Thashë me vete: “Si mundet që të kryej një mëkat të tillë të lënies pas dore? Krishti ka thënë se ne duhet të bëjmë dy gjëra të ndryshme. Një, që të gëzohemi, dhe e kam bërë këtë. E dyta, që ‘të kërcejmë nga gëzimi,’ dhe nuk e kam bërë këtë.” Kështu që kërceva. Zbrita nga shtrati dhe nisa të kërceja vërdallë. Në burg, dera e qelisë ka një vrimë, përmes së cilës roja mund të shohë brenda në qeli. Ndodhi që ai po shihte, teksa unë kërceja vërdallë. Kështu që ai besoi se unë kisha dalë mendsh. Ata kishin një urdhër që të silleshin mirë me të çmendurit, me qëllim që të bërtiturat e tyre dhe goditjet e murit të mos i shqetësonin të tjerët në burg. Roja hyri menjëherë, më qetësoi dhe tha: “Ti do të lirohesh; do ta shohësh se gjithçka do të bëhet mirë. Thjesht rri i qetë. Do të të sjell diçka.” Ai më solli një pllakë të madhe buke. Racioni ynë ishte një fetë buke në javë dhe unë tani kisha një pllakë të tërë buke, plus djath. Ishte i bardhë. Kurrë mos e hani shpejt e shpejt djathin; së pari admironi bardhësinë e tij. Është diçka e bukur për t'u parë. Ai gjithashtu më solli sheqer. Ai tha ca fjalë të mira sërish, e mbylli derën dhe u largua.

I thashë: “Do t'i ha të gjitha këto gjëra, pasi ta kem përfunduar kapitullin tim nga Shën Luka” dhe u shtriva sërish e u përpoqa

ta kujtoja se ku e kisha lënë leximin. “Po, tek ‘kur ju përndiqeni për hir të emrit Tim, gëzohuni... dhe kërceni nga gëzimi, sepse i madh është shpërblimi juaj.’” Pashë pllakën e bukës dhe djathin. E vërtetë, shpërblimi ishte i madh!

Prandaj detyra tjetër është të mendosh për Biblën e të meditoosh mbi të. Çdo natë, hartoja një predikim që fillonte me: Të dashur vëllezër e motra” dhe mbaronte me “Amen.” Pasi e hartoja, e thosha predikimin. Më pas i rishkruaja predikimet në formën e vargjeve shumë të shkurtra me rimë, që të mund t’i mbaja mend ato. Librat e mi *Me Perëndinë në Qelinë e Izolimit* dhe *Nëse Muret e Burgut Mund të Flisnin* përmbajnë disa prej këtyre predikimeve. I kam mësuar përmendësh treqind e pesëdhjetë prej tyre. Kur dola nga burgu, i shkrova disa prej tyre. Nja pesëdhjetë prej tyre janë botuar në këto dy libra. Ato ishin predikime që ia drejtova Perëndisë dhe engjëjve. Engjëjt kanë krahë dhe ata mund t’ia shpien mendimet dikujt tjetër. “Tani ato predikime janë botuar në shumë gjuhë dhe po përdoren.) Kështu e mbushnim kohën. Unë shkrova libra e poema. Mendova për gruan time e për fëmijët. Çdo natë i tregoja vetes shaka, por gjithmonë shaka të reja, që nuk i dija më parë, që të ishin të gjitha optimiste. Ato tregonin sesi ndihesha atëherë. Njëra nga shakatë ishte: Një grua i tha të shoqit: “Pjetër, ç’të bëj? U ula mbi dhëmbët e vënë (protezat) dhe i theva ata.” Burri i tha: “Gëzohu, përfytyro si do të ishte, nëse do të ishe ulur mbi dhëmbët e tu natyrorë.” Kështu që unë shihja anën e mirë të gjërave.

Prej bukës bëra ca figurina shahu, disa prej tyre i zbardha me një shkumës dhe të tjerat i lashë gri. Luaja shah me veten. Mos besoni kurrë se Bob Fisher është mjeshtri më i madh i shahut në botë. Ai fitoi në ndeshjen e fundit me Spaski (Spassky). Ai fitoi tetë ndeshje dhe humbi dy. Unë, në tre vjet, nuk humba kurrë asnjë ndeshje; unë gjithmonë fitova, ose me të bardhët, ose me gritë!

Kisha e fshehtë

Ua kam treguar të gjitha këto gjëra, ngaqë ato u përkasin sekreteve të punëtorit të fshehtë, kur ai vuan. Mos lejoni kurrë që mendja tuaj të shqetësohet, ngaqë atëherë komunistët ju kanë krejtësisht në duart e tyre. Ju duhet ta ushtroni vazhdimisht mendjen tuaj. Duhet të jetë e zgjuar, duhet të mendojë. Gjithsecili sipas aftësive të tij, duhet të kompozojnë gjëra të ndryshme, etj.

Identiteti i Vërtetë

Kisha e fshehtë nuk është diçka e re. Pasi kisha punuar në kishën e fshehtë, e lexoja Dhjatën e Re me sy të rinj. Lexova tek Veprat e Apostujve shembuj ku apostujt dhe dishepujt mbanin emra “të tjerë” nga ata që kishin më përpara, dhe ka shumë shembuj të kësaj kudo nëpër Dhjatën e Re (Zbulesa 2:17, që është një rast sublim).

“JOZEFI, i quajtur BARSABA, i cili mbiquhej JUST” (Veprat e Apostujve 1:23).

“IOSE, që gjithashtu mbiquhej BARNABA prej apostujve” (Veprat e Apostujve 4:36).

“SIMEONI, i quajtur NIGER” (Veprat e Apostujve 13:1).

“JUDA, i mbiquajtur BARSABA” (Veprat e Apostujve 15:22).

“JEZUSI, i quajtur JUST” (Kolosianëve 4:11).

Pse duhej që Jakobi e Gjoni të merrnin cilësimin “bijtë e bubullimës” dhe një Simon të quhej “Pjetër”? Unë kurrë nuk e dija shpjegimin për këtë. Në Dhjatën e Re gjejmë shumë emra që ishin ndryshuar. Tani, saktësisht e njëjta gjë ndodh në kishën e fshehtë. Unë kisha shumë emra. Kur shkoja në një qytet ose fshat, ata kurrë nuk thoshin se kishte ardhur Vëlla Vurmbrandi. Në një qytet unë isha Vasili, në një tjetër, Gjeorgjesku, në një tjetër isha Rubeni, etj. Kur u arrestova, unë isha, Riçard Vurmbrandi, i quajtur ashtu e kështu.

Unë besoj në frymëzimin e drejtpërdrejtë të Biblës, jo vetëm në frymëzimin fjalë për fjalë. Pse atëherë ajo përmban fjalët në

dukje “të padobishme”? Ishte shkruar te Luka: “Jezusi u lut në një vend të caktuar. (Luka 11:1). Ju duhet të ndodheni diku kur luteni. Po atëherë, pse duheshin këto fjalët: “në një vend të caktuar?” Shkruhet: “Ai erdhi në një qytet të caktuar.” Secili qytet është një qytet i caktuar, por kjo është saktësisht gjuha që përdoret në kishën e fshehtë. Kur kthehesha nga ndonjë udhëtim, i thosha gruas sime: “Isha në një qytet të caktuar, dhe në një vend të caktuar, takova një vëlla të caktuar. Ne vendosëm se në një orë të caktuar do të takoheshim në një shtëpi të caktuar.”

Jezusi dëshiroi të hante darkën me dishepujt e tij (Luka 22:7-13). Tani, gjëja normale për Të do të ishte të kishte thënë: “Shkoni tek ajo rruga me atë emër, tek shtëpia me këtë numër, dhe pyesni për Z. XYZ, dhe atje e përgatisni darkën.” Në vend të kësaj, Ai thotë: “Kur të hyni në qytet, do të takoni një burrë, që mban në dorë një brokë uji; ndiqeni atë për tek shtëpia ku do të hyjë ai.” (Luka 22:10) (Do të ishte një gjë e rrallë në atë kohë që një burrë të “mbante një brokë ujë” ngaqë ishin gratë ato që shkonin tek pusi.) Kjo është saktësisht sesi veprojmë ne: kur kemi një takim lutjeje, nuk japim një adresë, ngaqë nuk e dimë se kush është informatori. Qëndroni te qoshja e ‘asaj’ rruge, ose uluni atje në një park publik dhe do të shihni një burrë që kalon, me një kravatë blu, ose me ndonjë shenjë tjetër. Shkoni pas tij.” Nëse ndonjëri e pyet tjetrin: “Si e ke emrin?” atëherë ne e dimë se ai person është një informator i Policisë Sekrete.

Kisha e fshehtë ishte diçka që ekzistonte tashmë në kohën e shkrimit të Dhjatës së Re. Ne kemi kritikë që thonë se ajo që bëjmë është e paligjshme përpara Perëndisë, sepse një Kishë nuk duhet të punojë në fshtehtësi. Ne duhet t’u bindemi autoriteteve. Këshilli Botëror i Kishave na akuzon ne, por ata iu japin para guerilasve, që nuk iu binden autoriteteve⁵⁴. Në Bibël shkruhet

⁵⁴ Këshilli Botëror i Kishave në fillim ishte shumë skeptikë ndaj pretendimeve të Të Përndershmit Vurmbrand për vuajtjen e të krishterëve në vendet komuniste. Në vend të këtyre pretendimeve, ata dëgjonin raportet e kishave

se ai që ka autoritet është një sundues që e ndëshkon të ligën dhe e shpërblen të mirën. Një autoritet që e ndalon Fjalën e Perëndisë, e vendos veten jashtë çdo sfere njerëzore. Atij nuk i zbatohet as edhe një varg nga Bibla. Çdo autoritet ka ligjet dhe padrejtësitë e veta dhe abuzimet, sepse asnjë qeveri nuk përbëhet nga Shenjtorë. Ajo përbëhet nga mëkatarë. Çdo autoritet bën gjëra të drejta dhe të gabuara. Gjëja kryesore është se ata nuk duhet ta pengojnë një vemje që të bëhet flutur. Ata nuk duhet ta pengojnë një burbuqe që të bëhet lule; ata nuk duhet ta pengojnë një mëkatar që të bëhet shenjtor. Për sa kohë që ata ma lejojnë mua këtë gjë, nuk pres prej tyre të bëhen shenjtorë që bien nga qielli. Unë pres prej tyre që ata të bëjnë ca gjëra të mira, dhe që ndonjëherë do të kenë ligje të këqija, që ata mund t'i ndryshojnë pas dy ose tre vitesh. Unë do t'i respektoj ata si autoritet. Por, nëse ata ma heqin vetë kuptimin e jetës sime, që është ta përgatis veten për një ekzistencë më të bukur në parajsë, unë nuk ndiej asnjë lloj detyrimi ndaj këtij autoriteti. Misioni ynë thjesht vazhdon punën e fshehtë për ta ndihmuar Kishën e Fshehtë në vendet komuniste dhe ato myslimane.

Unë ju kam dhënë vetëm një shikim të shpejtë të problemeve që ka kjo kishë e fshehtë, që juve, disi, ta keni një përfytyrim sesi duket ajo.

Perëndia ju bekoftë.

të lidhura me qeveritë komuniste. Ato raporte pretendonin se të krishterët në vendet komuniste përjetonin lirinë e plotë të adhurimit. Këshilli Botëror i Kishave gjithashtu nuk e pëlqente fare konceptin e Vurmbrandit për një kishë të fshehtë. Ata e konsideronin atë të ishte joetik, ngaqë nuk vepronte me miratimin e qeverisë. Ndërkohë që erdhi në dispozicion gjithnjë e më tepër informacion për përndjekjen e të krishterëve në vendet komuniste, Këshilli Botëror i Kishave nisi ta ndryshonte opinionin e tij lidhur me Të Përndershmin Vurmbrand.

ËJESA II

MBJELLJA E KISHËS
SË FSHEHTË

Nga **Pastor Erik Folei** (Eric Foley)

HYRJE

Qëllimi i këtij libri është t’ju ndihmojë për të mbjellë një kishë të fshehtë ose për të kaluar nga një kishë ekzistuese në një kishë të fshehtë. Libri përmban dymbëdhjetë parime, që praktikohen nga të krishterët e fshehtë nga shumë vende e në periudha të ndryshme kohore. Këto parime i kanë aftësuar të krishterët e fshehtë për ta mbajtur besimin në mes të kundërshtimeve serioze.

Ky nuk është një libër vetëm për pastorët e drejtuesit e kishave ose kryesisht për ta. Siç do të shohim, ky libër është për të gjithë të krishterët, ngaqë, kishat e fshehta mbillen duke filluar nga familja e zgjerohen më tej, në vend që të mbilleshin atje lart tek podiumi i foltores e duke zbritur poshtë. Secili parim mund të ishte tema për një libër më vete, prandaj prezantimet këtu janë patjetër të shkurtra. Gjithsesi, çdo kapitull përfundon me hapa veprimi që ju mund t’i zbatoni menjëherë: njëri grup hapash është për besimtarët, që kërkojnë të mbjellin një kishë të fshehtë, dhe grupi tjetër i hapave është për kishat ekzistuese, që kërkojnë të kalojnë në fshehtësi.

Po çfarë është një “kishë e fshehtë” dhe pse do donim ne që të mbillnim një të tillë ose ta transformonim një kishë ekzistuese në një kishë të fshehtë?

Termi “kishë e fshehtë” mund të jetë pështjellues. Ne e dimë se çfarë është një megakishë. E dimë se çfarë është një kishë Presbiteriane, Metodiste ose Baptiste. E dimë gjithashtu se çfarë është një kishë që mblidhet në shtëpi. Po kjo “kisha e fshehtë”

çfarë është? Në cilat mënyra është ajo e ngjashme ose e ndryshme nga këto llojet e tjera të kishave që njohim deri tani?

Që ta kuptojmë se ç'do të thotë “kishë e fshehtë” le të nisim me fjalën “e fshehtë.” Ky është një term që në anglisht përdoret në mënyra të ndryshme. Ndonjëherë i referohet një grupi që është i fshehtë ose sekret. Herë të tjera nënkupton një lëvizje që i bën rezistencë ose e kundërshton një autoritet të vendosur. Dhe në raste të tjera përdoret për të përshkruar diçka që është kundër kulturës ose është shumë e ndryshme nga publiku i gjerë (ndoshta është edhe ofendues për të).

Nuk ka asnjë përkufizim të saktë të termit “i/e fshehtë” në anglisht, dhe kjo gjë është e qëllimshme. “I/e fshehtë” është një fjalë që supozohet të jetë e mjegullt ose e paqartë. Arsyeja pse, është se organizatat ose njerëzit kalojnë në “fshehtësi” pikërisht, ngaqë duan që qeveria dhe publiku i gjerë të ketë vetëm njohuri të mjegullt për ekzistencën e për qëllimin e tyre. Ata duan ta shmangin mundësinë për t’u zbuluar me lehtësi, ose për t’u vëzhguar apo për t’u infiltruar prej kundërshtarëve më të mëdhenj e më të fuqishëm, që duan t’i ndryshojnë ata, t’i kontrollojnë, t’i ndalojnë ose madje edhe t’i shkatërrojnë. Organizatat e fshehta përpiqen të jenë strategjike dhe përzgjedhëse lidhur me kur dhe si shfaqen në publik dhe çfarë informacioni dihet për ta. Nëse përpiqen ta ndryshojnë ose ta ndikojnë botën, ata e bëjnë këtë gjë privatisht, ose në mënyrë anonime, ose ndonjëherë edhe befasisht (që do të thotë, pa lajmëruar dhe kur njerëzit nuk e presin atë gjë).

Të kaluarit në fshehtësi mund të mos tingëllojë gjëja e duhur—sidomos për një kishë! Nëse dëgjojmë se një organizatë është duke vepruar në fshehtësi, ose po fshihet, zakonisht kemi dyshime se ajo organizatë po bën diçka të gabuar. Terroristët veprojnë në fshehtësi. Kriminelët veprojnë në fshehtësi. Spiunët veprojnë në fshehtësi. Pse do të rrezikonim të identifikoheshim me grupe të tilla nga njerëzit në botë që kanë dëshpërimisht

nevojë të dëgjojnë mesazhin e ungjillit? A nuk na thotë Jezusi që ta lejojmë dritën tonë të shkëlqejë para njerëzve e të mos e fshehim nën një shinik?

Kjo është arsyeja se përse kur mbillen kishat sot në vendet e botës së lirë, qëllimi i mbjellësit të kishës zakonisht është të përhapë sa më tepër informacion për kishën, sa më shpejt, sa më shpesh e sa më gjerë të mundet. Mbajllësit e kishave shpërndajnë materiale të tilla si magnetë për në frigorifera, kalendarë, karta biznesi e fletushka për kishën kudo që munden, ndaj kujtdo që do t'i pranojë ato. Këto materiale promovuese tregojnë emrin e kishës, adresën e saj, kohët e adhurimit, emrin e pastorit, informacion kontakti, cilit denominacion i përkasin, dhe sa më tepër foto tërheqëse dhe deklarata lidhur me gjërat që ndodhin në kishë, që mund të vendosen në hapësirën e disponueshme. Mbajllësi i kishës nuk shqetësohet se mos njerëzit e zbulojnë kishën, por se mos nuk e marrin vesh kurrë që ajo ekziston!

Kjo lloj metode ndaj kishëmbjelljes mund të funksionojë në vendet ku:

- qeveria nuk kërkon ta bllokojë ose ta kufizojë ndonjë pjesë të mesazhit të kishës, që të mos ndahet publikisht ose të mos jetohet;
- publiku i gjerë nuk e sheh kishën si një shtypëse të fuqishme e të rrezikshme dhe si një armike të lirisë; dhe
- qeveria e publiku i gjerë nuk kanë ndonjë axhendë specifike për ta detyruar kishën që t'i ndryshojë besimet bazë.

Kurse sot, si rezultat i revolucionit seksual, qeveritë në botën e lirë gjithnjë e më tepër po kërkojnë ta bllokojnë ose ta kufizojnë një pjesë të mesazhit të kishës, që të mos ndahet publikisht e të mos jetohet prej tyre. Publiku i gjerë në botën e lirë gjithnjë e më tepër e portretizon kishën si një shtypëse të

fuqishme dhe të rrezikshme që përhap urrejtje dhe që e kufizon lirinë. Qeveritë dhe publiku i përgjithshëm në botën e lirë e kanë vërtet një axhendë aktive e specifike për ta detyruar kishën t'i ndryshojë besimet më themelore lidhur me çështjet e revolucionit seksual. Të krishterët dhe kishat që nuk ndryshojnë për ta mbështetur këtë axhendë përballen me tallje, kufizime, ndëshkime dhe përjashtim.⁵⁵

Strategjitë për mbjelljen e kishave që synojnë të rrisin vëmendjen e publikut dhe vetëdijen për kishën, në fakt mund ta forcojnë kundërshtimin e publikut dhe të qeverisë ndaj krishterimit në botën e lirë. Kjo ndodh ngaqë, kur një i krishterë ose një kishë del në vëmendjen e publikut këto ditë, publiku i gjerë ka gjithnjë e më tepër të ngjarë të hetojë dhe t'i ekspozojë besimet e atij të krishterë ose të asaj kishë lidhur me revolucionin seksual — madje edhe kur ai i krishterë ose ajo kishë nuk ka qenë duke folur fare për revolucionin seksual. Është pak a shumë një lloj “testi sigurie” për revolucionin seksual. Nëse publiku i gjerë zbulon se një i krishterë i mirënjohur ose një kishë nuk e mbështet qëllimin e revolucionit seksual, ai i bie alarmit në mediat e ndryshme, si dhe në median sociale në internet. Ai kërkon që, ata që e mbështesin ofenduesin ta ndërpresin mbështetjen e tyre, derisa ofenduesi të përgjigjet me pendim publik, kërkesë për falje dhe konfirmim të revolucionit seksual. Gjithnjë e më në rritje, publiku i gjerë gjithashtu i bën thirrje qeverisë dhe gjykatave që “t'i mbrojnë” ata nga të krishterët dhe nga kishat që nuk pranojnë ta konfirmojnë revolucionin seksual. Ai kërkon që qeveritë dhe gjykatat ta kontrollojnë ose ta kufizojnë aftësinë e të krishterëve dhe të kishave për të vepruar, për të folur, ose për të mësuar publikisht në mënyra që janë kundër revolucionit

⁵⁵ Për më tepër informacion lidhur me si dhe pse po ndodh kjo, shihni Hyrjen time tek libri i të Përndershmit Riçard Vurmbbrand *Përgatitja për kishën e fshehtë*, të botuar nga Zëri i Martirëve në Kore (2017). Ai libër është vëllimi i parë në një seri me tri pjesë, tek e cila ky libër është vëllimi i dytë.

seksual. Ai këmbëngul se ka të drejtën për t'u mbrojtur nga ajo, që ai e konsideron si sjellje dhe e folur urrejtjeje, fanatike, e dalë mode, e papërgjegjshme, homofobike, dhe shtypëse nga ana e krishterimit tradicional.

Disa të krishterë koreanë mund ta konsiderojnë revolucionin seksual thjesht si një mundësi tjetër të rëndësishme ungjillëzuese për kishën koreane që t'i thërrasë mëkatarët të pendohen. Ata mund t'i shohin çështje të tilla si homoseksualiteti dhe martesat brenda së njëjtës gjini thjesht si prirjet më të fundit mëkatore, që kanë nisur të depërtojnë në shoqërinë koreane, ndaj të cilave kisha duhet të përgjigjet. Ata mund ta përfytyrojnë rolin e kishës koreane në këtë situatë si mbajtje të një qëndrimi publik për vlerat tradicionale familjare përmes predikimit të fortë, shkrimit të librave, transmetimit të programeve në media, organizimit të marshimeve dhe protestave, debatimit në publik për mbrojtjen e të drejtave të personave gei, dhe — aty ku është e nevojshme — përfshirjes në procese gjyqësore për të mbrojtur konceptin tradicional të martesës.

Natyrisht kjo ishte mënyra sesi reagues dhe bënë strategji shumica e të krishterëve evropianë e amerikanë, kur nisën të përballen me këto çështje në vitet 1980të e 1990të. Pavarësisht nga përgjigjja ndaj shenjave të para të shqetësimit dhe nga lutjet e tyre pasionante, planifikimit mjeshtëror, protestave të zhurmshme dhe me shpenzime marramendëse të kohës dhe parave, forcat e tyre u shpartalluan dhe u shpërndanë menjëherë pasi ra boria e betejës. Martesat brenda së njëjtës gjini tani janë vendosur në ligj në pothuajse çdo vend perëndimor dhe shumica e të krishterëve e mbështesin dhe madje marrin pjesë në revolucionin seksual. Pavarësisht nga kapitullimi i tyre, çdo vit miratohen ligje shtesë dhe merren vendime gjyqësore që vazhdojnë t'i përjashtojnë sa më shumë e t'i mbajnë sa më larg të krishterët prej shoqërisë perëndimore dhe t'i detyrojnë të kthehen brenda ndërtesave të kishave. Madje edhe atje, ata

po fundosen poshtë ujërave në rritje të talljes, kufizimit dhe ndarjeve të brendshme.

Pse e humbën kishat evropiane dhe amerikane betejën kaq thellë dhe pse po vazhdon të zbehet liria e tyre dita-ditës? A ndodhi kjo ngaqë ata nuk nisën të mbroheshin në kohë? Apo ngaqë lutjet e tyre nuk ishin mjaft pasionante, plani i tyre jo aq mirë i organizuar, protestat jo aq të zhurmshme, buxhetet dhe ushtritë e tyre në betejë jo shumë të mëdha?

Apo mos ndoshta kjo ndodhi, ngaqë revolucioni seksual nuk është vetëm një vegël në duart e armikut, por gjithashtu një vegël në duar të tjera, pafundësisht më të mëdha, më të gjera dhe më të mençura — në duart e vetë Perëndisë? A mos vallë Perëndia po i lejon revolucionarët seksualë dhe qeveritë e botës së lirë të përdorin këtë mjet të dhimbshëm për të gdhendur dhe hequr gjithë atë që ne, në begatinë tonë, kërkuam ta shtonim në kishë, por që në fakt ka zvogëluar shkëlqimin verbues të pranisë së tij? A mund të ndodhë që Perëndia nuk do të na japë sukses për ta mbrojtur shprehjen tonë të tanishme të begatë të kishës kundër revolucionit seksual, ngaqë tashmë ne jemi tepër të ngjashëm me këtë revolucion, dhe ai do që brenda nesh të rifitohet pasqyrimi i kishës si më e përlur, më e shenjtë, e fshehtë, të cilën ne e kemi lënë mënjanë?

Përgjatë historisë, dy faktorë e kanë pështjelluar rregullisht kishën: popullariteti dhe prosperiteti. Kisha shpesh i ka konsideruar këta të dy si bekime të çmuara prej Perëndisë, që duhen kërkuar shumë dhe mirëmbajtur me kujdes. E prapëseprapë që të dy: popullariteti dhe prosperiteti në mënyrë specifike u kundërshtuan nga Jezusi si mjete për kryerjen e punës së tij.

Kisha në botën e lirë ndërtoi një model kishë që mbështetet mbi një masë popullariteti dhe prosperiteti që të funksionojë. Por në shkrimet e shenjta, Jezusi i mëson dishepujt e tij që të mbjellin kisha duke përdorur si lëndë të parë vetëm përndjekjen dhe varfërinë. “Unë po ju dërgoj si qengja në mes të ujqve,” -

thotë ai. “Mos merrni me vete as kuletën, as çantën e as sandale.”⁵⁶ Rruga për te mbjellja e kishës mundet që ndonjëherë dhe për njëfarë kohe të kalojë përmes kullotave të popullaritetit dhe të prosperitetit, por rruga nuk nis atje, e as nuk përfundon atje, dhe Zoti e këshilloi kishën që të mos e ndërtojë shtëpinë e saj atje.

Për qindra vjet, pasi Krishti u dha porosinë kishëmbjellësve të parë, të vetmet rrugë që ishin përpara të krishterëve ishin shtigjet e përndjekjes dhe varfërisë. Duke punuar në fshehtësi, të krishterët e hershëm ishin objekt dyshimi, kudo ku udhëtonin. Për shkak se publiku i gjerë dhe qeveria kishin vetëm njohuri të turbullt për ta, të krishterët rregullisht akuzoheshin për kanibalizëm, ateizëm, imoralitet seksual dhe mungesë patriotizmi. Kurdoherë që vendet ku ata qëndronin përjetonin ndonjë lloj vështirësie, të krishterëve iu vihej faji që i kishin zemëruar perënditë përmes mospranimit të tyre provokues për t’i adhuruar ato.⁵⁷

E prapëseprapë kisha hodhi rrënjë dhe lulëzoi.

Në fund të fundit, secila valë rritjeje i solli kishës popullaritet dhe prosperitet më të madh. Por sa herë që kisha doli nga fshehtësia, ajo u pështjellua. Ajo nisi të ndërtonte shtëpitë prej lëndës së parë të popullaritetit dhe të prosperitetit, dhe hoqi dorë nga modelet e mbjelljes së kishës që dha Zoti, të cilat bazohen mbi përndjekjen dhe varfërinë. Për shkak të popullaritetit dhe prosperitetit, kisha e mori të mirëqenë se ato modelet e para nuk ishin më të nevojshme.

Por modelet e mbjelljes së kishës së fshehtë, bazuar mbi përndjekjen dhe varfërinë, nuk janë shtegu i Zotit për ta drejtuar kishën tek popullariteti dhe prosperiteti. Ato janë shtegu i Zotit për ta mbajtur kishën të përlurur dhe të shenjtë përpara qiellit e tokës.

⁵⁶ Luka 10:3, NIV.

⁵⁷ Shihni për shembull “Oktaviani i Minuçius Feliks” *Shkrimet e hershme të krishtera*. (“The Octavius of Minucius Felix,” *Early Christian Writings*. <http://www.earlychristianwritings.com/octavius.html>).

Fatkeqësisht, kur kisha përballet me sfida të rënda, ajo shpesh e harron këtë. Ajo kërkon ta justifikojë dhe ta mbrojë veten duke u kapur pas popullaritetit dhe prosperitetit të saj. Kjo është mënyra sesi të krishterët amerikanë dhe evropianë kërkuar ta kundërshtojnë revolucionin seksual. Perëndia është i hirshëm për t'i bërë të katandisen në asgjë këto lloj zgjidhjesh.

Në vend të kësaj, Perëndia, i cili kurrë nuk ndryshon, na këshillon që t'i përballojmë sfidat e rënda të ekzistencës së kishës duke u kthyer në shtigjet e sigurta të përndjekjes dhe të varfërisë. Këto janë shtigjet e “vjetra, të besueshme” për tek të cilat na thërret Perëndia nëpërmjet profetit Jeremia:

Zoti i tha popullit të tij: “Ju po rrini nëpër udhëkryqe. Kështu që, shqyrtojeni shtegun tuaj. Pyesni ku janë shtigjet e vjetra e të besueshme. Pyesni ku është shtegu që të shpie në bekim dhe ndiqeni atë. Nëse bëni kështu, do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj.”⁵⁸

Për fat të keq, ai varg përfundon me: “Por ata thanë: - Ne nuk do ta ndjekim atë!” Ashtu si sundimtari i ri dhe i pasur, të krishterët amerikanë dhe evropianë në botën e lirë kërkuar për një shteg nëpërmjet revolucionit seksual që do t'i aftësonte ata të vazhdonin ta mbartnin me vete të gjithë popullaritetin dhe prosperitetin që kishin akumuluar. Ata hodhën poshtë shtigjet e vjetra dhe të sigurta të përndjekjes dhe të varfërisë, sepse kanë shumë pasuri dhe këto shtigje të vjetra, e të sigurta janë aq të ngushta saqë nuk lejojnë të mbartësh me vete asgjë tjetër, përveç shkëlqimit mahnitës të pranisë së Perëndisë.

Është e vështirë për të krishterët që të largohen nga kullota e popullaritetit dhe begatisë, pasi kanë mbërritur atje. Zakonisht kjo kërkon një shtysë të fortë nga Zoti. Sfida e padëgjuar e revolucionit seksual është pikërisht kjo shtysë e fortë. Thirrja

⁵⁸ Jeremia 6:16, NET.

e Perëndisë për kishën koreane është që t'i lerë pas kullotat e popullaritetit dhe begatisë në të cilat kemi qenë duke u prehur për shtatëdhjetë vitet e kaluara, dhe t'u kthehemi shtigjeve të vjetra e të sigurta të përndjekjes dhe varfërisë nëpër të cilat ecën paraardhësit tanë për të na sjellë këtu ku jemi sot.

Kisha e fshehtë mund të jetë udhërrëfyesi ynë. Ata janë Sherpat (Shënim i përkthyesit: Sherpat janë banorë të fiseve etnike tibetiane, që shërbejnë si udhërrëfyesit e alpinistëve në malet Himalaje) për në këto shtigje. Vetëm ata i dinë ku ndodhen ato pjesët e sipërme që zgjaten përpara nesh. Ata janë gati që të na ndihmojnë për ta rifilluar ngjitjen tonë.

Parimi I.

Përfshirja ligjore e vendos kishën në skllavëri; Në vend të kësaj, jini të huaj dhe banorë të përkohshëm

Kishat ndonjëherë zgjedhin të vazhdojnë ta kenë jetën e tyre në fshehtësi, kur përballen me kundërshtim të fortë prej qeverisë ose prej publikut të gjerë. Por edhe kur kisha kalon në fshehtësi, qeveria ose publiku i gjerë prapëseprapë mund të kërkojnë ta pengojnë kishën e fshehtë që të mos ketë mundësi të përdorë mjete të tilla si ndërtesat e kishave, Biblat ose burime trajnimi të krishtera. Kur ne të krishterët në botën e lirë mendojmë vetëm lidhur me arsyen pse një kishë do të duhej të kalonte në fshehtësi, zakonisht kjo është situata që përfytyrojmë: Një vend ku ndërtesat e kishave konfiskohen, Biblat digjen dhe shkollat e seminarët e krishtera mbyllen.

Kjo është arsyeja se pse ne të krishterët në botën e lirë nuk shohim ndonjë arsye për të kaluar në fshehtësi: qeveria dhe publiku i gjerë në botën e lirë nuk veprojnë në këtë mënyrë ndaj nesh. Ne besojmë se ligjet tona, zakonet dhe dashuria e përbashkët për lirinë, i shmangin këto lloje sulmesh, ndonëse e dimë se respekti për kishën po zvogëlohet në botën e lirë.

Është e vërtetë se veprime të tilla ekstreme sot nuk po ndodhin kundër kishës në botën e lirë, dhe as nuk ka të ngjarë që të ndodhin në të ardhmen e afërt. Por kjo ndodh ngaqë dhuna fizike nuk është e nevojshme për ta kontrolluar kishën në botën e lirë. Dhuna fizike, në fakt, do të bënte efektin e kundërt, ngaqë ajo do t'i zgjonte të krishterët ndaj thellësisë së armiqësisë së botës

ndaj mbretërisë. Kjo armiqësi, në fakt, ka ekzistuar që nga Rënia e Adamit dhe Evës, dhe është po aq e pranishme në shoqëritë demokratike sa edhe në ato totalitare. Asnjë shoqëri nuk mund ta nxjerrë dot veten jashtë mëkatit fillestar.

Demokracia ka një metodë më efektive për ta kontrolluar kishën sesa dhuna fizike. Kjo metodë është kaq efektive, saqë kisha aktualisht e percepton kontrollin nga qeveria si një përfitim.

Metoda është: regjistrimi ligjor.

Sipas Shkrimit të Shenjtë, kisha nuk është e kësaj bote. Ajo lindi prej vdekjes dhe ringjalljes së Zotit dhe prej dhuratës së tij të Frymës së Shenjtë.⁵⁹

Ajo nuk i përket këtij krijimit të tanishëm, por qiellit të ri dhe tokës së re.⁶⁰ Bibla e përshkruan kishën si trupin e Krishtit,⁶¹ nusen e Krishtit,⁶² Jeruzalemin e ri,⁶³ dhe një shtëpi frymërore prej gurësh të gjallë.⁶⁴ Kisha është një mister frymëror i denjë për përsiatjen tonë më të thellë.

Por sipas qeverive të botës së lirë, kisha nuk është një mister, as një shtëpi frymërore, as një Jeruzalem i ri, as një nuse, as trupi i Zotit të ringjallur. Është thjesht një korporatë: “Një ent i pavarur ligjor, i ndarë prej njerëzve që e zotërojnë, kontrollojnë dhe menaxhojnë atë.”⁶⁵ Në disa vende në botën e lirë, asaj mund të klasifikohet si një lloj i veçantë korporate, e quajtur jofitimprurëse, ose OJF, ose ndoshta një OJF fetare.

⁵⁹ Shih Veprat e Apostujve 2.

⁶⁰ Shih Isaia 65:17 dhe Zbulesa 21:1.

⁶¹ Shih për shembull Romakëve 12:5, 1 Korintasve 12:12-27, Efesianëve 3:6 dhe 5:23, Kolosianëve 1:18 dhe Kolosianëve 1:24.

⁶² Shih për shembull Mateu 9:15, Marku 2:19, Luka 5:34, Gjoni 3:29 dhe Efesianëve 5:22-33.

⁶³ Shih Zbulesa 3:12 dhe Zbulesa 21:2.

⁶⁴ Shih 1 Pjetrit 2:5.

⁶⁵ Nolo.com. “Pyetjet që bëhen shpesh për korporatat.” Nolo.com. <http://www.nolo.com/legal-encyclopedia/corporations-faq-29122.html>.

Me përkufizim, një korporatë është “e kësaj bote.” Kurse Jezusi tha se mbretëria e tij ishte “jo prej kësaj bote.”⁶⁶ Mbretëria e Jezusit natyrisht është më tepër sesa thjesht kisha që është në botë, por kisha patjetër që është e përfshirë në atë mbretëri. Kështu që, Jezusi synon që kisha në këtë botë gjithashtu të jetë “jo prej kësaj bote.” Sipas Shkrimit të Shenjtë, kisha është një organizëm – trupi i Krishtit⁶⁷ – jo një organizatë. Por sapo regjistrohet si një organizatë, ajo bie dakord me botën dhe nuk pajtohet me Zotin në këtë pikë.

Në vendet ku ndërtesat e kishave konfiskohen, Biblat digjen dhe shkollat e seminarit e krishtera mbyllen, kisha është paksa e tunduar që ta pohojë se ajo është një organizatë “prej kësaj bote.” Në vende të tilla, bota as nuk është e gatshme ta bëjë këtë ofertë!

Kurse në botën e lirë, kishës i jepen përfitime të pamasa, nëse ajo është e gatshme të emërtohet prej botës si një korporatë ligjore, e rikrijuar në shëmbëlltyrën e organizatave të botës. Duke u rilindur “prej kësaj bote,” kishës i jepet e drejta për të pasur qasje në sistemet financiare, komerciale, ligjore dhe politike të kësaj bote, dhe të ketë përfitimet që vijnë nga kjo përfshirje. Këto përfitime përfshijnë mundësinë e kishës për të hapur një llogari bankare, për të marrë me qira ose për të blerë pronë, për të marrë hua, dhe për të përdorur karta debiti apo krediti; mundësinë për të mos paguar taksa dhe për t’i pakësuar taksat që duhet të paguajnë pastorët e saj; mundësinë për të marrë donacione që nuk taksohen; mundësinë që pastorët e saj të kryejnë ceremoni martesore që janë të detyrueshme ligjërisht; mundësinë që shkollat dhe universitetet e saj të akreditohen dhe të trajtohen njësoj me institucionet e tjera arsimore; mundësinë për ta kufizuar detyrimin ligjor të anëtarëve të saj individualë, nëse kisha do të hidhet në gjyq; mundësinë për të bërë lobim ndaj qeverisë dhe ndaj opinionit publik; dhe mundësinë për të folur në publik, qoftë përmes transmetimeve në media, përfshirjes

⁶⁶ Gjoni 18:36.

⁶⁷ Shih shënimin 7, më lart.

në debatet dhe diskutimet publike me grupet e tjera, ose edhe duke ofruar lutje dhe bekime në ngjarjet qeveritare ose publike. Ndoshta gjëja më e dhimbshme nga të gjitha është kjo: megjithëse Jezusi u lut që kisha të ishte një, ashtu siç është një Ai me Atin,⁶⁸ sot kisha – e kthyer në një strukturë tokësore e ligjore – është në gjendje të pohojë se ndarjet, përçarjet dhe denominacionet e saj të panumërta janë ligjërisht shumë, shumë reale.

Tek Zbulesa 18:4, Zoti i bën thirrje kishës të “dalë jashtë” prej sistemeve të botës “që të mos marrë pjesë në mëkatet e saj, që të mos marrë asnjë prej plagëve të saj.”⁶⁹ Veprimet e kishës zbulojnë se ajo beson që Zoti është i shqetësuar në mënyrë të panevojshme për gjëra të tilla. Ajo është e sigurt se mund ta konsiderojë veten si një organizatë, të regjistrohët në sistemet e kësaj bote dhe të veprojë brenda tyre pa u “njollosur.”⁷⁰ Në fakt, ashtu siç tregon përpjekja e kohëve të fundit nga ana e pastorëve koreanë për t’u futur në politikë, kisha është jashtëzakonisht e sigurt se ajo mund t’i përmirësojë sistemet e botës (e të përfitojë shumë duke marrë pjesë në to) dhe njëkohësisht të shmangë çdo lloj njolle, rrudhe apo të mete.⁷¹ Por këto janë saktësisht gjërat kundër të cilave Zoti paralajmëron tek Zbulesa 18:4.

Natyrisht, thirrja e Zotit nuk është që kisha të dalë fare jashtë botës, por përkundrazi të jetë në botë pa u mbështetur në sistemet e botës për ndihmë. Siç Jezusi e bën të qartë tek Gjoni 17:18, ai vetë e dërgon kishën në botë ashtu si Ati i tij e dërgoi atë së pari në botë: pa asgjë. Dhe ai e dërgon kishën që ta mbartë kryqin e saj në botë, ashtu siç ai e mbarti të tijin. Ai iu nënshtroa sistemeve të botës – madje deri në vdekjen mbi kryqin që e mbarti vetë.⁷² Ai synon që edhe ne gjithashtu t’i nënshtrohemi sistemeve

⁶⁸ Shih Gjoni 17:21.

⁶⁹ Zbulesa 18:4, NIV.

⁷⁰ Shih Jakobi 1:27.

⁷¹ Efesianëve 5:27.

⁷² Shih Filipianëve 2:8.

të botës. Qëllimi i tij nuk është që kisha të mund të gjejë sukses përmes tyre, por përkundrazi, që kisha të mund t'i ekspozojë ata për atë që janë në të vërtetë, fuqi armiqësore. Ai nuk kërkoj autorizim prej sistemeve të botës, as nuk e ushtroi pushtetin e tij përmes tyre. Ai e ngatërroi çdo përpjekje prej atyre në botë për ta futur atë (Jezusin) në kategoritë e saj.⁷³ Ai i ngatërroi të dyja palët: ndjekësit e tij dhe armiqtë e tij, duke refuzuar çdo lloj përfitimi prej sistemit të botës, gjë që në dukje do ta kishte bërë detyrën e tij më të lehtë.⁷⁴

Disa mund të protestojnë: “Po, por Bibla na bën thirrje që të jemi të bindur ndaj sundimtarëve tanë.” Dhe kjo është e vërtetë. Por bindja që kërkohet nuk është as absolute, as e pakushtëzuar. Për shembull, neve as nuk na kërkohet, as nuk nxitemi që të jemi të bindur ndaj përkufizimit ose pritjeve që kanë për kishën qeveria ose publiku i gjerë. Gjithsesi, na bëhet thirrje t'i nënshtrohemi ndëshkimit prej qeverisë dhe publikut të gjerë kur, duke jetuar sipas përkufizimit të Perëndisë për kishën dhe pritshmërisë prej saj, ne hasim në konflikt me vetë përkufizimin dhe pritshmërinë prej qeverisë dhe botës. Do ta konsiderojmë më plotësisht këtë në parimin e dytë.

Thirrja e Zotit është që kisha të jetë në botë ashtu siç Ai vetë ishte në botë. Ky ka qenë gjithmonë qëndrimi i njerëzve të shenjtë të Perëndisë në botë: siç e përshkruan Hebrejve 11:13 “të huaj dhe banorë të përkohshëm në tokë.”⁷⁵ 1 Kronikave 29:15 thotë se ne jemi “thjesht duke kaluar përmes.”⁷⁶ Kur unë jam thjesht duke kaluar përmes një vendi, nuk kërkoj të vendos rezidencën ligjore atje, as nuk hap një llogari bankare atje, as nuk kërkoj të zgjidhem për poste drejtuese në atë vend. Vetë kryerja e

⁷³ krahaso Mateu 11:3, Luka 7:19, Marku 14:61, Marku 8:27-30, Luka 23:1-3, Gjoni 18:33-38, Mateu 14:2.

⁷⁴ krahaso Mateu 4:1-11, Luka 23:37, Mateu 27:40-42.

⁷⁵ Hebrejve 11:13, CJB.

⁷⁶ 1 Kronikave 29:15, CJB.

këtyre gjërave tregon se jam njollosur, duke marrë gabimisht të përkohshmen për të përhershmen. Në vend të këtyre gjërave, unë veproj në atë vend si i huaj dhe një banor i përkohshëm, edhe sikur të kem për të bërë biznes urgjent atje. Vetë parehatia që përjetoj si një i huaj dhe një banor i përkohshëm është një kujtesë e vazhdueshme (ndaj vetes dhe të tjerëve) se unë thjesht po kaloj atje, nuk po qëndroj.

Disa të krishterë do ta pohojnë se nuk ka ndonjë konflikt mes kishës që rrëfen përpara Perëndisë se ajo është një mister i pashoq dhe i shenjtë që thjesht po kalon përmes botës, ndërkohë që në të njëjtën kohë i rrëfen botës se është një OJF fetare që kërkon statusin e të qenit i përhershëm. Të paktën njëri nga këto rrëfime është gënjeshtër. Po të mos ishte kështu, atëherë është e vështirë të përfytyrohet se pse Jezusi nuk do ta bënte atë pretendimin e ngjashëm për statusin e dyfishtë përpara Pilatit të acaruar, që ishte shumë i motivuar për ta liruar atë. Nëse Jezusi do t'i kishte shpjeguar se ai ishte një mbret jashtë kësaj bote, por brenda saj ishte thjesht përfaqësuesi ligjor i një tjetër shoqate fetare që kërkonte të regjistrohej si institucion brenda perandorisë, do t'i kishte kursyer të gjithëve, përfshirë këtu edhe veten e tij, plot telashe.

Që nga fillimi i krijimit, më i madhi i ka dhënë emrin më të voglit. Adami iu dha emra kafshëve; kafshët nuk ia dhanë emrin Adamit. Prandaj, kur kisha ia lejon vetes që të emërtohet prej botës si një OJF fetare, ajo i tregon vetes se kush është më i madhi e kush është më i vogli.

Sa më gjatë që vepron një kishë me identitetin më të paktë të të qenit një korporatë fetare jofitimprurëse, aq më tepër e neglizhon ajo identitetin e saj më të madh si e vetmja nuse/trup/shtëpi frymërore/qytet qiellor i Birit të Perëndisë. Ajo harron se identiteti i saj i vërtetë nuk përshtatet brenda përshkrimeve dhe formave organizative të kësaj bote, por përkundrazi i kthen ato përmbys. Më keq akoma, kisha del se varet nga përfitimet e të

qenit një korporatë “e kësaj bote.” Nuk e përfytyron dot veten të veprorë pa marrë pjesë në sistemet e botës; madje e konsideron si qesharak sugjerimin se ajo duhet ta bëjë një gjë të tillë.

Si rezultat, kisha bëhet subjekt i kësaj bote. Për t’i mbajtur përfitimet e statusit të saj botëror, ajo duhet të pajtohet me kërkesat e vazhdueshme që bëhen prej sunduesve të kësaj bote. Këto ditë ato kërkesa janë gjithnjë e më tepër agresive, sidomos në lidhje me revolucionin seksual. Bota e lirë i sheh besimet tradicionale dhe praktikën e kishës se janë gjithnjë e më shumë problematike. Qeveria dhe publiku i gjerë e konsiderojnë mbështetjen e kishës si një gjë jo të domosdoshme dhe madje si të padëshirueshme. Ata kërkojnë ta ndryshojnë kishën, që kisha të paktën të mund të sigurojë një vitrinë për revolucionin seksual.

Kisha mund të mos i rezistojë dot rimodelimit të saj në duart e botës për një larmi arsyes. Ndonjëherë ajo nuk i reziston, ngaqë nuk i dallon dot arsyet (d.m.th. ajo mund të jetë në gjumë dhe ka një besim bazë tek qeveria dhe publiku i gjerë.) Ose, mund të mos i rezistojë dot ndryshimeve, ngaqë është nënshtruar mjaftueshëm (është zbutur, si kafshët shtëpiake) nga qeveria, duke besuar se ajo duhet të varet prej saj në mënyrë absolute dhe të pakushtëzuar. Më keq akoma, ajo mund të bëhet si një lloj nxitësi për ndryshimet që kërkojnë qeveria dhe publiku i gjerë, duke besuar se ajo mund ta rritë popullaritetin dhe rëndësinë e saj duke dhënë bekimin e saj. Ndonjëherë ajo iu nënshtrohet ndryshimeve për të qenë me këmbë në tokë, duke besuar se nuk ka vlerë të bësh rezistencë, ose se duke iu nënshtruar në një fushë, ajo mund të fitojë lëshime në një fushë tjetër. Në kohë të tjera, kisha iu nënshtrohet ndryshimeve prej frikës, duke besuar se, nëse nuk nënshtrohet me butësi, ajo mund të përballet me rritjen e mungesës së popullaritetit dhe me kufizime edhe më të dhimbshme.

Por deri më tani, arsyeja më e zakonshme se pse kisha në botën e lirë e lejon veten të rimodelohet prej qeverisë dhe publikut të gjerë është sepse sapo ajo i nënshtrohet regjistrimit, emërimit

dhe formave që i imponon bota, atëherë kisha fillon të ketë nevojë për to për të mbijetuar. Ajo nis të mendojë se është një kishë, ngaqë plotëson kërkesat e rregulloreve të qeverisë dhe pritjet e publikut të gjerë. Kjo nuk do të thotë se kisha gjithnjë bie dakord me qeverinë ose me publikun e gjerë. Thjesht do të thotë se kisha nuk e imagjinon dot ekzistencën e saj pa ta. Në botën e lirë, qeveria, publiku i gjerë dhe kisha ndërthuren me njëri-tjetri në një mënyrë Trinitariane: tre persona, por një thelb.⁷⁷

Niko Smithi (Nico Smith) ishte një pastor dhe profesor i teologjisë në Afrikën e Jugut në vitet 1960-të. Ai ishte gjithashtu një mbështetës i fortë i politikave të aparteidit për ndarjen racore në Afrikën e Jugut. Njëherë, Smithi takoi Karl Barthin, teologun e njohur zviceran, që kishte ndihmuar në formësimin e rezistencës së Kishës Gjermane të Rrëfimit ndaj Hitlerit në Gjermaninë naziste. Smithi shkroi për pikën kulmore të takimit të tij me Barthin:

Pastaj Barthi më pa e më tha: - A mundet të të bëj një pyetje personale, përpara se të largohesh? A je i lirë ta predikosh ungjillin në Afrikën e Jugut?

- Natyrisht, - i thashë. - Jam plotësisht i lirë, ngaqë ne kemi lirinë e besimit fetar në vendin tonë.

- Barthi menjëherë u përgjigj duke thënë se nuk ishte ky lloji i lirisë që ai kishte në mendje. Ai dëshironte të dinte, nëse unë, po të hasja në Bibël gjëra që nuk ishin në përputhje me ato që besonin miqtë dhe familja ime, do të isha i lirë të predikoja për ato gjëra?

Përsëri u zura ngushtë dhe i thashë se në të vërtetë nuk e dija, ngaqë kurrë deri më tani nuk e kisha pasur një përvojë të tillë.

⁷⁷ Për një konsiderim më të detajuar të kësaj dukurie, shihni analizën time për kapitullimin e kishës skandinave ndaj revolucionit seksual tek Hyrja e broshurës: *Përgatitja për kishën e fshehtë*, Seul: Zëri i martirëve, Kore, 2017, fq. 68-73.

Pastaj Barthi u përkul pak përpara nga karrigia e tij, dhe tha: - Po ti e di, mund të bëhet edhe më e vështirë. Mund të zbulosh në Bibël gjëra që bien ndesh me ato që po bën qeveria. A do të ishe i lirë për të predikuar kundër tyre?

Përsëri u detyrova t'i them se në të vërtetë nuk e dija.

Atëherë Barthi thjesht tha: - Mirë. Mund të largohesh.

Në tramvaj, duke u kthyer për në qendrën e qytetit, mendova për pyetjen e Barthit “A je i lirë?” I thashë vetes: - Jam i sigurt se Barthi mendon që ne në Afrikën e Jugut jemi racista dhe donte që të më paralajmëronte kundër aparteidit. Në njëfarë mënyre, u ndjeva si Pjetri, të cilin Jezusi e pyeti tri herë: - A më do ti mua? Por që nga ajo ditë, pyetja nëse isha i lirë vazhdoi të më kthehej në mendje aq sa nuk e shqisja dot prej saj.⁷⁸

Për Smithin, takimi me Barthin shpuri në atë që ai e quajti “konvertim” në bindjen se aparteidi ishte gabim. Përpara takimit, ai “kurrë nuk kishte menduar” lidhur me faktin nëse ishte i lirë për ta predikuar ungjillin, nëse ungjilli kundërshtonte ato gjëra që besonin miqtë dhe familja e tij dhe gjërat që po bënte qeveria. Smithi tha se ai “kurrë deri më tani nuk e kishte pasur një përvojë të tillë.” Kjo nuk do të thotë se Smithi gjithmonë kishte rënë dakord me miqtë dhe familjen e tij, dhe se ai kurrë nuk kishte shprehur mospajtim me qeverinë. Pyetja e Barthit ishte për supozimet themelore të shoqërisë së Smithit—gjërat që njerëzit në shoqërinë e Smithit i besojnë, madje pa menduar fare për to. Kur koreanët brenda kishave dhe jashtë tyre duken njësoj, veprojnë njësoj, shohin të njëjtat shfaqje, dëgjojnë të njëjtën muzikë, flasin për të njëjtat çështje, ndajnë të njëjtat

⁷⁸ Cituar tek Anxhela Dinhart Hankok (Angela Dienhart Hancock), *Urgjenca për artin e predikimit nga Karl Barth (Karl Barth's Emergency Homiletic)*. Grand Rapids, MI: Eerdmans Publishing Company, 2013, fq. viii-ix.

përkufizime për suksesin dhe jetën e mirë, ndjekin të njëjtat qëllime në të njëjtat mënyra, dhe përdorin saktësisht të njëjtat sisteme për të bërë biznes dhe për t'i realizuar qëllimet e tyre në botë, ne mund të pyesim veten, a jemi të lirë për ta predikuar ungjillin në Kore? Në cilat mënyra mund ta kompromentojë regjistrimi ligjor aftësinë tonë për ta bërë këtë gjë?

Por mospërfshirja e kishës ngre pyetje të tjera, të tilla si: Ku do të takoheshim, nëse nuk do të mundnim dot të merrnim me qera një ndërtesë? Si do t'i përpunonim dhuratat, ose si do t'i financonim misionet, ose si do ta paguanim një pastor, nëse nuk do të kishim një llogari bankare? Si do të mundet kisha ta ndikojë botën, nëse nuk ekziston ligjërisht në të?

Secila prej këtyre pyetjeve do të trajtohet në pjesën tjetër të këtij libri. Për tani, thjesht mjafton të kujtoni se në kohët dhe vendet më të vështira në historinë e kishës, ajo ka vepruar në fshehtësi dhe pa qenë e regjistruar si ent juridik. Nuk ka pasur ato mjete për të cilat sot ne të krishterët në botën e lirë jemi të bindur se janë të nevojshme për mbijetesën e kishës, dhe as nuk kishte hyrje për në sistemet e botës.

Por ajo e ndiqte lirshëm Zotin kudo ku e drejtonte ai, prandaj lulëzoi.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Mos e regjistroni kishën tuaj si një korporatë ligjore. Pranojeni identitetin e saj hyjnor si një i huaj dhe një banor i përkohshëm që po kalon nëpër këtë botë, dhe disiplinoheni veten për të folur, menduar dhe planifikuar në këtë mënyrë.
- Mos i jepni një emër kishës suaj. Nuk është një organizatë që është e jona për t'i vënë një emër. Tashmë ajo është emërtuar prej Zotit të saj. Në

Shkrimet e Shenjta, vetëm vendi ku ajo mbliidhet na është dhënë për t'u emërtuar — p.sh. kisha që takohet në shtëpinë e Nimfës.⁷⁹ Përmbajtja e vetes që të mos i vëmë emër asaj është mënyra sesi mund ta tregojmë vetëdijësimin tonë se ajo nuk është e kësaj bote dhe nuk është subjekt për t'u emërtuar prej gjërave më të vogla se ajo.

- Studiojeni Shkrimin e Shenjtë dhe ato që etërit e kishës së hershme kanë shkruar, që Zoti t'ua bëjë të qartë sesi kisha është një organizëm dhe jo një organizatë, dhe cili është ndryshimi mes të dyjave.
- Studiojeni kishën e fshehtë anembanë botës dhe nëpër shekuj, që ta kuptoni sesi kisha mund të mbetet në botë, por jashtë sistemit financiar, komercial, ligjor, dhe politik të botës.
- Studioni pjesën tjetër të këtij libri për të planifikuar një kishë të fshehtë, që nuk varet nga sistemet e qeverisë dhe të publikut të gjerë.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Themeloni një sistem financiar të bazuar mbi paranë e gatshme si rezervë, të cilën kisha mund ta përdorë për të shmangur ndërhyrjen e qeverisë në misionet dhe shërbesën e kishës. Gjithnjë e më tepër, vullneti politik i botës po ushtrohet përmes sistemit financiar të botës. Qeveritë dhe bankat mund t'i ngrijnë llogaritë bankare dhe pagesat me një lehtësi befasuese. Ata gjithashtu mund t'i gjurmojnë pagesat brenda vendit, edhe ato ndërkombëtare, kështu që kisha ose parandalohet për të dërguar para në fushën e misionit,

⁷⁹ krahaso Romakëve 16:5 dhe Kolosianëve 4:15.

ose është subjekt ndaj mbikëqyrjes së mëtejshme dhe ndërhyrjes. Qëllimi i këtij sistemi nuk është të gënjehet për punën e kishës, ose ta fshehë atë, por të ketë mundësi ta vazhdojë punën pa gënjyer. Caktoni udhëzime të kujdesshme për mbajtjen e llogarive dhe procedurat për këtë sistem të bazuar mbi paratë e gatshme, që të jetë i paqortueshëm, dhe për të cilin të raportohet plotësisht në deklaratat financiare të kishës dhe gjatë kontrollit financiar (auditit).

- Hartoni një plan lidhur me si do të takohet kisha, si do të veprojë dhe si do të komunikojë, në rast se e humbet ose do t'i duhet ta dorëzojë statusin si jofitimprurëse. Hartojeni këtë plan tani, shumë kohë përpara se të bëhet i dukshëm ndonjë shqetësim specifik. Ndonëse disa prej detajeve të planit duhet të mbahen konfidenciale për arsye sigurie, ai i duhet bërë i njohur bashkësisë se kisha e ka krijuar një plan të tillë, që anëtarët e kishës të mos kenë frikë për ndonjë kërcënim prej qeverisë ose prej publikut të gjerë ngaqë po kryejnë çfarëdolloj gjëje që urdhëron Zoti kishën të bëjë. Plani duhet të miratohet nga udhëheqësia e kishës, dhe ata që janë të ngarkuar me veprime të caktuara në atë plan duhen trajnuar sesi t'i realizojnë ato menjëherë pas miratimit të planit. Në mënyrë periodike duhet të ketë ushtrime stërvitore dhe pa njoftim paraprak, që kisha të praktikohet për të kaluar në fshehtësi.
- Në një kishë që është e regjistruar ligjërisht, pasuritë ekzistuese të kishës nuk mundet e nuk duhet t'u transferohen anëtarëve individualë të bashkësisë. Megjithatë, kisha duhet t'i marrë në konsideratë të gjitha blerjet e ardhshme kapitale dhe nismat për financime nën dritën e parimeve që u ndanë në

këtë kapitull. Mund të ndodhë që disa shërbime të caktuara të financohen drejtpërdrejt prej anëtarëve të kishës, e jo përmes llogarive të kishës, me qëllim që të parandalojnë ngushtimin, kufizimin ose kompromentimin prej qeverisë ose publikut të gjerë në të ardhmen.

- Mos pranoni asnjë lloj përfitimi që vjen prej regjistrimit si ent juridik. Për shembull, kishat dhe pastorët duhet të paguajnë taksa me të njëjtën përqindje si çdo korporatë apo punonjës tjetër. Anëtarët e kishës mund të mësohen që të mos kërkojnë zbritje tatimore për donacionet e tyre. Kjo e liron kishën nga frika e ndëshkimit prej qeverisë dhe opinionit publik dhe e çliron atë për të predikuar vërtet ungjillin.
- Në vendet ku pastorët kanë mundësi për t'i zyrtarizuar martesat që njihen prej shtetit, ndajeni martesën në kishë prej asaj civile duke zbatuar një politikë sipas së cilës kisha nuk do të nënshkruajë certifikata martesë. Kjo do të krijojë një precedent ligjor të rëndësishëm dhe të mbrojtshëm, kur revolucioni seksual të kërkojë që kishat të kremtojnë martesë në emër të shtetit, që bien jashtë përkufizimit besnik të kishës për martesën.⁸⁰
- Bëjini vetes pyetjen që Karl Barthi i bëri Niko Smithit: A jeni i lirë ta predikoni ungjillin?

⁸⁰ Për më tepër detaje lidhur me si po zbatohet kjo në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara, shihni librin e Efraim Radnerit (Ephraim Radner): “Pse e ndryshova mendjen lidhur me martesën civile,” *Gjërat e Para* (“Why I Changed My Mind on Civil Marriage,” *First Things*), <https://www.firstthings.com/web-exclusives/2014/11/why-i-changed-my-mind-on-marriage>.

Parimi II.

Mos ikni për të shpëtuar,
mos rezitoni, e mos e strehoni
përndjekjen; në vend të kësaj,
jini i krishterë i plotë
në mes të saj

Si duhet të përgjigjet kisha kur ajo has kundërshtim prej qeverisë dhe opinionit publik?

Ka katër përgjigje të mundshme. Tre e shkatërrojnë kishën. Vetëm një e çon përpara.

Kjo është ajo që Profesori Pjetër Kuzmic nga Seminari Gordon-Konuell (Gordon-Conwell) zbuloi, kur studioi sesi u përgjigj kisha në Evropën Lindore ndaj shtypjes komuniste nën Bashkimin Sovjetik.

Përgjigjja e parë shkatërruese që vëzhgoi Prof. Kuzmic mes të krishterëve të Evropës Lindore ishte *arratisja*. Kur hyri komunizmi, disa të krishterë u larguan: ose në një shtëpi tjetër, apo qytet tjetër (ndonjëherë madje edhe në një shtet tjetër) ngaqë kërquan t'i largoheshin përndjekjes. Disa qëndruan atje ku ishin, por u tërhoqën plotësisht prej shoqërisë. Të gjitha këto lloj arratisjesh dolën prej së njëjtës rrënjë mëkatore: Frikës. Ashtu siç vëren Prof. Kuzmic, të krishterët kishin frikë të ndërvepronin me komunizmin, ngaqë ata e panë atë si një pushtet të lig – një pushtet të lig e shumë të fuqishëm, me të cilin mënyra më e mirë e sjelljes ishte të fshiheshe prej tij.⁸¹ Në vend të ungjillëzimit – që

⁸¹ Pjetër Kuzmic. "Teologjia pentakostale dhe Evropa komuniste," tek W.K. Kay & A.E. Dyer, eds., *Pentakostalizmi evropian (Studime globale pentakostale dhe karizmatike)*. "Pentecostal Theology and Communist

është mënyra sesi gjithmonë supozohet që t'u përgjigjet kisha pushteteve të ligj – kisha

zhvilloi një mentalitet sektarian të getos... që i bëri ata të mos ishin të aftë të kishin ndikimin si 'kripë e dritë' në shoqërinë e tyre, ashtu siç përshkruhet tek ungjilli. Shpesh ata zhvilluan nënkulturat e tyre të devotshmërisë fetare me modelet e tyre të sjelljes, gjuhës, kodit të veshjes dhe madje edhe himnologjinë dhe mënyrat e lutjes.⁸²

Frika bën që kisha të maskohet dhe të shkojë të fshihet, duke shpresuar se e keqja nuk do ta vërejë se mbretëria e Perëndisë është afër. Ky është lloji i gabuar i të kaluarit në fshehtësi. Në të vërtetë është njësoj si ta fshehim llampën tonë nën shinik.⁸³ Ajo i sjell shkatërrim kishës, jo vetëm prej armiqve të saj, por gjithashtu edhe prej Zotit të saj. Tek Zbulesa 21:8, Jezusi i dorëzon në liqenin e zjarrtë jo vetëm vrasësit, magjistarët, idhujtarët, gënjeshtarët dhe imoralët seksualë, por gjithashtu edhe frikacakët.

Përgjigjja e dytë shkatërruese që vëzhgoi Prof. Kuzmic mes të krishterëve të Evropës Lindore ishte e kundërta e qëndrimit frikacak: *rezistenca*. Që do të thotë,

të reagosh duke luftuar, të marrësh pozicionin e kundërshtimit aktiv ndaj qeverisë dhe politikave të saj... Arsyetimi i thjeshtë prapa këtij mentaliteti të kryqëzorit ishte se sistemi i ri është i paperëndishëm dhe i lig, i frymëzuar nga djalli dhe ai as nuk duhet të tolerohet, as

Europe,” in W.K. Kay & A.E.Dyer, eds., *European Pentecostalism (Global Pentecostal and Charismatic Studies)*. Leiden, Holandë: Brill, 2011, fq. 340.

⁸² Kuzmic, fq. 342.

⁸³ Shih Mateu 5:15.

nuk duhet t'i bindesh, por përkundrazi të kundërshtohet në emrin e Krishtit.⁸⁴

Kjo përgjigje gjithashtu çoi në shkatërrim: Të krishterët u vranë, ndërtesat e kishave u shkatërruan, dhe—më e keqja nga të gjitha—ungjilli u tradhtua. Si u tradhtua ungjilli? Kuzmic shpjegon: “Kudo ku të krishterët u kapën në kurthin e presupozimit se detyra e tyre kryesore ishte ta luftonin komunizmin, ata i vunë pengesa vetes, ngaqë u bënë të paaftë për të praktikuar faljen dhe për të qenë dëshmitarë të gjallë (ose të vdekur) përpara armiqve të tyre komunistë.”⁸⁵ Me fjalë të tjera, kurdoherë që kisha i rendit në formacion luftimi forcat e saj për ta *mbrojtur veten* kundër një armiku—qoftë ky komunizmi ose revolucioni seksual—ajo reduktohet vetëm në një armik të armikut të saj. Nuk është më kisha. Është thjesht një parti tjetër politike.

Përgjigjja e tretë shkatërruese që vëzhgoi Prof. Kuzmic mes të krishterëve të Evropës Lindore ishte e kundërta e rezistencës: *përshtatja*. Prof. Kuzmic e përkufizon këtë si “tundimin për t’u konformuar ose për të bërë kompromis, për ta përshtatur mesazhin me situatën e re dhe për t’u pajtuar me ideologjinë mbizotëruese.”⁸⁶ Kjo është përgjigjja e Lëvizjes së Krishterë Gjermane nën Hitlerin dhe e Kishës së Tre-Vetave në Kinë. Është përgjigjja e kishave amerikane dhe evropiane, që iu përgjigjën revolucionit seksual duke shpallur se ata i kishin hapur Biblat e tyre dhe kishin gjetur se homoseksualiteti kishte qenë fshehur atje për 2000 vjet.

Përshtatja patjetër e shkatërron kishën duke e kompromentuar dëshminë e saj dhe duke e bërë mesazhin e saj të nënshtuar ndaj ideologjive botërore. Por, ashtu siç vëren Prof. Kuzmic, ajo gjithashtu shkakton një formë më të keqe të shkatërrimit:

⁸⁴ Kuzmic, fq. 343.

⁸⁵ Kuzmic, fq. 344.

⁸⁶ Kuzmic, fq. 344.

ndarjen e kishës. Ngaqë disa kisha u përshtatën, ndërkohë që të tjerat kalojnë në fshehtësi, kisha bëhet një shtëpi e ndarë.⁸⁷ Kisha bëhet armiku i vetes dhe madje mundet që ta përndjekë vetveten. Madje edhe pasi është mposhtur ideologjia – qoftë skllavëria, komunizmi ose revolucioni seksual – plagët që kisha ia ka shkaktuar vetvetes mund të mos shërohen. Përshtatja lë gjithmonë shenja plagësh pas.

Kështu që, nëse arratisja, bërja rezistencë, dhe përshtatja, që të gjitha e shkatërrojnë kishën, atëherë cila përgjigje e çon përpara atë?

Prof. Kuzmic thotë se vetëm një përgjigje e çoi përpara kishën në Evropën Lindore nën komunizëm: *teologjia e kryqit*.

Fjalët e Jezusit: “Nëse dikush do të vijë pas meje, ai duhet ta mohojë veten dhe ta marrë kryqin e tij e të më ndjekë” (Marku 8:34) - patën një kuptim të thellë përjetues për ta. Leximi i tyre kontekstual i Shkrimit të Shenjtë i bindi ata se vuajtja ishte një shenjë thelbësore e dishepullimit të vërtetë.⁸⁸

Të jetuarit sipas teologjisë së kryqit nënkuptonte një përkushtim të plotë ndaj kërkesave të Jezusit, pavarësisht nga kostoja. Do të thoshte ta jetoje jetën e krishterë në përgjigje të thirrjes së Krishtit, jo si reagim ndaj kundërshtimit të qeverisë. Kjo përfshiu pranimin e çdo lloji ndëshkimi të dhënë prej qeverisë për ta jetuar plotësisht “atë besim që ka qenë besuar kudo, gjithnjë, prej të gjithëve.”⁸⁹ Kjo është arsyeja pse në mes të shtypjes naziste ndaj kishës besnike, Ditrik Bonhofër (Dietrich Bonhoeffer) shkroi libra klasikë të krishterë që i qëndruan kohës, të tillë si *Kostoja*

⁸⁷ Kuzmic, fq. 344.

⁸⁸ Kuzmic, fq. 349.

⁸⁹ Vinsenti i Lerinsit (Vincent of Lérins.) Commonitory ch. II, §6; NPNF Series II Vol. XI fq. 132.

e dishepullimit dhe Jeta së bashku, kurse Karl Barthe shkroi teologji sistematike. Që të dy i mësuan kishës sesi të jetë më plotësisht një kishë, jo thjesht si ta kundërshtojë nazizmin.

Gjithnjë, është gatishmëria e kishës për të vuajtur pa u hakmarrë, ndërkohë që vazhdon t'i dojë armiqtë e saj, teksa e jeton plotësinë e jetës së krishterë, që e çon përpara çështjen e Krishtit.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave dhe kishat ekzistuese:

- Mos e përgatisni kishën tuaj për ta mbrojtur veten kundër një çështjeje të caktuar shoqërore, që të mos e shtrembëroni besimin klasik të krishterë, dhe ta bëni të vështirë që anëtarët e kishës suaj t'i duan armiqtë e tyre dhe të vuajnë për ta. Madje edhe në orën më të errët të kishës, sigurohuni që bashkësia juaj ta dijë dhe ta risjellë në kujtesë plotësinë e “atij besimi që ka qenë besuar kudo, gjithnjë, prej të gjithëve.”
- Për këtë qëllim, sigurohuni që të gjithë anëtarët e kishës suaj jo vetëm ta mësojnë përmendësh Kredon e Nikeas ose të Apostujve, por ta shpjegojnë plotësisht kuptimin e secilës fjali.
- Jepini kishës suaj një mësim mbi atë që themeluesi i Zëri i Martirëve, I Përndershmi Riçard Vurmbrand e quajti “mundimologji” — pra, si të vuash në emër të ungjillit dhe për hir të armiqve të ungjillit. Tek vëllimi i kësaj serie, *“Përgatitja për kishën e fshehtë”*, I Përndershmi Vurmbrand jep një nga kurrikulat e pakta që janë në dispozicion për këtë temë.
- Shqyrtojini shërbesat e mësimet tuaja për t'u siguruar që secila është rrënjësuar në teologjinë e kryqit ashtu

siç përkufizohet tek Marku 8:34. Libri *Nën hijen e kryqit* i shkruar nga Glen Pener (Glenn Penner) është në dispozicion nga Zëri i Martirëve, dhe e konsideron secilin nga librat e Biblës nën dritën e teologjisë së kryqit.

- Lexoni libra klasikë të krishterë, të tillë si *Kostoja e Dishepullimit* dhe *Jeta së Bashku*, që tregojnë plotësinë e traditës klasike të krishterë teksa mësohet e jetohet prej kishës në kontekstin e një kundërshtimi të madh. Përdorini ilustrimet nga libra të tillë në shërbesat tuaja për t'u siguruar që sa herë mblidhet kisha së bashku, ajo dëgjon thirrjen e Krishtit për t'i mbartur përditë kryqet tona.

Parimi III.

Në vend që të kaloni në
fshehtësi si kundërpërgjigje ndaj
përndjekjes, kaloni në fshehtësi
për ta mbajtur gjënë Kryesore,
gjë kryesore

Ka vetëm një arsye të ligjshme për ta kaluar një kishë në fshehtësi. Përgjigjja ndaj përndjekjes nuk është ajo arsye e ligjshme.

Ashtu siç e shpjegon parimi i mëparshëm, kur kisha i përgjigjet përndjekjes duke kaluar në fshehtësi, ajo ndjek një rrugë të shtyrë nga frika dhe mungesa e guximit. Kishës i është dhënë detyra prej Zotit të saj që vazhdimisht të tregojë dashurinë e tij sakrifikuese ndaj armiqve të tij. Kur nuk ia del mbanë të veprojnë kështu, ajo nuk duhet të kapet në befasi, kur të gëlltitet prej një balene dhe të nxirret jashtë tek dera e përparme e armikut.

Po ashtu, ta kalosh një kishë në fshehtësi, që t'i bëjë rezistencë një shtypësi, e kthen kishën në një parti politike. Kjo gjithnjë merr të njëjtin qortim me tre fjalë prej Zotit: “Largoje shpatën tënde!”⁹⁰ Kushdo që e mbron kishën me anën e një shpate—qoftë kjo shpata e medias, shpata e politikës, shpata e arsyetimit—do të vdesë prej së njëjtës shpatë.⁹¹ Kisha nuk i përket kësaj bote ashtu siç as Zoti i saj nuk i përkiste

⁹⁰ Mateu 26:52, NLT.

⁹¹ Mateu 26:52.

kësaj bote. Ajo nuk ka nevojë të mbrohet në këtë botë më tepër nga sa Zoti pati nevojë të mbrohej në këtë botë. Jezusi e quajti Pjetrin “Satan”, kur Pjetri debatoi për të kundërtën.⁹² Zoti dhe kisha e tij janë të pranishëm në botë si flijime të gjalla.⁹³ Kryqi i Jezusit e shpëton botën; kryqi i kishës i kujton botës se fitorja e Zotit është e sigurt.

Më së fundi, ta kalosh një kishë në fshehtësi, ngaqë të krishterët e tjerë janë përshtatur me ideologjinë e armikut është e trishtueshme. Kur ajo kishë “e zellshme” bërtet që nga fshehtësia: “Unë jam e vetmja që kam mbetur, dhe tani po përpiqen të më vrasin edhe mua,” Zoti do t’i kujtojë asaj kishe se Ai gjithnjë ka rezervuar të shtatë mijet e tij mbi dhe, që nuk i janë gjunjëzuar Baalit. Dhe Zoti i tërheq nga beteja të zellshmit.⁹⁴

E vetmja arsye e ligjshme për ta kaluar një kishë në fshehtësi është që “ta mbajë gjënë kryesore si gjëja kryesore.”

E mësova këtë shprehje nga Merv Najt (Merv Knight), historian dhe bashkëthemelues i i Zëri i Martirëve, Australi. Shprehja e mësipërme është mënyra e Mervit për të na kujtuar se, po të mos jemi të kujdesshëm, mund të bëhemi tepër të fokusuar në qëllimet dhe interesat dytësore në shërbesat tona dhe të përfundojmë duke e lënë pas dore qëllimin tonë kryesor. Ne duhet t’u themi “Jo” shumë gjërave të mira që *mund* t’i bëjmë në shërbesat tona, me qëllim që të jemi të fokusuar në gjënë e vetme që *duhet me patjetër* ta bëjmë.

Mbajtja e gjësë kryesore si gjë kryesore është një këshillë e mirë në çdo fushë të jetës. Është një këshillë absolutisht thelbësore në planifikimin e kishës së fshehtë.

Cila është gjëja kryesore për kishën?

⁹² Shih Mateu 16:23.

⁹³ Shih Romakëve 12:1-2.

⁹⁴ Shih 1 Mbretërve 19:9-18.

Xhon Kalvini (John Calvin) identifikoi dy shenja të një kishë të vërtetë: “Fjala e Perëndisë predikohet pastër dhe dëgjohej, dhe administrimi i pastër i sakramenteve.”⁹⁵

Atëherë, arsyeja e vetme për ta kaluar një kishë në fshehtësi është që të mposhtet cilado pengesë ndaj fjalës së Perëndisë për t’u predikuar pastër e për t’u dëgjuar, dhe që sakramentet të administrohen pastër.

- Kur qeveria vendos se kush mund të predikojë, çfarë mund të predikohet, ose ku mund të ndodhë predikimi, kisha është e detyruar të veprojë në fshehtësi, e jo të përshtatet me kufizimet.
- Kur qeveria ose publiku i gjerë e kufizon dëgjimin e lirë të ungjillit, kisha është e detyruar të kalojë në fshehtësi, e jo të përshtatet me kufizimet.
- Kur dëmtohet administrimi i pastër i sakramenteve, kisha është e detyruar të kalojë në fshehtësi, e jo të përshtatet me kufizimet.

Le të shqyrtojmë një shembull tejet të zakonshëm. Supozoni se një qeveri lejon “lirinë e besimit” për kishën: ata mund të predikojnë dhe ta dëgjojnë fjalën dhe të marrin pjesë në sakramentet, por vetëm brenda ndërtesave të regjistruara zyrtarisht pranë qeverisë. A është kisha e detyruar të kalojë në fshehtësi?

Po, kisha është e detyruar të kalojë në fshehtësi, ngaqë në një situatë të tillë fjala dhe sakramentet nuk janë më në gjendje të predikohen pastër, të dëgjoen ose të administrohen pastër pothuajse askund në atë shoqëri. Në një situatë të tillë kisha kalon në fshehtësi jo që ajo të mund të predikojë, dhe të dëgjojë

⁹⁵ Erik J. Titus (Eric J. Titus), “Shenjat e kishës nga Calvin: Një thirrje për shërim” (“Calvin’s Marks of the Church: A Call for Recovery”), UDK:265.1:265.3 Professional paper, 2011, fq. 114.

e të marrë pjesë në sakramentet vetëm në një shpellë të vogël sekrete ose në një vend pa pemë në mes të një pylli. (Ky është stereotipi i kishës së fshehtë.) Në vend të kësaj, ajo kalon në fshehtësi që fjala dhe sakramentet të mos lidhen, duke qëndruar besnike ndaj së vërtetës së 2 Timoteut 2:9. (Për të krishterin, e vërteta përkufizohet prej Shkrimit të Shenjtë, jo prej qeverisë ose publikut të gjerë. Shkrimi thotë se fjala nuk është e lidhur në pranga, dhe kisha e beson këtë, edhe kur qeveria këmbëngul për të kundërtën.) Ngaqë fjala dhe sakramentet nuk janë të lidhur në pranga, atëherë Zoti do ta drejtojë kishën në shumë vende jashtë ndërtesës së kishës, ku ai dëshiron që këto mjete të hirit të ndahen me të tjerët.

Le të shqyrtojmë një shembull tjetër. Supozoni se një qeveri miraton ligje që i kriminalizojnë thëniet kundër homoseksualitetit në vendet publike ose në media, përfshirë edhe mësimin e krishterë se homoseksualiteti është mëkat. Qeveria e siguron kishën se ajo ende mund të bëjë çfarë të dojë brenda ndërtesës së saj. A është kisha e detyruar të kalojë në fshehtësi?

Po, kisha është e detyruar të kalojë në fshehtësi, ngaqë sërish ka një përpjekje për ta lidhur fjalën. Kisha është shërbëtore e fjalës dhe e sakramenteve; fjala dhe sakramentet nuk janë shërbëtorë të kishës. Kjo do të thotë se kisha duhet t'i shërbejë fjalës, kudo që Zoti dëshiron që ajo fjalë të dëgjohet. Zoti nuk i respekton kufijtë e botës lidhur me ku, kur dhe prej kujt mundet ai ta dërgojë fjalën e tij, as se kujt mund t'ia dërgojë fjalën ai. Ai e ka mposhtur botën, nuk është se thjesht ka marrë prona të patundshme në të.

Por megjithatë, kisha në botën e lirë ka tendencën t'i pranojë kufizime si këto nga ana e qeverisë, në vend që të kalojë në fshehtësi. Kisha thotë: “Bashkësia jonë ende ka mundësi të predikojë e ta dëgjojë fjalën dhe t'i administrojë sakramentet; nuk është e nevojshme që ne të kalojmë në fshehtësi.” Por ky lloj qëndrimi e bën kishën Zot, dhe Zotin një shërbëtor. Kisha në këtë

rast është si ai i marri në shëmbëlltyrën e Zotit që thotë: “Do t’i them vetes: ‘Ke bollëk drithi të mbledhur për shumë vjet.’”:

Kurse Perëndia i tha atij: “O i marrë! Pikërisht këtë natë do të të kërkohet jeta jote. Atëherë kush do t’i marrë ato gjëra që ti ke përgatitur për vete?” Kështu do të jetë me këdo që grumbullon gjëra për vete, por nuk është i pasur ndaj Perëndisë.⁹⁶

Fjala dhe sakramentet nuk janë për t’u grumbulluar për kishën, në kishë, prej kishës. Kisha nuk mundet ta lidhë në pranga fjalën e sakramentet më tepër nga sa mund ta bëjë bota. Ato nuk lidhen. Kisha është e detyruar t’i ndjekë ato dhe t’u shërbejë atyre, kudo që i pëlqen vullnetit të erës t’i shpjerë.⁹⁷

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- A po mbillni një kishë të fshehtë ngaqë jeni kundër diçkaje në shoqëri apo në kishën ekzistuese? Nëse po, ndaloni menjëherë dhe pendohuni; asnjë kishë nuk mund të mbillet ngaqë mbjellësi është “për” diçka ose “kundër” diçkaje tjetër. Kisha është shërbëtore e fjalës dhe sakramenteve, nuk është zotëria i tyre.
- A jeni të përgatitur të vdisni fizikisht dhe shpirtërisht për armiq të ungjillit? Nëse jo, ju nuk do të jeni në gjendje ta mbani gjënë kryesore si gjë kryesore në kishën e fshehtë. Së pari, përgatituni të predikoni, të luteni ose të vdisni kurdoherë pa paralajmërim, dhe vetëm atëherë do të jeni gati për ta mbjellë një kishë të fshehtë.

⁹⁶ Luka 12:19-21, NIV.

⁹⁷ Shih Gjoni 3:8, NIV.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Studioni kur, si dhe pse kaluan në fshehtësi kishat në Gjermani. Studioni sidomos Deklaratën e Barmenit për Kishën që Rrëfëhet⁹⁸ dhe shtojeni atë tek dokumentet themelore të kishës suaj dhe kredot për t'i mësuar përmendësh e për t'i studiuar.
- Pyeteni veten: “A mundet që Fjala e Perëndisë të predikohet pastër, të dëgjohet dhe sakramentet të administrohen pastër kudo në Kore?” Nëse jo, ku jo dhe pse jo?
- A është gjëja kryesore ende gjë kryesore në kishën tuaj? Apo shërbesat po bëhen gjithnjë e më të shkurtra dhe sakramentet po administrohen gjithnjë e më rrallë, që gjërat e tjera më popullore të bëhen gjëja kryesore? Kur bashkësia mundet të durojë vetëm 20 minuta predikim të shëndoshë biblik, a duhet që pastori të përshtatet me këtë, apo të predikojë për aq kohë sa duhet që plotësia e ungjillit të dëgjohet, pavarësisht se sa e papëlqyeshme mund të jetë kjo nga anëtarë të kishës dhe vizitorë?
- Sunduesi i ri i pasur (Marku 10:17-27) ishte i përgatitur t'i bindej fjalës përbrenda territorit të tij, por ai nuk ishte i përgatitur ta braktiste territorin e tij dhe ta ndiqte fjalën, kudo ku erës i pëlqente ta shpinte. Shkrimi thotë se kjo ndodhi, ngaqë “ai ishte një person që zotëronte shumë prona”. Teksa qeveria dhe publiku i gjerë nisin të përpiqen ta lidhin fjalën në Kore, a jeni të përgatitur t'i shisni të gjitha ato gjëra që ka kisha, me qëllim që të kaloni në fshehtësi, që të mund ta shoqëroni fjalën kudo ku ajo dëshiron të shkojë? Zoti thotë se burri me hambarë të mëdhenj

⁹⁸ Shih <http://www.sacred-texts.com/chr/barmen.htm>.

nuk tregoi urtësi kur i shembi të vjetrit, me qëllim që të ndërtonte hambarë më të mëdhenj në atë kohë. Çfarë ju dikton urtësia se duhet të bëni tani, që të jeni në gjendje ta ndiqni fjalën dhe sakramentet për në ato fusha ku qeveria koreane dhe publiku i gjerë ka të ngjarë të përpiqen t'i lidhin ato?

Parimi IV.

Në vend që të siguroni ndërtesa, takohuni në vendet ku janë tashmë njerëzit

Ashtu siç e sqaron parimi i mëparshëm, problemi me mbjelljen e kishës është se shpesh ai fillon me ndërtesën: “Në këtë zonë ka nevojë për një ndërtesë, ku njerëzit të mund të shkojnë, kur të duan ta dëgjojnë Fjalën e Perëndisë të predikohet pastër dhe të marrin pjesë në sakramentet e administruara pastër.” Kjo gjë është pikërisht në rendin e kundërt. Kur Xhon Uesli tha: “Bota është famullia ime,” ai nuk pati ndërmend një fushatë ndërtimesh për të vendosur kishëza metodiste në çdo fshat, që të përmbushte kërkesën gjithnjë e në rritje të publikut për predikimet dhe sakramentet. Me fjalët e tij, ai nënkuptoi se: “në cilëndo pjesë [të botës] të jem, unë e gjykoj atë si të përshtatshme, të drejtë, dhe detyrën time për t’u deklaruar të gjithëve që kanë dëshirë të dëgjojnë, lajmin e mirë të shpëtimit.”⁹⁹

Fillimisht Uesli tmerrohej nga ideja e predikimit përjashta (d.m.th. predikimit në vendet publike ku njerëzit ishin tashmë, në vend që të merrnin ndërtesa ku njerëzit mund të vinin ta dëgjonin atë të predikonte). Kjo gjë shpejt u bë një domosdoshmëri

⁹⁹ Xhon Uesli (John Wesley), “E gjithë bota është famullia ime,” *Ditar i Xhon Ueslit* [“All the World My Parish,” *Journal of John Wesley.*] <https://www.ccel.org/ccel/wesley/journal.vi.iii.v.html>.

praktike, kur të gjitha ndërtesat e kishave u mbyllën për të.¹⁰⁰ Por më në fund ishte bindja teologjike, jo përfitimet praktike, që e bindën atë për domosdoshmërinë biblike të predikimit përjashta. Ai shkroi se ishte motivuar për të predikuar përjashta, thjesht për shkak të “një dëshire për t’u bërë i krishterë.”¹⁰¹

Sapo e kuptojmë se kisha është shërbëtori, jo Zoti, i fjalës dhe i sakramenteve, ne mund ta kuptojmë përse kisha e fshehtë nuk kërkon të marrë ndërtesa. Nuk ndodh kështu vetëm për shkak se ligjërisht ajo nuk ka mundësi ta bëjë këtë gjë, por gjithashtu ngaqë ajo duhet të jetojë sipas të vërtetës biblike se fjala dhe sakramentet nuk mund të lidhen. Nuk është e autorizuar për ta pranuar ofertën e qeverisë: “Prediko këtu, por jo atje. Prediko këtë, por jo atë. Predikoju këtyre njerëzve, por jo atyre.”

Kështu që, në terma më të thjeshta, ne duhet ta mbjellim kishën e fshehtë atje ku ne dhe ata që njohim tashmë jetojmë, punojmë, takohemi dhe luajmë.

Shkrimi i Shenjtë thotë se fjala nuk është e lidhur në pranga. Kishat duhet të bien dakord me Zotin, jo me qeveritë, të cilat gabimisht thonë se fjala është e lidhur vetëm për në ndërtesat e projektuara posaçërisht për këtë qëllim. Qeveritë mund ta hapin e ta mbyllin cilëndo ndërtesë, por gjithnjë do të ketë njerëz në një vend, dhe njerëzit e atij vendi gjithnjë do të jenë duke jetuar, punuar, duke u takuar apo duke luajtur diku. Kudo ku njerëzit jetojnë, punojnë, takohen dhe luajnë, aty është vendi ku kisha e fshehtë rrënohet. Në këtë mënyrë errësira nuk mund ta shuajë kurrë dritën¹⁰² dhe fjala nuk mund të lidhet kurrë.

¹⁰⁰ Historia e krishterë, “Xhon Uesli: A e dije?” *Krishterimi Sot (Christianity Today)*. <http://www.christianitytoday.com/history/issues/issue-2/john-wesley-did-you-know.html>.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Shih Gjoni 1:5.

Kjo është arsyeja pse ne nuk themi se kisha e fshehtë është “duke u fshehur.” Përkundrazi, ajo është duke u takuar, kudo ku takohen njerëzit. Pikërisht atje Zoti zgjedh t’i sjellë fjalën e sakramentet e tij, dhe kisha e tij është e detyruar që ta ndjekë. Në Librin e Veprave të Apostujve, kisha e re takohet nëpër shtëpi,¹⁰³ pranë një lumi¹⁰⁴ ose në një sallë leksioni,¹⁰⁵ jo ngaqë është duke u fshehur, por për shkak se këto janë vendet ku takoheshin njerëzit e zakonshëm dhe pikërisht atje zgjodhi Zoti që ta prezantonte veten e tij.

Për ta huazuar një shëmbëlltysë të Jezusit nga Mateu 13:33, kisha është majaja dhe vendet ku takohen tashmë njerëzit janë brumi. Problemi me të menduarin tonë sot është se, gabimisht, ne e identifikojmë vetë kishën me brumin. Ne kërkojmë ta bëjmë brumin e kishës të vijë, dhe ndërsa kisha vazhdon të rritet, ajo ka nevojë për një kuti buke gjithnjë e më të madhe. Ndërkohë, brumi i vërtetë – bota – lëngon.

Ngaqë bota është famullia për kishën e fshehtë (dhe këtu ne e përdorim termin “bota” jo nga pikëpamja gjeografike, por në kuptimin biblik, të gjithçkaje që kundërshton mbretërimin e Perëndisë), zgjedhja se ku të takohemi është e dukshme: ne takohemi saktësisht atje ku kemi qenë duke u mbledhur tashmë. Po të kishim kërkuar ndonjë ndërtesë të veçantë ku të takohemi, do të ishim duke mburjtur e fryrë vetveten (gjë që është mëkati i të marrit tek Luka 12:19-21 për të cilat u fol në parimin e mëparshëm) dhe do ta linim pa maja brumin e vërtetë.

Patjetër që ka shumë përfitime anësore për takimin në vendin ku mblidhemi tashmë. Për shembull, duke u takuar atje ku mblidhen njerëzit e zakonshëm, kisha e fshehtë mund të mësojë sesi të mblidhet kudo, kurdoherë. Kjo është një aftësi thelbësore në kohët e kundërshtimit të madh. Për më tej, ne nisim t’i shohim

¹⁰³ krahaso Veprat e Apostujve 2.

¹⁰⁴ krahaso Veprat e Apostujve 16:13.

¹⁰⁵ krahaso Veprat e Apostujve 19:9.

shtëpitë tona dhe vendtakimet tona si vende të shenjta dhe t'i trajtojmë ato në atë mënyrë. Shpenzimet për ndërtesat shkojnë pothuajse në zero, kështu që të krishterët mund t'ua kushtojnë të dhjetat e tyre shpalosjes së dashurisë vuajtëse të Perëndisë ndaj botës. Kjo do të diskutohet më tutje tek Parimi XI, mbi të dhjetat dhe dhënien në kishën e fshehtë.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Mbilleni kishën e fshehtë duke predikuar përjashta. Të predikuarit përjashta nuk do të thotë patjetër të predikosh duke qëndruar në qoshet e rrugës. Do të thotë të predikosh në vendet ku ju e të tjerët jeni tashmë. Për më tepër mbi predikimin përjashta, konsultohuni me tekstin klasik të Çarls Spërxhën (Charles Spurgeon), *Predikimi përjashta*¹⁰⁶
- A dini sesi ta ndiqni fjalën, teksa era e Frymës së Shenjtë e shpie atë kudo që i pëlqen? Lexoni Librin e Veprave të Apostujve, që është teksti themelor në lidhje me këtë çështje.
- Një kishë e fshehtë nuk është thjesht një kishë që mblidhet nëpër shtëpi. Çështja qendrore teologjike nuk është lloji i ndërtesës në të cilën mblidhet kisha, por nëse kisha konsiderohet se është majaja apo buka. Teksa nisni ta mbillni një kishë të fshehtë, bëjeni synim që të takoheni në një llojshmëri mjedisesh të ndryshme, atje ku janë njerëzit. Nëse takoheni vetëm në shtëpinë tuaj, atëherë ju thjesht do të jeni si një kishë që takohet në një ndërtesë të vogël; ju nuk do të bëheni një kishë e fshehtë.

¹⁰⁶ Një kopje falas në anglisht mund të shkarkohet nga kjo faqe interneti: <http://www.chapellibrary.org/files/3214/4908/7639/oapr.pdf>.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Cila është famullia e kishës suaj? Për shumicën e historisë së kishës, ndarjet gjeografike organizoheshin nëpër famulli, dhe pastori ishte përgjegjës për t'u kujdesur për të gjithë që ishin brenda kufijve gjeografikë të asaj famullie. Punoni me kishën tuaj për ta përcaktuar me lutje famullinë e saj, dhe pastaj për të predikuar besnikërisht e për t'i administruar sakramentet kudo tek ajo famulli. Kjo nuk do të thotë të organizoni skuadra të ndryshme për të bërë vizita që t'i ftojnë të gjithë në një ndërtesë kisha për ta dëgjuar Fjalën e Perëndisë të predikohet pastër dhe për të marrë pjesë në sakramentet e administruara me pastërti. Do të thotë se kisha shërben fjalën edhe sakramentet kudo nëpër famulli.
- Në vend që të ndërtoni vende të reja brenda hapësirës së kishës suaj, ku njerëzit mund të vijnë e të takohen, trajnojin anëtarët e kishës suaj që ta ofrojnë Fjalën e Perëndisë të predikuar pastër dhe të kryejnë administrimin e sakramenteve me pastërti, atje ku janë tashmë duke u takuar njerëzit në famullinë tuaj (d.m.th. në lagjen e madhe të cilën e dalluat me lutje në hapin e veprimit më sipër). Me fjalë të tjera, lejojini fjalën dhe sakramentet të shërbejnë si majaja që e bën të vijë brumin e famullisë suaj. Mos lejoni që ndërtesa juaj e kishës të bëhet brumi.
- Kryejini shërbesat e lutjes në mëngjes diku përjashta ndërtesës së kishës, nëse është e mundur duke i alternuar ato në vende të ndryshme në famullinë tuaj. Është e mundshme që të bëhet në shtëpitë e anëtarëve, vetëm bëni kujdes që të mos e kufizoni veten vetëm në vendet ku tashmë janë anëtarët ekzistues të kishës suaj.

Parimi V.

Kisha është një shtëpi e shtëpive

Ashtu siç e shpjegon parimi i mëparshëm, kisha e fshehtë mbillet në vendet e jetës së përditshme, atje ku janë tashmë të pranishëm njerëzit e zakonshëm. Por kjo nuk do të thotë se ne shkojmë atje ku janë të pranishëm njerëzit e zakonshëm, predikojmë ungjillin, dhe pastaj nisim të mbajmë shërbesa adhurimi në atë vend me ata që përgjigjen.

Kjo ndodh ngaqë ne nuk i mbjellim njerëzit dhe vendet *në* një kishë; në vend të kësaj, ne mbjellim një kishë *tek* njerëzit dhe vendet.

Ky është misteri i mbjelljes së kishës së fshehtë: ne në fakt nuk mbjellim *një kishë*. Në vend të kësaj, ne mbjellim *fjalën dhe sakramentet* në rrjetet ekzistuese të marrëdhënieve njerëzore: familjet, vendet e punës, shkollat dhe lagjet.

Çdo qenie njerëzore ekziston në rrjete të marrëdhënieve me njerëz. Në secilin prej këtyre “rrjeteve të marrëdhënieve” qeniet njerëzore lidhen me njëra-tjetrën sipas modeleve që kanë mësuar. Për ata që nuk e njohin Krishtin (ose për ata që nuk e njohin mirë atë), rrjetet e tyre të marrëdhënieve veprojnë sipas modeleve që kanë mësuar prej botës, si dhe sipas modeleve që kanë trashëguar prej mëkatit fillestar.¹⁰⁷ Kur fjala dhe sakramentet prezantohen te këto rrjete të marrëdhënieve, këto marrëdhënie mund të transformohen.

Nuk është thjesht individ i ai që transformohet; i tërë rrjeti mund të transformohet.¹⁰⁸ “Kisha” është ajo që ne e quajmë

¹⁰⁷ krahaso sidomos Zanafilla 3:16-19.

¹⁰⁸ Krahaso Veprat e Apostujve 16:31.

një rrjet të marrëdhënieve njerëzore ekzistuese, që është duke u transformuar prej predikimit të pastër e prej dëgjimit të fjalës, dhe prej administrimit të pastër të sakramenteve. Kur e kuptojmë mbjelljen e kishës në këtë mënyrë, ne mund ta shohim se shumë prej Dhiatës së Re është shkruar që të na trajnojë për ta përmbushur këtë detyrë — së pari në rrjetet tona, dhe pastaj si një ndihmës për t'i ndihmuar të tjerët ta përmbushin këtë detyrë nëpër rrjetet e tyre.

Jezusi vuri re se, kur prezantohet ungjilli në një rrjet të marrëdhënieve ekzistuese, rezultati shpesh është një konflikt: disa njerëz në atë rrjet do të duan të vazhdojnë të lidhen me njëri-tjetrin sipas modeleve që kanë mësuar prej botës dhe që kanë trashëguar prej mëkatit fillestar; të tjerët në rrjet do të donin të lidheshin me njëri-tjetrin sipas modeleve të reja që kanë mësuar prej Krishtit përmes fjalës dhe sakramenteve. Kjo është arsyeja se pse Jezusi thotë:

Unë kam ardhur që ta kthej një burrë kundër të atit të tij, një bijë kundër së ëmës së saj, një nuse kundër vjehrrës së saj — armiqtë e dikujt do të jenë anëtarët e shtëpisë së vet.¹⁰⁹

Fjala “shtëpi” këtu është e rëndësishme. Në kohën e Jezusit, “shtëpia” i referohej jo vetëm familjes së drejtpërdrejtë, por të tërë grupit të njerëzve — familjes së zgjeruar, skllëvërve, shërbëtorëve, punëtorëve — që vareshin nga njëri-tjetri për çdo ditë për mbijetesën e tyre.¹¹⁰ Atë që ne e kemi quajtur “rrjet të marrëdhënieve ekzistuese” Bibla e quan “shtëpi.” Pra, një kishë është një shtëpi ekzistuese që ka qenë transformuar përmes fjalës dhe sakramenteve që u mbollën brenda saj.

¹⁰⁹ Mateu 10:35-36.

¹¹⁰ Ben Uidherington. (Ben Witherington) *Veprat e Apostujve: Një komentari socio-retorik*. [The Acts of the Apostles : A socio-rhetorical commentary] Grand Rapids, MI: Wm. B. Eerdmans Publishing Company, 1997, fq. 338.

Në kohën e Jezusit, secila shtëpi drejtohej në mënyrë tipike prej vetëm një burri. Në latinisht, ky burrë quhej *paterfamilias*. *Paterfamilias* kishte autoritetin mbi jetën dhe vdekjen për anëtarët e shtëpisë së tij. Ai e drejtonte shtëpinë sipas modeleve të marrëdhënieve që mësoi prej botës dhe prej mëkatit fillestar. Për shembull, kur lindte një bebe në atë shtëpi, ajo lihej përdhe. Vetëm nëse *paterfamilias* e merrte dhe e ngrinte lart, bebja do të bëhej pjesë e familjes. Përndryshe do të lihej të vdiste, ose do të merrej nga dikush tjetër dhe do të rritej si skllav.¹¹¹

Qëllimi i të krishterëve të hershëm nuk ishte ta bindnin *paterfamilias* që të niste të vinte në kishë tek një ndërtesë aty pranë, as nuk ishte qëllimi ta bindnin *paterfamilias* që ta hapte shtëpinë e tij, që atje të takohej një kishë. Qëllimi i të krishterëve të hershëm ishte ta mbillnin fjalën dhe sakramentet brenda shtëpive që drejtoheshin nga *paterfamilias*, në mënyrë që marrëdhëniet e gjithkujt në atë shtëpi të mund të transformoheshin. Një shtëpi e transformuar është një njësi bazë e kishës.

Kur Jezusi i dërgon dishepujt e tij për ta mbjellë një kishë, strategjia e tij është të gjejnë një shtëpi me *paterfamilias*¹¹² të paqtë. Kur Pali cakton drejtuesit e krishterë në një qytet, ai zgjedh ata *paterfamilias* që e kanë drejtuar mirë shtëpinë e tyre, sipas mënyrës së Krishtit. Ai pyet: “Nëse dikush nuk e di si ta menaxhojë familjen e vet, si mundet vallë të kujdeset ai për kishën e Perëndisë?”¹¹³ Kjo ndodh ngaqë kisha e Perëndisë përshkruhet më së miri si *një shtëpi e shtëpive*.

Kishat publike ndërtohen duke “zbritur që nga foltorja”. Njerëzit vijnë tek një ndërtesë e veçantë që është e ngritur përreth një foltoreje. Pastori kryesor e drejton kishën prej

¹¹¹ PBS. “Jeta familjare” *Perandoria Romake në Shekullin e Parë*.<http://www.pbs.org/empires/romans/empire/family.html>.

¹¹² Shih Luka 10:6.

¹¹³ 1 Timoteut 3:1-5, NIV.

Kisha e fshehtë

asaj foltoreje. Foltorja është qendra e jetës së kishës. Është vendi ku predikohet pastër ungjilli dhe ku administrohen pastër sakramentet.

Kurse kisha e fshehtë ndërtohet “duke u ngjitur lart prej shtëpive”: Secila shtëpi është qendra e jetës së kishës, ku ungjilli predikohet pastër dhe ku administrohen pastër sakramentet. Puna e pastorit kryesor dhe e pleqve është që të sigurohet kjo.

Kisha publike mund të mbyllet lehtësisht: Pastori mund të burgoset, ose foltoret mund të mbyllen. Kurse kisha e fshehtë është shumë më e vështirë të ndalojë: Edhe kur pastori është në burg, secila shtëpi vazhdon të veprojë. Secili *paterfamilias* sigurohet që në shtëpinë e tij ungjilli predikohet pastër, sakramentet administrohen pastër dhe marrëdhëniet reflektojnë udhën e Krishtit.

Hapa meprimi për mbjellësit e kishave:

- A e keni drejtuar mirë shtëpinë tuaj? A predikohet pastër fjala atje? A administrohen pastër sakramentet atje? A reflektojnë marrëdhëniet tuaja udhën e Krishtit? Ky është gjithmonë vendi i duhur për të nisur mbjellja e kishës së fshehtë.
- Mos e përqendroni strategjinë tuaj tek ungjillëzimi i individëve, por në vend të kësaj, tek ungjillëzimi i shtëpive. Kujtoni se “gjëja kryesore” e kishës është që ungjilli të predikohet pastër dhe sakramentet të administrohen pastër përbrenda secilës shtëpi, ku është i pranishëm një njeri i paqes. Qëllimi nuk është që të largohet ai njeri i paqes prej shtëpisë së tij dhe të transplantohet tek shtëpia juaj. Studioni Luka 10 si një udhëzues praktik, hap pas hapi.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Sigurohuni që kisha juaj nuk e ka qendrën tek foltorja e pastorit kryesor, por përkundrazi është përqendruar tek secila shtëpi në bashkësinë tuaj. Shpjegojini bashkësisë suaj se funksioni kryesor i pastorit drejtues është ta pajisë secilin drejtues shtëpie (pavarësisht nëse drejtuesi i asaj shtëpie është një *paterfamilias*, ose një *materfamilias*, ose madje edhe një beqar) që ungjilli të predikohet pastër dhe të dëgjohet, dhe që sakramentet të administrohen pastër *në shtëpinë e tyre*. Sigurohuni që të gjitha planet e kishës të jenë të drejtuar kah përmbushjes së këtij qëllimi. Është “gjëja kryesore” e kishës.
- Pastorët duhet t’i bëjnë vetes të njëjtat pyetje që i bëhen mbjellësit të kishës në hapin e veprimit të mësipërm: A e keni drejtuar mirë shtëpinë tuaj? A predikohet pastër fjala atje? A administrohen pastër sakramentet atje? A reflektojnë marrëdhëniet tuaja udhën e Krishtit? Nëse shtëpia e pastorit nuk drejtohet mirë, nuk ka pothuajse asnjë shans që kisha do të drejtohet mirë.

Parimi VI.

Bëjeni jetën e përditshme të shtëpisë, jo adhurimin e së dielës, fokusin e kishës

Për të krishterët koreanë, pyetja: “A shkon në kishë?” do të thotë të njëjtën gjë si: “A je i krishterë?” Shkuarja në kishë nuk është e vetmja gjë që bëjnë të krishterët koreanë. Por përgjithësisht ajo konsiderohet si gjëja kryesore.

Në fakt, do të ishte e vështirë për të krishterët koreanë që ta perceptonin një mënyrë të të qenit i krishterë i fortë, pa u bazuar në mbledhjen së bashku për adhurimin e së dielës. Natyrisht, pak të krishterë koreanë do të thoshin se të shkuarit në kishë të dielën mjafton për ta bërë dikë një të krishterë të fortë. Por shumë të krishterë koreanë do të thoshin se, që të jesh një i krishterë i fortë, shkuarja në kishë të dielën është e domosdoshme.

Kurse kishat e fshehta përgjatë historisë nuk kanë qenë në gjendje ta jetojnë jetën e krishterë në këtë mënyrë. Në vende të tilla si Koreja e Veriut, Somalia ose Arabia Saudite, është thjesht e pamundur për njerëzit nga shtëpi të ndryshme të bashkohen çdo javë për të adhuruar së bashku. Prandaj, për të krishterët e fshehtë, jeta e krishterë nuk mund të përqendrohet tek mbledhja së bashku për adhurimin e së dielës. Ashtu siç e tregoi parimi i mëparshëm, kisha e fshehtë përqendrohet tek transformimi i secilës shtëpi duke e vendosur Krishtin në qendër të jetës së përditshme të familjes.

Por mungesa e të mbledhurit së bashku për adhurimin e së dielës nuk i bën të krishterët e fshehtë të dobët dhe të papërkushtuar.

Të krishterët e fshehtë nuk janë të krishterë të “Kanaanit”, që ndalojnë së shkuari në kishë, ngaqë ishin zhgënjyer me të ose ishin lënduar në kishë. Përkundrazi, ata në mënyrë tipike janë më të fortë së të krishterët në botën e lirë, ngaqë secila kishë e fshehtë që mbliidhet në shtëpi duhet të mësojë sesi të “jetë e tërë kisha” ndaj anëtarëve të saj. Secila shtëpi duhet të mësojë sesi ta predikojë pastër e ta dëgjojë fjalën dhe sesi t’i administrojë pastër sakramentet. Ata nuk munden dot që thjesht të shkojnë rregullisht në një ndërtesë kishë për t’u ushqyer prej pastorit. Atyre iu duhet të mësojnë të gatuajnë për vete.

Për kishën e fshehtë, fokusi i kishës — dhe i shërbesës kryesore të adhurimit — është adhurimi i përditshëm në shtëpi. Zakonisht është shumë i thjeshtë dhe joformal dhe mund të zgjasë nga 10 minuta deri në disa orë, varet nga rrethanat. Në mënyrë tipike, të vetmit njerëz që marrin pjesë janë anëtarët e shtëpisë, që janë gjithmonë bashkë përditë tashmë. Ja ku është një përmbledhje tipike e kohës së përditshme të adhurimit në shtëpi (shumë prej këtyre pikave do të diskutohen më hollësisht në parimet që vijojnë):

- Drejtuesi i shtëpisë mund ta drejtojë adhurimin çdo ditë (ose natë), ose drejtimi mund të kalojë nga njëri person tek tjetri (përfshirë fëmijët). Në këtë mënyrë, gjithsecili mëson ta drejtojë shtëpinë në adhurim.
- Shtëpia i këndon bashkë këngët që kanë mësuar përmendësh. Ajo praktikon këngë të reja që dëshiron gjithashtu t’i mësojë përmendësh. Shpesh janë vetëm zëra, pa instrumenta. Në këtë mënyrë, gjithsecili mëson të këndojë dhe të ndihet rehat, madje edhe për të kënduar vetëm fare.
- Drejtuesi i adhurimit ndan një pjesë nga Shkrimi i Shenjtë, që shpesh e ka mësuar përmendësh. Anëtarët e tjerë të shtëpisë pastaj udhëzohen që ta mbajnë mend përmendësh atë pjesë të Shkrimit. Ata mund

ta studiojnë të njëjtën pjesë nga Shkrimi i Shenjtë për shumë ditë, derisa e gjithë shtëpia ta këtë mësuar përmendësh.

- Drejtuesi i adhurimit ndan një pjesë mësimi ose këshillimi për Shkrimin e Shenjtë. Shtëpia diskuton sesi ta zbatojë atë pjesë të Shkrimit në jetën e tyre së bashku.
- Kredoja e Nikeas ose e Apostujve recitohet me zë të lartë së bashku, dhe mesazhi që është ndarë krahasohet me Kredon.
- Gjatë kohës së lutjes, shtëpia bën edhe lutje të mësuar përmendësh (si Lutja e Zotit, lutjet nga librat e lutjeve, dhe lutjet nga të krishterë të famshëm), edhe lutje personale individuale të improvizuara. Secili individ lutet. Në këtë mënyrë, gjithsecili mëson të lutet me zë të lartë.
- Çdo konflikt në shtëpi tregohet dhe zgjidhet sipas mënyrës së Krishtit.¹¹⁴ Pastaj ndahet paqja e Krishtit, përmes tokjes së duarve, puthjes ose përqafimit.
- Në varësi të prejardhjes denominacionale të kishës dhe të situatës aktuale, sakramentet mund të administrohen.

Përmes adhurimit të përditshëm në shtëpi, vjen shpëtimi tek ajo shtëpi¹¹⁵: udha e Krishtit i transformon përditë marrëdhëniet përbrenda shtëpisë, si dhe marrëdhënien mes shtëpisë dhe botës.

Në këtë mënyrë, kisha e fshehtë është më tepër si kisha e hershme. Publiku i gjerë nuk tha për kishën e hershme: “Shikoni sesa shpesh mbliidhen ata së bashku në ndërtesën e tyre për adhurim.” Në vend të kësaj, publiku i gjerë tha thjesht: “Shikoni sa shumë e duan ata njëri-tjetrin.”¹¹⁶

¹¹⁴ krahaso Mateu 18:15-35.

¹¹⁵ krahaso Luka 19:9.

¹¹⁶ Tertullian. “Citimet.” <http://www.tertullian.org/quotes.htm>.

Disa të krishterë mund ta lexojnë këtë parim dhe të protestojnë: “Po, por Hebrenjve 10:25 thotë: ‘Le të mos e lemë pas dore të mbledhurit së bashku.’” Hebrenjve 10:25 nuk duhet përdorur për të mbështetur vetëm mënyrën sesi mbledhet aktualisht kisha koreane. Hebrenjve 10:25 nuk thotë asnjë gjë për mbledhjen në ndërtesa të posaçme kishtare; ato nuk ekzistojnë në kohën kur u shkrua Hebrenjve 10:25. Dhe Hebrenjve 10:25 u shkrua kur kisha po përballej me përndjekje dhe në fakt po vepronte në fshehtësi. Të krishterët po e linin pas dore të mbledhurit së bashku prej frikës së kundërshtimit dhe të vuajtjes. Nuk ka asnjë dyshim se, në kohën kur u shkrua Hebrenjve 10:25 dhe pjesa tjetër e Dhiatës së Re, të krishterët mbledheshin nëpër kisha që bazoheshin nëpër shtëpi.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Përkushtohuni ndaj adhurimit të përditshëm në shtëpinë tuaj si përvoja kryesore e kishës. Kisha e fshehtë do të mbillet prej këtij procesi, teksa ju i pajisni shtëpitë e tjera për ta ndjekur si model përvojën tuaj.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Pastorët dhe drejtuesit e kishave gjithashtu duhet t'i përkushtohen adhurimit të përditshëm nëpër shtëpitë e tyre si përvoja kryesore e kishës. Pastaj koha e adhurimit të së dielës duhet përdorur kryesisht për t'i pajisur drejtuesit e shtëpive që ta dretojnë adhurimin e përditshëm nëpër shtëpitë e tyre, dhe për t'i mbajtur ata përgjegjës që të veprojnë kështu.

Kisha e fshehtë

- Kur pastorët dhe drejtuesit e kishës i vizitojnë shtëpitë e anëtarëve të kishës, ata duhet ta bëjnë qëllimin kryesor të vizitës së tyre pajisjen e secilës familje që të kryejë adhurimin në shtëpi. Libri i Donald Uitnit (Donald Whitney), *Adhurimi në familje*, është botuar në anglisht dhe koreanisht dhe mund të jetë i dobishëm në këtë aspekt. Sigurohuni që secila shtëpi ta ketë një kopje dhe planifikoni një studim me të gjithë kishën.

Parimi VII.

Në vend të drejtuesve profesionalë, përdorni amatorët

Për kishat publike, ka shumë përparësi të qenit sa më të mëdha, sa më të centralizuara, dhe sa më të profesionalizuara të jetë e mundur. Kishat më të mëdha mund të punësojnë predikuesit dhe drejtuesit e adhurimit më të talentuar. Ato mund të kenë libraritë, kafenetë dhe rrjetin e tyre të medias. Ato mund të rekrutojnë madje edhe më tepër anëtarë dhe të shtohen akoma më shumë në numër përmes reklamave, marketingut dhe përpjekjeve masive vullnetare. Ato mund t'u japin ndihmë kishave të vogla që vuajnë. Së fundmi, ato mund t'i ndikojnë politikatat dhe publikun e gjerë në interes të mesazhit të krishterë.

Ngaqë kisha publike është një korporatë, jeta e saj organizative është e lidhur me sistemet e botës, dhe struktura e saj e brendshme si dhe nevojat për burimet njerëzore janë komplekse. Si rezultat, kisha publike drejtohet më mirë prej një profesionisti.

Në kishën koreane, kur një anëtar kishe ndien thirrjen për t'u bërë më serioz për besimin e tij ose për të marrë më tepër përgjegjësi drejtuese në komunitetin e krishterë, ai shpesh inkurajohet për të shkuar në seminar. Atje ai trajnohet formalisht për shërbesën dhe i jepet mundësia për t'u kualifikuar zyrtarisht. Ky kualifikim hap perspektivën për punësim në kishën publike.

Kjo është strategjia që ka fuqizuar rritjen e kishës koreane përgjatë disa dekadave të fundit, dhe ajo sigurisht që ka dhënë sukses sipas shumë matjeve. Është një strategji që vepron mirë,

kur janë me bollëk paratë, njerëzit dhe interesi i publikut, dhe kur qeveria është përgjithësisht mbështetëse, ose të paktën asnjëse.

Por një strategji, e cila vepron mirë nën një grup kushtesh shoqërore, mund të mos veprojë po aq mirë nën një grup të ndryshëm kushtesh shoqërore. Dhe është e qartë se po agon koha për një grup të ri kushtesh shoqërore. Anëtarësia në kishë dhe pjesëmarrja janë në rënie të vazhdueshme, sidomos mes të rinjve.¹¹⁷ Kjo ngre pyetjen për financimin afatmesëm dhe afatgjatë, në mos edhe më shpejt se aq. Për më tepër, kultura koreane është në mes të një ndryshimi vendimtar kundër kishës.¹¹⁸ Në kontekstin e pakësimit të forcës dhe të rritjes së armiqësisë, si do të funksionojë strategjia e kishës koreane e ndërtuar mbi numrat, centralizimin dhe profesionalizmin?¹¹⁹

Trajnimi për ta drejtuar kishën si një korporatë publike, e madhe, e centralizuar, profesionale rrallë i sjell dobi kishës së

¹¹⁷ krahaso Bjung Jun Çang (Byung Joon Chung), “Një reflektim mbi rritjen dhe rënien e kishës protestante koreane,” (“A Reflection on the Growth and Decline of the Korean Protestant Church,”) *International Review of Mission*, 103:2, 2014, fq. 319–333; gjithashtu, Kuon Hijak-rul (Kwon Hyeok-ryul), “Pse po pakësohet numri i të krishterëve në Kore?” (“Why is the number of Christians decreasing in Korea?”) The Hankyoreh, http://english.hani.co.kr/arti/english_edition/e_opinion/148175.html.

¹¹⁸ Shih vëllimin 1 të këtyre serive: *Përgatitja për kishën e fshehtë* (Seul: Zëri i Martirëve, Kore 2017), sidomos Hyrjen time.

¹¹⁹ Historia paralajmëron se strukturat e kishave të mëdha, të centralizuara, profesionale mund të akomodojnë shpejt ndryshimin social dhe pastaj të përdoren nga qeveria për ta përparuar dhe mbështetur atë ndryshim social, madje edhe kur ai është haptas kundër asaj që ka mësuar gjithmonë kisha besnike. Krahaso Pjetër Kuzmic, “Teologjia pentakostale dhe Evropa komuniste,” tek W.K. Kay & A.E. Dyer, eds., *European Pentecostalism* (Global Pentecostal and Charismatic Studies). Leiden, Netherlands: Brill, 2011, . fq. 344; Robert P. Ericksen & Susannah Heschel (eds.), *Tradhtia: Kishat gjermane dhe Holokausti*, Minneapolis: Augsburg, 1999; gjithashtu Hyrjen time tek vëllimi i parë i këtyre serive, *Përgatitja për kishën e fshehtë*, Seul: Zëri i martirëve, Kore, 2017, fq. 68-73.

fshehtë. Nevojitet një lloj tjetër trajnimi, dhe ky lloj trajnimi i favorizon *amatorët*.

Sot, *amator* nuk është një fjalë e pëlqyer. Nuk përdoret kurrë si kompliment. Ajo përshkruan dikë që nuk është profesionist, ose ngaqë nuk është mjaftueshëm i aftë, nuk ka përvojën e mjaftueshme, nuk është mjaftueshëm serioz, ose nuk është i përshtatshëm për t'u paguar për punë në fushën e tij të specializimit. Por ky është një përkufizim i padrejtë. *Amator* vjen nga fjala latine *amare*, që do të thotë “të duash”.¹²⁰ Një *amator* është dikush që bën diçka thjesht ngaqë e ka me qejf, pa ndonjë mendim për përfitim personal. Kjo është e admirueshme, dhe—siç rezulton—e domosdoshme dhe efektive kur vjen puna për drejtimin e kishës së fshehtë. Në fakt, është biblike.

- Vetë Jezusi ishte një amator—nuk ishte as një rabi i trajnuar. Dhe ky fakt i bëri të çmenden drejtuesit profesionistë të kohës së tij.
- Gjoni? Amator.
- Pjetri? Amator.

Në fakt, shumica e figurave në historinë e kishës për disa nga shekujt e parë të ekzistencës së saj (përfshirë autorët e Dhiatës së Re, për shembull) ishin amatorë që drejtonin kisha shumë të vogla të fshehta, jo profesionistë të paguar, që drejtonin bashkësi të mëdha, të centralizuara dhe të regjistruara si korporata. Dhe ata nuk mundet të përshkruhen dot si joseriozë ose që ishin të patrajnuar mirë: ata ia dolën mbanë ta kthenin përmbys botën.¹²¹

Kisha e drejtuar prej amatorëve vështirë të jetë një relike e Dhiatës së Re. Është modeli që e futi në shërbim Xhon Uesli, së pari në Angli dhe më pas në Amerikën e Veriut, kur Rizgjimi

¹²⁰ Online Etymological Dictionary, <http://www.etymonline.com/index.php?term=amateur>.

¹²¹ krahaso Veprat e Apostujve 17:6.

Ueslian prodhoi atë lloj të konvertuarish në ato lloj vendesh që nuk e gjenin veten të përshtateshin në kishën publike. Uesli caktoi amatorët të jenë drejtues të bandës, pastorë vendorë, dhe predikues mbi kuaj për t'i bërë të gjitha ato lloje gjërash, që sot janë përqendruar në një figurë: pastori.

Pastorët amatorë dhe drejtuesit e kishës vazhdojnë ta kthejnë përmbys botën edhe sot. Thjesht shikoni një hartë ku po rritet kisha dhe pyeteni veten: Kush po drejton atje—amatorët apo profesionistët? Shihni ku po zvogëlohet kisha dhe bëjini vetes të njëjtën pyetje. Nuk është se kisha ngecet në pozicion asnjans, deri sa të paraqiten profesionistët e paguar dhe ndërtesat. Në fakt, është pak më tepër e kundërta e kësaj.

Ajo që profesionalizmi fiton në efikasitet, ai e humbet—në mënyrë dramatike—në nxitjen e pjekurisë së krishterë. Kjo do të thotë se, nëse pastori predikon në kishën tuaj të madhe, të centralizuar, profesioniste çdo të diel, ka pak të ngjarë që anëtari mesatar i kishës do të mësojë të predikojë, pavarësisht sesa shumë shërbesa ka dëgjuar ai anëtar kishe. Por, nëse pastori ndalet pranë një shtëpie njëherë në gjashtë javë ose gjashtë muaj (siç është rasti i predikuesve mbi kuaj të denominacionit Metodist), ose asnjëherë (si në Korenë e Veriut), dhe pjesën tjetër të kohës shtëpia nevojitet që të funksionojë vetë si e gjithë kisha, atëherë është e mrekullueshme sesa mirë mësojnë të predikojnë drejtuesit e shtëpive, të administrojnë sakramentet, të studiojnë teologjinë, të këshillojnë dhe dishepulllojnë të krishterët e zakonshëm për t'u rritur drejt plotësisë në Krishtin, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, pavarësisht nëse janë të trajnuar formalisht apo jo.

Kisha e fshehtë ka qenë e detyruar të mësojë mënyra adhurimi që nuk varen nga pastorët profesionistë. Baballarët, nënat dhe drejtuesit e shtëpive bëhen mbikëqyrësit e natyrshëm të kishave që takohen në shtëpitë e tyre. Nëse pastorët bëjnë një vizitë, ata e shtojnë—nuk e zëvendësojnë—mbikëqyrjen pastrorale të *paterfamilias* ose të drejtuesit të shtëpisë.

Dhe prej nga dalin drejtuesit e kishës së fshehtë, nëse nuk vijnë nga seminari? Në kishën e hershme, drejtimi nuk ishte diçka të cilën ti e zgjidhje për *t'u futur*, si një profesion. Ishte diçka tek e cila ti *rritesh*, ashtu siç rritesh në plotësinë e Krishtit dhe njerëzit e dallojnë këtë tek ti—se ti do t'i ndihmosh ata të rriten në të njëjtën mënyrë. Është ajo gjë që e bëri Palin të thotë tek 1 Korintasve 11:1: “Jini imituesit e mi, ashtu siç unë jam imitues i Krishtit.”

Përdorimi i drejtuesve amatorë është më shumë se një model taktik me përfitime strategjike, si mbajtja e kostove të ulëta ose mbijetesa ndaj armiqësisë publike. Përdorimi i drejtuesve amatorë siguron që *kisha e fshehtë ta vendosë prioritetin më të lartë tek secili anëtar për t'u rritur drejt plotësisë në Krishtin në kontekstin e jetës së tyre të zakonshme të përditshme*. Duke u siguruar që të gjithë drejtuesit e shtëpisë të jenë amatorë, drejtuesi i shtëpisë shërben si shembull për secilin anëtar të bashkësisë që ta imitojnë—tekta ai imiton Krishtin rreth tyre përditë, gjatë jetës së përditshme. Pali nuk ishte një bërës tendash, ngaqë kishat e tij ishin tepër të vogla për ta mbështetur me kohë të plotë. Ai zgjodhi që të ishte bërës tendash, ngaqë e konsideronte jetike të kishte një marrëdhënie *amatore*, e jo një marrëdhënie profesionale, si me ungjillin, ashtu dhe me ata që iu shërbeu.¹²²

A mos do të thotë kjo se shkollat Biblike, seminarët dhe kualifikimet janë të vjetëruara? Në asnjë mënyrë. Ato kanë kuptim të përsosur për drejtuesit që po kalojnë përtej mbikëqyrjes së shtëpisë së tyre dhe të disa shtëpive të drejtuesve të tjerë, tek mbikëqyrja e kishës rajonale, ku ata do të mbikëqyrin shumë shtëpi dhe drejtues. Vetëm në nivelin e drejtimit rajonal duhet të parashikohet ndonjë trajnim seminarik, kualifikim ose pagesë. Dhe kjo pagesë duhet të jetë diçka si bursë—të mjaftojë për të përballuar kostot, por të mos jetë aq e madhe,

¹²² krahaso 1 Korintasve 9:1-23.

sa ta bëjë dikë të aspirojë për atë pozicion si një mjet për të përballuar jetesën.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- A ndieni një thirrje për shërbesë? Në vend që të regjistrohemi në një seminar, trajnohuni si një drejtues shtëpie amator dhe pastaj si një mbikëqyrës i drejtuesve të disa shtëpive. Vetëm pasi të jeni njohur si një drejtues amator, i pjekur dhe ndihmues, prej disa shtëpive nën kujdesin tuaj, duhet ta konsideroni shkuarjen në seminar dhe kualifikimin.
- Ashtu si Apostulli Pal, vendosuni në mënyrë të përhershme si një drejtues amator dhe si një bërës tendash, jo vetëm përkohësisht, deri sa ata që janë nën kujdesin tuaj të jenë në gjendje t'ju mbështesin plotësisht.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Lëreni mënjane qëllimin e krijimit të një kisha të madhe publike. Nuk ka nevojë që në një botë armiqësore të krijohet një kishë më e madhe nga ato që përmenden në Bibël. Madje edhe letra drejtuar Romakëve iu shkrua një grupi prej disa shtëpish të vogla. Mbajeni numrin e shtëpive që mbikëqyrni mjaftueshëm të vogël, që të jetë një qëllim i arsyeshëm për ta vizituar secilin rregullisht dhe për ta ndjekur progresin e secilit anëtar të shtëpisë në rritjen drejt plotësisë në Krishtin.
- Si pastor, pyeteni veten: A më ka përgatitur mua trajnimi që të drejtoj një kishë të fshehtë të përbërë

nga shtëpitë, ku puna ime kryesore janë vizitat e rregullta në secilën prej shtëpive, për t'u siguruar që secili drejtues shtëpie është i aftë ta predikojë pastër Fjalën e Perëndisë dhe t'i administrojë sakramentet ndaj atyre që ka nën kujdesin e tij ose të saj? Lexoni libra të tillë si ai i Riçard Baksterit (Richard Baxter) *Shtëpia e perëndishme* dhe shkrimet e Xhon Ueslit, për të parë sesi pastorët e tjerë të trajnuar tradicionalisht mësuan ta theksonin dhe ta pajisnin drejtimin amator të shtëpive.

Parimi VIII.

Mos rekrutoni; në vend të kësaj porositini shtëpitë për ta ndjekur Krishtin

Mos vendosni parakushte dhe pengesa të kota njerëzore për të ndjekur Krishtin. Por as mos u përpiqni të rekrutoni ose t'i bindni njerëzit ta ndjekin Krishtin. Dhe mos premtoni bekime. Premtoni vetëm të vërtetën që çliron,¹²³ një kryq që do t'ju kushtojë gjithçka,¹²⁴ dhe praninë e përhershme të Krishtit gjatë atij udhëtimi,¹²⁵ ashtu siç bëri vetë Jezusi.

Jezusi i nxiti ata që dëshironin të bëheshin dishepujt e tij të llogaritnin kostot – ndaj familjes, pasurisë dhe ndaj sigurisë personale, përpara sesa të përkushtoheshin vetë, bashkë me shtëpitë e tyre për ta ndjekur atë.¹²⁶ Ai u shpjegoi qartë se ndjekja e tij nuk ishte vetëm një përgjegjësi më tepër, e cila thjesht mund t'i shtohet përgjegjësi të tjera, madje edhe atyre që dukeshin si të arsyeshme.¹²⁷ Dhe sa herë që përmendi përfitime të mundshme nga ndjekja e tij, ai gjithmonë përmendi kostot e larta në të njëjtën fjali.¹²⁸ Ai foli me

¹²³ krahaso Gjoni 8:32.

¹²⁴ krahaso Mateu 16:24.

¹²⁵ krahaso Gjoni 17:3 mbi jetën e përhershme si prania e përhershme e Krishtit; krahaso gjithashtu Mateu 28:16-20 si premtimi i Krishtit për t'i shoqëruar ata që janë duke shkuar, pagëzuar dhe mësuar.

¹²⁶ krahaso Luka 14:25-33.

¹²⁷ krahaso Mateu 8:18-22.

¹²⁸ krahaso Marku 10:28-30.

gjithsecilin që ishte i interesuar për ta ndjekur atë, por nuk kërkoi ta bindte askënd që ngurronte, dhe shumë prej tyre i la që të iknin.¹²⁹

Disa vjet më parë, një usta na erdhi për vizitë që të na jepte një çmim për disa riparime në shtëpi. Kur zbuloi se cilët ishim, ai na tregoi se ishte një i krishterë, por që nuk kishte qenë në kishë për një kohë të gjatë. Ai tha se po shpresonte të gjente një kishë me përjetim më të thellë nga ato që kishte gjetur deri tani. Kalova më tepër se dy orë duke biseduar me ustain për adhurimin në shtëpinë tonë, dhe e nxita që të vinte të ulej me ne. Dukej qartë që ai ishte magjepsur, dhe e përfundua bisedën me premtimin e tij se do të vinte të dielën.

Ai nuk erdhi asnjëherë.

Por ajo gjë që u shfaq atë të diel, gjithsesi, ishte një fragment magjepsës në një libër që po lexoja, një dokument i shekullit të tretë i titulluar *Tradita apostolike* nga Hipoliti (Hippolytus). Ai hedh dritë mbi mënyrën sesi kisha e re, e fshehtë dhe e përndjekur u soll me miqtë në brezat shumë shpejt pas apostujve. Kjo është ajo që shkroi Hipoliti:

Lejojini ata persona që do të sillen për herë të parë në besim ta dëgjojnë Fjalën e të sillen së pari tek mësuesit, përpara se të mbërrijnë njerëzit. Dhe le të pyeten për arsyen se përse ia kanë dhënë pëlqimin besimit. Dhe lejojini ata njerëz që i sollën këta persona të japin dëshmi, nëse ata janë në gjendje ta dëgjojnë Fjalën. Dhe le të pyeten për jetën e tyre: Çfarë lloj jete bëjnë?¹³⁰

¹²⁹ krahaso Marku 10:17-27.

¹³⁰ Pol F. Bradshou (Paul F. Bradshaw), Maksuell E. Xhonson (Maxwell E. Johnson), dhe L. Eduard Filips (L. Edward Phillips), *Tradita apostolike: Komentar (The Apostolic Tradition: A Commentary)*, Minneapolis: Augsburg Fortress Publishers, 2002, fq. 82.

Kjo më kujtoi mënyrën sesi të krishterët e fshehtë në Korenë e Veriut reagojnë edhe ndaj anëtarëve të familjes që shprehin interes për të mësuar më tepër për Krishtin.¹³¹ Në Korenë e Veriut, siç vëren Markus Noland (Marcus Noland): “Të sapomartuarit nuk njoftohen për praktikat fetare të familjes së bashkëshortit të tyre për ca kohë, deri sa të zhvillohet besimi i mjaftueshëm.”¹³² Ata madje do të flenë bashkë, përpara se ta bëjnë publik përkushtimin e tyre ndaj Krishtit!

Sa mënyrë e ndryshme nga ajo me të cilën iu afrova unë ustait! Përfytyroni se sa i ndryshëm do të kishte qenë bashkëbisedimi ynë, po të kisha thënë: “Vëlla, në kishën e hershme, përpara se të ftoheshin individët për të adhuruar me një bashkësi të caktuar, drejtuesit e bashkësisë do t’u shkonin për vizitë dhe do të bisedonin për jetën e tyre dhe për arsyen se pse donin ta ndiqnin Jezusin. Qëllimi ishte të siguroheshin se kisha përbëhej vetëm prej njerëzve që ishin atje për t’u rritur, ngaqë ata donin të rriteshin në plotësinë e Krishtit. Kjo gjithashtu është mënyra e kishës së fshehtë. Prandaj, nëse do të ishit i/e interesuar për të na ardhur për vizitë në shtëpinë tonë për adhurim, hapi i parë do të ishte që unë të vija për vizitë në fillim në shtëpinë tuaj për t’ju takuar ju dhe familjen tuaj dhe për të mësuar për jetën tuaj dhe për interesin që keni për Krishtin.”

Në një kishë të fshehtë, nuk ka nevojë të rritesh shumë në numër për të mbuluar rrogën e pastorit ose për të paguar për një ndërtesë. Prandaj, në vend që t’u lutemi njerëzve për të ardhur, mund ta trajtojmë pjesëmarrjen si një privilegj të çmuar. Ne

¹³¹ Kjo është një temë që shfaqet shpesh tek libri *Këta janë brezat (These are the Generations)* (Colorado Springs: W Publishing, 2012), librin që e shkrova bashkë me Z. dhe Zj Bae, të krishterë të fshehtë nga Koreja e Veriut.

¹³² Markus Noland (Marcus Noland), “Koreja e Veriut: Dëshmi për transformimin,” (“North Korea: Witness to Transformation,”) *Instituti Peterson për Ekonomi Ndërkombëtare (Peterson Institute for International Economics)*, 24 Prill 2011, <http://bit.ly/pxuq9r>.

mundemi që t'ju bëjmë vizita personalisht atyre që duan ta ndjekin Krishtin — përpara se ata të vijnë në kishë.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Pyeteni veten: A jeni të gatshëm të mbillni një kishë të fshehtë, nëse gjithçka që do të merrni është e vërteta, një kryq dhe prania e Krishtit?
- Përdorini pyetjet te pasazhi i Hipolitit për ta intervistuar këdo që është i interesuar të mbjellë një kishë të fshehtë.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Shqyrtojini materialet dhe proceset tuaja të rekrutimit dhe pyeteni veten: Çfarë zbulojnë këto lidhur me mënyrën sesi i ftojmë ne njerëzit për të marrë pjesë në kishën tonë? A premtojnë materialet vetëm të vërtetën, një kryq dhe shoqërinë e përzetshme të Krishtit gjatë atij udhëtimi? Apo ato reklamojnë përfitime dhe bekime? Rishikojini materialet për të reflektuar qortimet e Jezusit tek Luka 14:25-33. Bëjeni të dukshme këtë pjesë nga Shkrimi i Shenjtë në materialet dhe proceset tuaja të rekrutimit.
- Pyeteni secilin prej anëtarëve ekzistues të kishës suaj për arsyen se pse janë duke e ndjekur Krishtin. Atje ku ata po kërkojnë më tepër sesa të vërtetën dhe një kryq, paralajmërojeni që ta llogarisin koston, përpara se ta ndjekin Krishtin më tutje.

Parimi IX.

Trajnojin anëtarët për të pasur njohuri të përgjithshme, jo për të qenë specialistë

Ndarja e punës është një realitet i zakonshëm në kishat sot, saqë e kemi të vështirë ta përfytyrojmë se si do të dukej një kishë ku *secili* anëtar është trajnuar qëllimisht për të kryer *secilën* detyrë të shërbesës. Por ai është vizioni i Dhiatës së Re, dhe gjithashtu është një kërkesë për jetën në kishën e fshehtë.

Është gjithashtu thelbi i Urdhërimit të Madh: Jezusi nuk na urdhëron t'i ndihmojmë njerëzit të gjejnë e të përmbushin thirrjen e tyre personale në jetë. Në vend të kësaj, ai na urdhëron t'u mësojmë dishepujve që t'i binden gjithçkaje që ai ka urdhëruar.

Ndryshe nga shumë kisha, ungjijtë nuk e portretizojnë Jezusin duke administruar teste të dhuntive frymërore me dishepujt e tij dhe duke e ndarë punën sipas dhuntive dhe interesave të tyre. Në vend të kësaj, Jezusi i trajnon dishepujt e tij duke jetuar me ta dhe duke i përfshirë *secilin* prej tyre që të bëjë *secilën* nga gjërat që bën edhe ai — shërime, shpalljen e ungjillit, ndarjen e bukës, hapjen e shtëpive të tyre dhe madje edhe mbartjen e kryqeve të tyre. Ai e përfshin çdo dishepull të kryejë çdo detyrë të shërbesës, ngaqë çdo detyrë — sidomos ato që nuk i bëjmë mirë dhe ato që nuk na pëlqejnë — na mëson të mbështetemi plotësisht në forcën e Perëndisë, jo në aftësitë tona. Ne gjithashtu mësojmë se mund ta kryejmë çdo detyrë të shërbesës ndaj të tjerëve vetëm *pasi* së pari ta kemi lejuar Perëndinë ta kryejë atë detyrë shërbese ndaj

nesh.¹³³ Ashtu siç na mëson Apostulli Pal, ne mund të kryejmë shërbesë vetëm si “imitues të Perëndisë”¹³⁴; prandaj, duke kryer shërbesë ndaj të tjerëve ne mësojmë të bëhemi plotësisht të vetëdijshëm për shërbesën e mëparshme dhe të vazhdueshme të Perëndisë ndaj nesh.

Sot të krishterët ndonjëherë citojnë analogjinë që bën Pali me trupin (tek 1 Korintasve 12) si një shfaqësim për ta përqendruar shërbimin e tyre në një ose dy fusha të dhuntive frymërore, duke i lënë ndërkohë detyrat e tjera të shërbesës për të tjerët, që kanë “më tepër dhunti” në ato fusha. Ata e shohin veten si një sy e jo një këmbë—një drejtues adhurimi, por jo një shpallës i ungjillit, për shembull—dhe ata supozojnë se po të “fokusoheshin tek thirrja e tyre,” Krishti në ndonjë mënyrë mistike do t’i bashkojë të gjitha pjesët e veçuara të trupit që të jenë një trup që funksionon.

Por biologjia bashkëkohore tregon se edhe një qelizë e vetme e syrit përmban ADN që është në gjendje të riprodhojë jo vetëm syrin, por edhe këmbën, madje edhe të gjithë trupin. Kjo do të thotë se megjithëse mund të kemi një specializim të caktuar në shërbesën që po kryejmë në një moment të caktuar, ne prapëseprapë jemi thirrur që të jemi “të përgjithshëm” në shërbesë, njerëz që mund të kryejnë secilën nga detyrat e kërkuara që kisha të funksionojë. Ne mund të jemi një sy, por Krishti pret nga ne që të jemi një këmbë, kurdoherë që kërkohet një e tillë. “Specialistët” e shërbesës, që këmbëngulin se mund të kryejnë vetëm një lloj shërbese janë si qelizat e kancerit: ata nuk përfaqësojnë një rritje të shëndetshme, ngaqë ata vetëm mund të riprodhojnë vetveten, jo të gjithë trupin. Kishat e mbushura me specialistë përfundojnë duke përjetuar saktësisht atë gjë për të cilën paralajmëron Pali tek 1 Korintasve 12: mungesën e shëndetit të përgjithshëm të trupit dhe të koordinimit, ngaqë

¹³³ krahaso Gjoni 13:1-13; 1 Gjonit 4:19.

¹³⁴ krahaso Efesianëve 5:1, NIV.

secila pjesë e trupit fokusohet vetëm në ato gjëra për të cilat ajo vetë ka nevojë që të funksionojë.

Pastorët janë përgjegjës që t'i pajisin të gjithë anëtarët e kishës për të pasur njohuri të përgjithshme, jo për të qenë specialistë. Për fat të keq, pastorët përfundojnë duke u bërë specialistë për vete, duke u përqendruar në kryerjen e detyrave më të rëndësishme e më të vështira të kishës. Ndërtesat e kishave bëhen vendi i tyre kryesor i shërbesës, ku kryhen këto detyra të rëndësishme të specializuara.

Ashtu siç është vërejtur në një parim më të hershëm, Xhon Kalvini identifikon dy shenja të një kishe autentike: predikimi i pastër dhe dëgjimi i Fjalës së Perëndisë, dhe administrimi i pastër i sakramenteve. Disa tradita kishtarë i kufizojnë këto detyra vetëm për pastorët dhe kryerjen e tyre vetëm në ndërtesat e kishave, por nga ana biblike nuk jepen kufizime të tilla. Duke institucionalizuar Darkën e Zotit, Jezusi nuk thotë: “Bëjeni këtë aq shpesh sa është i pranishëm pastori,” por përkundrazi, “Aq shpesh sa ta bëni këtë, bëjeni për të më kujtuar mua.”¹³⁵ Kur eunuku etiopas i thotë Filipit në rrugën për në Gaza: “Shiko, ja ku është uji! Ç’më pengon të pagëzohem?”, Filipi nuk i përgjigjet: “Ajo që na pengon është se unë jam thjesht një dhjak; ne duhet të presim derisa të shkojmë në ndërtesën e kishës dhe ti mund të pagëzohesh prej dikujt që është i shuguruar plotësisht.”¹³⁶

Në Shkrimin e Shenjtë jepen shumë këshilla lidhur me predikimin, Darkën e Zotit dhe pagëzimin. Kufizimi i këtyre detyrave më të rëndësishme për t'u kryer nga pastorët dhe brenda ndërtesave të kishave është një përpjekje në disa denominacione të caktuara kishash për t'u siguruar se ato janë kryer mirë dhe ashtu siç duhet. Kurse për kishën e fshehtë, kufizime të tilla do të kishin efektin e privimit të anëtarëve të saj krejtësisht nga të pasurit e shenjave të vërteta të kishës, ngaqë shumë në

¹³⁵ krahaso 1 Korintasve 11:23-26.

¹³⁶ krahaso Veprat e Apostujve 8:26-40.

kishën e fshehtë duhet të veprojnë për periudha të gjata kohore — madje ndoshta edhe për të gjithë jetën e tyre — pa pastorë dhe pa ndërtesa kishash.

Madje edhe për të krishterët që kanë mundësi të takohen rregullisht me pastorët e të shkojnë në ndërtesën e kishës, nuk jemi mbi një themel të fortë biblik, kur i kufizojmë ata nga të mësuarit sesi t'i binden gjithçkaje që urdhëroi Krishti. Kjo përfshin mësimin sesi të predikosh dhe t'i administrosh sakramentet ndaj atyre që Zoti i ka vënë nën kujdesin tuaj; që do të thotë, personat në shtëpinë tuaj. Është plotësisht e drejtë dhe gjë e urtë që një kishë të thotë: “Askush nuk duhet të predikojë ose t'i administrojë sakramentet me përjashtim të atyre që janë trajnuar për ta bërë këtë gjë.” Dhe është plotësisht e drejtë dhe gjë e urtë të kufizohen të krishterët nga predikimi ose administrimi i sakramenteve tek njerëzit që nuk janë të shtëpisë së tyre, kur ata nuk kanë mësuar së pari t'i bëjnë këto gjëra mes anëtarëve të shtëpisë së tyre.¹³⁷ Por nuk është as e drejtë, as gjë e urtë të mos trajnohen të krishterët sesi t'i kryejnë këto detyra të rëndësishme në shtëpitë e tyre, sepse këtë gjë na e urdhëron Zoti.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave dhe kishat ekzistuese:

- Urdhërimi i Madh (Mateu 28:16-20) na urdhëron që t'i mësojmë dishepujt për t'iu bindur gjithçkaje që ka urdhëruar Krishti. Ajo gjë nuk ndodh automatikisht kur një person i bashkohet një kishë. Kisha duhet të ketë një plan. Ekzistojnë shumë plane të tilla, përfshirë atë që është përvijuar tek libri im *Oferta për të gjithë jetën* (Colorado Springs: W Publishing,

¹³⁷ krahaso 1 Timoteut 3:1-5.

2011). Vëllimi i tretë në këtë seri, *Të Jetuarit në kishën e fshehtë* (botuar në 2017) do të prezantojë një plan tjetër, të ndryshëm. Nëse ju përdorni secilin prej këtyre burimeve ose njërën prej shumë të tjerëve që janë në dispozicion, sigurohuni ta keni një plan për dishepullimin tërësor të gjithkujt që jua beson Zoti. Për këtë, ju do t'i jepni llogari atij.¹³⁸

- Nëse jeni një pastor ose drejtues kishë, shfityrëzoheni çdo mundësi për të trajnuar drejtuesit e shtëpive që janë nën kujdesin tuaj lidhur me mënyrën se si mund t'i sjellin në shtëpitë e tyre dy shenjat e kishës autentike: predikimin e pastër dhe dëgjimin e fjalës, dhe administrimin e pastër të sakramenteve. Pothuajse secili denominacion protestant ka disa përgatitje për të predikuar, për Darkën e Zotit dhe pagëzimin që të kryhen prej besimtarëve në shtëpitë e tyre. Sigurohuni që metodat tuaja të predikimit dhe administrimit të sakramenteve të mund të imitohen prej drejtuesve të shtëpive.
- Mos i lejonit anëtarët e kishës që të shërbejnë vetëm në ato fusha të shërbesës që përputhen me dhuntitë e tyre frymërore, me aftësitë dhe interesat e tyre. Ndihejini ata ta kuptojnë se veprat e mëshirës (p.sh. ndarja e bukës, hapja e shtëpisë, vizitat tek të sëmurët dhe ata që janë në burg) janë mjete të hirit me anë të të cilave ne arrijmë ta përjetojmë plotësisht sesi Perëndia na deshi neve së pari, kur ne jemi duke ua bërë këto vepra të tjerëve. Për më tepër informacion mbi veprat e mëshirës si mjete të hirit, konsultoni librin tim *Oferta për të gjithë jetën*.

¹³⁸ krahaso Jakobi 3:1.

Parimi X.

Kujtoni kush jeni

Për shkak të punës sonë me kishën e fshehtë në Korenë e Veriut, njerëzit shpesh më pyesin lidhur me jetën e krishterë në fshehtësi në Korenë e Veriut. Një nga pyetjet më të zakonshme që marr është: “Si adhurojnë të krishterët e fshehtë në Korenë e Veriut?” Kur u përgjigjem se adhurimi i të krishterëve të fshehtë në Korenë e Veriut është i përqendruar mbi Dhjetë Urdhërimet, Kredon e Apostujve dhe Lutjen e Zotit,¹³⁹ njerëzit pështjellohen. Ata i kishin përfytyruar besimtarët e fshehtë në Korenë e Veriut në një pyll duke kënduar himne me zëra të heshtur, por pasionantë; ose ndoshta të ngjeshur bashkë në ndonjë dhomë bodrumi për një maratonë mësimi gjatë gjithë natës, teksa nuk lëvizin nga vendi gjatë mësimit urgjent nga ana e pastorit për katërmëdhjetë orë rresht; ose ndoshta të mbledhur kruspull nën një batanije me një llambë dore duke lexuar një Bibël të vetme (të cilën njerëzit supozojnë se duhej t’u ishte dërguar prej të krishterëve në botën e lirë).

Gjëra si këto (ndonëse më pak dramatike!) me raste u ndodhin kishave të fshehta, por këto pamje janë më tepër produkt i imagjinatës sonë sesa i realitetit. Ngaqë shërbesat e adhurimit

¹³⁹ Dhe për Darkën e Zotit, ndonëse kjo është më pak e përhapur nga ato tre të tjerat, krahasoni me librin tim *Këta janë brezat* (Kolorado Springs: W, 2012) për më tepër detaje mbi adhurimin në kishën e fshehtë në Korenë e Veriut. Krahaso gjithashtu <http://dotheword.org/2013/08/26/how-to-sign-up-for-100-days-of-worship-in-the-common-places-with-the-north-korean-underground-church/>.

në botën e lirë ndërtohen bazuar mbi korin e adhurimit dhe predikimin e pastorit, të krishterët në botën e lirë supozojnë se adhurimi në kishën e fshehtë duhet të jetë i ngjashëm, por vetëm më i maskuar, më pak komod dhe shumë më i rrezikshëm. Të krishterët në botën e lirë janë të mirënjohur me Dhjetë Urdhërimet, kredot dhe Lutjen e Zotit; ata madje mund t'i recitojnë ato çdo javë si pjesë e një shërbese adhurimi; por jeta e tyre e adhurimit natyrisht që nuk është e përqendruar mbi këto gjëra.

Kurse për kishën e fshehtë, qoftë në Korenë e Veriut, ose së shpejti në Korenë e Jugut dhe në pjesën tjetër të botës së lirë, koha e adhurimit duhet të jetë më tepër sesa thjesht këngë e predikime. Koha e adhurimit është shpresa e vetme e kishës për t'u kujtuar se kush është ajo. Ajo bën kështu duke kujtuar saktësisht dhe specifikisht se kush është Perëndia i saj. Kjo është arsyeja përse në kishën e fshehtë, shkrimet e shenjta, kredot, dhe lutjet e kishës ashtu siç shprehen në Shkrimin e Shenjtë janë të pazëvendësueshme.

Krishterimi nuk ka të bëjë kurrë me të qenit krijues, por ka të bëjë gjithnjë me të qenit besnik. Ka të bëjë me pranimin, prej të krishterëve besnikë që erdhën përpara nesh, të plotësisë së asaj që kisha ka besuar gjithmonë, në çdo kohë e në çdo vend. Ka të bëjë me mishërimin dhe shpalljen e saj – të gjithës, krejt – pa ndryshime, pa përshtatje ose pa hequr gjë në kohën tonë. Dhe ka të bëjë me pasimin tek brezi tjetër i të krishterëve të çdo pjese të atij trupi të besimit, të paprekur dhe të pandryshuar.

Krishterimi është zbulesa e plotë e karakterit të Perëndisë. Karakteri përcillet vetëm pjesërisht dhe përafërsisht madje edhe në këngët më të mira të adhurimit. Ai shprehet në mënyrë jo të plotë, madje edhe në predikimet më kompetente. Kur Xhon Kalvini thotë se një nga dy shenjat e kishës autentike është predikimi i pastër dhe dëgjimi i fjalës, theksi është tek predikimi dhe dëgjimi *i fjalës*, jo tek predikimi në vetvete.

Po cila është rëndësia e Kredos?

Teologu i nderuar Tomas Oden (Thomas Oden) shpjegon:

Pika e parë e Kredos së Nikeas presupozon se ekziston një trup objektiv mësimesh, të cilin të krishterët pritet që ta rrëfejnë si besimin e tyre. Kjo ide duket normale dhe e natyrshme për ne, por ishte një gjë e re në botën e lashtë. As judaizmi, as ndonjë fe apo filozofi pagane nuk mund të pretendonte të kishte një grup të mirëpërcaktuar pikash besimi që gjithkush që i besonte ato pritej t'i shpallte publikisht dhe t'i mbronte ato prej të gjithëve që vijnë.¹⁴⁰

Për fat të keq, ideja e të pasurit të një grupi të mirëpërcaktuar pikash besimi që secili i krishterë duhet t'i mësojë përmendësh dhe t'i shpallë e t'i mbrojë publikisht është një gjë e re mes të krishterëve në botën e lirë sot. Të krishterët në botën e lirë shpesh mendojnë se marrëdhënia jonë me Jezusin është thellësisht personale dhe individuale. Ne flasim për Jezusin si shpëtimtari ynë “personal”, dhe themi se shpëtimi është rezultat i marrëdhënies sonë “personale” me Perëndinë. Ne i vlerësojmë këngët dhe predikimet, ngaqë i japim vlerë të lartë marrjes së njohurisë së thellë individuale dhe përjetimit të së vërtetës.

Por, për më tepër se shtatëmbëdhjetë shekuj, Kredoja e Nikeas ka qëndruar për t'i kujtuar kishës dhe botës se krishterimi nuk është një seri meditimesh të thella e përvojash individuale, por përkundrazi është një zbulesë hyjnore, e përjetshme, e pandryshuar e karakterit të Perëndisë. Ne nuk jemi thirrur për ta ndërtuar besimin tonë rreth meditimeve të thella e përvojave, por për të *marrë*, për të *shërbyer dhe* për ta *pasuar* plotësinë e besimit të krishterë në jetët tona dhe në shtëpitë tona, duke mos

¹⁴⁰ Tomas Oden (Thomas C. Oden), “Hyrje e përgjithshme,” Thomas C. Oden & Gerald Bray, *Doktrina e lashtë e krishterë (Ancient Christian Doctrine)*, Vol. 1, Downers Grove, IL: IVP Academic.

i shtuar asnjë gjë dhe duke mos i hequr asnjë gjë nga ajo që ka qenë besuar prej kishës besnike gjithmonë dhe kudo.

Karakteri i predikimit të fjalës në kishën e fshehtë e reflekton këtë. Predikimet e kishës së fshehtë nuk kërkojnë të jenë krijuese, të shkurtra ose interesante. Ato kërkojnë të jenë besnikë. E njëjta gjë është e vërtetë për administrimin e sakramenteve. Sakramentet e kishës së fshehtë nuk kërkojnë të jenë speciale, me kuptim ose nderuese. Ato kërkojnë të jenë besnike.

Madje edhe përpjekjet e kishës së fshehtë për t'i arritur njerëzit e për t'i ungjillëzuar ata nuk kërkojnë të jenë krijuese. Në kishën e fshehtë njerëzit nuk sillen te Krishti përmes tubimeve ungjillëzuese, të dielave ku ftohen njerëz të rinj ose bisedave në kafene, ku të krishterët ndajnë dëshminë e tyre ose diskutojnë përvojat e tyre personale me të tjerët. Ato ngjarje mund të ndodhin, por nuk quhen ungjillëzim. Ungjillëzimi i referohet specifikisht veprimit të *transmetimit me rëndësi primare të asaj që edhe ne kemi marrë*:

Sepse unë ju transmetova me rëndësi primare atë që edhe unë mora: se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se ai u varros, dhe se u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve, dhe se ai iu shfaq Kefës dhe pastaj të dymbëdhjetëve. Pastaj ai iu shfaq më tepër se pesëqind vëllezërve në të njëjtën kohë, shumica prej të cilëve janë ende gjallë, kurse disa kanë rënë në gjumë. Pastaj ai iu shfaq Jakobit, pastaj të gjithë apostujve. Më në fund, si dikush i lindur jashtë kohe, m'u shfaq edhe mua.¹⁴¹

Kundër praktikës popullore mes të krishterëve në botën e lirë, ungjilli nuk është një pohim i përgjithshëm i asaj që do të thotë të jesh i krishterë. Nuk është një prezantim i dëshmimeve të krishtera. Nuk është një prezantim i Katër Ligjeve Shpirtërore ose i disa

¹⁴¹ 1 Kor. 15:3-8 ESV (English Standard Version)

technikave të tjera ungjillëzuese. Nuk është Gjoni 3:16. Ungjilli është përmbajtja specifike e 1 Korintasve 15:3-7 – lajmërimi për një mbret të ri, i bazuar mbi profecitë e përmbushura të Dhiatës së Vjetër dhe i dëshmisë historike të atyre që e panë Jezusin të ringjallej prej së vdekurish.

Pali e quan këtë “të rëndësisë primare,” dhe çdo i krishterë duhet ta dijë përmendësh këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë. Ky është *ungjilli*. Kur ne trajtojmë *gjithçka* tjetër si të rëndësisë primare – si për shembull meditimet tona të thella personale për krishterimin ose dëshminë tonë – ne dështojmë në thirrjen tonë si të krishterë, e cila është ta marrim, ta mbajmë dhe ta pasojmë plotësinë e asaj që të krishterët e kanë besuar gjithmonë dhe kudo. Gjërat e tjera mund të jenë të vërteta dhe të rëndësishme, por ato nuk janë ungjilli, dhe ato nuk janë të rëndësisë primare.

Në prezantimin që Apostulli Pal i bën ungjillit me afro 90 fjalë te 1 Korintasve 15:3-8, ai bën çmos për t’u siguruar që krijimtaria të mos futet në besimin tonë. Ai e bën këtë duke e përsëritur të njëjtën shprehje dy herë. Është e vetmja shprehje që ai e përsërit në përmbledhjen e tij të ungjillit. Shprehja është “sipas Shkrimeve.” Është një shprehje që gjithashtu shfaqet te Kredoja e Nikeas, ngaqë qëllimi i Kredos së Nikeas është të fokusohet tek shkrimet, të na udhëzojë për interpretimin e tyre të saktë, dhe të na kujtojë për ato gjëra që janë të rëndësisë primare.

Të krishterët e fshehtë ia nënshtrojnë gjithçka Shkrimit, kredove dhe lutjeve të kishës tek Shkrimi. Ata i mësojnë përmendësh këto thesare dhe i mbrojnë ato me jetët e tyre. Përmes plotësisë së tyre ne predikojmë, dëgjojmë, i administrojmë sakramentet, dhe lutemi si 2000 vjeçarë – si ata, fryma e të cilëve është formësuar prej dy mijë vjet besnikërie.

Që të mos mendojë ndonjëri se një praktikë e tillë të shpie në një legalizëm monoton e pa jetë, kujtohuni se muzikantët e xhazit mësojnë shkallët dhe arpexhot e tyre nga fillimi në fund për të improvizuar mirë. Nëse të krishterët nuk i zotërojnë tamam

shkallët dhe arpexhot e besimit, improvizimi i tyre nuk do të jetë muzikë në veshët e askujt, e aq më pak në veshët e Krishtit.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Mos e mbillni një kishë të fshehtë me qëllim që të përpiqeni të krijoni kishën tuaj ideale, duke përzgjedhur sipas qejfit tuaj gjërat që pëlqeni e që nuk i pëlqeni në historinë e kishës dhe në pasqyrimet e tanishme të kishës. Kjo është idhujtari dhe papjekuri. Në vend të kësaj, kaloni në fshehtësi vetëm për shkak se kjo gjë ju aftëson për të qenë në bashkësi të plotë me kishën besnike kudo nëpër vende dhe epoka. Ajo bashkësi shprehet përmes shkrimeve, kredove dhe lutjeve të Shkrimit. Rrënjoseni jetën e kishës suaj të fshehtë në marrjen, mbajtjen dhe transmetimin e këtyre thesareve në plotësinë e tyre. Sigurohuni që kisha juaj e fshehtë nuk krijon asnjë gjë të re.
- Mësoni përmendësh, sa më tepër që të mundni, përmbajtje nga besimi historik i krishterë. Filloni me Dhjetë Urdhërimet, Kredon e Nikeas, Lutjen e Zotit dhe përmbledhjen e ungjillit nga Pali. Pastaj mësoni përmendësh të paktën një pjesë nga Shkrimi i Shenjtë (jo vetëm një varg, por një pjesë të tërë të Shkrimit) çdo javë. Ju nuk mund ta ruani si thesar dhe nuk mund t'i shërbeni diçkaje që nuk e njihni.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Konsideroni përdorimin e Kredos së Nikeas në vend të Kredos së Apostujve në adhurim. Jo vetëm që ajo

përmban një shprehje më të plotë të asaj që ka besuar kisha besnike gjithmonë dhe kudo, por ajo është kredoja që është miratuar si e përbashkët prej segmentit më të madh të të krishterëve anëmbanë botës.

- Mos u mjaftoni vetëm me recitimin e kredos, lutjeve dhe urdhërimeve, por mësojini ato rregullisht rresht pas rreshti. Mos u përpiqni të jeni krijues gjatë mësimdhënies së tyre. Në vend të kësaj, fokusohuni që të jeni sa më besnikë që të mundeni.
- Kërkoni që shpallja e Kredos së Nikeas të thuhet përmendësh në pagëzim, ose nga kandidati që pagëzohet, ose nga prindërit, ose nga mbështetësit e një të mituri ose fëmije që pagëzohet. Kërkoni jo vetëm mësimin përmendësh të kredos, por edhe aftësinë për ta shpjeguar atë rresht pas rreshti. Kjo praktikë shkon deri në ditët më të hershme të kishës.
- Auditoni predikimin tuaj. A karakterizohet ai prej krijueshmërisë apo prej besnikërisë për ta shpallur plotësinë e asaj që ka besuar kisha besnike gjithmonë dhe kudo? Sigurohuni që të merrni dhe transmetoni jo vetëm atë që theksohet brenda denominacionit tuaj ose brenda kishës koreane, por gjithashtu edhe atë që gjithnjë ka qenë besuar prej të gjithëve.

Parimi XI.

Jepni të dhjetën për të zbuluar karakterin e Perëndisë, jo për të mbështetur kishën

Meqenëse kisha e fshehtë në përgjithësi nuk regjistrohet ligjërisht, nuk kërkon ndërtesa, ose nuk paguan me kohë të plotë pastorë vendas, ajo ka nevoja financiare shumë modeste përgjithësisht. Kjo është shumë e ndryshme nga situata me të cilën përballen kishat publike, që shpenzojnë për veten e tyre mesatarisht 97% të parave që iu jepen.¹⁴²

Nëse kishat e fshehta nuk kanë nevojë për para për mbështetje institucionale, a inkurajohen të krishterët e fshehtë për të dhënë të dhjetën? Dhe nëse kishat e fshehta nuk kanë llogari bankare, atëherë si administrohet e dhjeta?

Ka më tepër se 2300 vargje në Bibël që flasin për paranë dhe zotërimet. Secili varg veç veç mund të përdoret për të justifikuar pothuajse çdo qasje lidhur me dhënien (ose mosdhënien). Por kur i lexon të gjitha së bashku, këto vargje nuk fokusohen kryesisht tek *sa shumë* duhet dhënë, por tek mënyra *si* duhet dhënë.

Për shembull, kur Jezusi flet për dhënien, ai nuk flet për ne që të japim si anëtarë kishe, por në vend të kësaj, ai flet për ne që të japim si fqinj, vëllezër e motra, dhe miq të atyre që kanë nevojë për ndihmë. Ai nuk flet për ne që t'i japim kishës, që ajo të mund t'i ndihmojë të tjerët, por në vend të kësaj, ai flet

¹⁴² Teri Austin (Terry Austin), “97% e parave të kishës shpenzohen për njerëzit që ia dhanë asaj? Diçka nuk shkon,” Kisha Bujare, 29 Dhjetor 2010, <http://www.generouschurch.com/512>.

për ne që t'u japim drejtpërdrejt dhe personalisht të tjerëve. Ai nuk flet që ne të japim për të zgjidhur problemet shoqërore, por në vend të kësaj, flet që ne të japim për të reflektuar karakterin e Perëndisë.

Jezusi nuk e sheh të dhënit si diçka që e bëjmë prej tepricave tona, por përkundrazi prej asaj që kemi për të jetuar. Me fjalë të tjera, ne nuk japim ngaqë jemi bekuar me teprica të mjaftueshme, që na mundësojnë dhënien. Ne japim, ngaqë jemi gjithmonë në rrezik për t'u bërë të varur nga vetja. Ai i thotë të riut të pasur që duket sikur nuk i mungon asnjë gjë, madje as drejtësia: “Një gjë të mungon.” Çfarë i mungon? Atij i mungon varësia nga Perëndia. Si mund ta marrë atë që i mungon? “Shko dhe shiti zotërimet e tua dhe jepua të varfërve dhe do të kesh thesar në qiell,” - thotë Jezusi.¹⁴³ Thesari në qiell është në përpjesëtim të drejtë me varësinë nga Perëndia në tokë.

Ngaqë kisha e fshehtë nuk ka pushtet, njerëz dhe begati, asaj i duhet patjetër të mësojë të mbështetet vetëm tek Perëndia. Të krishterët e fshehtë nuk japin ngaqë kisha e fshehtë ka nevojë për mbështetjen e tyre, ose ngaqë të varfrit kanë nevojë për ndihmën e tyre. Ata japin që t'u tregojnë vetes dhe të tjerëve se është e sigurt të mbështetesh tek Perëndia dhe të vendosesh në një pozitë varësie të plotë prej Tij. Të dhënit nuk është një shenjë e bujarisë sonë, por e besimit tonë tek bujaria e Perëndisë. Ashtu siç e shpjegon Znj. Bae, një e krishterë e fshehtë nga Koreja e Veriut, e dhjeta bëhet një formë ungjillëzimi për kishën e fshehtë:

Më lejoni t'ju tregoj sesi e dhamë të dhjetën ne. Nuk ka asnjë kishë në Korenë e Veriut. Nuk ka asnjë vend ose pastor të cilit t'ia japim të dhjetat tona. Por vjehrra ime e theksonte rëndësinë e së dhjetës. Prandaj, ndonëse nuk e dinim sesi ta ofronim të dhjetën tonë, ne gjithmonë e dhamë atë—duke e përdorur për të ndihmuar të tjerët.

¹⁴³ Marku 10:21, NASB.

Kur të varfrit nuk mund të paguanin dot për ilaçe ose trajtime, ne thjesht kujdeseshim për ta. U jepnim mjekime, edhe sikur të humbnim për vete. Blinim oriz për të uriturit, dhe i lejonim të na paguanin më vonë. U jepnim rrobat tona të tepërta të tjerëve. Kur blinim ushqimet, nuk e merrnim kusurin prej grave të moshuara ose nënave me fëmijë. Kur i peshonin perimet në peshore, thjesht u besonim atyre. Nuk e vinim në dyshim peshën.

Dhe i konsideronim të gjitha këto gjëra si të dhjetën tonë. Ne e quanim atë “ungjillëzim” por nuk Mund ta thoshim dot as me zë të lartë atë fjalë. Kur u shkonim për vizitë vëllezërve e motrave tona, ata do të ishin të lumtur nëse ju shpinim diçka. Ne nuk kishim mjaftueshëm për vete, por gjithmonë përgatisnim diçka për vëllezërit e motrat tona. Ju shpinim mjekime ose diçka të ëmbël kur ju shkonim për vizitë.¹⁴⁴

“Silluni me një nderim të tillë mes johebrenjve,” - shkruan Apostulli Pjetër, - “saqë, edhe pse mund të shpifin kundër jush si të ishit keqbërës, ata të mund t’i shohin veprat tuaja të mira dhe ta lavdërojnë Perëndinë në ditën që Ai do të na vizitojë ne.”¹⁴⁵ Kjo është dhënie si një formë ungjillëzimi—t’i lejosh të tjerët të bekohen nga mënyra juaj e jetës, saqë nuk ka më nevojë që të përqendrohemi tek siguri për veten tonë. Perëndia është një atë i mirë, dhe edhe nëse ju japim fqinjëve, vëllezërve, motrave, miqve dhe armiqve gjithçka që ai ka siguruar për ne, ne e bëjmë këtë me gëzim dhe me sigurinë se ai do të vazhdojë të përkujdeset me përsosuri për ne. Kjo lloj dhënieje synon ta bekojë madje edhe vjedhësin që vjedh prej nesh,¹⁴⁶ armikun që

¹⁴⁴ Znj. Bae tek Erik Folei, *Këta janë brezat*, Colorado Springs: W Publishing, 2012, fq. 88.

¹⁴⁵ 1 Pjetrit 2:12, BSB.

¹⁴⁶ krahaso Luka 6:30.

na hedh në gjyq,¹⁴⁷ dhe përndjekësin që derdh gjakun tonë.¹⁴⁸ Kjo ndodh ngaqë të dhënit në thelb nuk ka të bëjë me diçka kaq të vogël sa transferimi i parave për të mbështetur çështje të denja ose njerëz në nevojë. Përkundrazi, ka të bëjë me diçka po aq të madhe sa përmbysja e Rënies.

E dhjeta nuk është një arritje madhore e bujarisë njerëzore, por përkundrazi është pjesa më e vogël dhe më pak e rëndësishme e një jete dhuruese. Ashtu siç vëren Jezusi, ne duhet të japim të dhjetën, por ajo nuk renditet mes “çështjeve më me peshë të ligjit.”¹⁴⁹ Ashtu siç shpjegon Znj. Bae, e dhjeta nuk kërkon një kishë ose një llogari bankare të kishës. Një kishë e fshehtë që mbliidhet në shtëpi mundet të japë të dhjetën madje edhe për fqinjët e saj — dhe përndjekësit e saj. Ajo mund të japë të dhjetën në formën e mjekimeve, ushqimeve dhe qerasjeve. Duke dhënë të dhjetën si fqinjë, vëllezër e motra, dhe miq të atyre që i kemi fare pranë nesh, në vend që t’ia japë të dhjetën vetvetes, kisha e fshehtë zbulon dhe përjeton një Perëndi që është i denjë për t’i zënë besë më tepër sesa mamonit.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Mbjellja dhe drejtimi i një kishe të fshehtë nuk e bëri kurrë të pasur një pastor të kishës së fshehtë. Kujtohuni nga parimet e mëparshme se kishat e fshehta janë shtëpi të familjeve, që drejtohen prej drejtuesve të shtëpive e jo prej pastorëve me kohë të plotë që marrin rrogë për atë punë. Vetëm pastorët që mbikëqyrin zonat e drejtuesve të shtëpive, zakonisht marrin mbështetje, dhe kjo vjen në formën e bursave

¹⁴⁷ krahaso Mateu 5:40.

¹⁴⁸ krahaso Mateu 5:44, Romakëve 12:14, 1 Korintasve 4:12.

¹⁴⁹ krahaso Mateu 23:23, Luka 11:42.

të vogla. Kjo është e vërtetë jo vetëm kur numri i shtëpive është i vogël, por edhe kur ato janë më të shumta. A jeni i gatshëm t'i përkushtoheni sigurimit të përditshëm të Perëndisë si mjet praktik mbështetjeje për ju dhe familjen tuaj? Një pjesë e mbështetjes suaj mund të vijë nga bërja e tendave, por pjesa kryesore e përgjigjes duhet të jetë ajo që është diskutuar në këtë parim, që do të thotë, t'i besosh përditë karakterit të Zotit e jo aftësisë suaj për të siguruar. Mbillni këtë lloj besimi në kishën e fshehtë që po themeloni duke e demonstruar atë në vetë jetën tuaj që nga sot. Edhe kur nuk keni tepricë, jepni nga ajo që keni për të jetuar vetë.

- Sigurohuni që të jepni të dhjetën jo vetëm nga ana financiare, por edhe përmes ilaçeve, ushqimeve, dhuratave, dhe çdo gjë tjetër që Perëndia siguron. Jezusi e miraton këtë lloj dhënieje si themelore. Ajo nuk duhet të bëhet qendra e dhënies sonë, as një burim krenarie që na largon vëmendjen nga çështjet më me peshë të jetës së kishës së fshehtë. Por ndarja e pjesës së parë të gjithçkaje që marrim, në emrin e Jezusit, me fqinjët, vëllezërit, motrat, miqtë e armiqtë tanë duhet që të jetë themelore gjithmonë në mënyrën tonë të jetës në Krishtin.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Kërkojuni anëtarëve të kishës të japin vetëm një pjesë të së dhjetës së tyre në kishë, ndërkohë që e mbajnë një pjesë tjetër për ta përdorur në shërbesën e tyre të drejtpërdrejtë dhe personale duke iu dhënë fqinjëve, vëllezërve, motrave, miqve dhe armiqve në emrin e

- Jezusit. Kjo dhënie nuk duhet bërë tek organizatat e tjera, por duhet shpërndarë personalisht në atë mënyrë që Znj. Bae e përshkruan në parimin e mësipërm.
- Analizoni se sa është përqindja e parave që jepen në kishë, e cila përdoret për ta financuar kishën. Bëni një plan për ta pakësuar atë përqindje vit pas viti. Përdorini paratë që u kursyen për t'i përfshirë anëtarët e kishës në dhënien e drejtpërdrejtë dhe personale ndaj fqinjëve, vëllezërve, motrave, miqve e armiqve në emrin e Jezusit dhe për të zbuluar karakterin e tij.

Parimi XII.

Përhapeni ungjillin në fshehtësi përmes misioneve të varësisë

Misionet janë një pjesë po aq e madhe e kishës së fshehtë, sa edhe e kishës publike. Kisha e fshehtë nuk qëndron e fshehur, duke pritur që të përfundojë armiqësia ndaj saj, që pastaj të dalë nga vrima ku fshihet dhe të nisë të përmbushë sërish Urdhërimin e Madh. Siç kanë synuar të sqarojnë parimet e tjera në këtë libër, kishat kalojnë në fshehtësi pikërisht sepse janë duke u përpjekur t'i qëndrojnë besnike gjithçkaje që ka urdhëruar Krishti. Të qenit besnik ndonjëherë kërkon që të kryesh misione në fshehtësi.

Në kishat publike, misionarët ngrenë mbështetje financiare dhe pastaj shkojnë në misione. Në kishat e fshehta, misionarët shkojnë në misione dhe mbështeten prej atyre që takojnë rrugës. Një pjesë e arsyes pse kjo është praktike: Misionet e fshehta nuk mund të reklamojnë publikisht se kanë nevojë për mbështetje. Në shumicën e rasteve, ato as nuk mund të flasin dot hapur për një mision në fazën e planifikimit.

Por arsyeja kryesore se pse misionarët e kishës së fshehtë marrin mbështetje prej atyre që i mikpresin gjatë rrugës është teologjike: Kjo është qasja biblike ndaj misioneve, e cila pothuajse ka qenë harruar prej kishës publike në botën e lirë.

Në shkrimet e shenjta, *mesazhi* i ungjillit dhe *lajmëtari* i ungjillit janë “të pandashëm, si mish e thua”: Ai që e mikpret lajmëtarin merr mesazhin, dhe ai që merr mesazhin e pranon mbretin që e dërgoi mesazhin, vetë Krishtin. Por të mos e mikpresësh lajmëtarin e Krishtit është njësoj si të refuzosh

mesazhin e ungjillit — dhe në këtë mënyrë, vetë Krishtin. Rezultati do të jetë gjykim në ditën e fundit.

Jezusi e ndan në mënyrë të përsëritur këtë mesazh tek ungjijtë. Tek Gjoni 13:20, ai thotë: “Në të vërtetë ju them, se kushdo që e pranon këdo që dërgoj unë, më pranon mua; dhe kushdo që më pranon mua e pranon atë që më dërgoi mua.”¹⁵⁰ Tek Mateu 10:40-42, ai e shtjellon në më tepër detaje këtë mësim:

Kushdo që ju mikpret juve më mikpret mua, dhe kushdo që më mikpret mua, mikpret atë që më dërgoi mua. Kushdo që e mikpret një profet si profet, do të marrë shpërblimin e profetit, dhe kushdo që e mikpret një person të drejtë si një person të drejtë, do të marrë shpërblimin e personit të drejtë. Dhe, nëse dikush i jep qoftë edhe një gotë me ujë të ftohtë njërit prej këtyre të vegjëlve që është dishepull i imi, në të vërtetë po ju them, se ai person me siguri nuk ka për ta humbur shpërblimin e tij/saj.¹⁵¹

Tek Mateu 10:14-15, ai paralajmëron për pasojat e mospranimit të lajmëtarëve të tij:

Nëse ndonjë nuk do t’ju mikpresë ose nuk do t’i dëgjojë fjalët tuaja, largohuni nga ajo shtëpi ose ai qytet dhe shkundeni pluhurin nga këmbët tuaja. Në të vërtetë po ju them, do të jetë më e durueshme për Sodomën dhe Gomorrën në ditën e gjykimit sesa për atë qytet.¹⁵²

Për t’u siguruar se ata që po vizitohen po e pranojnë ose po e mohojnë lajmëtarin vetëm mbi bazën e mesazhit dhe të asnjë gjëje tjetër, Jezusi urdhëron që lajmëtarët e tij të mos marrin

¹⁵⁰ Gjoni 13:20, NIV.

¹⁵¹ Mateu 10:40-42, NIV.

¹⁵² Mateu 10:14-15, NIV.

asnjë gjë tjetër me vete, me përjashtim të mesazhit të ungjillit. Ata duhet ta lenë veten krejtësisht në duart e atyre që po ju shkojnë për vizitë, për t'u pranuar ose për t'u mohuar. Merrni parasysh Luka 10:1-4:

Pas kësaj, Zoti caktoi shtatëdhjetë e dy të tjerë dhe i dërgoi dy e nga dy përpara tij në secilin qytet dhe vend ku ai do të shkonte më vonë. Ai ju tha: “E korra është e bollshme, por punëtorët janë të paktë. Prandaj, kërkojini Zotit të të korrave të dërgojë punëtorë në fushat e korrjes së tij. Shkoni! Po ju dërgoj si qengja në mes të ujqve. Mos merrni asnjë kuletë, ose çantë, ose sandale; dhe mos përshëndetni asnjë gjatë rrugës.”¹⁵³

Me fjalë të tjera, Jezusi i urdhëron misionarët e tij që, përpara se të nisen për në fushën e misionit, të *zbrazen* nga çdo mbështetje dhe jo të *ngrenë* mbështetje. Ata duhet të shkojnë në fushën e misionit vetëm me mesazhin e ungjillit. Ata që i pranojnë me mikpritje, do të marrin shpërblimin e misionarit; ata që i refuzojnë do të refuzohen në ditën e fundit prej Krishtit që i dërgoi ata.

Krishti e modelon këtë strategji misionari në vetë jetën e tij. Ai vjen prej qiellit me asgjë, duke pasur nevojë për mikpritjen e mitrës së një virgjëreshe. Përgjatë jetës së tij, deri në ngjitjen e tij në parajsë, ai kërkon përditë mikpritjen mbi bazën e mesazhit të tij. Tek Mateu 8:20, ai thotë: “Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e ajrit kanë fole, kurse Biri i Njeriut nuk ka as ku të verë kokën.”¹⁵⁴

Jezusi nuk iu tha apostujve ta ndiqnin këtë qasje ndaj misioneve derisa të mblidheshin fonde të mjaftueshme për t'i bërë misionet siç duhej. Ai pati një arsye për t'i trajnuar ndjekësit e

¹⁵³ Luka 10:1-4, ESV.

¹⁵⁴ Mateu 8:20, ESV.

tij që ta mishëronin ungjillin përmes misionëve të varësisë. Boni Mjedema (Bonnie Miedema) shpjegon:

Kur Jezusi i dërgoi të Dymbëdhjetët që të predikonin e t'i shëronin të sëmurët, Ai i udhëzoi: “Mos merrni asnjë gjë për udhëtimin - asnjë shkop, asnjë çantë, as bukë, as para, as rroba shtesë” (Luka 9:3). Më në fund po filloj ta kuptoj se pse e tha atë Jezusi. Ai donte që dishepujt ta përjetonin mikpritjen e vendasve dhe të ishin të varur prej tyre. Ai e dinte se identifikimi me njerëzit dhe qëndrimi në shtëpitë e tyre do të hapte dyer për shërbesën e tyre.¹⁵⁵

Kërkimi i përditshëm i mikpritjes ishte po aq pjesë e ungjillit të Jezusit, sa edhe vetë mesazhi i ungjillit: Kush do t'ia hapë derën mbretit të lavdisë dhe lajmëtarëve të tij?

Kur e kuptojmë këtë parim të misionëve të varësisë, ne mund ta shohim historinë e sundimitarit të ri e të pasur tek Marku 10:17-22 nën një dritë të re.

Dhe teksa ai po bëhej gati për t'u nisur në udhëtimin e tij, një burrë vrapoi drejt tij, u gjunjëzua përpara tij dhe e pyeti: “Mësues i mirë, çfarë duhet të bëj që ta trashëgoj jetën e përjetshme?” Dhe Jezusi i tha: “Pse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë përveç Perëndisë. Ti i njeh urdhërimet: ‘Mos vrit, mos bëj tradhti bashkëshortore, mos vidh, mos jep dëshmi të rreme, mos mashtro, ndero babain dhe nënën tënde.’” Dhe ai i tha atij: “Mësues, që të gjitha

¹⁵⁵ Tek E. Tomas Bruster & Elizabeta S. Bruster (E. Thomas Brewster & Elizabeth S. Brewster,) “Mësimi i gjuhës është komunikim - është shërbesë!”, *Udhëtimet e misionëve të krishtera: Informacion, ndikim & mundësi! [Language Learning Is Communication – Is Ministry!]*, *Christian Missions Trips: Information, Impact, & Opportunities!* <https://shorttermmissiontrips.wordpress.com/2011/01/18/how-to-look-at-language-learning-in-a-new-way/>.

këto i kam mbajtur që kur isha i ri.” Dhe Jezusi, duke e parë, e deshi dhe i tha: “Një gjë të mungon: shko, shiti të gjitha gjërat që ke, dhe jepua të varfërve, dhe do të kesh thesar në qiell’ dhe eja e më ndiq.” I mërzhitur nga këto fjalë, ai iku i trishtuar, sepse kishte pasuri të madhe.¹⁵⁶

Jezusi nuk propozoi ta trajnonin sundimtarin e ri e të pasur në mënyrë të ndryshme nga ajo që ai po i trajnonte apostujt e tij ose nga mënyra sesi po jetonte vetë. Ai e fton sundimtarin e ri të pasur të hyjë tek faza e zbrazjes së mbështetjes për t’u përgatitur për mision (“shiti të gjitha gjërat që ke dhe jepua të varfërve ... dhe eja, ndiqmë”). Në vend të një misionari të një kishë publike, që udhëton kishë më kishë për të ngritur mbështetje financiare, i krishteri i kishës së fshehtë përgatitet për shërbesën e misionit duke udhëtuar vërdallë për ta zhveshur veten nga zotërimet tokësore. Misionari deklarohet se është gati për shërbesë kur llogaria bankare e tij ose e saj shkon në zero.

Për fat të keq, sundimtari i ri i pasur, e kundërshtoi ftesën e trajnimit.

Nëse sundimtari i ri i pasur do të kishte shkuar në mision me para, në atë mënyrë që shkojnë shumica e misionarëve të kishave publike, ai do të ishte mikpritur ngrohtësisht prej kujtdo që do t’i shkonte për vizitë. Kjo ju ndodh shpesh misionarëve të botës së lirë. Ata futen në një zonë të varfër, dhe pranohen mjaft mirë prej njerëzve atje, jo për shkak se njerëzit po i përgjigjen mesazhit të ungjillit, por ngaqë ata janë duke iu përgjigjur një mesazhi që nuk thuhet me fjalë por që nënkuptohet: Bërja i/e krishterë do t’ju sjellë përfitime materiale!

Në kishën e fshehtë, misionet janë praktika e ndarjes së ungjillit duke i lejuar ata që po vizitojmë të na bëjnë të mira—që nga ushqimi, tek strehimi nëpër shtëpitë e tyre deri tek ndihma për të çuar ungjillin tek shtëpitë e fqinjëve. Ajo që sjellim

¹⁵⁶ Marku 10:17-22, ESV.

është vetëm mesazhi dhe vetja jonë si lajmëtarët e Krishtit. Ne i lejojmë njerëzit e panjohur të na strehojnë, sepse vijmë në emër të Zotit. Duke na strehuar ne, ata strehuan Zotin dhe e mikpritën ungjillin. Zoti nuk harron kurrë.

Hapa veprimi për mbjellësit e kishave:

- Vëllimi i tretë dhe i fundit i këtyre serive, i titulluar *Të jetuarit në kishën e fshehtë*, u botua në nëntor 2017, sipas planit të Zotit. Është një paketë me vegla dishepullimi dhe hermeneutike nga tradita e kishës për t'i pajisur të krishterët që ta dëgjojnë e ta zbatojnë fjalën në kontekstin e kishës së fshehtë. Megjithatë, ajo që detajohet në këtë parim të fundit të këtij libri mjafton për t'ju aftësuar që ta dëgjoni e ta zbatoni fjalën që thuhet te Luka 10 për të ndërmarrë ose një udhëtim misioni afatshkurtër sipas stilit të Luka 10 (shih Hapat e veprimit për kishat ekzistuese më poshtë), ose për të...
- ... Shitur gjithçka që keni, për t'ju dhënë të varfërve dhe për të ardhur e ndjekur Krishtin. Hyni në fazën e zbrasjes së mbështetjes, teksa përgatiteni për të shkuar të mbillni kishën e fshehtë, në një mision varësie vetëm mbi Zotin dhe mbi ata tek të cilët ai do t'ju dërgojë.

Hapa veprimi për kishat ekzistuese:

- Bëni një udhëtim misioni njëjavor sipas stilit tek Luka 10 me anëtarët e kishës suaj. Kaloni një javë në lutje me grupin, duke i kërkuar Zotit se ku dëshiron t'ju dërgojë. Vendosi të merrni me vete vetëm gjërat

absolutisht më thelbësore, siç u specifikuan nga Jezusi te pasazhi i përshkruar tek Luka 10. Unë dhe Dr. Folei bashkë me katër të tjerë bëmë një udhëtim sipas stilit të Luka 10 disa vjet më parë, kur isha pastor i një kishe publike në Hjuston, Teksas. Nuk morëm ndërresa me vete, as kuleta, as para—vetëm një celular (për t’u dhënë mundësi familjeve tona të shqetësuara dhe anëtarëve të kishës që të na kontaktonin, dhe për të raportuar përditë mbi gjërat që kishin ndodhur), një makinë, patentën time (për të shkuar në Bomont, Teksas, ku e ndjemë se po na drejtonte Zoti) dhe një videokamera për të regjistruar se ç’po ndodhte. Gjatë asaj jave nuk na mungoi kurrë asnjë vakt ushqimi; nuk mbetëm pa bërë dush; nuk na u desh kurrë të vishnim rroba të pista; dhe, në fund të javës, Perëndia na dha dy shtëpi—dhe një ofertë të dhjete me më tepër se \$600 për t’i sjellë te kisha në Hjuston, që na kishte dërguar.

PJESA III

TË JETUARIT NË
KISHËN E FSHEHTË

Nga **Pastor Erik Folei** (Eric Foley)

HYRJE

Ky libër është vëllimi i tretë dhe i fundit mbi ardhjen e kishës së fshehtë në vendet liberal-demokrate të së ashtuquajturës “botë e lirë”, si Koreja.

Vëllimi i parë, *Përgatitja për Kishën e Fshehtë*, riprezantoi esenë historike të vitit 1969, dhe megjithatë të pazbuluar, shkruar nga I Përndershmi Riçard Vurmbrand (Richard Wurmbrand). Në atë ese I Përndershmi Vurmbrand shpjegoi se pse kishës në vendet liberal-demokrate shumë shpejt do t’i duhej të adoptonte metodat dhe mënyrën e jetës së kishës, që atëherë praktikohej prej besimtarëve besnikë në vendet totalitare, ku krishterimi ishte bërë një fe e ndaluar. Ai ofroi strategji praktike për tranzicionin e kishave ekzistuese në “botën e lirë”, ndërsa rrethanat e lejonin ende këtë gjë. Vetë hyrja ime në atë vëllim identifikoi “Revolucionin Seksual” të ditëve të sotme si një manifestim të plotë të forcave anti-kishë, të cilat I Përndershmi Vurmbrand i parashikoi pothuajse pesëdhjetë vjet më parë. Unë përshkrova sesi kishat në Evropë e në Amerikë e humbën betejën e tyre kundër martesave gei. Ata i përqendruan përpjekjet e tyre për ta kundërshtuar homoseksualitetin, në vend që ta pranonin vetë bashkëfajësinë e tyre të thellë në kulturën e vetë-krijimit, e cila është rrënja prej së cilës burojnë martesat gei dhe Revolucioni Seksual. Unë i nxita kishat koreane që të mos e kopjojnë strategjinë e dështuar kundër-homoseksualitetit të homologëve të tyre Evropianë dhe Amerikanë. Në vend të

kësaj, rekomandova se kishat Koreane duhej t'i përgjigjeshin kundërshtimit kulturor dhe kufizimeve ligjore gjithnjë e në rritje të Revolucionit Seksual duke ndërtuar lloje të reja bashkësish (kisha “të fshehta”) që nuk kërkojnë qasje në sistemet financiare, komerciale, ligjore ose politike të kësaj bote, me qëllim që të veprojnë. Vura re se një model kishe i tillë nuk është aspak i ri, por ai ka qenë vërdallë që nga fillimi i krishterimit, duke këmbëngulur përmes kushteve më të këqija në dymijë vitet e fundit dhe në fakt duke vazhduar sot në më tepër se në 50 vende, ku Krishterimi Biblik është i ndaluar, përfshirë edhe në Korenë e Veriut.

Vëllimi i dytë, *Mbjellja e Kishës së Fshehtë*, identifikoi parimet dymbëdhjetëshekullore që i kanë aftësuar të krishterët e fshehtë anembanë botës të përparojnë në besimin e tyre, pavarësisht nga kundërshtimi serioz me të cilin përballen. Tregova sesi pastorët e kishave ekzistuese koreane dhe mbjellësit e kishave mund ta zbatojnë secilin prej këtyre parimeve sot, në përgatitje ndaj kundërshtimit kulturor e politik gjithnjë në rritje, që del prej Revolucionit Seksual. Unë debatova se epoka e suksesit për megakishat e profesionalizuara, të ndërtuara “duke zbritur prej podiumit të foltores” është duke përfunduar shpejt, dhe ne duhet të nisim tani të ndërmarrim nismën pioniere të bashkësive të vogla kristiane të ndërtuara “prej familjes e sipër.” Ashtu si të krishterët e hershëm koreanë, ne duhet ta bëjmë fokusin e jetës së kishës në Kore adhurimin e përditshëm në shtëpi, në vend të shërbesës së të dielës.

Në shumë mënyra mund të thuhet se, që krishterimi të vazhdojë të mbijetojë e të përparojë tek brezi tjetër në Kore, që është më armiqësor dhe kufizues, ai duhet të rikthehet tek praktikat e brezit të parë fare të të krishterëve koreanë. Këtu unë nuk jam duke iu referuar brezit të të krishterëve koreanë që doli nga Rilindja e Madhe e Pjongiangut në vitin 1907. Në vend të kësaj, jam duke iu referuar atij brezi të të krishterëve

koreanë prej të cilëve doli Rilindja e Madhe e Pjongiangut: Të krishterëve koreanë të viteve 1873 deri në vitin 1906.¹⁵⁷

Shumë dihet prej historianëve për këtë brez të parë të të krishterëve koreanë, por vetëm pak u mësohet për të, të krishterëve të zakonshëm koreanë sot, dhe për fat të keq, pothuajse asnjë gjë prej tyre nuk vlerësohet për t'u imituar prej kishave koreane, misionarëve, ose të krishterëve. Megjithatë, jeta dhe praktika e këtij brezi të parë të të krishterëve koreanë ishte kaq transformuese, kaq e padëgjuar në historinë moderne të krishterë, saqë ata ishin në fokusin e librave dhe artikujve apo studimeve në Amerikë e në Evropë, shumë kohë përpara se të ndodhte Rilindja e Pjongiangut.

Ky libër nuk është për historinë e këtij brezi pionier, ndonëse ai përmban disa prej historive të tyre, me qëllim që të na ndihmojë për ta rifituar dhe rikuperuar atë formë origjinale të krishterimit korean — një krishterim pa pastorë të emëruar, pa foltore ose ndërtesa kishash dhe denominacionesh, ose pa para apo pozitë ligjore ose leje qeverie apo pranim publik.

Në vend të këtyre, fokusi i këtij libri është tek ai që ishte fokusi i krishterimit të tyre: Bibla.

Kaq i fokusuar ishte brezi i parë i të krishterëve koreanë tek Bibla, saqë feja e tyre përshkruhej prej misionarëve të huaj të sapoardhur si “Krishterim Biblik”.¹⁵⁸ Të krishterët e parë koreanë nuk ishin të konvertuarit prej këtyre misionarëve të

¹⁵⁷ 1873 është viti në të cilin Misionari Xhon Ros (John Ross) filloi të shiste libra të krishterë në gjuhën kineze te Porta Korea (Corea Gate). Shih J. Ross, Metodat e Misionit në Mançuri. (J. Ross, *Mission Methods in Manchuria*.) Londër: Fleming H. Revell Co., 1903, fq. 17.

¹⁵⁸ SHBBH (Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj), *Gjethet e Pemës: Një Raport Popullor i Ilustruar i Shoqërisë Biblike Britanike dhe të Huaj për vitin, 1906-1907*. [BFBS (British and Foreign Bible Society), *[BFBS (British and Foreign Bible Society), The Leaves of the Tree: A Popular Illustrated Report of the British and Foreign Bible Society for the Year, 1906-1907.]* Londër: Bible House, 1907, fq. 70.

huaj. Përkundrazi, ata kishin genë konvertuar prej Biblave që lexonin dhe prej shitësve ambulantë koreanë, që i fusnin ato kontrabandë—ku ata shitës ambulantë ishin të sapokonvertuar në krishterim për vete.

Këta të krishterë të brezit të parë nuk e lexonin Biblën si një prej shumë veprimtarive të krishtera në jetën e tyre. Leximi i Biblës *ishte* jeta e tyre. Për ta, *sagyeonghoe* (takimi për shqyrtimin e Biblës) nuk ishte një ngjarje speciale vjetore, që drejtohej prej një pastori ose prej një folësi të nderuar të ftuar. Ishte një ngjarje e përditshme ku merrte pjesë secili i krishterë korean, teksa ata përpiqeshin të kalonin përmes kësaj “bote të re e të çuditshme të Biblës” në të cilën kishin hyrë. Siç e shpjegojnë historianët e kishës koreane Sebastian Kim dhe Kirstin Kim (Kirsteen Kim),

Sapo të krishterët koreanë e pranonin Biblën si tekstin e tyre të shenjtë, ai nderohej si autoritet përmbi të tjerët. Studentët e lexojnë atë sipas mënyrës së Konfucit; me zë të lartë, duke kujtuar tekstet dhe duke i recituar ato, dhe pastaj duke ndjekur mësimet e saj fjalë për fjalë në etiket ditore, sjelljen morale dhe në çështjet e parimeve shoqërore-politike. Njerëzit e pranonin tekstin si autoritativ, pa qëndrim kritik ose pa konsideruar vlefshmërinë e tij në kontekstin e Koresë.¹⁵⁹

Ç’do të thotë të jesh një i krishterë që jeton në një kishë të fshehtë? Do të thotë se jeta bëhet *sagyeonghoe*. Do të thotë se, teksa e lexojmë Biblën në vendin ku jetojmë aktualisht, mes njerëzve që njohim realisht, ne zgjohemi prej gjumit ashtu si Jakobi dhe themi bashkë me të: “Me siguri që Zoti është në

¹⁵⁹ S.C.H. Kim & K. Kim, *Një Histori e Krishterimit Korean*. (Kim and K. Kim, *A History of Korean Christianity*.) Nju Jork: Cambridge University Press, 2015, fq. 87-88.

këtë vend; dhe unë nuk e dija.”¹⁶⁰ Do të thotë se ne lexojmë me zë të lartë, mësojmë përmendësh tekste nga Bibla dhe i recitojmë ato, pastaj e ndjekim mësimin e tyre fjalë për fjalë në etiket e përditshme, sjelljen morale dhe në çështjet e parimeve shoqërore-politike. Do të thotë se ne e pranojmë tekstin si autoritativ, pa qëndrim kritik ose pa konsideruar vlefshmërinë e tij në kontekstin e Koresë. Do të thotë se ne e ndërmarrim këtë detyrë të vetme si gjatësinë e gjerësinë e jetës sonë të krishterë, me të njëjtin intensitet, fokus, braktisje dhe besnikëri ndaj Perëndisë, ashtu si bënë të krishterët më të hershëm koreanë.

Qëllimi i këtij libri është të sigurojë një metodë të thjeshtë për ta jetuar atë jetë, gjë që, siç do ta shohim, gjithmonë e ngre një person në drejtim pingul me botën, dhe kështu shkakton në mënyrë të pashmangshme që të kalojë në fshehtësi. Metoda konsiston në shtatë hapa—një kohë përgatitjeje e pasuar nga gjashtë kërkesa:

1. Përgatituni ta merrni Biblën.
2. Si më ndihmon Kredoja e Nikeas ta shoh Perëndinë Trini në këtë Shkrim të Shenjtë?
3. Cili është konteksti i këtij pasazhi nga Shkrimi?
4. Çfarë bën Perëndia Trini në këtë pasazh të Shkrimit?
5. Si e urdhëron Perëndia trupin e Krishtit, dhe ne duke qenë anëtarë të atij trupi, në këtë pjesë të Shkrimit?
6. Si do ta zbatojmë tani atë fjalë që sapo kemi lexuar?
7. Çfarë mësuam për karakterin e Perëndisë përmes dëgjimit dhe zbatimit të këtij Shkrimi të Shenjtë?

Në këtë vëllim, secilit hap i kushtojmë një kapitull.

Deri në shkallën që këta hapa mund të shërbejnë si një metodë e dobishme e studimit të Biblës për lexuesit, unë jam i kënaqur në Zotin.

¹⁶⁰ Zanafilla 28:16, KJV.

E megjithatë, ky vëllim është një përpjekje për të bërë diçka më tepër. Dy vëllimet e mëparshme kërkuan ta demistifikojnë dhe ta operacionalizojnë konceptin e kishës së fshehtë për të krishterët në të ashtuquajturën botë “e lirë”. Ky vëllim i tretë përpiqet t’i përgjigjet pyetjes: Çfarë do të bënin të krishterët në një mbledhje të tillë? Me fjalë të tjera, si duket liturgjia e një kishe të fshehtë?

Ajo që shpaloset në këtë vëllim nuk nxirret në mënyrë speciale prej brezit të parë të “të krishterëve Biblikë” koreanë, dhe as prej të krishterëve të fshehtë në përgjithësi. Në fakt, metodat e leximit të Biblës që janë të posaçme për një kohë, një vend, një popull ose një pastor të caktuar, me të drejtë vihen në dyshim. Një metodë për leximin e Biblës nuk duhet të bëjë asnjë gjë më tepër ose më pak sesa të na vendosë në një lidhje të duhur me Shkrimin e Shenjtë dhe Perëndinë Trini. Që nga ajo pikë, siç e thotë Karl Barthei, “Është një lumë...”

Është një frymë në Bibël, që na lejon të ndalojmë për pak dhe të luajmë mes gjërave dytësore, siç është zakoni ynë - por për tani ai fillon të na shtyjë; dhe sido që të mund të kundërshtojmë ne, se jemi vetëm njerëz të dobët, të papërsosur dhe shumë të zakonshëm, mesatarë, ai na shtyn për tek fakti parësor, pavarësisht nëse ne duam apo jo. Është një lumë në Bibël që na shpie tutje, sapo ia kemi besuar fatin tonë atij — na nxjerr jashtë vetes për në det.¹⁶¹

¹⁶¹ K. Barth, *Fjala e Perëndisë dhe Fjala e Njeriut (The Word of God and the Word of Man.)* Gloucester, MA: Peter Smith Publisher, Inc., 1978, fq. 34.

Kapitulli 1.

Përgatitja për ta marrë Biblën

Një ditë, në njërin nga stacionet e misionit erdhi një i krishterë i fortë nga veriu. Pas përshëndetjeve të zakonshme, atë e pyetën për qëllimin e vizitës së tij. Përgjigjija e tij ishte: “Kam mësuar përmendësh disa vargje në Bibël dhe kam ardhur t’jua recitoj ato.” Ai jetonte mbi 150 kilometra larg, dhe kishte ecur përgjatë tërë rrugës, duke udhëtuar për katër net—një shëtitje goxha e gjatë për t’i recituar ca vargje nga Shkrimi i Shenjtë pastorit të tij, por atë e dëgjuan teksa e recitonte në koreanisht, pa asnjë gabim në fjalët që thoshte, të tërë Predikimin në Mal. Atij i thanë se, nëse thjesht e mësonte përmendësh atë pasazh, do të ishte një vepër heroike për kujtesën e tij e asgjë më tepër; ai duhej që t’i praktikonte mësimet e tekstit. Fytyra i ndriti me një buzëqeshje, teksa u përgjigj shpejt: “Kjo është arsyeja se pse e mësova. U përpoqa ta mësoja përmendësh, por nuk më ngjiste, kështu që bëra këtë plan. Do ta mësoja përmendësh një varg e pastaj do të gjeja një fqinj pagan timin me të cilin do ta vija në praktikë atë varg. Atëherë zbulova se vargjet ngjiteshin në kujtesë.”¹⁶²

Çfarë është jeta e krishterë? Cila është mënyra më e thjeshtë për të përshkruar saktësisht e plotësisht qëllimin, natyrën dhe drejtimin e saj?

Jeta e krishterë është dëgjimi dhe zbatimi i fjalës.

¹⁶² G.H. Jones, *Korea: Toka, Njerëzit dhe Zakonet*. Nju Jork: Eaton & Mains, 1907, fq. 99-100.

“Atëherë kushdo që i dëgjon këto fjalë të miat dhe i zbaton është si një njeri i urtë, që e ndërtoi shtëpinë e tij mbi një shkëmb,” - thotë Jezusi.¹⁶³ Kur Jezusi thotë “këto fjalë të miat” ai është duke iu referuar në mënyrën më të menjëhershme Predikimit të tij në Mal tek Mateu 5-7. Me të vërtetë, ishin pikërisht këto fjalë specifike që i arrestuan kaq shumë nga të krishterët e hershëm koreanë — jo vetëm “të krishterin e fortë nga veriu” të përmendur më lart, por edhe një të krishterë tjetër të fortë nga veriu, të madhin Kim Kjo Shin (Kim Kyo Shin) i cili, sapo i dëgjoi fjalët e predikimit, arriti në përfundimin se duke mësuar si t’i zbatonte ato, ai do të bëhej një burrë i drejtë, dhjetë vjet më përpara nga sa do të arrinte të bëhej i tillë, nëse do t’i ndiqte mësimet e Konfucit.¹⁶⁴

Por, ashtu si Kim Kjo Shini, kushdo që kërkon t’i dëgjojë e t’i verë në praktikë fjalët e Jezusit tek Mateu 5-6, do ta kuptojë shpejt se ato fjalë — dhe Jezusi — janë të pandashme nga tërësia e Biblës. “Ju i shqyrtoni Shkrimet, ngaqë mendoni se ato ju japin jetën e përjetshme,” - thotë Jezusi. “Por Shkrimet flasin për mua!”¹⁶⁵ “Dhe duke nisur me Moisiun e me të gjithë Profetët, ai u shpjegoi se çfarë thuhej në Shkrimet lidhur me të.”¹⁶⁶

Tek Zbulesa kapitulli 5, Apostulli Gjon sheh një rrotull — fjalën e Perëndisë. Një engjëll i fuqishëm pyet: - “Kush është i denjë t’i thyejë vulat dhe ta hapë rrotullën?” Por Gjoni thotë: “Askush në qiell ose në tokë, ose nëntokë, nuk munda ta hapte rrotullën, e madje as nuk munda të shihte brenda saj.” Bibla është krejtësisht e mbyllur për të kuptuarin e bijve të Adamit. Dhe për këtë arsye, Gjoni vajton.

¹⁶³ Mateu 7:24, ESV.

¹⁶⁴ “Kujtimet e Kim Kjo-shinit” (“Recollection of Kyo-shin Kim,”) fq. 1. Të lexuara në datën 29 qershor 2017, në: www.biblekorea.net/articles/Recollection_of_Kyo-shin_Kim.doc.

¹⁶⁵ Gjoni 5:39, NLT.

¹⁶⁶ Luka 24:27.

Kështu pra, Bibla zotëron një marrëdhënie të pazgjidhshme me Krishtin, dhe në mënyrë të ngjashme, Krishti zotëron një marrëdhënie të pazgjidhshme me Biblën. Prandaj, të thuash se jeta e krishterë është dëgjimi dhe zbatimi i fjalës nuk ka kuptimin se krishterimi është një jetë me studim Bible. Bibla nuk mund të studiohet, të kërkohet ose të zotërohet sikur ajo të detyrohej për të prodhuar ndonjë gjë. Bibla mundet vetëm të zbulohet, dhe i vetmi që mund ta zbulojë atë është Krishti. Ai e zbulon atë vetëm me kushtet e tij, për qëllimin e tij. Zbulesa e tij e Biblës është zbulesa e Perëndisë Trini, sepse nuk ka asnjë zbulesë të diçkaje në Bibël që është tjetër gjë nga kjo.

Perëndia e zbulon vetveten tek të gjithë që e kërkojnë atë¹⁶⁷, dhe ai duhet të na transformojë neve, me qëllim që ta pranojmë atë. Ai transformim duhet të ndodhë tek të dy: dëgjimi dhe zbatimi nga ana jonë.

Shumë të krishterë e pranojnë se ai transformim duhet të ndodhë tek dëgjimi ynë. Kjo është arsyeja se pse ata kryejnë studime Bible, gjë që ata e shohin si një disiplinë të brendshme, ose frymërore. Ata caktojnë kohë të posaçme përditë, për ta lexuar Biblën e për t'u lutur. Ata përdorin shprehje të tilla si “të dëgjojmë prej Zotit.” Disa njerëz e quajnë këtë KQ, ose Kohë e Qetë.

Por Jezusi ka një emër tjetër për një praktikë të tillë. Ai e quan atë KM ose kohë e marrë:

Dhe kushdo që i dëgjon këto fjalë të miat dhe nuk i zbaton ato, do të jetë si një i marrë, që e ndërtoi shtëpinë e tij mbi rërë. Dhe ra shiu, erdhi përmbytja, dhe fryra era e u përplas mbi atë shtëpi, dhe ajo ra, e rënia e saj ishte e madhe.¹⁶⁸

¹⁶⁷ Krahaso Hebrenjve 11:6.

¹⁶⁸ Mateu 7:26-27, ESV.

Ose ashtu siç shkruan Jakobi:

Kushdo që e dëgjon fjalën, por nuk e kryen atë që ajo thotë, është si dikush që e sheh fytyrën e tij në një pasqyrë dhe, pasi e ka parë veten, largohet dhe harron menjëherë sesi dukej. Por kushdo që sheh me vëmendje në ligjin e përsosur që jep liri, dhe vazhdon në të — pa harruar se çfarë kanë dëgjuar, por duke e zbatuar atë — ata do të bekohen në gjithçka që bëjnë.¹⁶⁹

Jezusi dhe Jakobi nuk janë thjesht duke i nxitur të krishterët për t'u përpjekur më fort ta zbatojnë atë që kanë lexuar në KQ. Ata janë duke dëshmuar se dëgjimi dhe zbatimi i fjalës janë të pandashëm; Perëndia zbulohet vetëm përmes bashkimit të tyre.

Ky ishte mësimi i të krishterit të fortë nga veriu. Kur ai kërkoi vetëm ta dëgjonte fjalën, ajo nuk do t'i "ngjiste," edhe pse ai u përpoq ta mësonte atë përmendësh. Por, kur ai e praktikoi secilin varg me fqinjën e tij pagan, fjala i "ngjiti."

Çfarë është ajo gjë që "ngjiti"? Fjalët? Kuptimi? Ndryshimi i sjelljes? Ku ngjitet kjo gjëja ngjitëse? Në kujtesën tonë? Në shpirtin tonë? Në vullnetin tonë? Si ngjitet gjëja ngjitëse tek ajo gjë ku është ngjitur? Dhe a mundet të rrijë e ngjitur, apo shpejt do të shkëputet?

Pyetje të tilla janë themelore për të kuptuarin e Biblës dhe të jetës së krishterë, dhe për arsyen se pse që të dyja në mënyrë të pashmangshme na shpien drejt të kaluarit në fshehtësi. Me qëllim që t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve, ne duhet ta kuptojmë botën dhe veten tonë dhe atë gjë me të cilën është e ngjitur bota, ose me të cilën nuk është e ngjitur dhe arsyen përse ndodh kështu.

Bota është e rënë dhe ne jemi të rënë së bashku me të. Trupat tanë janë robër të mëkatit. Mendjet tona, vullneti dhe

¹⁶⁹ Jakobi 1:23-25, NIV.

emocionet janë të errësuar, të paafta për t'i kuptuar gjërat e Perëndisë dhe për të vepruar mbi to, madje edhe të paafta për ta dëgjuar zërin e tij. Megjithatë, ngaqë Perëndia në fillim i krijoi njerëzit sipas shëmbëlltyrës së tij¹⁷⁰, dhe për shkak se ai nuk është larg prej asnjërit prej nesh, dhe ngaqë në të ne kemi jetën dhe lëvizjen e qenies tonë¹⁷¹, një vetëdijësim i saponisur se diçka brenda nesh *nuk është ashtu siç duhet* ngrihet në ne, madje edhe në mes të robërisë sonë të plotë ndaj mëkatit. Kur ky vetëdijësim pasohet prej një kërkimi për drejtësi, ose ajo që Apostulli Pal e quan një kërkim me anë të prekjes për Perëndinë¹⁷², ose ajo që Jezusi e quan një “uri dhe etje për drejtësinë,”¹⁷³ atëherë Perëndia e llogarit këtë si një kërkim të zellshëm për të, dhe ai e jep shpërblimin e tij.¹⁷⁴ Ashtu siç tha Jezusi, ai i plotëson ata.¹⁷⁵

Po, cili është shpërblimi? Me se janë mbushur ata? Përgjigjja është një ndërgjegjësim dhe bindje për mëkatin, gjë që është njëra nga dhuratat më të mëdha e më të mrekullueshme për mëkatarët, që jepet përmes Frymës së Shenjtë.¹⁷⁶ Është një dhuratë që nuk duhet përçmuar kurrë. Sepse ka vetëm dy përgjigje të mundshme ndaj ndërgjegjësimi dhe bindjes për mëkatin. Njëra është një zemër e thyer dhe një frymë e penduar. Perëndia nuk do ta përçmojë këtë dhe në fakt ai do ta pranojë atë si një flijim.¹⁷⁷ Është një veprim i pastërtisë në zemër që të biesh dakord me Perëndinë se ne meritojmë vdekjen. Për atë person që bie dakord

¹⁷⁰ Krahasoni Zanafilla 5:1-3, ku Adami dhe Eva janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, por pasardhësit e tyre janë krijuar në formën dhe shëmbëlltyrën e Adamit të rënë.

¹⁷¹ Krahaso Veprat e Apostujve 17:28.

¹⁷² Veprat e Apostujve 17:27.

¹⁷³ Mateu 5:6, NKJV.

¹⁷⁴ Krahaso Hebrejve 11:6.

¹⁷⁵ Krahaso Matteu 5:6.

¹⁷⁶ Krahaso Gjoni 16:8.

¹⁷⁷ Psalmi 51:17.

me këtë, Krishti e zbulon veten përmes fjalës së tij; ashtu siç premton ai tek Predikimi në Mal, “Të bekuar janë të pastrit në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë.”¹⁷⁸ E vetmja përgjigje tjetër e mundshme ndaj bindjes së Frymës së Shenjtë për mëkatin është vetë-mashtrimi. Kjo është ajo gjë, që Jezusi e quan ta duash e ta praktikosh gënjeshtren. Ata që bëjnë kështu, janë të përjashtuar përjetësisht nga prania e tij.¹⁷⁹

Kur ndërgjegjësimi dhe bindja për mëkatin nga ana e Frymës së Shenjtë takohen brenda nesh me një zemër të thyer e një frymë të penduar, atëherë Krishti shfaqet: ne shohim Perëndinë. Në cilën formë e shohim ne Perëndinë? Në formën e fjalës së tij, Biblës, të cilën na e zbulon Ai. Fjala, e gjallëruar prej Krishtit, futet në ne dhe mishërohet brenda nesh. Kjo është më tepër sesa, kur ne marrim një çast meditimi të thellë, ose kur jemi të gjendje ta kuptojmë ose ta mësojmë përmendësh një pjesë të Shkrimit; ashtu siç shënon Jakobi, shumë shpejt ne do t'i harrojmë ato gjëra. Kur na zbulohet fjala prej atij, në vend të thjesht leximit nga një faqe Bible duke u përpjekur për ta mësuar përmendësh, për ta studiuar ose për ta zotëruar atë, “ajo nuk do të kthehet tek unë bosh, por do ta përfundojë atë që unë dëshiroj dhe do të realizojë qëllimin për të cilin e dërgova atë.”¹⁸⁰ Fjala është agjenti shenjtërues i Perëndisë. Shenjtërimi është emri i procesit me anë të të cilit fjala e lidh veten me mendjen tonë të rënë, me vullnetin e emocionet tona. Fjala depërton në errësirën tonë me dritë, i riparon shkeljet tona, i rindërton rrënojat e lashta që dikur ishin shëmbëlltyra e Perëndisë në ne.¹⁸¹ Ky proces ndodh teksa fjala e zbuluar nga Krishti aftësohet për të banuar plotësisht me bollëk në ne.¹⁸² Siç do ta shohim pas pak, i tërë

¹⁷⁸ Mateu 5:8, NKJV.

¹⁷⁹ Krahason Zbulesa 22:15.

¹⁸⁰ Isaia 55:11, NIV.

¹⁸¹ Krahason Isaia 58:12.

¹⁸² Krahason Kolosianëve 3:16.

ky proces fillon përmes pagëzimit, dhe varet nga kujtesa jonë e rregullt e pagëzimit tonë, gjë për të cilën Efesianëve 5:26 e quan këtë “larje me ujë përmes fjalës”.¹⁸³

Më këtë sistem në mendje, ne jemi në gjendje që të kthehemi tek pyetja jonë për ngjitshmërinë.

Çfarë është ajo gjëja e ngjitshme? Është fjala e zbuluar dhe e risjellë në jetë prej Krishtit. Me çfarë objekti ngjitet ajo? Ngjitet me zemrën tonë të thyer e të penduar, që përfshin mendjen, vullnetin dhe emocionet tona. Si ngjitet ajo? Përmes pagëzimit dhe kujtimit të rregullt të pagëzimit tonë, krijohet një vend i pasur ku mund të banojë fjala. A rri e ngjitur ajo, apo shkollitet shpejt? Ajo rri e ngjitur kur, ashtu siç vëren Jakobi, ne vazhdojmë në të, duke mos e harruar fjalën që dëgjuam, por duke e zbatuar atë. Ashtu sikurse fjala depërton në errësirën përbrenda nesh me dritë, Krishti synon që ne të jemi drita e botës. Ashtu sikurse fjala i riparoi të çarat dhe i rindërtoi rrënojat e lashta përbrenda nesh, ai synon që ne të jemi riparuesit e të çarave të botës dhe rindërtuesit e rrënojave të botës. Në këtë mënyrë, njerëzit e restauruar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, të brendabanuar nga Perëndia, e plotësojnë qëllimin e tyre fillestar të ushtrimit të sundimit mbi tokë.

Kjo është arsyeja se pse Bibla dhe jeta e krishterë e dëgjimit dhe zbatimit të Fjalës në mënyrë të pashmangshme na çojnë drejt kalimit në fshehtësi. Perëndia i krijoi njerëzit për të pasur sundim jo vetëm mbi mendjen, vullnetin dhe emocionet e tyre, por edhe mbi të gjithë tokën. Ashtu sikurse Fjala e tij ngjiti vendet e thyera në ne, Ai na bën ne që t'i ngjitem vendet e thyera në botë. Ashtu sikurse i krishteri i fortë nga veriu, Krishti na dërgon ne tek fqinjët tanë paganë dhe na urdhëron të praktikojmë vargjet tona me ta. Kjo nuk është KQ. Në fakt nuk ka asnjë gjë të qetë lidhur me të. Ashtu siç u shënua të vëllimi i mëparshëm, kisha e fshehtë nuk është një kishë që rri fshehur. Është një kishë e

¹⁸³ Efesianëve 5:26, BSB.

shkëputur nga sistemet e kësaj bote, me qëllim që praktikimi nga ana e saj i vargjeve që kanë lidhje me botën, për hir të botës, të mos pengohet në asnjë mënyrë nga sistemet e botës.¹⁸⁴ Ashtu siç vihet re në kapitullin e fundit të këtij vëllimi, dhe ashtu siç u përjetua prej të krishterëve të hershëm koreanë dhe të krishterëve të çdo epoke dhe vendi, ne mundet dhe duhet të presim që praktikimi ynë të hasë përndjekje.

Ky është një mendim që të bën esëll dhe të cilin çdo i krishterë duhet ta marrë seriozisht:

Sa më tepër që ta bekojë Krishti praktikimin tonë të dëgjimit dhe zbatimit të fjalës, aq më tepër ka të ngjarë që ne do të vuajmë në mish.

Mënyra sesi na përgatit ai për këtë vuajtjen në mish është përmes procesit frymëror të vdekjes ndaj vetes.

Atëherë, cili duhet të jetë orientimi ynë frymëror, teksa e marrim në dorë Biblën?

Ne duhet ta marrim Biblën si të ishim duke mbartur kryqin.

Tek Luka 9:23, Zoti ynë urdhëron: “Kushdo që dëshiron të bëhet dishepulli im, duhet ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet përditë dhe të më ndjekë mua.”¹⁸⁵ Fjala “mohoj” këtu ka kuptimin “ta bësh hasha” vetveten, ta hedhësh poshtë vetveten, të jesh i rremë me veten tënde, të veprosch krejtësisht jo si vetja jote.¹⁸⁶

Kur e marrim Biblën, sikur ta mbartnim kryqin, leximi i Biblës bëhet si një vepër vetë-tradhtie, që na shpëton ne. Perëndia thotë përmes profetit Jeremia: “Zemra është e mashtrueshme përmbi të gjitha gjërat dhe është e pakurueshme.”¹⁸⁷ Prandaj, ne nuk e

¹⁸⁴ Krahamo E. Folei, *Mbjellja e kishës së fshehtë*. Seul: Zëri i Martirëve Kore, 2017, fq. 68-81.

¹⁸⁵ Luka 9:23, NIV.

¹⁸⁶ Bible Hub, “720. arneomai.” *Biblehub.com*. <http://biblehub.com/greek/720.htm>. Lexuar më 26 qershor 2017.

¹⁸⁷ Jeremia 17:9, NIV.

marrim Biblën për ta kuruar zemrën tonë ose për ta ngushëlluar atë. Ne e marrim Biblën që ta tradhtojmë zemrën tonë në të njëjtën mënyrë që tradhtohet i dashuri. Ne e marrim Biblën për ta tradhtuar veten tonë të rënë, ndaj së cilës jemi më besnikët. Ne ndërmarrim një veprim që është krejtësisht jo si vetja jonë: kryqëzimi. Kur e marrim në dorë Biblën, ne e mohojmë dhe e hedhim poshtë vetveten. Kush është ai që e merr Biblën? Nuk jam më unë, por Jezus Krishti që jeton në mua.¹⁸⁸

Kur merret në dorë Bibla ekziston një risk. Ashtu siç shkroi Karl Barthe: “Bibla ua jep të gjithë njerëzve në çdo epokë përgjigjet ndaj pyetjeve të tyre, siç i meritojnë. Ne gjithmonë do të gjejmë në të aq sa kërkojmë dhe aspak më tepër.”¹⁸⁹ Kjo ndodh ngaqë Perëndia i Biblës vepron sipas urdhrit të tij: “Jepuni të gjithëve që ju kërkojnë, dhe nëse dikush ta merr atë që të përket ty, mos kërko që të ta kthejë mbrapsht.”¹⁹⁰ Ai do të na e japë Biblën në cilëndo mënyrë që e marrim prej tij.

Prandaj, nuk është gjithmonë Jezus Krishti që jeton brenda nesh ai që e merr Biblën. Shpesh janë zemrat tona mashtruese që e marrin atë. Në raste të tilla ne kërkojmë në Bibël, jo një shpatë për ta vrarë mishin tonë të lënduar, por përkundrazi kërkojmë një balsam për ta lehtësuar atë. Armiku i shpirtave tanë do të sigurohet që ne ta gjejmë atë atje. Armiku e njeh Biblën më mirë se pothuajse të gjithë ne, dhe ai e di si ta përdorë Biblën për ta forcuar mishin tonë që ta largojë sa më tepër kryqin.¹⁹¹ Ai nuk kërkon që të na mashtrojë duke na tërhequr larg prej Biblës sonë, por përkundrazi, duke e larguar leximin e Biblës prej kryqit. Doktrina e shëndoshë thotë se jeta me bollëk vjen prej mbartjes së kryqit tonë teksa e ndjekim Krishtin. Por Satani i trajnon

¹⁸⁸ Krahaso Galatasve 2:20.

¹⁸⁹ K. Barth, *Fjala e Perëndisë dhe Fjala e Njeriut*. Gloucester, MA: Peter Smith Publisher, Inc., 1978, fq. 32.

¹⁹⁰ Luka 6:30 NIV.

¹⁹¹ Krahaso Luka 4:1-13.

mësuesit e Biblës që t'i mbushin veshët tanë, që na kruhen, me përrallat se Krishti na shpëton jo vetëm nga mëkatet tona, por gjithashtu edhe nga kryqi ynë.¹⁹²

Atëherë, kur mëkatuan Adami me Evën, rruga për tek pema e jetës u mbyll, për hir të njeriut;¹⁹³ përmes Biblës, ajo rrugë u hap sërish. Nëse nuk e marrim Biblën si një veprim për vetë-tradhti, do të hamë nga pema e jetës thjesht si një ëmbëlsirë ndaj vaktit tonë kryesor të kushtueshëm, duke festuar me frytin e pemës së njohjes së të mirës nga e keqja; zemrat tona mashtruese munden në këtë mënyrë të jetojnë përjetë, edhe kur jemi duke e marrë atë libër.

Kjo është arsyeja pse ka shumë rëndësi se kush jemi ne, teksa e marrim Biblën. Karl Barthe shkroi: "Pyetja 'Çfarë ka brenda Biblës?' ka një mënyrë vdekjeprurëse të konvertimit të saj për në një pyetje kundërshtuese: 'E po, çfarë jeni duke kërkuar, dhe kush jeni, ju lutem, që guxoni të shihni?'"¹⁹⁴ Ne protestantët ungjillorë jemi mësuar të mendojmë për Biblën se ajo është e arritshme në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe mjafton për shpëtimin e të gjithëve. Këto gjëra janë të vërteta, siç e konfirmon përvoja e të krishterëve më të hershëm koreanë. Atyre iu erdhi Bibla pa misionarë, ose pastorë, ose ndërtesa kishe, ose me ndonjë kurrikulum për studim Bible që e shoqëronte atë, dhe përmes vetëm atij libri ata arritën ta njihnin shpëtimtarin e shpirtrave të tyre. Është gjithashtu e vërtetë, ashtu si thotë Karl Barthe, se Fryma e Shenjtë është i hirshëm për ta pranuar futjen tonë në Bibël, në cilindo moment dhe për cilëndo arsye.¹⁹⁵

¹⁹² Krahajo 2 Timoteut 4:3-5.

¹⁹³ Krahajo Zanafilla 3:22-24.

¹⁹⁴ K. Barth, *Fjala e Perëndisë dhe Fjala e Njeriut*. Gloucester, MA: Peter Smith Publisher, Inc., 1978, fq. 32.

¹⁹⁵ K. Barth, *Fjala e Perëndisë dhe Fjala e Njeriut*. Gloucester, MA: Peter Smith Publisher, Inc., 1978, fq. 34.

Por kjo nuk do të thotë se ne mund ta lexojmë Biblën si të duam, për aq kohë sa të duam, në cilëndo gjendje shpirtërore që të na pëlqejë të jemi. Nëse bëjmë kështu, me siguri do të biem patjetër në përralla. Krishti thotë: “Prandaj, kini vëmendjen ndaj mënyrës sesi lexoni. Kushdo që ka, do t’i jepet edhe më tepër, por kushdo që nuk ka, edhe ajo që ai mendon se ka do t’i hiqet.”¹⁹⁶ Të krishterët më të hershëm koreanë nuk kontaktuan me misionarët e parë të huaj prej nevojës për dikë që t’u predikonte atyre, me shpresën se ata do të mund të arrinin ta kuptonin Biblën. Ata erdhën pikërisht, për shkak se e *kishin* kuptuar Biblën, dhe ishin duke i kushtuar vëmendje fjalës që e kishin studiuar. Ashtu siç shkroi C.S. Deming, një misionar i hershëm amerikan në Kore:

I krishteri korean është një student i Biblës. Shumica prej tyre e llogarisin jetën e tyre si rezultat jo aq shumë i predikimit, sa i studimit të Fjalës së Perëndisë. Ky është alarmi që i zgjon ata.¹⁹⁷

Për çfarë i zgjoi ata ky alarm i Biblës? Për urdhërimin e Krishtit që “të besojnë dhe të pagëzohen.”¹⁹⁸ Pasi e hasën këtë urdhërim në studimin e tyre të Biblës, ata erdhën tek misionarët për t’iu bindur atij urdhërimi. “Shumë prej këtyre [të krishterëve koreanë] janë jashtë shtetit,” - i shkroi misionari H. G. Andërvud [H. G. Underwood] kolegut të tij F. F. Ellinvud (F. F. Ellinwood) në vitin 1887, “por sapo ta [dëgjojnë] se do

¹⁹⁶ Luka 8:18, BSB.

¹⁹⁷ C.S. Deming, “I krishteri korean” (“The Korean Christian.”) Tek S.D. Oak, *Sources of Korean Christianity 1832-1945*. Seul: Instituti për Historinë e Kishës Koreane, 2004, fq. 199.

¹⁹⁸ S.D. Oak, *Krijimi i Krishterimit Korean (The Making of Korean Christianity): Takimet Protestante me Fetë Koreane (Protestant Encounters with Korean Religions) 1876-1915*. Waco, TX: Baylor University Press, fq. 229.

të ketë një mundësi për ta shpallur Krishtin dhe për t'u pagëzuar këtu në kryeqytet, ata do të vijnë.”¹⁹⁹

Ata erdhën për t'u pagëzuar jo thjesht për në një anëtarësi organizate, por përkundrazi për në vdekjen e Krishtit, me të cilën ata po identifikoheshin plotësisht nëpërmjet pagëzimit. Andërvudi shkroi:

Ata duket se e kuptojnë që [duke u pagëzuar] do ta marrin jetën e tyre në duart e veta, por ashtu siç e tha njëri prej tyre, se, nëse Perëndia i ka shpëtuar, edhe pse Mbreti i tyre do t'i vrasë ata, do të jetë gjithçka mirë, dhe një tjetër tha: “edhe sikur mbreti të ma presë kokën për bindjen ndaj Perëndisë tim, unë do të jem mirë.”²⁰⁰

Ashtu siç treguan të krishterët më të hershëm koreanë, kur e marrim Biblën pa misionarët ose pastorët, ose ndërtesat e kishave ose kurrikulumin e studimit të Biblës, nuk ka rëndësi se në cilin çast futemi tek ajo, Bibla do t'i drejtojë të gjithë studentët seriozë së pari për tek ujërat e pagëzimit.

Pagëzimi nuk është thjesht një formalitet në jetën e krishterë. Është orientimi i domosdoshëm shpirtëror për marrjen e Biblës si të ishim duke e marrë një kryq. Kjo ndodh ngaqë pikërisht në ujërat e pagëzimit ne kryqëzohemi me Krishtin. “Apo nuk e dini se të gjithë ne që u pagëzuam në Krishtin Jezus, u pagëzuam në vdekjen e tij?” - pyet Apostulli Pal.²⁰¹ Kur pagëzohemi, ne vdesim me dëshirë ndaj vetes - ndaj dëshirave tona, planeve, ëndrrave, zgjedhjeve, vetë-krijimit dhe qëllimeve tona, që vullneti i tij të bëhet në ne dhe përmes nesh. Kjo mund të mos

¹⁹⁹ S.D. Oak, *Burimet e Krishterimit Korean (Sources of Korean Christianity) 1832-1945*. Seul: Instituti për Historinë e Kishës Koreane, 2004, fq. 24.

²⁰⁰ S.D. Oak, *Burimet e Krishterimit Korean (Sources of Korean Christianity) 1832-1945*. Seul: Instituti për Historinë e Kishës Koreane, 2004, fq. 24.

²⁰¹ Romakëve 6:3, NKJV.

ndodhë përnjëherësh për ne; në shumë mënyra ne “rritemi për tek” pagëzimi ynë përgjatë gjithë jetës. Sidoqoftë, sa herë që e marrim Biblën për ta lexuar, bëjmë mirë ta sjellim ndërmend pagëzimin tonë, duke kujtuar përkushtimin që bëmë atë ditë dhe duke besuar se një nga mënyrat që Perëndia është duke i sjellë ato përkushtime përpara nesh është pikërisht përmes leximit të Biblës që do të jemi duke bërë. Vetëm kur e marrim Biblën e duke kujtuar me vetëdije pagëzimin tonë, Bibla ndodhet në duart tona të sigurta; vetëm atëherë zemrat tona mund t’i thonë Biblës gjithçka, me përjashtim të: “Sidoqoftë, jo vullneti yt, por imi u bëftë.”

Gjithashtu, ne duhet ta kryejmë me padurim pagëzimin, sepse kur dalim prej ujërave, ne marrim Frymën e Shenjtë përmes vendosjes së duarve. Vetëm Ai mund të na e hapë Biblën neve, kur e marrim ta lexojmë. Pa të, edhe ai pak të kuptuar mbi Biblën, që mendojmë se kemi, do të na hiqet tutje.²⁰²

Disa të krishterë debatojnë se Fryma e Shenjtë na është dhënë në ndonjë mënyrë tjetër, nga ajo e vënies së duarve në pagëzim, por ne duhet të kujtohem se jemi pagëzuar me Pagëzimin e Krishtit, dhe tek Marku 1:10 ne e shohim Frymën e Shenjtë që zbret mbi Krishtin, pasi ai doli prej ujërave të pagëzimit. Ka disa raste në Shkrimet e Shenjta, kur Fryma e Shenjtë shfaqet përpara pagëzimit, por këto janë cilësuar si përjashtime, dhe megjithatë, edhe në ato raste, besimtari është pagëzuar menjëherë më pas.

Disa të krishterë debatojnë se shenja kryesore e marrjes së Frymës së Shenjtë është të folurit në gjuhë, por Jezusi thotë se shenja kryesore e marrjes së Frymës së Shenjtë nuk është të folurit tonë për ndonjë gjë, por në vend të kësaj, është që Fryma e Shenjtë flet dhe ne e dëgjojmë—dhe e kuptojmë—të gjithë të vërtetën, që na është dhënë në Bibël. Kjo është arsyeja që Jezusi madje e quan Frymën e Shenjtë “Fryma i së Vërtetës” tek Gjoni 16:13. Ai thotë: “Kur të vijë ai, Fryma i së Vërtetës, do t’ju

²⁰² Krahaso Luka 8:18.

udhëzohet për tek e gjithë e vërteta.” Ai thotë tek Gjoni 14:26, se Fryma e Shenjtë “do t’ju mësojë të gjitha gjërat, dhe do t’ju kujtojë për gjithçka që unë ju kam thënë.” Prandaj, shenja se ne e kemi marrë Frymën e Shenjtë nuk është ndonjë tingull që del nga goja jonë, por në vend të kësaj është tingulli që tani ne mund ta dëgjojmë brenda frymës sonë: zëri i Birit të Perëndisë. Kështu që, Jezusi thotë tek Gjoni 5:25: “Me të vërtetë, me të vërtetë, ju them, se ora po vjen dhe madje ka ardhur, kur të vdekurit do ta dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë dhe ata që e dëgjojnë do të jetojnë.” Ajo pjesë e Shkrimit përmbushet në pagëzimin tonë.

Dhe kur përmbushet, Bibla fillon të hapet për ne. Shenja se është Fryma e Shenjtë që na e hap Biblën është se ne, ashtu si edhe dishepujt dhe Pali pasi morën Frymën e Shenjtë, do të nisim ta shohim se e tërë Bibla, që nga fillimi në fund, është për kryqëzimin e Krishtit. Kjo është arsyeja se përse thotë Pali tek 1 Korintasve 2:2: “Sepse e mblodha mendjen që të mos dija asnjë gjë, kur isha me ju, me përjashtim të Jezus Krishtit, dhe atë të kryqëzuar.” Dhe tek 1 Korintasve 1:23, ai thotë: “Ne predikojmë Krishtin e kryqëzuar.” Dhe te Galatasve 6:14, ai thotë: “Sa për mua, mos u mburrsha kurrë për asgjë, me përjashtim të mburrjes për kryqin e Zotit tonë Jezus Krisht.” Sapo Fryma e Shenjtë i hap Shkrimet e Shenjta për ju, do ta shihni Krishtin e kryqëzuar në çdo faqe e në çdo varg.

Dhe jo vetëm që do ta shihni këtë në faqet e Shkrimit; ju gjithashtu do ta shihni të shpalosur në vetë jetën tuaj, teksa Fryma e Krishtit ju thërret që ta merrni kryqin tuaj përditë në plotësim të betimit tuaj të pagëzimit për të qenë i vdekur ndaj kësaj bote. Kujtohuni: Krishti së pari u pagëzua në lumin Jordan nga Gjon Pagëzori, por pastaj ai vazhdon tek Marku 10:38-40, ku e quan kryqëzimin e tij pagëzimin e tij—dhe ai tha se ne do të bashkoheshim me të në atë pagëzim të mbartjes së kryqit tonë.

Me fjalë të tjera, simboli i pagëzimit bëhet për ne, realiteti i jetës së pagëzuar, pikërisht ashtu siç u bë për Jezusin. Kjo është

mënyra sesi ne “rritemi për në” pagëzimin tonë: sakramenti që e rrethon të gjithë jetën tonë. Ashtu siç thotë Tomas Hopko (Thomas Hopko): “E tërë jeta e krishterë është që të pagëzohesh në vdekjen e tij, të hash trupin e tij të thyer dhe të pish gjakun e tij të derdhur, dhe të kryqëzohesh me të.”²⁰³

Kjo është njëra nga arsytet se pse në kishën e hershme katekumenët (Shënim i përkthyesit: personat që bëheshin gati për pagëzimin) udhëzoheshin që ta mësonin përmendësh Kredon e Nikeas përpara pagëzimit dhe madje përpara se ata të fillonin ta mësonin përmendësh Shkrimin e Shenjtë. Ata e recitonin Kredon e mësuar përmendësh gjatë pagëzimit. Kredoja e Nikeas na mëson sesi ta identifikojmë në mënyrë të pagabueshme Perëndinë Atë, Perëndinë Bir, dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë. Ne duhet të jemi në gjendje ta identifikojmë Perëndinë Frymë e Shenjtë, sepse është Ai që do të na e mësojë Biblën si zbulesën e Perëndisë Trini. Kredoja e Nikeas është pohimi i kishës se, nëse një mësues i ndryshëm nga Fryma e Shenjtë, na drejton për të takuar në Bibël një Perëndi të ndryshëm nga ai në Kredo, atëherë ne duhet të bërtasim anathema (mallkim).

Jo vetëm që Fryma e Shenjtë na e mëson Biblën dhe na drejton atje për tek Perëndia Trini; por është vetëm përmes brendabanimit të tij që ne jemi në gjendje ta zbatojmë fjalën që ai na lejon ta dëgjojmë. Ashtu siç shkruan Alan Krieder për pagëzimin e Çiprianit, i cili u bë njëri nga etërit e mëdhenj të kishës:

“Me ndihmën e ujit të lindjes së re” [Çipriani] ka përjetuar faljen e të gjithë mëkateve të tij dhe pajtimin me Perëndinë; “me anë të veprimit të Frymës, që fryu prej së larti” ai është bërë “një njeri i ri”... Më në fund Çipriani mund të jetojë si i krishterë, thjesht dhe i kënaqur. “Ajo që më përpara më dukej e vështirë [mua], nisi të sugjerojë

²⁰³ Hopko, T. 2012. “Vdekja e Krishtit dhe Vdekja tonë në Të Pjesa 1 dhe 2,” Youtube. <https://www.youtube.com/watch?v=gyTYHnMWcbg>.

një mjet arritjeje, lidhur me atë që [unë] e kisha menduar se nuk mund të arrihet të realizohet.”²⁰⁴

Kjo është arsyeja pse Jezusi mund t'i referohet vetë-tradhtisë dhe kryqëzimit, që përjetojmë kur marrim Biblën, si një zgjedhë e lehtë dhe një barrë jo e rëndë.²⁰⁵ Përmes saj ne lirohemi prej lodhjes së madhe dhe barrës së rëndë të një zemre mashtruese.²⁰⁶ Nën pedagogjinë e Frymës së Shenjtë, Bibla është helm për mishin dhe, siç vërente ati i madh i kishës, Xhon Krisostomi (John Chrysostom), ajo është “mjekim për shpirtin.”²⁰⁷ Ajo gjë që më përpara ishte e vështirë, nis të sugjerojë një mjet për arritje; ajo për të cilën menduam se është e pamundshme tani është e mundshme të arrihet; dhe ne jemi të kënaqur.

²⁰⁴ A. Krieder, *Fermentimi i Durueshëm i Kishës së Hershme (The Patient Ferment of the Early Church.)* Grand Rapids, MI: Baker Academic, 2016, Loc. 5078.

²⁰⁵ Mateu 11:30.

²⁰⁶ Krahase Mateu 11:28.

²⁰⁷ J.A. McGuckin, *Shtegu i Krishterimit: Një mijë Vitet e Para. (The Path of Christianity: The First Thousand Years.)* Downers Grove, IL: IVP Academic Press, 2017, fq. 786-787.

Kapitulli 2.

Shikimi i Kredos së Nikeas me sytë e një foshnje

Sa herë që e hapim Biblën për të lexuar një pjesë të Shkrimit të Shenjtë, ne duhet të fillojmë duke bërë pyetjen: “Si më ndihmon mua Kredoja e Nikeas për ta parë këtu Perëndinë Trini?”

Tek Mateu 11:25, Jezusi flet për ata, të cilëve iu është zbuluar Ati dhe Biri. Ai e lavdëron Atin, duke thënë: “ti ua ke fshehur këto gjëra të urtëve dhe të mësuarve, dhe ua ke zbuluar ato fëmijëve të vegjël.”²⁰⁸

Përfytyroni një person të urtë e që ka mësuar, të futet në një dhomë, ose në një metro, në një rrugë ose në një shtëpi. Çfarë do të bëjë ai njeri i urtë dhe i mësuar? Në mënyrë instiktive ai do t'i hedhë një sy të gjithë hapësirës dhe do të përpiqet të marrë një ndjesi lidhur me kush është i pranishëm, çfarë po ndodh dhe në u dashtë puna, çfarë do të bëjnë ata për t'u përgjigjur.

Tani, përfytyroni një foshnje të futet në të njëjtën hapësirë. Çfarë do të bëjë foshnja? Në mënyrë instiktive, foshnja do të kërkojë vetëm për fytyrën e prindit. Deri sa foshnja ta gjejë prindin dhe të jetë në krahët e prindit, dhoma mbetet e mjegullt dhe një mister jo interesant. Misteri i foshnjës gjithmonë është: Ku është prindi im? Deri sa të zgjidhet ai mister, nuk vëren asgjë në dhomë dhe nuk merret me ndonjë gjë tjetër atje.

²⁰⁸ Mateu 11:25, NIV.

Kapitulli 2. Shikimi i Kredos së Nikeas me sytë e një foshnje

Në të njëjtën mënyrë, sa herë që e marrim Biblën për të lexuar një pjesë të Shkrimit të Shenjtë, madje edhe që në leximin e parë fare, ne duhet ta shohim atë me zemrën dhe me sytë e një foshnjeje. Ne duhet të pyesim: “Ku është prindi im, Perëndia Trini?” Fjalët dhe e tërë pjesa e Shkrimit duhet të mbeten të mjegullt për ne, ndërkohë që e kërkojmë me urgjencë Perëndinë Atë, Perëndinë Bir dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë atje brenda. Ne nuk duhet të ndalemi për asnjë çast tek asnjë fjalë tjetër, ose asnjë pyetje apo meditim i thellë, ose ndonjë e vërtetë teologjike për një pjesë të Shkrimit. Përndryshe, Perëndia Trini do të jetë i mjegullt për ne në Shkrimin e Shenjtë, ndërkohë që pjesa tjetër e Shkrimit do ta urdhërojë fokusin tonë. Gjithmonë, ne duhet ta gjejmë atë që në fillim fare. Shkrimi i Shenjtë nuk do ta kryejë qëllimin e tij në ne, deri sa ne të prehem në krahët e tij brenda Shkrimit.

Ky është qëllimi i Kredos së Nikeas për ata që jetojnë në kishën e fshehtë. Ai u jep jetëve tona një vëmendje të palëkundur, jokompromentuese, ndaj të vetmit Perëndi të vërtetë.

Kur e lexojmë me kujdes Kredon e Nikeas, ne shohim se ajo nuk është puna e një të urti ose të mësuar, por e foshnjeje, për foshnjët. Kjo është një perspektivë ndryshe nga ajo që mund të kemi qenë mësuar më përpara, sesi ta konsideronim Kredon e Nikeas. Kredoja e Nikeas shpesh konsiderohet gabimisht si një vepër e një teologjie të thellë, një ndërfitje e filozofisë greke për në bukurinë e thjeshtë të Shkrimit të Shenjtë. Por kjo thjesht nuk është e vërtetë.

Në fakt, Kredoja e Nikeas u formulua që përpara sesa kisha e hershme (ende në stadin e fëmijërisë) të finalizonte listën e librave që përbëjnë Dhiatën e Re.²⁰⁹ Kisha e hershme e formuloi Kredon si një përkushtim që gjithmonë ta lexonin Biblën në një mënyrë të caktuar: I dominuar prej plotësisë së Perëndisë Trini, me gjithçka tjetër si një sfond i mjegullt. Kredoja e Nikeas është britma e gëzueshme e kishës foshnje: Ja ku është Perëndia Trini — e kemi parë! Mos na u heqtë nga sytë asnjë pjesë e tij, as

²⁰⁹ Krahajo <http://www.scborromeo.org/papers/nicenecreed.pdf>.

për një çast të vetëm, ose as edhe një varg i vetëm! Të krishterëve të hershëm u kërkohet që të mësonin përmendësh dhe ta kuptonin plotësisht secilën thënie të kredos, madje që përpara sesa të pagëzoheshin dhe të pranoheshin plotësisht në adhurim në kishë.²¹⁰ Vetëm në këtë mënyrë, kisha foshnje do të mund të sigurohej se një besimtar foshnje—dhe besimi i krishterë foshnje—do të mbeteshin foshnje dhe nuk do të binin robër të të urtëve e të mësuarve, dhe ndaj të gjitha gjërave që i mbajnë robër të urtit dhe të mësuarit.

Kredoja e Nikeas na i tregon të gjitha gjërat lidhur me natyrën, karakterin dhe veprimtarinë e Perëndisë, që janë të domosdoshme e të mjaftueshme për ta identifikuar atë në Bibël dhe në botën përreth nesh. Secila thënie e Kredos është një deklaratë që është e vërtetë vetëm për Perëndinë dhe gjithmonë e vërtetë për Perëndinë. Madje edhe deklaratat në Kredon e Nikeas që janë për pagëzimin, kishën, gjykimin final, dhe botën që do të vijë, janë në fund të fundit për Perëndinë Trini; ato e marrin kuptimin e tyre të duhur vetëm në lidhje me të. Për shkak se Perëndia Trini nuk ndryshon kurrë, që të gjitha deklaratat të Kredoja janë gjithnjë të vërteta për Perëndinë në çdo pjesë të Shkrimit të Shenjtë dhe në çdo moment në histori e në përjetësi, përfshirë edhe këtë.

Ja ku është ajo që gjithnjë ka qenë më e rëndësishmja: Kredoja e Nikeas është ajo që na i hap sytë mjaftueshëm për të parë plotësinë e Perëndisë Trini në secilin pasazh të Shkrimit të Shenjtë dhe në vetë jetët tona.

Konsideroni një shembull nga Mateu 8:23-27.

Pastaj [Jezusi] u fut në barkë dhe dishepujt e tij shkuan pas tij. Befas një stuhi e fortë ra mbi liqen, saqë dallgët e

²¹⁰ E. Ferguson. "Catechesis, Catechumenate." Tek *Enciklopedia e Krishterimit të Hershëm, botimi i 2-të*, Nju Jork: (In *The Encyclopedia of Early Christianity*, 2d ed. New York:) Routledge, 1999, fq. 224.

Kapitulli 2. Shikimi i Kredos së Nikeas me sytë e një foshnje

përmbytën barkën. Por Jezusi po flinte. Dishepujt shkuan dhe e zgjuan duke i thënë: “Zot, shpëtona! Do të mbytemi!”

Ai u përgjigj: “O besimpakë, pse kemi kaq frikë?? Pastaj ai u ngrit, i qortoi erën dhe dallgët dhe gjithçka u qetësua.

Burrat u mrekulluan dhe pyetën: “Ç’lloj njeriu është ky? Edhe era dhe dallgët i binden atij!”²¹¹

Po ta lexonim këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë si njerëz të urtë e të mësuar, do të tërhiqeshim për ta shqyrtuar përvojën e dishepujve, ngaqë edhe neve, gjithashtu, jemi dishepuj të Jezusit. Ne mund të mendojmë lidhur me, nëse do të përgjigjeshim në të njëjtën mënyrë siç bënë ata. Ne mund të mendojmë për situata në jetët tona, kur kemi përjetuar stuhi e dallgë metaforike dhe kemi pyetur veten, nëse Jezusi ishte i pranishëm. Ne mund të pyesim veten se përse Jezusi po flinte, dhe sesi ishte e mundur që ai të flinte përmes një stuhie në det (sidomos, kur dishepujt e tij po punonin kaq fort përreth tij). Ne mund të vendosim, se qëllimi i këtij pasazhi në Shkrimin e Shenjtë është që të na mësojë lidhur me besimin dhe që të na sfidojë që të kemi më tepër besim. Ndoshta mund ta kemi vështirë ta kuptojmë këtë lloj mrekullie natyrore lidhur me faktin, nëse vërtet ndodhi një ngjarje e tillë, ngaqë jemi kaq të urtë e të mësuar, dhe ngaqë kurrë nuk i kemi parë erën e dallgët të qetësohen në këtë mënyrë.

Kurse, po ta lexojmë këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë me sytë tanë foshnjorë, të trajnuar prej Kredos së Nikeas, ne do ta lexonim atë krejtësisht ndryshe. Do të fillonim duke kërkuar me urgjencë te ky Shkrim për Perëndinë Trini, siç përshkruhet në Kredo. Vëmendja jonë së pari duhet të shkojë tek fjalët në këtë pjesë të Shkrimit që i kemi mësuar përmendësh nga Kredoja: *Jezus. Zot. Shpëto. Njeriu*. Këtu janë edhe ato fjalët e tjera si *stuhia, era, dhe valët* që na kujtojnë për qiellin, tokën dhe Krijuesin e tyre, të cilat gjithashtu përmenden në Kredo.

²¹¹ Mateu 8:23-27, NIV.

Prandaj, kur dishepujt pyesin: “Ç’lloj njeriu është ky?”, ne jemi tashmë gati për t’u dhënë përgjigje, madje pa e lexuar ende pjesën tjetër të pasazhit.

Kredoja e Nikeas thotë se Perëndia Atë është “krijuesi i qiellit dhe i tokës, i gjithçkaje që shihet dhe që nuk shihet.” Për shkak se ai është krijuesi i erës dhe i dallgëve, ai është personi i vetëm të cilit ato i binden. Por Kredoja e Nikeas na kujton se Krishti është “Perëndi prej Perëndisë, dritë prej dritës, Perëndi i vërtetë prej Perëndisë së vërtetë.” Era dhe dallgët që shfaqen në këtë pasazh të Shkrimit të Shenjtë e dinë këtë, gjithashtu, dhe për këtë arsye ato i binden atij. Ato e dinë se çfarë na mëson kredoja: Biri nuk është më pak se Ati ose më i ulët në pozitë nga ai; ai është saktësisht shëmbëlltyra e tij e dukshme. Kredoja na thotë: “Për ne dhe për shpëtimin tonë, ai zbriti nga qielli. Prej fuqisë së Frymës së Shenjtë, ai u lind nga e virgjëra Mari dhe u bë njeri.” Ç’lloj njeriu është ky? Ai është Perëndia Bir, që është plotësisht Perëndi. Biri erdhi për të na shpëtuar ne. Ai mund të na shpëtojë, për shkak se është Perëndi. I tërë krijimi jep dëshmi për këtë dhe i nënshtrohet atij.

Përmes Kredos së Nikeas, ne, si foshnja, jemi futur tek pasazhi i Shkrimit dhe së pari, me urgjencë të madhe, e gjetëm prindin tonë, Perëndinë Trini. Pasi e gjetëm atë në plotësinë e tij, ne mund të vazhdojmë të kërkojmë në pjesën tjetër të këtij Shkrimi të Shenjtë duke përdorur pyetjet e detajuara në kapitujt që pasojnë në këtë libër. Përmes Frymës së Shenjtë, ai pastaj do të na drejtojë që ta dëgjojmë fjalën, në atë mënyrë që ai do që ne ta dëgjojmë atë dhe për ta zbatuar atë, në atë mënyrë që ai synon: Të përqafuar prej tij, me fuqinë e tij që derdhet përmes nesh.

Kapitulli 3.

Konteksti

Pasi e identifikojmë Perëndinë Trini në një pjesë të Shkrimit të Shenjtë, ne pastaj duhet të pyesim: “Cili është konteksti i këtij pasazhi?”

Shumica prej nesh bien dakord se që ta kuptojmë pasazhin e një Shkrimi të Shenjtë, ne duhet ta kuptojmë kontekstin e tij. Në fakt, kjo është arsyeja se pse shumë njerëz nuk e lexojnë Biblën shumë, ose nuk futen shumë thellë vetë në të: Ata mendojnë se nuk mundën dot ta kuptojnë plotësisht ose saktësisht atë, po që se konteksti nuk iu është shpjeguar së pari atyre prej një profesionisti, si një pastor, ose prej shënimeve të studimit të Biblës, apo komentareve e librave të shkruar prej teologëve.

Pastorët dhe teologët e përforcojnë këtë ide duke i mbushur predikimet dhe librat e tyre me informacion për Shkrimin e Shenjtë, që gjendet vetëm jashtë Shkrimit të Shenjtë: meditime të thella mbi kulturën, informacion për historinë, komentar teologjik, dhe studime mbi fjalën. Mesazhi i pathënë është i qartë: Konteksti është i domosdoshëm për leximin si duhet të Shkrimit të Shenjtë, dhe konteksti është sfera e profesionistëve.

Për shembull, ndërkohë që po e shkruaja këtë kapitull, dëgjova nga një motër në shërbesën tonë sesi ajo ka themeluar një takim të përjavshëm të nënave në lagjen e saj për ta lexuar Biblën, sipas metodës së përshkruar në këtë libër. “Me përjashtimin që ne nuk merremi me pyetjen e kontekstit,” shtoi ajo. Ajo nuk kishte nevojë të shpjegonte pse-në. Për të thjesht ishte e dukshme: Ajo dhe nënat e tjera nuk janë pastorë ose dijetarë të Biblës; prandaj, ato

nuk kanë mjaftueshëm njohuri për ta dhënë kontekstin e duhur të pasazheve të Shkrimit që lexojnë çdo javë në studimin e tyre.

Por ka edhe një kontekst tjetër të Biblës, që është në dispozicion të kujtudoje. Ai është lloji më i rëndësishëm i kontekstit nga të gjithë. Ky lloj konteksti nuk kërkon asnjë trajnim profesional ose përgatitje teologjike për t’u zbuluar. Në fakt, profesionistët ka më shpesh të ngjarë ta anashkalojnë ose ta neglizhojnë këtë lloj konteksti, për shkak se ai duket kaq i thjeshtë fare, bazik.

Lloji i kontekstit që lavdërohet këtu është thjesht një *vëmendje më e thellë ndaj të gjithë informacionit për një pasazh që vjen drejtpërdrejt nga vetë Shkrimi*.

Me anë të një “vëmendjeje të thellë,”unë nuk jam duke iu referuar ndonjë gjëje misterioze ose të mbinatyrshme. Unë i referohem praktikës së bërjes në mënyrë të vetëdijshme të të gjitha pyetjeve të mëposhtme, dhe përgjigjes ndaj tyre sa më thjesht dhe drejtpërdrejt që të jetë e mundur, sa herë që lexohet një pjesë e Shkrimit:

- Kush po flet?
- Kujt po i drejtohet?
- Ku ndodhen ata teksa po flasin, dhe pse janë atje ata?
- Përse po flasin, sipas Shkrimit (d.m.th. Cila është çështja që po prezantojnë?)
- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me atë që ndodhet direkt përpara saj?
- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me atë që vjen direkt pas saj?
- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me pjesët e tjera të Shkrimit në Bibël? A ka pjesë të tjera të Shkrimit që:
 - përdorin fjalë të njëjta ose të ngjashme?
 - përfshijnë të njëjtit njerëz, vend ose kohë?
 - i referohen këtij pasazhi të Shkrimit, ose që ky shkrim iu referohet atyre?

Secila pyetje që jepet këtu, me përjashtim të kësaj të fundit, mund ta marrë përgjigjen nga dikush që e hap Biblën për herë të parë. Pyetja e fundit e merr përgjigjen gradualisht, sa më tepër që të lexojmë, madje edhe kur lexojmë pa ndonjë ndihmë të jashtme ose pa ndonjë drejtues.

Megjithatë është për t'u habitur, sesa rrallë bëhen këto pyetje. Një arsye është se shumë prej nesh e marrim ta lexojmë Biblën, ngaqë po kërkojmë një fjalë të drejtpërdrejtë nga Perëndia për t'iu drejtuar situatës sonë të tanishme. Ndoshta forma më ekstreme e kësaj janë njerëzit që e hapin Biblën në një faqe të rastësishme, venë gishtin rastësisht diku, e lexojnë pikërisht atë varg ku shkoi gishti, dhe e marrin atë varg si drejtimin e Perëndisë.

Por ne duhet të kujtohem se qëllimi kryesor i Shkrimit të Shenjtë nuk është që të na udhëzojë ne, por që ta zbulojë karakterin e Perëndisë. Për ta thënë pak më ndryshe, Perëndia nuk e krijoi Biblën si një mënyrë për të na pasuar neve shënime në mënyrë të mbinatyrshme për të na treguar se ç'të bëjmë. Ashtu siç e thotë autori i letrës drejtuar Hebrenjve:

Në të kaluarën Perëndia u foli paraardhësve tanë përmes profetëve në shumë kohëra e në mënyra të ndryshme, kurse në këto ditët e fundit, ai na ka folur neve përmes Birit të tij.²¹²

Kjo është arsyeja se pse Krishti iu tregon dishepujve se ai është rruga, e jo se ai e *tregon* rrugën.²¹³ Kur e lexojmë Biblën për ta gjetur fjalën e drejtpërdrejtë të Perëndisë për ne në situatën tonë të tanishme, ne aktualisht jemi duke mos e përfillur dhe anashkaluar vetë-zbulesën e Perëndisë, gjë që është i tërë kuptimi dhe qëllimi i Shkrimit të Shenjtë. Nuk ka ndonjë mënyrë që të mos e përfillim e ta anashkalojmë vetë-zbulesën e Perëndisë dhe prapëseprapë të marrim udhëzimin e tij për situatën tonë të tanishme.

²¹² Hebrenjve 1:1-2a, NIV.

²¹³ Krahazo Gjoni 14:5-6.

Kjo ndodh ngaqë vetë-zbulesa e Perëndisë është udhëzimi i tij: Teksa Ai na e zbulon karakterin e tij në Shkrimin e Shenjtë, ne arrijmë ta njohim atë. Ndërkohë që e njohim atë, më vonë ne do të jemi në gjendje ta identifikojmë praninë e tij dhe punën e tij në jetët tona dhe në botën përreth nesh, dhe pastaj ne do ta dimë si të veprojmë, në mënyrë që t'i nënshtrohemi Atij dhe të përparojmë në atë që Ai po bën. Të kuptuarit e kontekstit në Shkrimin e Shenjtë është preludi i të kuptuarit të jetës sonë si konteksti për punën e Perëndisë. Konteksti për punën e Perëndisë ndryshon përmes vendeve, shekujve dhe kulturave, por karakteri i tij mbetet i njëjtë. Veprimtaria e tij në cilindo kontekst është e identifikueshme, me kusht që ne të mësojmë ta njohim atë në sa më shumë kontekste të ndryshme që të jetë e mundur. Shkrimi i Shenjtë është vendi ku mësojmë ta bëjmë një gjë të tillë.

Prandaj, kur vjen puna tek Bibla, jeta në kishën e fshehtë është një proces me tre hapa, jo një proces me dy hapa: Ja ku jepet një proces i paplotë e me gabime me dy hapa:

Ne lexojmë një pjesë të Shkrimit të Shenjtë → Ajo pjesë e Shkrimit zbulon praninë e Perëndisë dhe drejtimin në situatën tonë aktuale

Ja ku është procesi i saktë, i plotë, me tre hapa:

Ne lexojmë një pjesë të Shkrimit të Shenjtë → Ajo pjesë e Shkrimit zbulon karakterin e Perëndisë → Ngaqë karakteri i Perëndisë nuk ndryshon, ne jemi gjithnjë e më tepër në gjendje ta njohim praninë e Perëndisë dhe drejtimin në situatën tonë të tanishme.

Kur e lexojmë Biblën sipas këtij procesi me tre hapa, mund ta shohim se pse është kaq thelbësor konteksti: Ne nuk mundemi ta kuptojmë dot plotësisht karakterin e Perëndisë ose veprimet

e tij në ndonjë pjesë të Shkrimit pa atë (kontekstin). Në fakt, roli i kontekstit nuk është që të na japë informacion mbi sfondin historik ose kulturor lidhur me atë pjesë të Shkrimit që po e lexojmë. Por roli i tij është që të na japë neve një pamje panoramike sa më të madhe të karakterit të Perëndisë në pjesën e Shkrimit që po e lexojmë.

Merrni në konsideratë një shembull të thjeshtë: Jezusi që po i dërgon të dymbëdhjetë dishepujt tek Mateu 10:1-4:

Jezusi i thirri të dymbëdhjetë dishepujt e tij dhe iu dha atyre autoritet për t'i përzënë frymërat e ndyra dhe për ta shëruar çdo lëngatë e sëmundje.

Këta janë emrat e të dymbëdhjetë apostujve: Së pari, Simoni (që quhet Pjetër) dhe vëllai i tij Andrea; Jakobi i biri i Zebedeut, dhe vëllai i tij, Gjoni; Filipi dhe Bartolomeu; Tomasi dhe Mateu, tagrambledhësi; Jakobi, i biri i Alfeut, dhe Tadeu; Simoni Zelotas dhe Juda Iskarioti, që e tradhtoi atë.²¹⁴

Duke përdorur listën e pyetjeve mbi kontekstin që u dha më lart, ne mund ta shohim se disa janë shumë të thjeshta për t'iu përgjigjur:

- Kush po flet? Jezusi.
- Kujt po i drejtohet? Të dymbëdhjetë dishepujve.

Por shumë shpejt, edhe pyetjet e thjeshta bëhen sfiduese:

- Ku janë duke ndenjur teksa po flasin?

Këtu, Mateu nuk jep një përgjigje të saktë. Po t'i lexojmë vargjet më sipër e më poshtë këtij pasazhi nga shkrimi (që janë

²¹⁴ Mateu 10:1-4, NIV.

dy nga pyetjet e kontekstit, gjithashtu të shënuara tek lista), ne mund të shohim tek Mateu 9:35-36 dhe Mateu 11:1 disa detaje lidhur me vendndodhjen e Jezusit:

Jezusi kaloi nëpër të gjithë qytetet dhe fshatrat, duke i mësuar në sinagogat e tyre, duke shpallur lajmin e mirë të mbretërisë dhe duke shëruar çdo lëngatë e sëmundje. Kur i pa turmat, ai pati mëshirë për ta, ngaqë ishin të lodhur dhe të pafuqishëm, si delet pa bari.²¹⁵

...

Pasi Jezusi mbaroi së mësuarit të dymbëdhjetë dishepujt e tij, ai iku prej atje për të mësuar e për të predikuar në qytetet e Galileës.²¹⁶

Pyetja e fundit mbi kontekstin (tek e cila do të kthehemi më vonë në këtë kapitull) është lidhur me, nëse ka pjesë të tjera të Shkrimit që janë të lidhura me këtë pasazh. Marku 3:13-19 dhe Luka 6:12-16 gjithashtu regjistrojnë dërgimin e të dymbëdhjetëve nga Jezusi. Marku 3:13 jep një vendndodhje specifike: “Jezusi u ngjiti në një anë mali dhe i thirri tek vetja ata që deshë, dhe ata erdhën tek ai.”²¹⁷ Luka 6:12-13 shton ca detaje më tepër, duke specifikuar në cilën pjesë të ditës:

Në njërën nga ato ditë, Jezusi shkoi të lutej në një faqe mali, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë. Kur erdhi mëngjesi, ai i thirri dishepujt e tij të vinin tek ai dhe zgjodhi dymbëdhjetë prej tyre, të cilët gjithashtu i caktoi si apostuj.

Megjithatë, një pjesë e të kuptuarit të kontekstit të Shkrimit është të vëresh atë që nuk e thotë shkrimtari. Në këtë rast,

²¹⁵ Gjoni 9:35-36, NIV.

²¹⁶ Mateu 11:1, NIV.

²¹⁷ Marku 3:13, NIV.

Mateu nuk e përmend vendin. Ne nuk duhet të presupozojmë se kjo ndodh ngaqë Mateu e anashkalon këtë detaj, ose nuk bie dakord me Markun ose Lukën në lidhje me të. Në vend të kësaj, ne duhet ta pranojmë se Mateu mund të jetë duke theksuar diçka tjetër këtu, në lidhje me karakterin e Perëndisë, krahasuar me atë që theksohet tek Marku ose tek Luka. Ne mund ta kuptojmë këtë theksim, duke iu përgjigjur pyetjeve të tjera të kontekstit:

- Përse po flasin, sipas Shkrimit (d.m.th. Cila është çështja që po prezantojnë?)
- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me atë që ndodhet direkt përpara saj?
- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me atë që vjen direkt pas saj?

Po ta lexonim vetëm Mateu 10:1-4, çështja që prezantohet lidhur me Jezusin që i dërgon të dymbëdhjetët nuk është e qartë. Por po ta lexojmë fillimin te Mateu 9, nis të dalë në pah pamja. Menjëherë përpara kësaj pjese të Shkrimit këtë javë, Jezusi po jep mësim në një sinagogë. Drejtuesit fetarë e panë atë t’ia forconte këmbët një burri të paralizuar, ta ngrinte një vajzë prej së vdekurish, t’i kthente shikimin dy të verbërve, dhe madje ta shëronte një burrë të idemonizuar. E megjithatë, ata pëshpërisnin ende mes tyre: “Ai e bën këtë përmes djallit.”²¹⁸

Drejtuesit fetarë, që Zoti i kishte ngarkuar për ta drejtuar popullin tek Perëndia, nuk mundnin dot ta njihnin Perëndinë—edhe kur ai po u rrinte përballë tyre në formë njerëzore. Ata madje thanë se ai ishte në të njëjtën ligë me Satanin.

E megjithatë, kudo ku shkonte Jezusi, e ndiqnin njerëzit e Perëndisë.

²¹⁸ Krahazo Mateu 9:34.

Kur Jezusi i pa këta njerëz, ai “u mbush me dhembshuri”, ngaqë ata ishin “të lodhur dhe të shpërndarë.”²¹⁹ Është pikërisht për shkak të karakterit të tij—në mënyrë specifike, prej dhembshurisë dhe shqetësimit të tij për lodhjen dhe shpërndarjen e deleve të tij të dashura—që ai dëshiron t’i dërgojë të dymbëdhjetë nën-barinjtë e tij më të trajnuar.

Mateu na ndihmon ta shohim se “dërgimi i të dymbëdhjetëve” nuk ishte një rast formal, pa afat, ashtu siç mund të portretizohet prej fuqës mjeshtërore të një piktori. Ishte një ngjarje e nxitur prej një dhimbjeje të thellë, thumbuese, që ndjeu Krishti kur i pa delet e tij të humbura. Me të vërtetë, ky ishte më tepër një çast pikëllues në shkretëtirë, sesa një ceremoni diplomimi në majën e një mali. Jezusi u dha atyre udhëzime të shpejta: “Shëroni të sëmurët, ngrini nga varri të vdekurit, pastrojini lebrozët, dhe përzini demonët.”²²⁰ Me fjalë të tjera, bëni gjithçka që është e nevojshme për këto dele.

Një pyetje përfundimtare mbi kontekstin do ta nxjerrë në pah këtë aspekt të karakterit të Perëndisë për të kuptuarin tonë:

- Si lidhet kjo pjesë e Shkrimit me pjesët e tjera të Shkrimit në Bibël? A ka pjesë të tjera të Shkrimit që:
 - përdorin fjalë të njëjta ose të ngjashme?
 - përfshijnë të njëjtit njerëz, vend ose kohë?
 - i referohen këtij pasazhi të Shkrimit, ose që ky Shkrim iu referohet atyre?

Në këtë pasazh, shprehja që dalëngadalë do ta kapë vëmendjen tonë, teksa lexojmë gjithnjë e më tepër nga Shkrimi është “dele pa bari.” Është një shprehje që shkon deri tutje nga fillimi i Biblës, tek Numrat 27:15-17:

²¹⁹ Mateu 9:36, NKJV.

²²⁰ Mateu 10:8, NKJV.

Moisiu i tha Zotit: “Le të caktojë Zoti, Perëndia që u jep frymë të gjitha gjërave, dikë mbi këtë bashkësi, që të dalë e të hyjë përpara tyre, dikë që do t'i nxjerrë ata përjashta e do t'i kthejë përsëri, që populli i Zotit të mos jenë si delet pa bari.”²²¹

Ajo që sheh Jezusi, kur hedh sytë mbi popullin e Perëndisë, është saktësisht ajo gjë që i trembej Moisiu: dele pa bari.

Ndërsa reflektojmë mbi kontekstin e gjerë të Ungjillit të Mateut, në tërësi, ne mund të kujtohem se Mateu, tek Mateu 2:6, na ka përgatitur tashmë ta dallojmë që Jezusi ishte dërguar prej Perëndisë për të qenë pikërisht bariu që i mungonte popullit të tij, ai për të cilin ishte lutur Moisiu:

Dhe ti, O Betlehem, në tokën e Judesë, nuk je më i vogli nga qytetet sundimtare të Judës, sepse prej teje do të dalë një sundimtar, që do të jetë bariu i popullit tim Izraelit.²²²

Dhe teksa mendojmë për kontekstin më të gjerë të Biblës në tërësi, ne mund të arrijmë ta shohim se Mateu është duke cituar Mikea 5:2, në të cilin ne mësojmë se bariu që do të vijë është I Përrjetshmi, vetë Perëndia:

Por sa për ty, Betlehem Efratah, që je tepër i vogël për të qenë mes klaneve të Judës, Prej teje do të dalë për Mua, Një që do të jetë sundues në Izrael. Fillimet e tij janë prej kohëve të lashta, që nga ditët e përjetësisë.²²³

Këto rezonanca më të thella në Shkrimin e Shenjtë mund të mos na shfaqen me leximin tonë të parë. Por është në natyrën

²²¹ Numrat 27:15-17, NIV.

²²² Mateu 2:6, NIV.

²²³ Mikea 5:2, NIV.

Kisha e fshehtë

e Frymës së Shenjtë dhe për kënaqësinë e tij që të na i sjellë ato ndërmend gjithnjë e më shumë, sa më tepër ta ngopim mendjen tonë me Shkrimin e Shenjtë, dhe sa më tepër të përqendrohemi mbi karakterin e Perëndisë sa herë që e hapim një pjesë nga Shkrimi i Shenjtë duke kërkuar të kuptojmë karakterin e tij në kontekst.

Kapitulli 4.

Veprimet e Perëndisë

Përpara se të pyesim: Çfarë më urdhëron Perëndia që të bëj në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë?” ne duhet të meditojmë mbi pyetjen: “Çfarë është duke bërë Perëndia Trini në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë?”

I tërë veprimi njerëzor është një përgjigje ndaj veprimtarisë së Perëndisë Trini: Ky është kushti paraprak themelor i hirit. E thënë ndryshe, asnjë gjë që bëjmë ne nuk e nxit Perëndinë të veprojë; përkundrazi, është veprimi i Perëndisë ai që gjithmonë na nxit neve. Ne jemi krijesa të afta për t’iu përgjigjur nismës së Perëndisë, asnjë gjë më tepër. Dhe megjithatë, duke parë gjatësinë, gjerësinë, lartësinë dhe thellësinë e asaj nisme, asnjë qenie njerëzore nuk e ka gërvishtur akoma sipërfaqen e asaj që janë në gjendje të bëjnë qeniet njerëzore, si përgjigje e këtij hirit kaq jashtëzakonisht të madh.

Kjo është një e vërtetë të cilën ne të krishterët e besojmë nga ana teologjike, por e injorojmë nga ana praktike. Lutjet tona dhe adhurimi ynë japin ndjesinë sikur jemi ne ata që fillojmë një bisedë disi të kufizuar me Perëndinë Trini për nevojat dhe interesat tona, në vend që ne të jemi duke e pranuar me vëmendje dhe t’i përgjigjemi veprimit të tij të pakufishëm, të pandërprerë dhe të pafund, që Ai e bën nga ana jonë.

I njëjti orientim e karakterizon leximin tonë të Biblës. Me vetëdije ose jo, interesi ynë i pangopur për veten tonë depërton në çdo pasazh të Biblës. Ne tërhiqemi në mënyrë të pashmangshme

ndaj atyre vargjeve të Biblës, që na tregojnë se çfarë gjëje duhet të bëjmë dhe se çfarë do të marrim, kur ta bëjmë atë gjë. Kjo prirje është kaq e theksuar, saqë sa herë që ne e hapim Biblën, shohim urdhërime të nënkuptuara dhe premtime të ngjeshura cep më cep; ne i mbitheksojmë dhe i fryjmë tej mase urdhërimet dhe premtimet që janë realisht të pranishme; dhe në super-vëmendjen tonë ndaj gjithçkaje lidhur me veten tonë, i bëjmë aq të vogla veprimet e Perëndisë Trini, të cilat i nxisin pjesën tjetër të qiellit e tokës, së pari të rrinë në një heshtje të ngrirë e më pas të shpërthejnë në lavdërim.

Tek Hyrja ime e *Përgatitja për Kishën e Fshehtë*, unë shkrova: “Kisha e fshehtë është struktura e paprishshme e punës së Krishtit që del në dukje kur kisha publike nuk mundet dot më ta mbajë veten, ose për shkak të ndonjë sulmi shkatërrues, ose për shkak të përmbysjes nga përbrenda.”²²⁴ Unë dyshoj se kjo është arsyeja se pse të krishterët e fshehtë janë, nga përvoja ime, më pak të dashuruar e të magjepsur prej pushtetit dhe potencialit të veprimitarisë njerëzore, qoftë e tyrja ose e dikujt tjetër, dhe për këtë arsye janë më të prirur të ndalen tek veprimet e Perëndisë, kur lexojnë Shkrimin e Shenjtë. Të krishterët e fshehtë e kanë parë kapacitetin e plotë të mundësisë njerëzore, edhe atë të miqve të Perëndisë, edhe të armiqve të Perëndisë, dhe ata kanë gjetur se këto veprime kanë mangësi. Shpesh i kujtoj fjalët e të krishterit të parë nga Koreja e Veriut, që takova, që më tha: “Ne të krishterët e Koresë së Veriut nuk kemi as para, as pushtet. Ne kemi vetëm Krishtin. Dhe kemi zbuluar se Ai mjafton.”

Në Shkrimin e Shenjtë, veprimet e Perëndisë Trini janë jo vetëm të mjaftueshme për të na shpëtuar ne; ato janë të mjaftueshme për ta gjallëruar botën. Prandaj, çfarëdolloj konsiderate që ne u japim veprimeve të Perëndisë Trini, kur e lexojmë Shkrimin e Shenjtë, nuk është e mjaftueshme. Kjo do të thotë se ne mund të

²²⁴ E. Folei, “Hyrja” Tek *“Përgatitja për Kishën e Fshehtë”* nga R. Vurmbrand. Seul: Zëri i Martirëve, 2017, fq. 55.

meditojmë me dobi mbi veprimet e Perëndisë Trini, për atë kohë sa të mundim ta mbajmë vëmendjen e përqendruar. Pastaj, kur të jemi në gjendje për vëmendje më të zgjeruar, mund të meditojmë me dobi mbi veprimet e Perëndisë edhe më tepër. Edhe shprehja më e thjeshtë — “Perëndia tha,” ose “Jezusi e dinte,” ose “Fryma u ndal përmbi” — përmban një botë të tërë kuptimi më të thellë nga sa ne mund ta përshkojmë ndonjëherë plotësisht. Ne nuk duhet ta anashkalojmë kurrë një folje për veprimin hyjnor pa përjetuar një ndjenjë të madhe habie.

Dhe kjo është saktësisht detyra thellësisht e thjeshtë por thellësisht shpërblyese, që ne e ndërmarrim te ky hap i leximit të Biblës: Në pasazhin e Shkrimit që jemi duke lexuar, ne kërkojmë çdo rast ku Ati, Biri ose Fryma e Shenjtë është personi që kryen një veprim, ose është pjesëmarrës në të. E thënë ndryshe, ne kërkojmë për secilin rast, ku Perëndia Trini është kryefjala, i pasuar prej një foljeje që tregon veprim (p.sh. Ati *do*, Jezusi *pa*, Fryma e Shenjtë *u dha*). Në një hap të mëvonshëm të leximit tonë të Biblës, ne do t’i shohim rastet në secilin pasazh të Shkrimit të Shenjtë, ku karakteri i Perëndisë përshkruhet duke përdorur emra dhe mbiemra (ose ato që quhen folje përshkruese në koreanisht). Kurse, në këtë hap të tanishëm, fokusi ynë është në identifikimin e veprimeve të Perëndisë Trini.

Sapo t’i identifikojmë këto veprime, ne meditojmë thellë mbi secilin prej tyre. Ky nuk është kërkim për një kuptim të fshehur mistik. Ky është një reflektim mbi të dukshmen - çfarë është deklaruar plotësisht dhe qartësisht në pasazhin e Shkrimit. Nuk është një proces i vështirë. Megjithatë, me raste, vargjet mund të jenë sfiduese, ngaqë ka kohë kur veprimet e Perëndisë janë të nënkuptuara, ose Perëndia nuk deklarohet drejtpërdrejt si aktor. Për shembull, Psalmi 85:10-11 thotë:

Dashuria dhe besnikëria takohen së bashku;
drejtësia dhe paqja e puthin njëra-tjetrën.

Besnikëria buron nga toka,
dhe drejtësia sheh që nga qielli.²²⁵

Në vargun e fundit, përdoren cilësitë e Perëndisë për t’iu referuar personit të tij, p.sh. “Drejtësia” sheh që nga qielli. Këtu, psalmisti po na tregon diçka për të dyja: karakterin e Perëndisë dhe për veprimet e tij: Perëndia po sheh që nga qielli, dhe Perëndia është i drejtë. Kur psalmisti shkruan: “Besnikëria buron nga toka,” ne mund ta kuptojmë se besnikëria është pjesë e karakterit të Perëndisë.

Po çfarë do të thotë se besnikëria “buron” që nga toka? Kuptimi nuk është i dukshëm menjëherë. Hapat e përshkruar në kapitujt e mëparshëm — për Kredon e Nikeas dhe për kontekstin e Shkrimit — mund të ofrojnë ide të thella e të dobishme. Vargu mund të sjellë ndërmend mishërimin e Jezusit. Në situata të tilla, është e rëndësishme për ne që të dallojmë mes asaj që është e deklaruar qartë e në mënyrë të dukshme në pasazhin e Shkrimit të Shenjtë dhe asaj që ne jemi duke nxjerrë bazuar mbi leximin tonë të përgjithshëm. Ajo që deklarohet qartë duhet konsideruar si autoritative dhe që mund t’i zësh besë, kurse përfundimet tona gjithnjë duhet t’i konsiderojmë si subjekt për t’u rishikuar e korrigjuar.

Për shembull, kur psalmisti shkruan: “Dashuria dhe besnikëria takohen bashkë, drejtësia dhe paqja puthin njëra-tjetrën,” ne nuk duhet të angazhohemi me nxjerrjen e përfundimeve të ndërlikuara teologjike. Edhe pse atje ka të pranishme folje veprorë (d.m.th. “takoj” dhe “puth”), ne duhet të nxjerrim përfundimin më të thjeshtë të mundshëm: Psalmisti këtu është duke folur për aspektet e karakterit të Perëndisë. Tek Perëndia, dashuria e besnikëria, drejtësia e paqja gjejnë shprehjen e tyre të plotë dhe ekuilibrin e përsosur. Pastaj më vonë ne do t’i shënojmë këto mendime të

²²⁵ Psalmi 85:10-11, NIV.

thella te hapi i mëvonshëm mbi karakterin e Perëndisë, e jo te ky hapi mbi veprimet e Perëndisë.

Ashtu siç është e vërtetë për të gjithë leximin e Biblës, mendimet e thella më të mëdha nuk vijnë prej nxjerrjes së përfundimeve mbi gjërat e fshehura, por duke i kushtuar vëmendje gjërave të dukshme. Tregojnë një shaka për një burrë në Berlinin Perëndimor, i cili gjatë Luftës së Ftohtë kalonte përditë me biçikletë për në Berlinin Lindor. Ditë pas dite, vit pas viti, rojet kufitare të Berlinit Lindor e ndalonin dhe e kontrollonin burrin bashkë me biçikletën e tij, duke e ditur se ai mund të fuste gjëra kontrabandë në anën tjetër të kufirit. Megjithatë, ditë pas dite, vit pas viti ata nuk gjetën as edhe një gjë të vetme. Më në fund, kur ra Muri i Berlinit, Berlinezët Perëndimorë dhe ata Lindorë po festonin së bashku. Në turmë, rojet takuan burrin të cilin e kontrollonin përditë. Ata i thanë burrit: “Vëlla, të kontrollonim përditë ty dhe biçikletën tënde, ngaqë e dinim se ti fusje kontrabandë diçka në anën tonë të kufirit. Por nuk të gjetëm asnjëherë asnjë gjë. Tani, të lutemi na trego se çfarë fusje kontrabandë.” “Biçikleta”, u përgjigj burri.

Në të njëjtën mënyrë, qëllimi i Shkrimit të Shenjtë është ta zbulojë, jo ta fshehtë, veprimtarinë e Perëndisë. Paaftësia jonë për ta parë qartë veprimtarinë e Perëndisë në Shkrimin e Shenjtë dhe në jetët tona e ka rrënjën tek fakti që kemi dështuar për ta kërkuar atë. Në mënyrë tipike, ne e anashkalojmë atë, sikur të jemi duke kërkuar për diçka tjetër (në mënyrë tipike urdhërimet dhe bekimet), ashtu si ata rojet e kufirit që e anashkalonin biçikletën ditë pas dite e vit pas viti. Ne vetë e meritojmë qortimin më të fortë që Jezusi i dha Pjetrit: Ne nuk i kemi ndërmend gjërat e Perëndisë, por gjërat e njerëzve.²²⁶ Edhe kur fokusohemi me qëllim mbi urdhërimet e Perëndisë në një pjesë të caktuar të Shkrimit të Shenjtë, nëse bëjmë kështu përpara se të jemi fokusuar me qëllim për një kohë të gjatë mbi veprimet

²²⁶ Krahazo Mateu 16:23.

e Perëndisë në atë pasazh, me të drejtë e meritojmë qortimin. Kjo ndodh, ngaqë duke bërë kështu, ne e errësojmë të vërtetën themelore se Perëndia është një Perëndi i hirit, dhe se që të gjitha veprimet njerëzore nuk janë gjë tjetër, përveçse një përgjigje ndaj veprimtarisë së Perëndisë Trini.

Le të marrim një shembull që do ta nënvizojë pikëpamjen tonë e gjithashtu do të ilustrojë si ta ndërmarrim këtë hap në metodën tonë. Le ta përqendrojmë vëmendjen tonë tek Mateu 28:16-20. Shumë të krishterë modernë i referohen kësaj pjese të Shkrimit me emrin “Porosia e Madhe.” Kjo ndodh ngaqë, kur e lexojmë këtë pjesë të Shkrimit, ne përqendrohemi mbi atë që Krishti na urdhëron për të bërë:

Prandaj, shkoni dhe bëni dishepuj nga të gjitha kombet, duke i pagëzuar ata në emrin e Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar që t’u binden të gjitha gjërave që ju kam urdhëruar.²²⁷

Urdhërimi i Krishtit këtu është i saktë, i qartë dhe i rëndësishëm. Kjo është arsyeja që unë po e shkruaj këtë libër nga Koreja, për shembull, edhe pse kam lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por theksimi i urdhrit të Krishtit në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë si pika qendrore është një zhvillim modern. Për 1800 vitet e para të historisë së kishës, askush nuk iu referua kësaj pjese të Shkrimit të Shenjtë si “Porosia e Madhe.”

Dhe sipas kritereve që i kemi shpalosur këtu, është e preferueshme. Ngaqë, siç e kemi mësuar, Shkrimi i Shenjtë nuk është shkruar kryesisht si një zbulësë etikash. Në vend të kësaj, ai është shkruar kryesisht si një zbulësë për karakterin e Perëndisë. Meqenëse Perëndia është Perëndia i hirit, dhe ngaqë e gjithë veprimtaria njerëzore është një përgjigje ndaj veprimtarisë së

²²⁷ Mateu 28:19, NIV.

Perëndisë, ne i japim të drejtë karakterit të tij (dhe Shkrimit të Shenjtë) vetëm kur përqendrohemi tek veprimi i Perëndisë, përpara se të fokusohemi tek urdhërimet që rrjedhin prej tij. Ashtu siç do ta shohim te ky pasazh i Shkrimit nga Mateu, vetëm në këtë mënyrë mundemi ta kuptojmë drejt etikën që rrjedh prej veprimit të hirshëm të Perëndisë, dhe vetëm në këtë mënyrë mund të fuqizohemi prej lumit të hirit.

Kur përqendrohemi tek veprimi i Perëndisë te Mateu 28:16-20, ne shohim plotësinë e lumit prej të cilit rrjedh Porosia e Madhe. Aq i madh është hiri i atij lumi, saqë i tërë pasazhi i Shkrimit të Shenjtë, kur kuptohet siç duhet dhe theksohet siç duhet, mund të titullohej me të drejtë më mirë si “Pretendimi i Madh”, sesa si “Porosia e Madhe.”

“I gjithë autoriteti në qiell e në tokë më është dhënë mua,” - shpall Krishti.²²⁸

Vini re se Jezusi përdori fjalën “i gjithë.” Jezusi pretendon e shpall se atij i është dhënë i gjithë autoriteti në qiell e mbi tokë. Ai nuk deklaroi se i është dhënë “më tepër autoritet nga të tjerët”, ose “shumë ndikim.” Ai nuk thotë: “Ne mund të jemi pakica tani, por në të ardhmen unë do të kem të gjithë autoritetin dhe do t’i shpërblej ata që i durojnë gjërat ndërkohë. Ai tha se i gjithë autoriteti në kohën e tanishme është në duart e tij.

Kjo do të thotë se Jezusi ka aq shumë autoritet mbi Korenë e Veriut, sa ka edhe mbi kishën besnike.

“Si mund të ndodhë kjo?” - pyesim ne. “Njerëzit vuajnë urie në Korenë e Veriut! Të krishterët përndiqen! Jetimët e pastrehë ngrijnë së ftohti gjatë natës! Cili lloj Perëndie do të zgjidhte t’i lejonte këto mizori, pavarësisht se ai ka autoritet dhe fuqi për t’i rregulluar ato?”

Bërja e kësaj pyetjeje na tregon se jemi në shtegun e drejtë për ta kuptuar karakterin e Perëndisë. Pse? Ngaqë kjo është pyetja që njerëzit e Perëndisë e bëjnë vazhdimisht në Shkrimin

²²⁸ Mateu 28:18, NIV.

e Shenjtë,²²⁹ me këtë inkurajim: “Zot, pse i lejon të padrejtët që të lulëzojnë? Pse nuk kthehesh ta gjykosh botën e ta bësh të drejtë?” Secila prej këtyre pyetjeve është një pikë hyrjeje për në një të kuptuar më të thellë të karakterit dhe veprimit të Perëndisë, nëse ne kemi veshë për ta dëgjuar atë.

Vini re se asnjë nga autorët e Dhiatës së Re nuk e vë në dyshim se Krishti është plotësisht përgjegjës. Në fakt, ngaqë ata e dinë se Krishti ka marrë të gjithë autoritetin prej Atit të tij, shqetësohen prej zgjedhjeve që është duke bërë ai. “Pse na braktis?” - pyesin ata. “Pse nuk na e merr hakun?” Këto pyetje vlejné, vetëm nëse besojmë se i gjithë autoriteti me të vërtetë është në duart e Krishtit.

Për shumicën e historisë së kishës, siguria se që të gjitha gjërat ekzistojnë aktualisht nën autoritetin e Krishtit, ka qenë fokusi i pasazhit të Mateu 28:16-20, jo urdhërimi i vargut 18. Kjo është arsyeja se pse, nga ana historike, kur të krishterët përndiqeshin dhe burgoseshin, ata përgjigjeshin me gëzim jo të kësaj bote, dhe me dashamirësi, në vend të frikës. Ata arritën ta dinë e ta besojnë se Krishti aktualisht ka në dorë të gjithë autoritetin. Ata arritën në përfundimin se atyre nuk mund t’u ndodhte asnjë gjë të cilën Krishti nuk e kishte autorizuar personalisht.

Gjithsesi, ky pretendim është i rëndë për t’u mbartur. Shumë prej nesh mund të tundohemi që të ikim tutje, duke thënë: “E dua Perëndinë, besoj se Jezusi u ringjall prej të vdekurve, dhe besoj se bota u krijua prej dorës së Perëndisë, kurse këtë gjë nuk mundem dot ta besoj.”

Por ne nuk mundemi dot të ikim tutje prej saj. Është një deklaratë e saktë, e qartë dhe e rëndësishme e veprimtarisë së Perëndisë. Në shumë mënyra ajo është themeli i besimit të krishterë. Ne mund të besojmë se Perëndia e krijoi botën, se Jezusi është biri i Perëndisë, se gjaku i Jezusit i lau mëkatet tona dhe se Jezusi u ringjall prej të vdekurve. Megjithatë, nëse nuk

²²⁹ Krahaso Zbulesa 6:10, Habakuku 1:2, Psalmi 13:1.

besojmë se Jezusi ka të gjithë autoritetin në qiell dhe në tokë, ne nuk mundim dot ta quajmë veten të krishterë.

Pse?

Nëse nuk besojmë se Jezusi zotëron të gjithë autoritetin, atëherë ne jemi duke adhuruar një tjetër Perëndi nga ai që adhuroi kisha besnike që erdhi para nesh — dhe një Perëndi tjetër nga Perëndia i Biblës.

Shkrimi i Shenjtë dhe dëshmia e kishës besnike janë të një mendjeje me ne në këtë pikë. Jezusi na tregon se ai “i mban çelësat e vdekjes dhe të Hadesit.”²³⁰ Pjetri na tregon se Perëndia lejon që ne të vuajmë për pak kohë, dhe pastaj na ngre lart.²³¹ Pali na kujton se Perëndia na dha formën në mënyrë të përsosur neve (dhe botës përreth nesh) në atë mënyrë që deshi ai, dhe se kjo duhet të na nxitë për ta adhuruar atë, jo për t’u ankuar.²³² Të krishterët e hershëm e “kthyen botën përmbys” thjesht duke dëshmuar me besnikëri për një fuqi që ishte më e madhe nga Cezari.²³³

Vini re se theksi tek secili prej këtyre pasazheve të Shkrimit të Shenjtë është në veprimet e Perëndisë, jo në etiket e njerëzve. Jezusi nuk është se thjesht frymëzoi një revolucion të hirit. Ai e nisi atë dhe vazhdon ta ndërmarrë secilin aspekt të tij personalisht. Ai nuk na thërret ne që t’i vijmë në ndihmë atij në këtë revolucion, por në vend të kësaj kërkon që ne t’i përgjigjemi nismës së tij duke e mikpritur atë, duke dëshmuar për të, duke i pagëzuar të tjerët në të, dhe duke i mësuar të tjerët që t’i binden atij ashtu siç kemi zgjedhur të bëjmë ne. Në këtë mënyrë, ne arrijmë ta shohim se pjesa më e rëndësishme e Mateut 28:19 nuk është shprehja “shkoni tek të gjitha kombet: por lidhëza “prandaj,” e cila na kujton se veprimet tona janë gjithmonë një

²³⁰ Zbulesa 1:18, NIV.

²³¹ Krahajo 1 Pjetrit 5:10.

²³² Krahajo Romakëve 9:19-21.

²³³ Krahajo Veprat e Apostujve 17:6-7.

përgjigje ndaj veprimit të tij. Jo vetëm që i gjithë autoriteti është i tiji, por që të gjitha veprimet e pasojës në këtë revolucion të hirit janë të tijat gjithashtu. Nëse të qëndruarit besnik në krah të tij nuk na duket një rol mjaft i madh në mbretëri, ia vlen të vihet re se ishte më tepër nga sa ishin në gjendje të mblidhnin vetë apostujt.

Ashtu si apostujt pas ringjalljes së Krishtit prej të vdekurve, ne e kemi marrë Frymën e Shenjtë prej tij, dhe për këtë arsye me të vërtetë ne mund të mbetemi besnikë në krah të tij deri në fund të epokës. Ai nuk na e jep Frymën e tij, që të na fuqizojë për ta vazhduar punën e tij në vend të tij—e gjithë fuqia i përket atij, dhe ai është gjithmonë me ne—por me qëllim që ne të mbetemi dëshmitarët e tij gjithmonë besnikë, të përqendruar gjithmonë tek veprimet e tij, e jo të jemi të kënaqur tej mase ose të magjepsur prej veprimeve tona.

Kapitulli 5.

Urdhërimet e Perëndisë

Si e urdhëron Perëndia trupin e Krishtit, dhe ne duke qenë gjymtyrë të atij trupi, në këtë pjesë të Shkrimit?

Identifikimi i urdhërimeve të Perëndisë në Shkrimin e Shenjtë nuk është as i vështirë, as që kërkon kohë për t'u gjetur. Ne kalojmë përmes pjesës që po lexojmë dhe i nënvizojmë ose i theksojmë foljet hyjnore. Merr vetëm pak çaste.

Por ajo që merr një jetë të tërë të krishterë është të kuptuarit e kujt i jepet urdhërimi dhe kush e përmbush urdhërimin.

Krishti e urdhëron trupin e tij, kishën.

Në këtë, ai është si ne. Secili prej nesh gjithashtu urdhëron trupin e vet. Ne e urdhërojmë trupin tonë, për shembull, të ngrihet në këmbë, ose të ulet poshtë, të shkojë këtu apo atje, të marrë një gjë ose ta hedhë poshtë një tjetër, të flasë ose të rrijë në heshtje.

Por ne gjithashtu i urdhërojmë trupat e njerëzve të tjerë. Komandantët i urdhërojnë trupat e ushtarëve. Prindërit i urdhërojnë trupat e fëmijëve. Zotërinjtë i urdhërojnë trupat e punëtorëve.

Në këtë, Krishti nuk është si ne. Në mënyrë të habitshme, me pak përjashtime, urdhërimet e tij fokusohen në vetë trupin e tij, gjymtyrët e të cilit janë pagëzuar në të. Urdhërimet e tij janë si perla të shenjta, prandaj ai i lejon ato vetëm për ta zbukuruar nusen e tij. Ai thotë tek Mateu 7:6: “Mos u jepni qenve atë që është e shenjtë; mos ua hidhni perlat derrave. Nëse bëni kështu,

ata do t'i shkelin me këmbë, dhe do të kthehen kundër jush e do t'ju bëjnë copash.”²³⁴ Ai thotë mallkime mbi disa njerëz, i përgjigjet kërkesave e pyetjeve të të tjerëve, i dëbon demonët, dhe në fund fare i gjykon cjeptë. Por me përjashtime të pakta, për çudi, ai urdhëron vetëm trupin e tij, kishën.

Ne nuk jemi të ftuar për t'u anëtarësuar në trupin e Krishtit si shpërblim për mbajtjen e urdhërimeve të tij, as pranoemi atje me kohë prove, bazuar mbi zotimin tonë për të bërë kështu. Ne jemi përfshirë në trupin e tij, vetëm duke u pagëzuar në vdekjen e tij.²³⁵ Mbajtja e urdhërimeve të tij nuk është ajo gjë që na bën ta meritojmë ose ta mbajmë anëtarësinë tonë në të. Ne nuk i konsiderojmë këmbët tona se janë pjesë e trupit tonë, vetëm për aq kohë sa ato bëjnë atë që duam ne që ato të bëjnë. Në mes të dhimbjeve natën, kur kërciri është i thyer, kur janë paralizuar, ose kur janë plakur, ato prapë janë këmbët tona. Në mënyrë të ngjashme, ne nuk i konsiderojmë këmbët tona sikur kanë meritë, kur na aftësojnë për t'u ngritur nga vendi sipas urdhrit tonë. Kjo është ajo gjë, që supozohet të bëjnë këmbët. Jezusi thotë: “Edhe ju, pasi ta keni kryer plotësisht gjithçka që ju thanë ta bëni, duhet të thoni: ‘Ne jemi shërbëtorë të padobishëm; kemi bërë vetëm detyrën tonë.’”²³⁶

Kur këmbët tona nuk e kryejnë detyrën e tyre, a mos vallë ne i heqim ato prej trupit tonë? Natyrisht që jo. Ashtu siç shkruan Apostulli Pal:

Jo, përkundrazi, ato gjymtyrë të trupit që duken se janë më të dobëtat, janë të domosdoshme. Dhe ato gjymtyrë të trupit për të cilat ne mendojmë se janë më pak të nderuara, këtyre ne u japim nderim më të madh; dhe pjesët tona jo të paraqitshme kanë modesti më të madhe, kurse pjesët e

²³⁴ Mateu 7:6, NIV.

²³⁵ Krahaso Marku 16:16.

²³⁶ Luka 17:10 NIV.

paraqitshme nuk kanë nevojë. Por Perëndia e ka ndërtuar trupin, duke i dhënë nder më të madh asaj pjese së cilës i mungon ai, që të mos ketë përçarje në trup, por që gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën. Dhe nëse një gjymtyrë vuan, që të gjitha gjymtyrët vuajnë bashkë me të; ose nëse një gjymtyrë nderohet, që të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të.²³⁷

Kështu, edhe për ato gjymtyrë të trupit të Krishtit, që nuk i zbatojnë urdhërimet e tij, ne nuk i presim ato, as nuk i trajtojmë me përbuzje. Ashtu siç pyet Apostulli Pal: “Kush je ti që e gjykon shërbëtorin e dikujt tjetër? Për zotërinë e tyre, shërbëtorët rrinë drejt në këmbë ose rrëzohen përtokë. Dhe ata do të qëndrojnë në këmbë, sepse Zoti është në gjendje t’i bëjë ata të qëndrojnë.”²³⁸ Në vend që t’i presim këto gjymtyrë, ne kujdesemi për to, kërkojmë t’i shërojmë, kompensojmë me dëshirë për mangësitë e tyre, pa përbuzje ose fyerje, dhe i trajtojmë ato me durim. Ne, ashtu si ata, jemi gjymtyrë të trupit të Krishtit. Ai është koka. Dhe urdhërimi i tij ndaj nesh, në lidhje me gjymtyrët tona më të dobëta na kërkon madje shumë më tepër, nga sa kërkon urdhërimi i Palit që të mos i gjykojmë ato: “Duajeni njëri-tjetrin, ashtu siç ju kam dashur unë juve.”²³⁹

Sot të krishterët kanë tendencën të mendojnë për urdhërimet biblike sikur janë përgjegjësia e të krishterëve individualë për t’i përmbushur ato, sikur Bibla të ishte një udhëzues për sjelljen individuale. Por ky është një i kuptuar bashkëkohor, ai nuk është biblik. Sot, disa njerëzve iu pëlqen të përdorin shprehjen “shpirtëror, por jo fetar” për ta përshkruar veten. Ata e shohin këtë si një përshkrim të favorshëm. Me anë të kësaj shprehjeje ata duan të tregojnë se për ta besimi është një çështje private,

²³⁷ 1 Korintasve 12:22-26, NKJV.

²³⁸ Romakëve 14:4, NIV.

²³⁹ Krahaso Gjoni 13:34.

dhe se ata e praktikojnë besimin e tyre individualisht, pa u lidhur me pjesën tjetër të trupit. Prandaj, për ta është e natyrshme ta lexojnë Biblën si një manual privat për praktikimin, ose të paktën si një burim frymëzimi personal.

Por te Kolosianëve 2:18, Pali e përshkruan një sjellje të tillë si “joshpirtërore.” Ne bëhemi “jofrymërorë,” thotë Pali, kur “e kemi humbur lidhjen me kokën, prej së cilës i gjithë trupi, që mbështetet dhe mbahet së bashku prej ligamenteve dhe tendinave, rritet ashtu siç e bën Perëndia të rritet.”²⁴⁰ Atëherë, që të jesh frymëror, *do të thotë* të jesh fetar: Feja, (religjioni) vjen nga fjala në latinisht *religare*, që do të thotë “të bindësh.”²⁴¹ Të krishterët ekzistojnë vetëm të lidhur së bashku si gjymtyrë të trupit të Krishtit, nën kryesimin e tij. Krishti nuk i urdhëron individualisht të krishterët, sikur ata të ishin një konfederatë e pangjitur e njerëzve shpirtërorë në të njëjtën mendje, ku secili prej tyre kërkon që të jetë besnik. Ai e urdhëron trupin e tij *si një trup*, “i bashkuar dhe i mbajtur së bashku prej çdo nyjeje”, siç thotë Pali tek Efesianëve.²⁴²

Prandaj, kur e lexojmë Biblën, neve na drejtohet fjala, dhe bekimet dhe urdhërimet të gjithëve së bashku, prej një fjale të gjallë. Kjo është e vështirë për ne, për t’u kuptuar nga ana praktike. Si e kthen e tërë kisha “faqen tjetër”, nëse ishte faqja ime që u godit? Ose si do ta dojë e tërë kisha armikun tim, nëse armiku im është dikush në vendin tim të punës, të cilin nuk e njeh askush nga kisha ime? Me fjalë të tjera, si lidhen urdhërimet e Perëndisë edhe me mua si individ, edhe me trupin e Krishtit, ku janë të gjithë së bashku?

Kjo është një temë thelbësore në Shkrimin e Shenjtë, por shpesh ne nuk ia dalim mbanë ta vemë re atë, ngaqë ai flet në

²⁴⁰ Kolosianëve 2:18-19, NIV.

²⁴¹ S.F.Hojt (S.F. Hoyt), 1912. “Etimologjia e Fesë.” («The Etymology of Religion.») *Journal of the American Oriental Society* 32, no. 2, fq. 126.

²⁴² Efesianëve 4:16, ESV.

mënyra të cilat e ngatërrojnë të kuptuarin tonë individualist bashkëkohor. Tek 1 Korintasve 12:26 që u shënua më lart, Pali shkruan: “Dhe nëse një gjymtyrë vuan, që të gjitha gjymtyrët vuajnë bashkë me të; ose nëse një gjymtyrë nderohet, që të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të.”²⁴³Në mënyrë tipike, ne e (keq) lexojmë këtë varg, sikur Pali po jepte një urdhër, ose po deklaronte një ideal, d.m.th., “Dhe nëse një gjymtyrë vuan, që të gjitha gjymtyrët *duhet* të vuajnë bashkë me të; ose nëse një gjymtyrë nderohet, që të gjitha gjymtyrët *duhet* të gëzohen bashkë me të.”

Por kjo është pikërisht e kundërta e kuptimit që jep Pali. Kuptimi i Palit është se, kur neve na dhemb fyti, shpesh ne themi: “Jam sëmurë,” e jo vetëm thjesht “Fyti im është i sëmurë.” Në të njëjtën mënyrë, në trupin e Krishtit vuajtja e një gjymtyre konsiderohet dhe madje përjetohet si vuajtja e të gjithë trupit. Prandaj, Krishti i ringjallur mund t’i shfaqet Saulit, përndjekësit, dhe ta pyesë: “Saul, Saul, përse më përndjek?”²⁴⁴ jo: “Saul, Saul, përse je duke i përndjekur të krishterët në Jeruzalem e tani në Damask?”

Shkrimtari i Hebrenjve nxjerr përpara të njëjtën logjikë identifikimi mes anëtarit dhe trupit me këtë urdhërim: “Vazhdoni t’i kujtoni ata që janë në burg, si të ishit bashkë me ta në burg, dhe ata që keqtrajtohen, si të ishit duke vuajtur ju vetë.”²⁴⁵ Ashtu si me pasazhin më lart të 1 Korintasve 12, kuptimi i vargut humbet, nëse e lexojmë sikur thotë: “*Ju duhet t’i kujtoni ata që janë në burg, sikur ju të ishit bashkë me ta në burg, ndonëse ju nuk jeni atje.*” Kuptimi i vargut kapet saktë, nëse e lexojmë atë sikur thotë: “*Për shkak se jeni një trup, ju që jeni jashtë burgut jeni një, bashkë me ata që janë në burg; prandaj, edhe ju vetë jeni duke vuajtur bashkë me ta.*” Kjo nuk është një thirrje

²⁴³ 1 Korintasve 12:26, NIV.

²⁴⁴ Veprat e Apostujve 9:4, NIV.

²⁴⁵ Hebrenjve 13:3, NIV.

përgjëruese për të mos i harruar të burgosurit e ngratë; është një thirrje për të vepruar *sipas identifikimit me atë trup, me të cilin ne u bashkuam në pagëzim*.

Edhe për të krishterët që janë aktivë në kisha, trupi i Krishtit zakonisht është në sfond të procesit të vendim-marrjes individuale të përditshme në jetët e tyre personale. Kur vjen puna për çështje që ndodhin prapa dyerve të mbyllura, për shembull, rrallë ka një të krishterë që pyet: “Me çfarë po e lidh kishën dhe Krishtin me anë të veprimeve të mia private?” Për fat të keq, gjithashtu rrallë ka një të krishterë që e bën të njëjtën pyetje lidhur me veprimet e veta publike.

Megjithatë për Palin, pyetja etike e dukshme dhe themelore për të krishterin individual është sesi veprimet tona individuale e lidhin trupin e Krishtit, përfshirë kokën e tij, për ta nderuar ose për ta bërë të vuajë. Për shkak se jemi pjesë e trupit të Krishtit, veprimet tona, janë veprimet e tij. Në këtë mënyrë, kur bëjmë seks me një prostitutë ne e bashkojmë trupin e Krishtit me atë të prostitutës. “A nuk e dini ju se trupat tanë janë gjymtyrë të vetë Krishtit?” - pyet apostulli Pal. “Atëherë, a do t’i marr gjymtyrët e Krishtit dhe do t’i bashkoj ato me një prostitutë? Kurrë!”²⁴⁶ Në mënyrë të ngjashme, duke i shpënë në gjykata mosmarrëveshjet tona, ne e turpërojmë Krishtin, përpara botës që vëzhgon.²⁴⁷

Ne mendojmë për veprimet tona individuale sikur janë veprimet tona individuale; më së shumti ne mendojmë se veprimet tona mund t’i ndikojnë ata që njohim për të menduar më pozitivisht ose më negativisht për Perëndinë ose për kishën. Por megjithatë, Perëndia në Krishtin e ka identifikuar veten kaq plotësisht me ne, saqë ai i zotëron veprimet tona individuale si të jenë rrënjësisht veprimet e tij dhe veprimet e trupit të tij. Identifikimi është kaq absolut dhe i plotë e i prekshëm, saqë Apostulli Pal e përshkruan atë me gjuhën fizike më të mundshme tek Efesianëve

²⁴⁶ 1 Korintasve 6:15, NIV.

²⁴⁷ Krahaso 1 Korintasve 6.

5:30: “Sepse ne jemi gjymtyrë të trupit të Tij, *të mishit të Tij dhe të kockave të Tij*.”²⁴⁸

Për shkak të këtij identifikimi të plotë me trupin e tij, dhe të të gjithë trupit të tij me secilën gjymtyrë të atij trupi, Krishti mund të thotë: “Me të vërtetë ju them, se çfarëdolloj gjëje që ta lidhni në tokë do të jetë lidhur edhe në qiell, dhe çfarëdolloj gjëje që ta lironi në tokë, do të jetë e liruar në qiell.”²⁴⁹ Ky nuk është një privilegj që u jepet pak vetave të caktuar, se trupi i Krishtit është një trup priftërinjsh—secila gjymtyrë është një prift—një priftëri e të gjithë besimtarëve.²⁵⁰ Nëse jemi të shqetësuar prej shkallës së identifikimit që bën Krishti mes vetes së tij, trupit të tij dhe besimtarit individual, ne duhet të kujtohem se është vetëm ky identifikim i plotë që e bën të mundur shpëtimin: Ai vdiq për ne. Ne u pagëzuam në vdekjen e tij. Ne jetojmë vetëm në Të.

Ngaqë Krishti është thellësisht i pranishëm në veprimet tona, dhe meqë Krishti është thellësisht i pranishëm në më të voglin nga vëllezërit e motrat e tij,²⁵¹ veprimet tona kundrejt më të vegjëlve, në realitet janë veprimet e Krishtit kundër vetvetes: Krishti është ai që urdhëron; Krishti është ai që vepron; Krishti është ai që pranon veprimin. Kjo gjithashtu është e vërtetë lidhur me veprimet tona kundër besimtarëve të tjerë, që janë gjymtyrë të të njëjtit trup: Ai urdhëron; ai vepron; ai merr. Një dinamikë e ngjashme gjithashtu vepron lidhur me armiqtë tanë: Kur armiqtë tanë veprojnë kundër nesh, në të vërtetë ata janë duke vepruar kundër Krishtit, ngaqë nuk jemi ne ata që jetojmë, por ai.²⁵² Krishti urdhëron që ne të marrim e të përgjigjemi ndaj veprimeve të armikut tonë sikur ato të kryheshin ndaj tij dhe ndaj trupit

²⁴⁸ Efesianëve 5:30, NKJV, theksimi i imi.

²⁴⁹ Mateu 18:18, NKJV.

²⁵⁰ Krahazo 1 Pjetrit 2:5; Hebrenjve 4:14-16.

²⁵¹ Krahazo Mateu 25:31-46.

²⁵² Krahazo Galatasve 2:20.

të tij të përbashkët, tek i cili ne jemi vetëm një gjymtyrë, një pjesë. Një sulm mbi njërin, është sulm mbi të gjithë—ose, më mirë, mbi Njërin. Përmes nesh, armiqve tanë iu duhet ofruar mëshira e Krishtit dhe dashuria e të gjithë trupit të Krishtit. Ne duhet ta rezervojmë gjykimin deri sa Krishti të rikthehet në lavdi. Kështu, Apostulli Pal shkruan:

Mos u hakmerrni vetë, të dashur, por i lini vend zemërimit të Perëndisë. Sepse është shkruar: “Hakmarrja është Imja, unë do të shpaguej, thotë Zoti.” Dhe në të kundërtën: “Nëse armiku yt ka uri, ushqejeni; nëse ai është i etur, jepini të pijë. Sepse duke bërë kështu, ju do të grumbulloni thëngjij të ndezur mbi kokën e tij.”²⁵³

Kjo është arsyeja se përse fokusi “atomik”, d.m.th. fokusi mbi veprimet tona individuale—d.m.th., konsiderimi i veprimeve tona sikur na përkasin krejtësisht neve, sikur burojnë prej nesh, duke na dhënë lavdërim ose ndëshkim neve, të ndarë nga Krishti dhe nga trupi i tij—është mallkim për ungjillin. Çështja kryesore lidhur me drejtësinë e veprave nuk është thjesht përpjekja jonë për ta fituar miratimin e Perëndisë, por është besimi ynë se vetja jonë është e aftë për të bërë gjithçka, si të ishim aktorë të automatizuar, e jo shprehjet lokale të Adamit të Dytë, të bashkuar në çdo moment me të gjithë besimtarët e tjerë si vetë trupi i tij real.

Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, kur e lexojmë Biblën, që të mos shpikim ose të mos nxjerrim urdhërime për veten tonë individualisht. Urdhërime të tilla mund të duken të drejta dhe të nderuara për mendjen fetare individuale—urdhërime të tilla si “bindju Perëndisë” dhe “dëgjoje Perëndinë” dhe “lutu” dhe “jep” dhe “shërbe.” Ne tentojmë t’i lexojmë këto në çdo pjesë të Shkrimit të Shenjtë, duke iu vënë përpara shprehjen

²⁵³ Romakëve 12:19-20, BSB.

“ti duhet” dhe duke i trajtuar ato si urdhra me të cilat merret Perëndia. “A është ky i krishterë duke m’u bindur mua? A është ky i krishterë duke më dëgjuar mua? A është ky i krishterë duke u lutur? Duke dhënë? Duke shërbyer?” Perëndia i Biblës nuk flet ashtu, kurse perëndia që jeton në kokën tonë, i cili pretendon se është Perëndia i Biblës natyrisht që flet ashtu. Urdhërimet si ato që u përmendën këtu, fluturojnë nën “radarin” e veprave të drejtësisë së shumicës së të krishterëve, ngaqë ato tingëllojnë si veprime të përlulura, të bindura e jo si veprime që i japin të drejtë vetes. Por një vepër është gjithçka që fillon me ne dhe të cilën ne e perceptojmë si të jetë veprimi ynë i ndarë nga Krishti dhe trupi i tij—nuk ka rëndësi sesa i përlulur ose i bindur mund të tingëllojë ai. Përfundimisht, ne jemi vetëm duke iu bindur vetes sonë në këto pseudo-urdhërimet, ngaqë ne, jo Perëndia, jemi ata që i filluam urdhërimet e tilla.

Prandaj, e kundërta e veprave të drejtësisë nuk është thjesht hiri, por përkundrazi është të kapërcejmë mbi vetveten. Është ta kuptojmë se jetët dhe veprimet tona nuk janë më për ne, por janë për të tërë Krishtin, kokë e trup. Dashuria për veten është zëvendësuar nga dashuria për trupin dhe për kokën e tij. Ndërsa veprojmë, ne sjellim vuajtje ose gëzim tek ai Krishti i tërë, me të cilin u lidhëm pandashmërisht në pagëzim. Dhiata e Re na mëson se ne nuk jemi më në gjendje të veprojmë në mënyrë të pavarur nga lidhja jonë me Krishtin dhe me trupin e tij; gjithçka që bëjmë buron nga i tërë Krishti dhe i shtohet krejtësisht atij. Çfarëdo që të bëni ju, e bën edhe trupi i Krishtit. Çfarëdo që të bëni ju, e bën edhe vetë Krishti. Nëse bashkoheni me një prostitutë, ju e bashkoni Krishtin dhe trupin e tij me një prostitutë. Anasjelltas, nëse ju vuani për emrin e tij, atëherë me Apostullin Pal, ju “merrni mbi mishin tuaj ato që ende i mungojnë vuajtjeve të Krishtit, për hir të trupit të tij, që është kisha.”²⁵⁴

²⁵⁴ Kolosianëve 1:24, NIV.

Në këtë mënyrë, që të gjitha urdhërimet e Perëndisë siç jepen te Shkrimi i Shenjtë janë ftesa për të ndërvepruar me të, që nga përbrenda trupit të Krishtit, së bashku me atë trup, duke marrë pjesë bashkë në karakterin e tij, në të njëjtën mënyrë që ne marrim pjesë së bashku nga trupi i tij e nga gjaku i tij në Darkën e Zotit.

Me të vërtetë, përmes Darkës së Zotit ne trajnohemi që ta shohim e të veprojmë sipas kësaj të vërtete themelore të krishterë: *Ky është trupi, trupi, trupi...* Në pagëzim ne vdesim jo vetëm kundër vetes, por edhe kundër ndarjes: Në Darkën e Zotit ne e zëmë në mënyrë të përhershme vendin tonë në trupin e tij, të bashkuar e të mbajtur së bashku prej secilës njeje. Kjo është arsyeja se pse *kur nuk ia dalim mbanë ta dallojmë trupin*—d.m.th. ta shohim Darkën e Zotit kryesisht si një kohë për bashkësi individuale me Perëndinë dhe për ta forcuar marrëdhënien tonë individuale me të—do të thotë të marrësh pjesë në një mënyrë të padenjë. Lidhur me këtë, Apostulli Pal thotë: “Sepse ata që hanë e pinë pa dalluar trupin e Krishtit, hanë e pinë gjykim mbi veten e tyre.”²⁵⁵

Prandaj, kur i lexojmë urdhërimet në Shkrimin e Shenjtë, ne nuk u qasemi me pyetjen: “Çfarë po *më* thërret Perëndia që të bëj?” Në vend të kësaj, ne së pari e nisim duke kujtuar se kush jemi ne: Ne jemi *gjymtyrë të trupit të tij*. Veprimi i njëanshëm nga natyra është i pamundur për të krishterin. I gjithë veprimi i krishterë, nga natyra, është i shumanshëm. Është Krishti, është trupi, është i krishteri si gjymtyrë e trupit, është Krishti i pranishëm në më të vegjlit e këtyre vëllezërve e motrave, është Krishti në vëllezërit e motrat tona, është Krishti që zgjat dorën e pajtimit ndaj armiqve të tij. Ne e lexojmë secilin urdhërim me atë ndërgjegje të shumanshme, që na jepet përmes hirit të Krishtit të cilin e marrim gjatë Darkës së Zotit. Pastaj ne pyesim: “Çfarë është duke e thirrur Perëndia që të bëjë trupi i Krishtit?”,

²⁵⁵ 1 Korintasve 11:29, NIV.

dhe ne veprojmë si shprehja e plotë e atij trupi në vendin e në kohën tonë.

Anëtarësia në trup nuk mund të shprehet plotësisht përmes anëtarësisë në një shprehje institucionale lokale të tij, p.sh. Një kishë e caktuar në një denominacion të caktuar në një qytet të caktuar, me njerëz të caktuar, që ne i pëlqejmë e i zgjedhim. Ne nuk mund ta shohim një njësi të tillë e të themi: *Ky* është trupi i Krishtit, për mua.” Vetëm Krishti mund të caktojë kufijtë ndarës për trupin e tij. Dhe Krishti nuk lejon kohën ose distancën apo kombësinë për ta ndarë trupin e tij të vetëm në shumë trupa të Krishtit për rehatinë tonë ose për të kuptuarin, ose për veprime pragmatike. Ne nuk mund të themi: “Kisha koreane, kisha kineze, kisha amerikane.” Ne nuk mund të themi: “Kisha e hershme, kisha mesjetare, kisha moderne.” Ne nuk mund të themi: “Kisha lokale, kisha kombëtare, kisha globale.” Ne jemi po aq të bashkuar në secilën nyje me të krishterët kinezë të shekullit të 17të, sa jemi me të krishterët rusë të shekullit të 21të, sa edhe jemi të bashkuar me kishën e një denominacioni të ndryshëm në anën tjetër të rrugës. Krishti njeh vetëm një trup — ose, siç e rrëfejmë ne bashkë me Kredon e Nikeas, Një Kishë Apostolike, të Shenjtë Katolike. Tek ai trup i vetëm, shkruan Apostulli Pal: “Këtu nuk ka as Johebre, as Jude, as të rrethprerë, as të parrethprerë, barbar, skithas, skllav ose të lirë, por Krishti është gjithçka dhe është në të gjithë.”²⁵⁶ Përtej kohës, hapësirës, denominacionit, dhe çdo lloj kufiri njerëzor, pazgjidhshmëria e saj është shenja e autenticitetit, thotë Pali. Dhe, nëse një gjymtyrë vuan, që të gjitha gjymtyrët vuajnë me të; ose nëse një gjymtyrë nderohet, që të gjitha gjymtyrët gëzohen me të.”²⁵⁷ Nëse nuk ndodh kështu, atëherë kjo nuk është kishë.

Atëherë, kur Krishti urdhëron në Shkrimin e Shenjtë, ai është duke urdhëruar trupin e tij të vetëm, përmes kohës, hapësirës,

²⁵⁶ Kolosianëve 3:11.

²⁵⁷ 1 Korintasve 12:26, KJV.

kufijve kombëtarë dhe denominacioneve. Me anë të Darkës së Zotit, ne trajnohemi për t'i dëgjuar urdhërimet e tij të gjithë bashkë si trup, dhe prej hirit të tij misterioz, t'i kuptojmë vetë veprimet tona individuale si veprimet e të gjithë kishës dhe të Zotit të saj.

Kjo nuk do të thotë se Krishti dhe e tërë kisha varen prej nesh, që ta kryejmë saktë secilin veprim. Në fakt, krejt e kundërta është e vërtetë. Krishti dhe e gjithë kisha varen nga fakti që Krishti vetë e ka kryer secilin veprim saktësisht, dhe që ne e pranojmë atë gjë dhe i nënshtrohemi vdekjes me të cilën vdiqëm në pagëzim, që ai të mund të punojë përmes nesh me gjithnjë e më pak rezistencë prej nesh. Çështja kryesore për ne është ta pranojmë se Krishti e urdhëron trupin e vet, dhe se ne duhet ta dëgjojmë secilin urdhër nga pikëpamja e të qenit tonë si gjymtyrë brenda trupit, dhe ne duhet t'ia ofrojmë trupat tanë atij për ta përmbushur atë urdhërim përmes nesh, siç tregohet tek Romakëve 12:1-2. Ne duhet të kujtohemi se, për shkak të bashkimit tonë me kokën dhe trupin e Krishtit, i tërë Krishti është i pranishëm në veprimin tonë, për vuajtje dhe për nderim.

Prandaj, po, e tërë kisha kthen faqen, kur ne kthejmë tonën si përfaqësuesi i duhur lokal. Dhe e tërë kisha nuk e kthen faqen e saj, kur ne si përfaqësuesi i saj nuk bëjmë kështu. Kur kemi një armik në vendin tonë të punës, ai armik duhet kuptuar prej nesh se është armiku i të tërë kishës dhe i Krishtit, dhe pikëllimi ose nderimi që përjetojmë ne në duart e atij armiku i kalon kokës dhe trupit si i tërë, ndërkohë që i duam ata sipas urdhrit të Krishtit. “Përse më përndjek mua?” - e pyet Krishti armikun e vendit tonë të punës, jo “Përse e përndjek Sonilën?”²⁵⁸ (Natyrisht, ne duhet të dallojmë, nëse armiku ynë

²⁵⁸ Krahaso E. Folei, 2012. “Armiku Juaj në Fakt po Sulmon Krishtin - Jo Juve. Dhe Krishti Prapëseprapë iu Bën Mirë Atyre — Përmes Jush.” *Bërësit e Fjalës*. <http://dotheword.org/2012/01/11/your-enemy-is-actually-attacking-christ/>.

është aktualisht armik, apo nëse ai person në fakt është një shërbëtor i Krishtit, të cilin Krishti po e përdor për të na shpënë më thellë për tek vdekja ndaj vetes, në të cilën hymë përmes pagëzimit. Ndoshta janë të dyja këto gjëra.)

Prandaj, kur i dëgjojmë urdhërimet e Perëndisë, së pari ne kujtojmë se kush jemi dhe çfarë jemi ne: Ne jemi gjymtyrë të përlulura të një trupi që është duke u komanduar nga koka e tij. Një kujtim i tillë është thelbësor për ta dëgjuar fjalën siç duhet dhe për ta zbatuar atë. Kjo bëhet e dukshme, kur shqyrtojmë madje edhe një shembull të vetëm të urdhërimit biblik, të tillë si fjalët e Jezusit nga Predikimi në Mal:

Ju jeni kripa e tokës. Por, nëse kripa e humb shijen e saj, si mund të bëhet e kripur sërish? Nuk vlen më për asnjë gjë, përveçse të hidhet jashtë e të shkelet me këmbë.

Ju jeni drita e botës. Një qytet i ndërtuar mbi një kodër nuk mund të fshihet. As njerëzit nuk e ndezin një llambë për ta fshehur nën një babune. Përkundrazi, ata e vendosin atë mbi shandan dhe ajo i ndriçon të gjithë në shtëpi. Në të njëjtën mënyrë, le të shkëlqejë drita juaj përpara të tjerëve, që ata të mund t'i shohin veprat tuaja të mira dhe ta lavdërojnë Atin tuaj në qiell.²⁵⁹

Kur i lexojmë urdhrat e Krishtit duke pasur ndër mend identitetin tonë të përbashkët, gjëja e parë që zgjidhet është ndonjë pështjellim potencial mes pohimit të Jezusit tek Mateu 5:14: “Ju jeni drita e botës,” dhe pohimit të tij tek Gjoni 8:12: “Unë jam drita e botës.” Krishti është koka dhe kisha është trupi. Koka nuk mund të ndahet prej trupit. Së bashku ata formojnë atë që Agustini e quajti “Krishtin e plotë.”²⁶⁰ Në ne,

²⁵⁹ Mateu 5:13-16, NIV.

²⁶⁰ Krahaso Augustini, 1996. *Shërbesat 341-400 mbi Tema të Ndryshme*. Hyde Park, NY: New City Press, fq. 26.

janë të pranishëm drita e Krishtit dhe kisha e të gjitha epokave. Kjo prani shndërrohet kurdoherë që një gjymtyrë është në vend të shenjtë.

Bazuar mbi ato që kemi ndarë në këtë kapitull, tani ne jemi të ndjeshëm për të shmangur gjetjen e urdhërimeve në Shkrimin e Shenjtë, atje ku asnjë prej tyre nuk ekziston. Në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë, Krishti nuk na urdhëron neve: “Jini kripa e tokës. Jini drita e botës.” Këtu nuk ka asnjë urdhërim tjetër për t’u bërë diçka tjetër nga ajo që jemi bërë tashmë duke u bashkuar me të në pagëzim.

Në vend të kësaj, në këtë pasazh ka vetëm një urdhërim: “Le të shkëlqejë drita juaj përpara të tjerëve.” Është një urdhërim që ka kuptim në kontekstin e asaj që vjen menjëherë përpara saj, tek Mateu 5:11-12:

“Të bekuar jeni ju, kur njerëzit ju fyejnë, ju përndjekin dhe në mënyrë të rreme thonë gjithë të këqijat kundër jush, për shkakun tim. Gëzohuni e ngazëllohuni, sepse i madh është shpërblimi juaj në qiell, sepse në të njëjtën mënyrë i përndoqën ata profetët, që ishin përpara jush.”²⁶¹

Kur një person rrethohet nga përndjekja, tendenca e menjëhershme është për t’u fshehur, për t’u përzier me ta, për t’u bërë i sjellshëm, për t’i mohuar shokët e shoqet problematikë— *për t’u bërë sërish individual*. Por ky veprim, thotë Jezusi, do ta mposhte qëllimin e të qenit kripë e dritë, të cilët, jo rastësisht janë substanca që ekzistojnë në bashkësi. Prandaj, Krishti urdhëron që, në mes të përndjekjes, trupi i tij nuk duhet të fshihet, asnjë pjesë e tija, dhe asnjë pjesë e mesazhit që iu besua atij prej kokës. Është një trup—i lavdishëm, i shndërruar, dhe ju jeni një shprehje lokale e tij. Ai trup—dhe tani trupi juaj i vetëm prej mishi e gjaku—e ndriçon botën si kisha e tërë në një

²⁶¹ Mateu 5:11-12, NIV.

pikë të vetme, që karakteri i Perëndisë të mund të shihet kudo, dhe prej të gjithëve.

Përmes gjërave që kemi ndarë në këtë kapitull, tani ne jemi gjithashtu të ndjeshëm ndaj tendencës sonë për t'i individualizuar urdhërimet e Krishtit. Tani ne e dimë si ta shmangim nxjerrjen e urdhërimeve nga fjala e Perëndisë për veten tonë, që t'u bindemi individualisht. Fjala i drejtohet të tërë trupit besnik përmes kohës, hapësirës, kombit dhe denominacionit, dhe ne jemi pjesë e pandashme e tij. Gjithashtu ne e dimë si të shmangim nxjerrjen tonë jashtë trupit, teksa e dëgjojmë secilin urdhër, sikur të mund të bënim cilendo pjesë të tij ashtu siç synon ai, nëse do ta ndanim veten nga tërësia e trupit.

Secila “ju” dhe “juaj” në këtë pjesë të Shkrimit të Shenjtë nga Predikimi në Mal është në numrin shumë, përfshirë edhe urdhrin për ta lënë dritën “tuaj” të shkëlqejë. Kjo nuk është një thirrje ndaj të krishterëve individualë për të shkëlqyer dritën e tyre individuale, sikur atëherë së bashku ne do të bënim njëmijë pika dritë, secili në atë qoshen tonë të errët të botës, sipas drejtimit privat të Perëndisë dhe sipas dhuntive tona frymërore. Është urdhri i Krishtit që ta lejojmë dritën e vetme të shkëlqejë përmes nesh — Krishtin e plotë — të gjithin, kokë e trup, “atë besim, që ka qenë besuar kudo, gjithmonë, prej të gjithëve,”²⁶² nëpër të gjitha epokat, hapësirat, kombet dhe denominacionet. Shkëlqejeni të gjithë atë, duke mos pranuar që të bëheni *kisha siç e shoh unë*, duke jetuar *besimin siç e praktikoj unë*, duke mbajtur qëndrim për *ato pjesë të tij, që unë i konsideroj të rëndësishme dhe të arsyeshme*.

²⁶² Vinsenti i Lerinsit (Vincent of Lérins), 1894. Tek Schaff, Philip; Wace, Henry. *Një Bibliotekë e përzgjedhur e etërve të Kishës së Krishterë të Nikeas e të pas-Nikeas*. 2. 11. Përkthyer nga Çarlz A. Hërtli [Charles A. Heurtley (American ed.)]. Buffalo: Letërsi e Krishterë. [Vincent of Lérins, 1894. In Schaff, Philip; Wace, Henry. *A select library of the Nicene and post-Nicene fathers of the Christian Church*. 2. 11. Translated by Heurtley, Charles A. (American ed.). Buffalo: Christian Literature.]

Kisha e fshehtë

Identifikimi i urdhërimeve të Perëndisë në Shkrimin e Shenjtë nuk është as i vështirë, as që kërkon kohë për t'u gjetur. Mësimi për t'i dëgjuar e për t'i zbatuar ato si gjymtyrë të trupit të tij, me kokën që komandon, zbaton dhe merr, kërkon tërë jetën e krishterë.

Kapitulli 6.

Çfarë duhet të bëjmë?

Si gjymtyrë të trupit, të drejtuar prej urdhrit të Perëndisë, ne e zbatojmë fjalën sa më në mënyrë të drejtpërdrejtë që ta lejojë karakteri i Perëndisë.

Nëna e tij iu tha shërbëtorëve: “Bëni gjithçka që t’ju thotë ai.”²⁶³

Urdhri i Perëndisë na drejtohet neve vetëm në mënyrë dytësore. Në radhë të parë dhe më së shumti është një thënie lidhur me si ka vepruar Perëndia dhe si do të veprojë ai. Ajo që na thuhet neve në urdhërim është *i vetmi reagim i arsyeshëm lidhur me çfarë ka bërë Perëndia e çfarë do të bëjë*. Me fjalë të tjera, urdhri i Perëndisë është udhëzimi i tij i hirshëm, i cili na tregon sesi synon ai që ne të lëvizim në koordinim me veprën e tij, me qëllim që të mos na shtypin, por përkundrazi, që të shpengohemi, kur ai ta rregullojë botën.

Të gjitha urdhërimet e Perëndisë janë të këtij karakteri. Ne mendojmë gabimisht për Perëndinë, sikur ai rri ulur në parajsë, duke i vëzhguar qeniet njerëzore dhe duke i gjykuar veprimet e tyre si të mira ose të liga; atëherë njerëzit fitojnë dënimin ose lavdërimin, sipas rastit.

Ky i kuptuar nuk përputhet në asnjë mënyrë me karakterin e Perëndisë. Karakteri i Perëndisë është se ai e nxit të gjithë veprimin. Ai vetë po vendos rregull në botë. Ai nuk synon, që ne të lëvizim vetëm. Lëvizja sipas mendjes sonë, vetëm, në fakt është vetë përkufizimi i mëkatit. Sipas Shkrimit të Shenjtë, drejtësia e

²⁶³ Gjoni 2:5, NIV.

vërtetë do të thotë përgjigje e duhur ndaj nismave të Perëndisë. Pa Frymën e Shenjtë, kjo është e pamundur. Kurse, kur e marrim Frymën e Shenjtë në pagëzim, kjo është e mundshme.

Në fakt, është natyra e Frymës së Shenjtë që të na drejtojë në të gjithë të vërtetën.²⁶⁴ Fryma e Shenjtë na i hap Shkrimet e Shenjta dhe na udhëzon se ku të jemi e se çfarë të bëjmë, me qëllim që të jemi “në linjë” me punën e Perëndisë, ndërkohë që ai e vendos botën në rregull. Në fakt, sapo e marrim Frymën e Shenjtë, mospërgjigjja ndaj nismave të Perëndisë prodhon bindjen për mëkatin. Fryma e Shenjtë na bën me dije se jemi “jashtë linjës,” d.m.th., jemi duke ndenjur në vendin e gabuar, duke lëvizur në drejtimin e gabuar, dhe kështu do të shtypemi, kur Perëndia të vendosë rregull në botë.

Kjo është arsyeja se përse drejtësia me anë të veprave nuk është vetëm një gjë e neveritshme për Perëndinë; ajo gjithashtu është e pakuptimtë. Kur ne kërkojmë të nisim veprim, edhe sikur ai veprim të na duket se është i mirë ose i drejtë, me përkufizim ai është problematik, ngaqë vetëm Perëndia nxit veprimin shpengues. Nëse jemi ne që marrim nismën, ne nuk po ia dalim dot mbanë t'i kushtojmë vëmendje atij. Ne po e keqkuptojmë natyrën e veprimit njerëzor. Ne po e trajtojmë veprimin njerëzor sikur ai të ishte në gjendje të përmbushej në vetvete ose të ishte në gjendje të fillonte ndonjë gjë të domosdoshme për punën e Perëndisë. Ashtu siç tha Apostulli Pal: “[Perëndia] nuk shërbehet prej duarve njerëzore, sikur ai të kishte nevojë për ndonjë gjë. Përkundrazi, ai vetë i jep jetë gjithkujt dhe frymë gjithçka tjetër.”²⁶⁵

Kur ne fillojmë veprimin, madje edhe në ndonjë përpjekje për “të qenë të mirë”, kjo gjë mund të rezultojë vetëm në ne dhe të tjerët duke qenë në vendin e gabuar, duke lëvizur për në drejtimin e gabuar, dhe duke përfunduar të shtypur, ndërkohë që Perëndia bën punën e tij. Nga ana tjetër, kur veprimet tona

²⁶⁴ Krahason Gjoni 16:13.

²⁶⁵ Veprat e Apostujve 17:25, NIV.

janë si përgjigje ndaj nismave të Perëndisë ashtu siç synon Perëndia, ne nuk jemi “duke fituar” shpëtimin; ne jemi duke e përjetuar atë. Të lëvizësh në harmoni me Perëndinë do të thotë të shpëtohesh. Do të thotë të përjetosh shpëtimin. Do të thotë të veprosh ashtu si i krijoi Perëndia qeniet njerëzore për të vepruar: gjithmonë në përgjigje ndaj tij, duke pasqyruar karakterin e tij në botën e dukshme.

Kjo do të thotë se Perëndia e ka përcaktuar që çdo veprim njerëzor të jetë i pakuptueshëm dhe i paplotë në vetvete. Qëllimi është që gjithmonë të tregojë përtej vetes – drejt Zotit. Është mishëruar në vetë veprimin e Perëndisë dhe në këtë mënyrë duhet të jetë krejtësisht i varur nga Perëndia për kuptimin, fuqinë dhe plotësinë. Thelbi i mëkatit është të “veprosh në mënyrë të arsyeshme,” që do të thotë, në mënyra që janë të kuptueshme dhe të plota në vetvete dhe prej vetvetes, plotësisht të varur nga vetja jonë dhe mbi ata në sferën tonë të ndikimit për kuptim, fuqi dhe plotësim.

Me fjalë të tjera, natyra e jetës njerëzore të shpenguar është e tillë që, askush që e vëzhgon atë nuk duhet të jetë ndonjëherë në gjendje ta kuptojë atë pa iu ridrejtuar vëmendja e tyre drejt Perëndisë. Për më tutje, veprimet e qenieve njerëzore të shpenguara janë synuar gjithmonë të jenë në harmoni me njëra-tjetrën – jo vetëm në të tashmen, por përmes epokave; jo vetëm në lagjen tonë, por anëmbanë botës. Në fakt, pikërisht kur kisha në një vend e kohë të caktuar nuk mundet dot të veprojë në harmoni me kishën universale, ajo duhet të zgjedhë të kalojë në fshehtësi.²⁶⁶ Ashtu siç e vendosëm në kapitullin e fundit, Krishti e urdhëron trupin e tij të vetëm si një trup, jo qytetarë të mbretërisë, autonomë e të veçantë.

Një mënyrë e tillë veprimi është e pamundur të kuptohet ose të praktikohet nga njerëzimi i rënë. Edhe për të shpenguarit,

²⁶⁶ Krahaso E. Folei, 2017. *Mbjellja e Kishës së Fshehtë*. Seul: Zëri i Martirëve, fq. 71-77.

ne duhet të mbështetemi në atë që tregon Jezusi në kohën e tij në tokë lidhur me si t'i dëgjojmë e si t'i zbatojmë urdhërimet e Perëndisë. Jezusi tregon sesi të veprojmë gjithmonë dhe vetëm në harmoni me Atin e tij. Ky është kuptimi i Gjonit 5:19, ku Jezusi thotë: “Me të vërtetë po ju them se Biri nuk mund të bëjë asnjë gjë nga vetja; ai mundet të bëjë vetëm ato që sheh të bëjë Ati i tij, ngaqë gjithçka që bën Ati, e bën edhe Biri.”²⁶⁷ Ashtu si përgjigjja e Birit ndaj urdhërimeve të Atit e ridrejton vëmendjen për tek Ati, veprimet tona e ridrejtojnë vëmendjen e botës ndaj Perëndisë Trini.

Udhëtimi i Krishtit për te kryqi është krejtësisht i pakuptueshëm për dishepujt e tij. Madje Pjetri e qorton atë që ua shpjegoi. Jezusi i përgjigjet duke vënë re ato që i kemi ndarë këtu: Pjetri është duke kërkuar për veprime që kanë kuptim në vetvete dhe nga vetvetja për njerëzimin e rënë. Ai nuk mund ta imagjinojë të ndërmarrë asnjë gjë, që do të dështojë, po të mos ndërhyjë Perëndia:

Që nga ajo kohë e më pas, Jezusi nisi t'u shpjegojë dishepujve të tij se duhet të shkonte në Jeruzalem e të vuante shumë gjëra në duart e pleqve, kryepriftërinjve dhe mësuesve të ligjit, dhe se ai duhet të vritej dhe të ringjallej të tretën ditë.

Pjetri e mori mënjanë atë dhe nisi ta qortonte. “Kurrë Zot! - tha ai. - Kjo nuk do të të ndodhë kurrë ty!”

Jezusi u kthye dhe i tha Pjetrit: “Largohu prej meje, Satan! Ti je një gur pengese për mua; ti nuk ke ndërmend punët e Perëndisë, por thjesht punët njerëzore.”²⁶⁸

Krishti vdes në kryq. Veprimi i tij është i pakuptueshëm dhe i paplotë në vetvete dhe nga vetvetja, siç dëshmojnë reagimet e

²⁶⁷ Gjoni 5:19, NIV.

²⁶⁸ Mateu 16:21-23, NIV.

dishepujve ndaj vdekjes së tij. Por Ati e ngriti Krishtin prej së vdekurish, prej fuqisë së Frymës së Shenjtë, dhe puna e Krishtit sillet në një përfundim të lavdishëm. Në këtë ne shohim sesi Perëndia Trini synon që veprimet tona të mishërohen përbrenda të tijave dhe të jenë si përgjigje ndaj tyre. Pa veprimin e tij të mëparshëm, veprimi ynë garantohej të shpjerë vetëm në mëkat e në vdekje. Por ngaqë na është dhënë garancia se ai gjithmonë do ta nderojë fjalën e tij dhe do të veprojë sipas karakterit të tij, ne jemi të sigurt se të gjitha gjërat — edhe vdekja — do të bashkëveprojnë për mirë,²⁶⁹ dhe se asnjë gjë që ne e bëjmë me urdhrin e tij nuk do të jetë kot. Kjo është mënyra sesi duhet ta kuptojmë mësimin e Jezusit ndaj dishepujve të tij pas qortimit të Pjetrit:

Pastaj Jezusi iu tha dishepujve të tij: “Kushdo që dëshiron të jetë dishepulli im, duhet ta mohojë vetveten dhe ta marrë kryqin e vet e të më ndjekë. Sepse kushdo që kërkon ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë, por kushdo që e humbet jetën e vet për mua do ta gjejë atë.”²⁷⁰

Jezusi është duke thënë se, kur e konsiderojmë vetëm veprimin tonë për hir të Krishtit, ne shohim vetëm humbjen e jetës sonë. Por kur ne konsiderojmë gjithashtu veprimin e Perëndisë që nxit, shoqëron dhe plotëson veprimin tonë, ne gjejmë jetë, edhe sikur të na ishte dashur domosdoshmërisht ta japim jetën tonë përgjatë rrugës. Anasjelltas, kur e shohim veprimin njerëzor si të plotë dhe të kuptueshëm në vetvete, shpëtimi i vetë jetës sonë ka kuptim; megjithatë, kur i zgjerojmë lentet për t’i përfshirë veprimet e vetë Perëndisë, shpëtimi i vetë jetëve tona zbulohet se është marrëzi. Veprimet e paplota të të shpenguarve do të plotësohen prej Perëndisë; veprimet e plota të të pashpenguarve do të zhbëhen prej Perëndisë.

²⁶⁹ Krahaso Romakëve 8:28.

²⁷⁰ Mateu 16:24-25, NIV.

Prandaj, si veprojmë ne në harmoni dhe në koordinim me Perëndinë dhe me njerëzit e tij përmes kohës e hapësirës — me të “tërë Krishtin” — tekta e zbatojmë fjalën e urdhëruar në Shkrimin e Shenjtë që jemi duke lexuar?

Së pari, ne duhet të nënshtrohemi ta shohim botën ashtu si na e tregon ai se është ajo. Ne duhet të heqim dorë nga shikimi ynë dhe të bëhemi të verbër, që janë plotësisht të varur nga Fryma e Shenjtë për drejtim. Apostulli Pal e quan këtë të jetosh me anë të besimit e jo me anë të shikimit.²⁷¹ Gabimi që ne bëjmë në mënyrë tipike në përgjigjen tonë ndaj urdhrit të Perëndisë është “ta ndajmë urdhrin në formë trekëndore”: Ne përpiqemi ta pajtojmë fjalën e Perëndisë me botën ashtu siç e kuptojmë ne atë dhe me jetët tona ashtu siç i kuptojmë ne ato. Duke bërë kështu ne e reduktojmë atë që është e mundshme në atë që ne mund ta kuptojmë, ose në atë që ne besojmë se mund të pritet në mënyrë të arsyeshme prej nesh, ose në atë që ne besojmë se njerëzit e tjerë do të na tolerojnë për ta bërë. Në këtë mënyrë ne e familjarizojmë ose e zbutim Fjalën e Perëndisë. E bëjmë atë të përshtatet me jetët tona dhe me botën.

Me qëllim që të parandalojmë familjarizimin e urdhërimeve të Perëndisë, ne duhet ta marrim secilin urdhër të Shkrimit të Shenjtë *sa më fjalë për fjalë që ta lejojë karakteri i Perëndisë*. Me fjalë të tjera, ne duhet të vendosim ta zbatojmë secilin urdhër që lexojmë sa më saktë, ashtu siç është shkruar. Ne duhet ta zbatojmë atë në një mënyrë të tillë që plotësia e karakterit të Perëndisë, ashtu siç jemi në gjendje ta kuptojmë për momentin, bëhet e dukshme, d.m.th., ashtu siç e tregon Predikimi në Mal, respektimi ynë fillon që nga zemra dhe vazhdon nga ana e jashtme; nuk mund të ketë thjesht respekt vetëm nga ana e jashtme. Kur zbatimi i një urdhri saktësisht ashtu siç është shkruar në mënyrë të qartë do ta cënonte atë që Perëndia e ka zbuluar për veten e vet në Shkrimin e Shenjtë në tërësi, ne duhet t’i përdorim hapat

²⁷¹ 2 Korintasve 5:7, NIV.

e tjera të detajuar në këtë libër, me qëllim që ta kuptojmë më plotësisht se çfarë po kërkon Ai prej nesh.

Për shembull, kur Krishti thotë: “Nëse syri yt i djathtë të bën që të mëkatosh, nxirre syrin e hidhe tutje,” ne e dimë se nuk na kërkohet që ta zbatojmë fjalë për fjalë këtë urdhërim. Ne e dimë këtë, *jo* ngaqë mendojmë se nuk është praktike ta nxjerrim syrin (ndonëse nuk ka dyshim që kjo është e vërtetë), dhe *jo* ngaqë të tjerët do të shqetësoheshin, nëse ne do ta nxirrnim syrin tonë (ndonëse kjo është natyrisht e vërtetë), por ngaqë ne e dimë se karakteri i Perëndisë na ndalon që t’i trajtojmë trupat tanë sikur ata janë prona jonë që t’i gjytojme ashtu siç duam vetë. Flijimi i tij për mëkatin është biri i tij, Jezusi, jo syri ynë i nxjerrë; prezantimi i këtij të fundit si shlyerje për mëkatin e fyen sakrificën e Jezusit, të përmendur më parë. Prandaj, e dimë se nuk duhet ta marrim këtë urdhër fjalë për fjalë, por në vend të kësaj të përdorim Kredon e Nikeas, informacionin kontekstual për këtë pasazh të Shkrimit të Shenjtë, dhe meditimet e thella mbi karakterin dhe veprimet e Perëndisë në këtë pasazh e në pjesë të tjera të Shkrimit të Shenjtë për të kuptuar se çfarë po na kërkon Perëndia që të bëjmë. Për shembull, në këtë rast, në vargun që i paraprin, tek Mateu 5:28, Krishti na tregon neve se kurorëshkelja ndodh në zemër, jo në shtrat. Prandaj, ne duhet ta kuptojmë se nuk është syri i djathtë ai që shkakton mëkatin, por është zemra. Ai që e shkul syrin e djathtë dhe madje e nxjerr nga vendi edhe të majtin prapëseprapë do të jetë një skllav i mëkatit; ajo gjymtyrë që duhet shkullur është zemra.

Gabimi që ne bëjmë në këtë pikë është se e marrim të mirëqenë se, nëse Jezusi nuk është duke folur fjalë për fjalë, ai nuk është duke folur seriozisht. Në raste të tilla ne mendojmë gabimisht se në vend që të kërkojë për ndonjë veprim, ai është duke përdorur ekzagjerim me plot figura letrare për të na dhënë një mësim të thjeshtë moral si: “Kini kujdes ku i hidhni sytë.” Por, nëse e ndjekim parimin e shënuar më sipër për ta marrë secilin urdhërim

*sa më fjalë për fjalë që ta lejojë karakteri i Perëndisë, atëherë ne do të arrijmë në përfundimin se Jezusi me të vërtetë po na kërkon që të shkulim nga vendi jo sytë, por zemrat tona. Kjo mund të ndodhë vetëm në pagëzim. Jezusi nuk është thjesht duke na urdhëruar që të jemi të kujdesshëm se çfarë po shohim. Ai na nxit që të futemi në ujërat e vdekjes e të rilindjes, ku ai do të na japë një zemër të re e një frymë të re.*²⁷²

Atje ku nuk ka asnjë pengesë për ta marrë fjalë për fjalë urdhërimin e Perëndisë, ne duhet të bëjmë ashtu, edhe në ato raste kur zbatimi fjalë për fjalë nuk na duket praktik, dhe edhe në ato raste kur duke e zbatuar fjalë për fjalë urdhërimin do të vuajmë përndjekje prej të tjerëve. Një shembull në dukje kundërshtues gjendet tek Mateu 5:33-37, ku Jezusi urdhëron:

Sërisht, ju keni dëgjuar se iu tha njerëzve në kohët e lashta: “Mos e shkelni betimin, por përmbushjani Zotit betimet që i keni bërë.” Por unë po ju them, të mos bëni fare asnjë betim: as për qiellin, sepse është froni i Perëndisë; as për tokën, sepse është stoli i këmbëve të tij; as për Jeruzalemin, sepse është qyteti i Mbretit të Madh. Dhe mos u betoni as për kokën tuaj, sepse nuk mundni dot të bëni as edhe një flok të bardhë apo të zi. Gjithçka që ju duhet të thoni është thjesht “Po” ose “Jo”; çdo gjë tjetër, përveç këtyre vjen nga i ligu.²⁷³

Shembulli është kundërshtues, për shkak se të krishterët e mirë nuk kanë rënë dakord, nëse të krishterët duhet të bëjnë betime. Por nëse ne do ta zbatonim parimin e dhënë në këtë kapitull (d.m.th., merrini urdhërimet e Perëndisë sa më fjalë për fjalë të mundni, me përjashtim të rastit kur kjo e cënon dukshëm karakterin e Perëndisë), atëherë

²⁷² Krahazo Ezekieli 36:26.ve

²⁷³ Mateu 5:33-37, NIV.

çështja është e zgjidhur: Nuk ka asnjë gjë në karakterin e Perëndisë, e cila do të kompromentohej, kur ne nuk bëjmë betime; prandaj, të krishterët nuk duhet të bëjnë betime. Në shumë raste, mospranimi për të bërë betime me të vërtetë do të tërhiqte kundërshtime, dhe madje edhe përndjekje nga bota; më tej, sipas vetë gjykimit tonë, ne mund të mendojmë se nuk është praktike për ne që të bëjmë një betim (p.sh., ne mund të shqetësohemi se njerëzit do të mendojnë se ne jemi duke gënjyer, po të mos bëjmë një betim). Por asnjëra nga këto arsye nuk e tejkalon parimin gjithëpërfshirës: Merreni urdhërimin sa më të drejtpërdrejtë që të jetë e mundur, pa dhunuar karakterin e Perëndisë. Prandaj, zbatimi i fjalës tek Mateu 5:33-37 nënkupton të mos bëjmë fare betime.

Në disa raste, ne nuk do të jemi të sigurt, nëse duhet ta marrim një urdhërim fjalë për fjalë ose jo; ne nuk mund ta dimë me siguri nëse një urdhërim madje edhe ka zbatim për ne apo jo. Një shembull i shquar është urdhri i Jezusit ndaj sunduesit të ri të pasur te Marku 10:21: “Shko, shit gjithçka që ke dhe jepja të varfërve, dhe do të kesh një thesar në qiell. Pastaj eja, e më ndiq mua.”²⁷⁴ A duhet që ne ta zbatojmë këtë fjalë, apo Jezusi e synoi atë vetëm për sundimtarin e ri të pasur?

Të krishterët e mirë nuk bien dakord mbi përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje, si dhe me interpretimin e shumë urdhërimeve të tjera biblike. Kur ekzistojnë vështirësi në interpretim, ne mund t'i përdorim parimet nga ky kapitull, me qëllim që të vendosim se cili drejtim është më i miri. Në praninë e Frymës së Shenjtë dhe të kishës (në mënyrë tipike në formën e partnerëve, me të cilët mbajmë përgjegjësinë njëri-tjetrit, nga kisha jonë lokale, ose përmes mësimin nga të krishterët besnikë nëpër epokat), ne mund t'i shqyrtojmë zemrat tona që të zbulojmë burimin e parehatisë tonë lidhur me marrjen e urdhërimit fjalë për fjalë. Nëse burimi i parehatisë është vetë

²⁷⁴ Marku 10:21, NIV.

gjykimi ynë, ose shqetësimi ynë lidhur me si do të përgjigjen të tjerët, atëherë ne duhet t'i nënshtrohemi atij urdhërimit. Nëse e ndiejmë se burimi i parehatisë është hyjnor, atëherë ne duhet t'i zbatojmë mjetet e dhëna në këtë libër, që ta lokalizojmë më plotësisht atë urdhërim përbrenda këshillës më të zgjeruar të fjalës së Perëndisë.

Veprat e Apostujve 10:9-16 jep një shembull:

Afër mesditës, të nesërmen, teksa [shërbëtorët e Kornelit] ishin gjatë rrugës e po i afroreshin qytetit, Pjetri u ngjit në tarracë për t'u lutur. Atë e mori uria dhe deshi të hante diçka, e ndërkohë që po ia përgatisnin ushqimin, ai kaloi në ekstazë. Ai pa qiellin e hapur dhe diçka si një çarçaf të madh që po e zbrisnin në tokë duke e mbajtur nga të katër qoshet e tij. Ai përmbante të gjitha llojet e kafshëve katërkëmbëshe, si dhe zvarranikë e zogj. Pastaj zëri i tha atij: "Pjetër, ngrihu. Vra dhe ha."

"Në asnjë mënyrë jo, Zot! - u përgjigj Pjetri. - Unë kurrë nuk kam ngrënë asnjë gjë të papastër ose të ndotur."

Zëri i foli atij për herë të dytë: "Mos e quaj të papastër, atë që Perëndia e ka pastruar."

Kjo gjë ndodhi tri herë, dhe menjëherë çarçafi u mor lart në qiell.²⁷⁵

Teksa Fryma e Shenjtë vazhdon që ta udhëzojë Pjetrin, e ndërsa ai reflekton më tej lidhur me këshillën më të zgjeruar të Perëndisë, dhe teksa dëgjon dëshminë e Kornelit, Pjetri mbërrin në një të kuptuar të ri dhe më të thellë të urdhërimit të Perëndisë në atë vizion:

Atëherë Pjetri nisi të flasë: "Tani unë e kuptoj sa e vërtetë është se Perëndia nuk tregon anësi, por e pranon

²⁷⁵ Veprat e Apostujve 10:9-16, NIV.

nga çdo komb, këdo që i druhet atij dhe bën atë që është e drejtë.”²⁷⁶

Veprimet e Pjetrit ilustrojnë një temë që rishfaqet në Shkrimin e Shenjtë. Ne nuk duhet të mos ia dalim mbanë ta zbatojmë fjalën, për shkak të shqetësimit se mund të mos e zbatojmë atë saktësisht. Shkrimet regjistrojnë se Perëndia na dishepullizon “në lëvizje” — që do të thotë, teksa po kërkojmë me gjithë zemër për të vepruar në harmoni me të, me qëllim që ta reflektojmë sinqerisht karakterin e tij duke zbatuar fjalën e tij. Ne mund të inkurajohemi se Zoti e dishepullizon madje edhe Saulin që, kishte mendim të gabuar dhe bënte kërcënime, kur ai ishte “në lëvizje” gjatë rrugës për në Damask për t’i përndjekur të krishterët:

Atëherë Sauli, ende duke shfryrë kërcënime e vrasje kundër dishepujve të Zotit, shkoi te kryepriifti dhe kërkoi lejen prej tij për sinagogat e Damaskut, që, nëse do të gjente ndonjë që ishin nga të Udhës, qoftë burra apo gra, ai të mund t’i sillte ata të lidhur në Jeruzalem.

Ndërkohë që ishte ende rrugës, dhe erdhi afër Damaskut, befas përreth tij shkëlqeu një dritë prej qiellit. Ai ra përdhe, dhe dëgjoi një zë që po i thoshte: “Saul, Saul, përse po më përndjek?”

Dhe ai tha: “Kush je Ti, Zot?”

Atëherë Zoti i tha: “Jam Jezusi, që ti je duke e përndjekur. Është e rëndë për ty t’i biesh me shkelma hostenëve.”

Prandaj ai, duke u dridhur dhe i shtangur, tha: “Zot, çfarë do Ti që unë të bëj?”

Atëherë Zoti i tha atij: “Ngrihu dhe shko në qytet, dhe do të të tregohet se çfarë duhet të bësh.”²⁷⁷

²⁷⁶ Veprat e Apostujve 10:34-35, NIV.

²⁷⁷ Veprat e Apostujve 9:1-6, NIV.

Nuk janë të pasaktët ata që i përçmon Zoti, por krenarët;²⁷⁸ nuk janë të nxehtët ose të ftohtët ata që i pështyn nga goja e vet Zoti, por të vakëtit.²⁷⁹ Nëse ai na dishepullizon ne kur jemi në lëvizje, atëherë të vetmit të pashpresë mes nesh janë ata që rrinë në vend. Kur rrimë në vend nga frika se mos gabojmë, patjetër që do të konsiderohemi prej tij si “të ligj dhe përtacë,” jo njerëz të matur e të kujdesshëm.²⁸⁰ “Sepse sytë e Zotit vëzhgojnë kudo nëpër tokë për t’i forcuar ata, zemrat e të cilëve janë plotësisht të përkushtuara ndaj atij,” thotë shikuesi.²⁸¹ Kur zemrat tona janë plotësisht të përkushtuara ndaj atij, kur ne jemi duke kërkuar me përlulësi që t’i koordinojmë veprimet tona me të tijat, nëse jemi të nxehtë ose të ftohtë, kur e zbatojmë Fjalën e tij sa më drejtpërdrejt që ta lejojë karakteri i Perëndisë, ne mund të bëjmë kështu me mirëbesimin se ai vetë do të na drejtojë me hir për tek e vërteta e plotë.²⁸²

²⁷⁸ Krahaso Jakobi 4:6.

²⁷⁹ Krahaso Zbulesa 3:16.

²⁸⁰ Krahaso Mateu 25:26, ESV.

²⁸¹ 2 Kronikave 16:9, NIV.

²⁸² Krahaso Gjoni 16:13.

Kapitulli 7.

Karakteri i Perëndisë

***Çfarë mësuam për karakterin e Perëndisë përmes
dëgjimit dhe zbatimit të këtij Shkrimi të Shenjtë?***

Në Dhomën e Sipërme, pak përpara se të shkonte në Gjetsemani, Jezusi i lutet Atit. Fokusi i kësaj lutjeje nuk është që dishepujt e tij do të arrinin ta dallonin dhe ta përmbushnin thirrjen e tyre, as që dishepujt do të arrinin ta njihnin plotësisht e ta zbatonin atë që do Perëndia, as që dishepujt do të shpëtoheshin, as që dishepujt do të vdisnin ndaj vetes.

Në vend të këtyre gjërave, Jezusi u lut që karakteri i Atit të tij të mund t’u bëhej i njohur atyre. Jezusi e quan këtë “jeta e përjetshme”:

Pasi Jezusi e tha këtë, ai pa drejt qiellit dhe u lut:

“Atë, ora ka ardhur. Përlëvdoje Birin, që Biri yt të mund të të përlëvdojë ty. Sepse ti i dhe atij autoritet përmbi të gjithë njerëzit, që ai të mund t’u japë jetën e përjetshme të gjithë atyre që ti ia ke dhënë atij. Tani kjo është jeta e përjetshme: që ata të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezus Krishtin, që ti ke dërguar.”²⁸³

Jezusi po lutet që të përmbushet Jeremia 31:34:

“Ata nuk do të mësojnë sërish, secili fqinjin e vet, dhe secili vëllain e vet, duke thënë: ‘Njiheni Zotin,’ sepse ata

²⁸³ Gjoni 17:1-3, NIV.

që të gjithë do të më njohin Mua, që nga më i vogli i tyre e deri tek më i madhi i tyre,” deklaroi Zoti, “sepse unë do ta fal paudhësinë e tyre dhe nuk do ta kujtoj më mëkatit e tyre.”²⁸⁴

Kur të përmbushet ajo pjesë e Shkrimit të Shenjtë, atëherë “toka do të mbushet me njohurinë dhe lavdinë e Perëndisë ashtu si ujërat që mbulojnë detin.”²⁸⁵

Ne e studiojmë Shkrimin e Shenjtë, jo për ta dalluar e për ta përmbushur thirrjen tonë, as për ta njohur plotësisht e për ta zbatuar atë që kërkon Perëndia Aspirata të tilla mund të na duken aq të shenjta, sa të lënë pa frymë, por kjo ndodh vetëm ngaqë zemra njerëzore është e errësuar dhe e shtrembëruar prej mëkatit. Ajo na mashtron që të besojmë se Perëndia do urgjentisht që ne të bëhemi më fisnikë e më të vetëdijshëm për Perëndinë në egocentrizmin tonë.

Përkundrazi, Perëndia kërkon që ne ta njohim atë. Kjo nuk vjen nga vdekja e vetes sonë, por nga vdekja e fiksimit tonë për veten. Kjo është arsyeja se pse në Kopshtin e Gjetsemanisë, Krishti nuk lutet: “Asgjësoje vullnetin tënd” ose “Përfshije vullnetin tim tek yti” ose “Ma trego vullnetin tënd e më jep forcën për t’iu nënshtruar atij.” Në vend të kësaj, ai lutet: “Jo vullneti im, por yti u bëftë.”²⁸⁶ Vullneti i Perëndisë nuk është që të eliminohen të gjitha vullnetet rivale, ose që ato të shkrihen e të bëhen një me vullnetin e tij, por që të gjithë të vijnë në bindjen ndaj tij duke pasur një dëgjueshmëri të dashur e plot besim, e cila buron nga njohja e tij, ashtu siç ishte me Jezusin.

Autori i Hebrenjve thotë se Krishti “e mësoi bindjen prej gjërave që ai vuajti.”²⁸⁷ Kjo nuk do të thotë se Krishti i bëri

²⁸⁴ Jeremia 31:34, NIV.

²⁸⁵ Habakuku 2:14, NIV.

²⁸⁶ Luka 22:42, NIV.

²⁸⁷ Hebrenjve 5:8, NIV.

rezistencë vuajtjes, por përfundimisht ai iu dorëzua një Perëndie të paepur, sikur mesazhi i ungjillit të jetë “Rezistenca është e kotë.” Do të thotë se në çastin më të errët, më të pakonceptueshëm në histori, Krishti zgjodhi ta përqafonte Atin e tij, ngaqë ai e dinte se Ati i tij ishte i denjë për t’i besuar në të gjitha gjërat. Profeti Samuel thotë se bindja është më e mirë se flijimi²⁸⁸ — që do të thotë, më e mirë sesa flijimi i vetes. Perëndia nuk do që ne të vdesim. Kjo është arsyeja që Apostulli Tomas e kishte gabim kur tha: “Le të shkojmë edhe ne, që të vdesim me të.”²⁸⁹ Apostulli Pjetër ka të drejtë kur thotë se Perëndia “nuk do që askush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim.”²⁹⁰ Po të ishte qëllimi i tij vdekja jonë ndaj vetes, atëherë pendimi ynë mund të përmbushej përmes urrejtjes së vetes, turpit dhe vetëvrasjes. Por kjo nuk është pendesë. Është thjesht rezultati i pashmangshëm dhe gjithmonë fatal i egocentricitetit tonë. Profeti Isaia bërtet: “Mjerë unë! Jam i shkatërruar! Sepse unë jam një burrë me buzë të papastra, dhe jetoj mes një populli me buzë të papastra, dhe sytë e mi kanë parë Mbretin, Zotin e Plotfuqishëm.”²⁹¹ Të gjithë që e shohin Zotin flasin në këtë mënyrë. Nëse kjo ishte gjithçka që dëshiroi Perëndia, ai mund ta realizonte atë thjesht duke iu shfaqur të gjithëve, ashtu siç iu shfaq Isaia; atëherë pagëzimi mund të ishte një lloj largimi prej pranisë së tij dhe mbytje, dhe jeta e krishterë mund të ishte një veprim i vetë-urrejtjes së zgjeruar.

Në vend të kësaj, pendesa që kërkon Perëndia është ajo e llojit që ka ndërmend Jezusi, kur thotë: “Mbretëria e qiellit është si thesari i fshehur në një arë. Kur një burrë e gjeti atë, ai e fshehu sërish, dhe pastaj nga gëzimi, shkoi dhe shiti gjithçka që kishte dhe e bleu atë arë.”²⁹² Pendesa e vërtetë gjithmonë është

²⁸⁸ Krahazo 1 Samuelit 15:22.

²⁸⁹ Gjoni 11:16, NIV.

²⁹⁰ 2 Pjetrit 3:9, NIV.

²⁹¹ Krahazo Isaia 6:5, NIV.

²⁹² Mateu 13:44, NIV.

e rrënjosur në gëzim. Është e rrënjosur në zbulimin e gëzueshëm të Atij, me të cilin ne jemi një shëmbëlltyrë e rënë. Po, njohuria e shkallës së rënies sonë mundet dhe duhet të na shpjerë në pikëllim, por asnjëherë nuk duhet të na bëjë të ndihemi pa shpresë, ose të dëshpëruar ose të na çojë në shkatërrim. Dikush nuk mund të vijë në pendesë të vërtetë me anë të urrejtjes dhe hedhjes poshtë të shëmbëlltyrës së rënë, ose duke e groposur atë prej frikës se ai, shëmbëlltyra e të cilit jemi ne, është një njeri i ashpër.²⁹³ Dikush mundet të vijë në pendesë të vërtetë, duke e ruajtur si thesar shëmbëlltyrën, edhe në gjendjen e saj të rënë, dhe duke e kthyer atë me gëzim, me pritshmëri, me mirëbesim, tek ai që i bën të gjitha gjërat të reja.²⁹⁴

Kjo është arsyeja se pse qëllimi i leximit që u bëjmë Shkrimeve të Shenjta është jeta e përrjetshme, njohja e karakterit të Perëndisë. Kjo është arsyeja pse, në këtë vëllim të tanishëm, zbatimi i urdhërimeve prezantohet si një pjesë e procesit të leximit, jo si rezultati i tij ose nxitja. Kjo do të thotë se ne nuk e lexojmë Shkrimin e Shenjtë me qëllim që ta njohim atë, që të mund të zbulojmë se çfarë do ai që të bëjmë. Përkundrazi, ne bëjmë atë që ai do që të bëjmë si pjesë e njohjes që i bëjmë atij.

Pikërisht ashtu siç pyesin dishepujt: “Ç’lloj njeriu është ky?” Madje edhe era dhe valët e detit i binden atij!”²⁹⁵, ka aspekte të karakterit të Perëndisë, të cilat mund t’i njohim për ta zgjidhur nga përbrenda procesin e kërkimit për ta dëgjuar e për ta zbatuar fjalën e tij. Madje edhe ky është një aspekt i karakterit të Perëndisë. Pavarësisht nga librat e shumtë teologjikë që kërkojnë ta sistematizojnë karakterin e tij dhe ta renditin atë si një seri e cilësive filozofike – vetekzistenca e vetmjaftueshmëria, gjakftohtësia, plotfuqishmëria, sovraniteti – Perëndia nuk pranon asnjë nga këto. Ashtu sikurse R. L. Brolei (R. L. Brawley)

²⁹³ Krahase Mateu 25:24, NIV.

²⁹⁴ Zbulesa 21:5, NIV.

²⁹⁵ Mateu 8:27, NIV.

vëren, “Perëndia është një personazh, të cilin lexuesi e ndërton prej ndërthurjes së informacionit, veprimit, karakteristikave dhe vlerësimit.”²⁹⁶

Dhe kjo është mënyra sesi e kërkon ai. Ashtu siç thotë Isaia, “Me të vërtetë ti je një Perëndi që e fsheh veten, O Perëndi i Izraelit, Shpëtimtar,”²⁹⁷ Ai e ka zbuluar veten e vet plotësisht në Krishtin, e megjithatë Krishti është Perëndia që tregon shëmbëlltyra, i cili nuk ua hedh perlat derrave.²⁹⁸ Madje edhe dishepujve të tij, që e kanë shoqëruar atë nga afër për vite të tëra, ai iu drejton pyetjen: “Kush thoni ju se jam unë?”²⁹⁹ Edhe pasi ai u ngrit prej së vdekuri — në fakt, edhe kur ai u pa prej Gjonit pikërisht në parajsë — pranimi se kush është ai dhe si është ai është i ngadaltë deri në dhimbje dhe plot me gabime. Ne do të bënim mirë që ta këmbenim sigurinë tonë me përlësinë; ai është, në fund të fundit, Perëndia që shpall se emri i tij është: “Do të jem ai që do të jem.”³⁰⁰

Sidoqoftë, ne e njohim atë si Ati i atij që na urdhëron: “Ejani tek unë, të gjithë ju që jeni të lodhur e të rënduar, dhe unë do t’ju jap prehje.”³⁰¹ Ai nuk është i ngarkuar rëndë ose i lodhur prej mangësive të njohurisë sonë, por vetëm prej arrogancës, mospërfilljes, dhe mëkatit që na i heq gatishmërinë të durojmë edhe korrigjimin më të lehtë nga ana e tij, gjë që do të na aftësonte për ta njohur atë pak më mirë. Nëse e kemi synim njohjen e tij dhe të karakterit të tij, dhe nëse kemi pritshmëri se

²⁹⁶ R. L. Brolei (R. L. Brawley), 1990 *Duke u Përqendruar mbi Perëndinë: Metoda dhe Mesazhi tek Luka - Veprat e Apostujve (Rrymat e drejtpërdrejta në Interpretimin Biblik)*. [Centering on God: Method and Message in Luke-Acts (Literary Currents in Biblical Interpretation)]. Louisville, KY: Westminster John Knox Press, fq. 111.

²⁹⁷ Isaia 45:15, ESV.

²⁹⁸ Mateu 7:6, NIV.

²⁹⁹ Mateu 16:15, NIV.

³⁰⁰ Krahaso Eksodi 3:14.

³⁰¹ Mateu 11:28, NIV.

ai do të jetë besnik ndaj fjalës së tij për ta zbuluar veten përpara nesh dhe brenda nesh, dhe nëse jemi të gatshëm t'i sakrifikojmë të gjitha gjërat për madje edhe një grimcë më tepër të njohjes së tij, atëherë ai do të kënaqet për të na i plotësuar atë dëshirë. Është karakteri i tij.³⁰²

Prandaj, përpara se ta marrim Biblën për ta lexuar çdo ditë, ne duhet të lutemi: “Zot, zbuloma karakterin tënd.” Dhe përpara se ta ulim Biblën poshtë pasi ta kemi lexuar, ne duhet të lutemi: “Zot, zbuloma karakterin tënd.” Dhe në mes të leximit, teksa jemi duke e zbatuar fjalën që kemi dëgjuar (gjë që është pjesë e leximit tonë, jo rezultat i tij), ne duhet të lutemi: “Zot, zbuloma karakterin tënd.”

Dhe në të gjithë këtë, ne duhet ta vlerësojmë gjithçka që Ai zbulon. Ne nuk duhet t'ia besojmë kujtesës sonë, sepse ajo mezi zbulon përlësi ose gjykim të mirë. Në vend të kësaj, ne duhet ta shkruajmë diku atë që kemi mësuar. Ajo që shkruajmë mund të jetë aq e thjeshtë, sa edhe kopjimi i mbiemrave që janë në atë pjesë të shkrimit që lexojmë: “Zoti, Zoti Perëndi, i dhembshur dhe i hirshëm, i ngadalshëm në zemërim dhe i pasur në dashamirësi e të vërtetë; që e mban dashamirësinë për mijëra, që fal paudhësinë, shkeljen dhe mëkatin; e që megjithatë, në asnjë mënyrë Ai nuk do ta lerë fajtorin të pandëshkuar, duke e vizituar paudhësinë e etërve mbi fëmijët e nipërit e mbesat deri në brezat e tretë dhe të katërt.”³⁰³ Ose mund të jetë aq e ndërlikuar sa shkrimi i një reflektimi të zgjeruar për një revistë lidhur me kush mendojmë ne se është ai, bazuar mbi atë që ai na e ka treguar përmes një procesi, si ai që u përvijua në këtë vëllim.

Ose, ashtu si Jobi, mund të marrë formën e heqjes dorë nga ajo që dikur e shihnim pjesërisht, tani që kemi marrë diçka më të plotë;³⁰⁴ mund të jetë hedhja poshtë e një idhulli që e kishim

³⁰² Krahaso Mateu 18:19; Mateu 21:22; Marku 11:24; Gjoni 14:13; Gjoni 15:7.

³⁰³ Eksodi 34:6-7, NASB.

³⁰⁴ Krahaso 1 Korintasve 13:12.

Kapitulli 7. Karakteri i Perëndisë

bërë prej saj sipas imazhit tonë; ose mund të jetë rënia në heshtje e vetes sonë për në një qetësi të gëzuar, adhuruese të jetës së përvetshme të njohjes së Perëndisë:

“Kam dëgjuar me veshët e mi për Ty; Por tani sytë e mi të kanë parë; Prandaj tërhiqem, dhe pendohem me pluhurin dhe hirin.”³⁰⁵

³⁰⁵ Jobi 42:5-6, NASB.

PËRFUNDIMI

Tani ne kemi mbërritur në fund të metodologjisë sonë të propozuar për ta marrë Biblën në një mënyrë që na shpie në fshehtësi. Çfarë përfundimi mund të arrijmë mbi bazën e kësaj liturgjie të propozuar për jetën në kishën e fshehtë?

Specifikisht këtë: Se ne jemi shpëtuar me anë të hirit, përmes besimit.

Kjo shprehje përdoret në mënyrë tipike si një hyrje në jetën e krishterë. Dhe megjithatë, ajo që na ndihmon të kuptojmë metoda jonë e propozuar është se kjo gjithashtu është përfundimi i jetës së krishterë, bashkë me gjatësinë, gjerësinë, pikën e mesit dhe shpalosjen e saj çast pas çasti. **Shpëtimi** është më tepër sesa një shpallje juridike e Perëndisë Trini. Është përvoja e përditshme, e jetuar, përmes së cilës është themeluar kisha dhe me anë të së cilës përkufizohet ajo. Me fjalë të tjera, kisha është bashkësia e atyre që shpëtohen prej hirit, nëpërmjet besimit.

Hiri nuk është shpallja e Perëndisë, e dashurisë së Perëndisë, e faljes së Perëndisë, ose i ndonjë lloji orientimi të Perëndisë drejt nesh. Në fjalët e Karl Rahner, hiri është “vetëkomunikimi: i Perëndisë: plotësia e vetes që ka Perëndia, që na është dhënë neve. Xhorxh Vandervelde (George Vandervelde), duke e përpunuar përkufizimin e Rahnerit, shkruan:

Në hir Perëndia nuk është se thjesht bën diçka, shkakton të ndodhë diçka, jashtë qenies hyjnore. Në vend të saj, Perëndia ua dhuron qenieve njerëzore pikërisht veten e tij.

Perëndia dhuron veten e Perëndisë si Perëndi, d.m.th., si qenie e pafund. Perëndia jep realitetin e vërtetë, jetën e brendshme, hyjnore, Trinitare. Perëndia dhuron thelbin e brendshëm të qenies hyjnore mbi qeniet njerëzore. Në përputhje me këtë koncept të hirit si komunikimi i vetë qenies së Perëndisë, Rahner këmbëngul se vetëkomunikimi i Perëndisë është një proces ontologjik.³⁰⁶

Të thuash se ky është një proces ontologjik, do të thotë të thuash se është diçka që ndodh aktualisht në ne (dmth, Perëndia hyn në ne), në vend të diçkaje që thjesht ndodh rreth nesh (d.m.th., Perëndia na shpall të drejtë). Ashtu siç thotë Jezusi tek Zbulesa 3:20, ai vjen që ta bëjë shtëpinë e tij në ne. Ose, ashtu siç thotë Jezusi tek Gjoni 15:4, “Qëndroni në mua, dhe unë në ju.”³⁰⁷

Shtëpia e tij në ne, qëndrimi i tij në ne, na bashkon me të gjithë të tjerët e të gjitha kohërave dhe vendeve tek të cilët qëndron ai. Bashkësia e shenjtoreve në tempullin e tij të shenjtë.³⁰⁸ Kjo është asyeja se pse Shkrimi i Shenjtë nuk thotë se në konsumimin e të gjitha gjërave Perëndia do të jetë *gjithçka në secilin*, por në vend të saj, thotë *gjithçka në të gjithë*.³⁰⁹ Në këtë ne nuk e humbim individualitetin tonë, sikur të ishim përfshirë në ndonjë lloj kolektivi universal. Përkundrazi, ashtu siç vëren Rahneri, ne bëhemi plotësisht njeri e plotësisht vetvetja, vetëm kur ai vetëkomunikon në ne, d.m.th., kur ai qëndron në ne. Vetëm atëherë ne jemi në gjendje t’ia japim veten plotësisht atij dhe njëri-tjetrit.³¹⁰

³⁰⁶ G. Vandervelde, 1998, “Gramatika e Hirit: Karl Rahner si një Ujëndarës në Teologjinë Bashkëkohore,” *Studime Teologjike*, [The Grammar of Grace: Karl Rahner as a Watershed in Contemporary Theology,” *Theological Studies*,] 49(8):445-459, fq. 446.

³⁰⁷ Gjoni 15:4, ESV.

³⁰⁸ Krahason 1 Korintasve 6:19, Efesianëve 2:21-22, 1 Timoteut 3:15, Hebrejve 3:6.

³⁰⁹ Krahason 1 Korintasve 15:28.

³¹⁰ G. Vandervelde, 1998, fq. 447.

Besimi është të zënit besë se Perëndia do të jetë, në ne, ai që ka qenë gjithnjë dhe kudo, se ai do të bëjë, në ne, atë që ka bërë gjithmonë dhe kudo. Nuk mund të jetë besimi lidhur me faktin se Perëndia në fund do të na falë që kemi jetuar në pozitën e vazhdueshme të mosbesimit ndaj tij. Ashtu siç vëren Jezusi tek shëmbëlltyra e talentave, nëse besoni se Perëndia është një zotëri i ashpër, atëherë, do të bënit mirë që, më së pakti, të jetonit ashtu, dhe të bënit më të mirën tuaj për ta zbutur ndëshkimin që po prisni. Një person i tillë mund të presë ndëshkim, jo falje.³¹¹

Shpëtimi me hir nëpërmjet besimit nuk është gjë tjetër, përveçse një siguri se, falë Jezusit, nuk ka rëndësi se çfarë mendoni ju për Perëndinë dhe për të tjerët, dhe nuk ka rëndësi sesi reagoni ju ndaj Perëndisë dhe të tjerëve, në fund fare gjithçka do të jetë mirë për ju. Në vend të kësaj, shpëtimi me hir përmes besimit është ofrim i një jete të tërë, i llojit që përshkruhet te Kapitulli 6: e paperceptueshme nga ana njerëzore dhe në mënyrë dëshpëruese dhe të rrezikshme, e paplotë në vetvete e nga vetvetja, që kërkon nga Perëndia të kryejë atë që premtoi të bëjë, me qëllim që ndonjë pjesë e saj — cilado pjesë e saj — të durojë deri në jetën e përjetshme. Shpëtimi me hir nëpërmjet besimit do të thotë se çdo aspekt i jetës sonë mbështetet tek Perëndia Trini për të vepruar siç ka vepruar gjithnjë Perëndia Trini, vetëm se kësaj radhe përbrenda nesh; do të thotë se fati ynë tashmë është bashkuar përjetësisht me ata të çdo epoke dhe vendi, të cilët janë krejtësisht të varuar nga e njëjta gjë.

Tek 1 Korintasve 11:1, Apostulli Pal thotë: “Ndiqeni shembullin tim, ashtu si unë ndjek shembullin e Krishtit.”³¹² Kjo ndonjëherë na bën të mos ndihemi rehat, ngaqë tingëllon si çdo gjë, përveç shpëtimit me hir. Por kjo ndodh vetëm ngaqë ne nuk jemi studentë të kujdesshëm të Shkrimit të Shenjtë. Karakteristika përkufizuese e Krishtit është varësia e tij absolute

³¹¹ Krahazo Mateu 25:24-30.

³¹² 1 Korintasve 11:1, NIV.

në Atin e tij. Tek Gjoni 5:19, Jezusi thotë: “Në të vërtetë, po ju them se Biri nuk mund të bëjë asnjë gjë nga vetvetja; ai mund të bëjë vetëm atë që sheh se bën Ati i tij, ngaqë çfarëdo gjëje që e bën Ati, e bën gjithashtu edhe Biri.”

Jezusi nuk përpiqet të jetë i përsosur, ose personalisht i plotësuar. Ai thjesht i beson Atit të tij. Ai vepron me besim se Ati i tij do të jetë ai që ati i tij thotë se është, dhe se ati i tij do të veprojë ashtu siç ati i tij ka thënë se do të veprojë. Prandaj, kur themi se jemi shpëtuar me hir nëpërmjet besimit, ne jemi thirrur me të vërtetë ta ndjekim Krishtin në këtë, dhe Palin, dhe të tërë “renë e madhe të dëshmitarëve” tek Hebrenjve 11. Ajo gjë që të gjithë këta e kanë të përbashkët është pakonceptueshmëria dhe paplotësia e veprimeve të tyre nga perspektiva njerëzore. Ose ashtu siç e thotë shkrimtari i Hebrenjve te kapitulli i madh i besimit, Hebrenjve 11:

Që të gjithë këta njerëz ishin ende duke jetuar me anë të besimit, kur vdiqën. Ata nuk i morën gjërat e premtuara; ata vetëm i panë ato dhe i mikpritën nga larg, duke e pranuar se ata ishin të huaj dhe shtegtarë mbi dhe. Njerëzit që i thonë gjëra të tilla tregojnë se ata janë duke kërkuar për një atdhe të tyrin. Po të kishin menduar për vendin prej të cilit ata ishin larguar, do të kishin pasur mundësi për t’u kthyer atje. Në vend të kësaj, ata kishin mall të madh për një vend më të mirë—atë qiellorin. Prandaj Perëndia nuk ka turp të quhet Perëndia i tyre, sepse Ai ka përgatitur një qytet për ta.³¹³

Ndërsa e ndjekim Krishtin, dhe teksa e ndjekim Palin që është duke e ndjekur Krishtin, ne bëhemi, bashkë me renë e madhe të dëshmitarëve, të huaj e shtegtarë mbi dhe. Kjo nuk ndodh ngaqë Krishti po na drejton jashtë vendeve ku jetojmë e larg

³¹³ Hebrenjve 11:13-16, NIV.

tyre, ndonëse ai edhe mund ta bëjë një gjë të tillë. Përkundrazi, ndodh ngaqë ai po na drejton për në një mënyrë jetese që na bën të huaj e shtegtarë, shpesh edhe në vetë familjet tona. Ashtu siç e thotë Psalmi 69:8: “Unë jam i huaj për familjen time, një i panjohur për vetë fëmijët e nënës sime.”³¹⁴ Megjithatë, Jezusi shton tek Mateu 12:50 se ata të çdo moshe dhe vendi, që jetojnë në varësi absolute tek Ati janë bërë nëna dhe vëllezërit e tij, dhe gjithashtu edhe tanët. Kjo është jeta e të krishterit të fshehtë. Kjo është sesi marrja e Biblës na drejton për në fshehtësi, në atë mënyrë sesi e kemi përdorur atë term në këto tre vëllime; që do të thotë jo duke qenë të fshehur, por përkundrazi duke mos qenë të varur prej sistemeve dhe strukturave prej të cilave ne jemi bërë të huaj prej Krishtit.

Ne e nisëm këtë vëllim, te Kapitulli 1, me pranimin se sakramenti i pagëzimit fillon udhëtimin tonë si të huaj në botë. Ne po e mbyllim këtë vëllim me pranimin se sakrameti i Darkës së Zotit na ushqen gjatë atij udhëtimi në fshehtësi. Ka edhe shumë gjëra të tjera për t’u shënuar lidhur me Darkën e Zotit, nga sa e lejon tema e tanishme, por do të bënim mirë ta shënonim të paktën këtë: Ashtu si Izraeli hëngri bukën me nxitim gjatë largimit të tyre prej Egjiptit,³¹⁵ po ashtu edhe neve na është dhënë buka e trupit të Krishtit për të na mbajtur gjallë gjatë eksodit tonë. Të krishterët e mirë mund të mos bien dakord lidhur me në cilën mënyrë na jepet trupi i tij neve gjatë Darkës së Zotit. Por ajo që është e qartë nga Shkrimi i Shenjtë është se ne nuk mund të mbahemi në jetën e shpëtimit me hir përmes besimit, çast pas çasti, thjesht me anë të shpalljes nga ana juridike e Perëndisë, ose nga dashuria e Perëndisë, apo prej faljes së Perëndisë, ose prej ndonjë lloji orientimi të Perëndisë ndaj nesh, ose prej ndonjë gjëje që Perëndia mund ta bëjë jashtë vetes së tij dhe jashtë nesh. “Po qe se nuk e hani mishin e Birit të Njeriut dhe nuk

³¹⁴ Psalmi 69:8, NIV.

³¹⁵ Krahazo Ligji i Përtërirë 16:3.

e pini gjakun e tij,” - thotë Krishti tek Gjoni 6:53,” - “ju nuk keni jetë në ju.”

Me fjalë të tjera, ju nuk mund të merrni vetëm dashurinë e tij, ose faljen e tij ose shpalljen e tij juridike. Ju duhet ta merrni të gjithin Atë. Kur ju e merrni Atë, Ai vazhdon të veprojë ashtu siç ka vepruar gjithmonë, vetëm se tani vepron përbrenda jush, ndërsa ju jeni të bashkuar me të gjithë ata prej çdo epoke dhe vendi, që kanë pasur mall pikërisht për këtë gjë, sipas Shkrimit të Shenjtë.

KISHA E FSHEHTË

Kishat në botën e lirë kanë pasur shumë përparësi për t'u rritur si kisha sa më të mëdha, të përqendruara, e sa më profesionale që mundën. Ky model e ka fuqizuar rritjen e kishës për dekada të tëra.

Por jeta po ndryshon shpejt për të krishterët anëmbanë botës. Qeveritë gjithnjë e më tepër po e kufizojnë mesazhin e kishës. Publiku i gjerë gjithnjë e më shumë e portretizon kishën si një shtypëse të rrezikshme, e cila përhap urrejtje dhe kufizon lirinë. Bota po kërkon t'i bindë të krishterët, që t'i rishikojnë besimet themelore të kishës. Kishat që bëjnë rezistencë hasin tallje, kufizim, ndëshkim dhe përjashtim.

Kishat e mëdha, të përqendruara dhe profesionale ishin të përshtatura mirë për të lulëzuar në epokën e mëparshme, por ato nuk janë të përshtatura aq mirë për të mbijetuar në epokën e tanishme. Qëllimi i këtij libri është t'i ndihmojë pastorët, drejtuesit e kishave dhe të krishterët e zakonshëm për të mbjellë kisha të fshehta dhe për t'i kaluar kishat ekzistuese në fshehtësi.

Armiqësia ndaj kishës në botën e lirë u parashikua më shumë se 40 vjet më parë prej Të Përndershmit Riçard Vurmbrand (Rev. Richard Wurmbrand), themelues i Zëri i Martirëve. Ai shkroi një pjesë të këtij libri për t'i ndihmuar kishat të përgatiten për vështirësitë, që kanë filluar të vijnë mbi to.

ERIK FOLEI (ERIC FOLEY): Pastori Erik Folei është bashkëthemeluesi [së bashku me gruan e tij, Dr. Hjun Suk Folei (Dr. Hyun Sook Foley)] dhe Drejtori Ekzekutiv i Zëri i Martirëve në Kore. Te ZIM Koreja ai mbështet punën e të krishterëve të përndjekur në Korenë e Veriut, Kinë dhe anëmbanë botës, duke përhapur praktikën e tyre të dishepullizimit kudo në botë.

RİÇARD VURMBRAND (RICHARD WURMBRAND): Pastori Riçard Vurmbrand (1909 – 2001) ishte një shërbyes ungjilltar, i cili duroi 14 vjet burgim dhe tortura gjatë komunizmit në atdheun e tij, Rumani. Pas lirimit të tij nga burgu, ai bashkëthemeloi (së bashku me gruan e tij, Sabina Vurmbrand) dhe krijoi një rrjet me mbi 30 zyra të Zëri i Martirëve anëmbanë botës.